

AGJËRIMI,  
ADHURIMI I VESHUR ME FALJE



AGJËRIMI,  
ADHURIMI I VESHUR ME FALJE

**M. Fethullah Gylen**

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Ndalohet shumëfishimi, botimi, fotokopjimi dhe depozitimi elektronik, mekanik apo me anë të ndonjë sistemi tjetër regjistrimi i teksteve dhe figurave të krejt librit apo të një pjese të tij, pa leje me shkrim nga shtëpia botuese.

**M. FETHULLAH GYLEN**  
**AGJËRIMI, ADHURIMI I VESHUR ME FALJE**

**Titulli i origjinalit në turqisht:**  
**GUFRANLA TÜLLENEN İBADET**

Kolana e librave për fëmijë - PRIZMI

Përktheu: Arjan Dodona

Grafika: Indrit Isufi

ISBN: -----

Shtëpia Botuese “ZAMBAKU”  
Adresa: Bulevardi Zogu I  
Pallati 63, Nr. 12

[www.zambaku.al](http://www.zambaku.al)

## PËRMBAJTJA

Në vend të një hyrjeje.....	4
-----------------------------	---

### PJESA E PARË

#### TRE MUAJT DHE RAMAZANI

<b>A. TRE MUAJT .....</b>	<b>7</b>
1. Tre muajt: Prerja e bekuar e kohës .....	7
2. Virtyti i tre muajve.....	11
<i>Muaji Rexhep .....</i>	<i>11</i>
<i>Muaji Shaban .....</i>	<i>12</i>
3. Të përfitosh nga tre muajt.....	14
<i>Programe të përshtatshme për shpirtin e fesë.....</i>	<i>15</i>
<b>B. MUAJI I RAMAZANIT DHE VIRTYTI I TIJ .....</b>	<b>16</b>
1. Adhurimi i veshur me falje.....	16
2. Kuptimi i fjalës Ramazan .....	19
3. Virtyti i muajit të Ramazanit.....	19
<i>Tre vetë e humbasin mundësinë .....</i>	<i>19</i>
<b>C. Vlerësimi i Ramazanit.....</b>	<b>24</b>
1. Përgatitja me mendim për Ramazanin .....	24
2. Mbajtja e agjërimit.....	24
3. Kalimi i kohës duke qenë i zënë me Kuranin .....	25
<i>Mukabeleja e Ramazanit.....</i>	<i>25</i>
<i>Kurani Famëllartë duhet të lexohet siç e meriton ai.....</i>	<i>25</i>
4. Namazi i teravive.....	29
5. Itikaf-i.....	30
6. Të ndash në rrugën e Allahut.....	33
7. Shtimi i punëve të mira.....	34
<i>Ta mbash gjallë gjithë muajin e Ramazanit .....</i>	<i>34</i>
8. Shtrimi i sofrave të iftarit edhe për të tjerët.....	36

<b>D. Nata e Kadrit.....</b>	<b>38</b>
1. Koha e natës së Kadrit.....	40
2. Vlerësimi i natës së Kadrit .....	42
<b>E. Sadakaja e Fitrit.....</b>	<b>43</b>
<b>F. Dieta .....</b>	<b>44</b>
<b>G. Bajrami i Ramazanit.....</b>	<b>44</b>
1. Mendimet e Bajramit.....	44
2. Dimensio­ni shpirtëror i Bajramit.....	48
<i>Bajramet tona .....</i>	48

## PJESA E DYTË

### TRE MUAJT DHE RAMAZANI

<b>A. Rëndësia e agjërimit në Islam .....</b>	<b>50</b>
Ramazani dhe ribati.....	51
<b>B. Përshkallëzimi i urdhërimeve të agjërimit.....</b>	<b>52</b>
<b>C. Agjërimi në Kuranin Fisnik.....</b>	<b>53</b>
Ata që nuk agjërojnë dot.....	53
Marrëdhëniet familjare në natën e agjërimit.....	53
Koha për të filluar agjërimin .....	54
Zëvendësimi i agjërimit dhe e vërteta historike .....	54
Shpërblimi i agjërimit .....	54
<b>D. Pranimi i agjërimit si dietë a shlyerje e gabimeve.....</b>	<b>54</b>
<b>E. Agjërimi në hadithe.....</b>	<b>56</b>
Shpërblimin e agjërimit e ka në dorë Allahu.....	57
Agjërimi është zekati i trupit .....	58
Agjërimi nuk ka të barabartë.....	58
<b>F. Llojet e agjërimit.....</b>	<b>59</b>
1. Agjërimet e detyrueshëm .....	59
a. <i>Agjërimi i Ramazanit.....</i>	59
b. <i>Zëvendësimi i agjërimit të Ramazanit.....</i>	59
c. <i>Agjërimi i faljes së agjërimit të prishur.....</i>	60
2. Agjërimet e domosdoshme .....	60
a. <i>Agjërimi i kushtimit.....</i>	60
b. <i>Zëvendësimi i agjërimit nafile.....</i>	61
3. Agjërimet nafile .....	61

<i>a. Agjërimi i Daudit (a.s.)</i> .....	61
<i>b. Agjërimi të hënë-të enjte</i> .....	62
<i>c. Agjërimi tri ditë në çdo muaj</i> .....	62
<i>d. Agjërimi i Dhulhixhes dhe i ditës së Arefesë</i> .....	63
<i>e. Agjërimi i Sheualit</i> .....	64
<i>f. Agjërimi i ditës së Ashures</i> .....	6
<i>g. Agjërimi i mbajtur gjatë muajve "Haram"</i> .....	64
<i>h. Agjërimi i mbajtur në muajin Shaban</i> .....	65
4. Agjërimet e ndaluara .....	65
<i>a. Agjërimet e mbajtura rresht</i> .....	65
<i>b. Agjërimi i mbajtur përditë</i> .....	65
<i>c. Agjërimi i mbajtur në ditën e dyshimit se ka hyrë Ramazani</i> .....	66
<i>d. Agjërimi i mbajtur në ditët e bajramit dhe ato të teshrikut</i> .....	66
<i>e. Agjërimi i mbajtur vetëm ditën e premtë</i> .....	67
<i>f. Agjërimi në periudhat e menstruacioneve dhe lehonisë</i> .....	67
<b>G. Çështjet që duhet të ketë kujdes një agjërues</b> .....	<b>67</b>
1. Çështjet që duhet treguar kujdes në syfyre .....	67
2. Çfarë duhet pasur kujdes në iftar .....	6
3. Qëndrimi larg të këqijave .....	70
<i>a. Ruajtja e syve</i> .....	71
<i>b. Ruajtja e gjuhës</i> .....	71
<i>c. Ruajtja e veshëve</i> .....	72
<i>d. Ruajtja e të gjitha shqisave të jashtme dhe të brendshme</i> .....	72
4. Mbajtja e përsinqertë e agjërimit .....	73

## PJESA E TRTË

### PËRFITIMET E AGJËRIMIT

<b>A. Përfitimet e individit</b> .....	<b>75</b>
1. Të mëson durimin .....	75
2. Edukon egon .....	76
3. Është mburojë ndaj mëkateve .....	78
4. E bën shpirtin të fitojë pjekuri .....	81
5. E lartëson njeriun drejt engjëllorës .....	82
6. Të mëson vlerën e mirësive .....	84
7. Forcon lidhjen me Allahun .....	85

8. Të kujton takimin me Allahun.....	85
9. Është i mirë për shëndetin .....	86
10. Të mëson me ekonominë.....	87
11. Përfton meritën për mirësi të përjetshme .....	88
12. Të mëson besnikërinë ndaj amanetit.....	89
13. Të mëson besnikërinë dhe mirënjohjen .....	90
14. Të mëson të mos kesh pritmëri.....	91
15. Të përfton sekretin që Allahu nuk ka nevojë për asgjë dhe çdo gjë ka nevojë për Allahun.....	92
16. Të mëson me disiplinën.....	93
<b>B. Përfitimet e shoqërisë .....</b>	<b>95</b>
1. Bën të mundur përbashkimin dhe bashkëjetesën .....	95
2. Të kujton gjendjen e të varfrit .....	96
3. Parandalon lypjen .....	97

## PJESA E TRTË

### ÇËSHTJE TË NDRYSHME NË LIDHJE ME RAMAZANIN DHE AGJËRIMIN

<b>A. Agjërimi gjatë tre muajve .....</b>	<b>97</b>
<b>B. Mosmarrëveshja në lidhje me vendin e lindjes së hënës .....</b>	<b>99</b>
<b>C. Kalendari hënor në adhurime .....</b>	<b>100</b>
<b>D. Agjërimi në pole .....</b>	<b>100</b>
<b>E. Lidhja e djajve gjatë Ramazanit.....</b>	<b>101</b>
<b>F. Ramazani: Një mysafir me naze .....</b>	<b>102</b>
<b>G. Përgatitjet për në Ramazan .....</b>	<b>102</b>
<b>H. Pritja me dëshirë të paduruar të Ramazanit të ardhshëm .....</b>	<b>103</b>
<b>I. Ta ndiesh të gjithë Ramazanin me tërë thellësinë e vet.....</b>	<b>104</b>
<b>J. Agjërimi me besim .....</b>	<b>106</b>
<b>K. Darkat gjithë madhështi të iftareve.....</b>	<b>108</b>



### *-Në vend të një hyrjeje-*

Sado thellë që të shkohet në thellësitë e historisë, në të gjitha bashkësitë dhe shoqëritë njerëzore do të vërehet prania e një mendimi fetar. Madje, kjo mund të haset edhe në komunitetet më primitive.

Fjala “din” (shih: fe), e cila është një fjalë arabe, bart kuptimin e rrugës, bindjes, si dhe të dhënies së ndëshkimit ose shpërblimit. Të tria kuptimet që janë të ngërthyera në thelbin e kësaj fjale, janë të pranishme edhe në përkufizimin e fesë. Ajo është një rrugë, një rrugë kryesore, një bulevard. Ajo është rruga në të cilën ka bindje ndaj Zotit. Dhe, poende, në të ka dy rrjedhoja, si shpërblimi për atë që bindet dhe e ndjek atë dhe ndëshkimi, për atë që nuk bindet dhe nuk e ndjek.

Ndërsa në terminologji feja përkufizohet si “tërësia e ligjësive hyjnore që i shtyn drejt së mirës dhe të mbarës ata që kanë arsye”. Feja u drejtohet njerëzve me arsye. Dhe njerëzit binden me vullnetin e tyre. Feja, i hap derën mendjes, përdor siç duhet vullnetin dhe nuk e privon atë nga mundësia për të zgjedhur. Ndërsa pika drejt së cilës i drejton feja njerëzit është e mira absolute.

Këtë udhëzim feja e bën para së gjithash nëpërmjet aspektit të saj të besimit. Vetëm përmes mendjes, njeriu mund të konceptojë se është dikush që i ka krijuar, atë vetë dhe tërë gjithësinë. Mirëpo, ai arrin të ketë besimin dhe bindjen e duhur vetëm kur dëgjon zërin kumbues të një profeti, atë zërin që e mbështet edhe pranimi në vetë ndërgjegjjen e tij. Ai profet ka ardhur me provat dhe argumentet që tregojnë se ai është i ngarkuar me detyrë nga Zoti i Madhërisëm. Dhe, nëse krahas qindra mrekullive të treguara, ka sjellë edhe një libër mrekullia e të cilit do të vazhdojë gjer në kiamet, atëherë do të thotë se për atë nuk ka më kurrfarë dyshimi. Në saje të atij libri besimtari mëson se si duhet

besuar tek amshimi (shih: jeta e përtėjme, ajo botë, përjetësia) dhe kaderi (shih: fati, (para)caktimi hyjnor, dija hyjnore) dhe në çfarë tjetër i duhet të besojë dhe po në të, vetë ai profet do t'i mësojë çështjet që kërkojnë shpjegim, duke ia shpjeguar një e nga një.

Që një bësım i këtillë të mund të qëndrojë në zemra përherë i freskët dhe të mos prishet e amortizohet, kjo varet nga adhurimet. Nëpërmjet adhurimeve besimi mund të qëndrojë gjithmonë i ri e i pavjetëruar. Njeriut pa adhurime, pas një farë kohe, nuk i mbetet vetëmse mburrja me të vjetërit që kanë ikur e janë tashmë nën dhë, përse i përket pasionit dhe emocionit të besimit.

Për rrjedhojë, çdokush që e fal namazin, shkon në haxh, jep zekatin, agjëron dhe kryen detyrën e udhëzimit në të mirë dhe parandalimit të së keqes, duhet t'i vlerësojë më së miri fuqinë dh dinamikat shtytëse dhe përforcuese, sipas adhurimit që kryen, në mënyrë që të mund ta fiksojë e perçinosë besimin e vet. Sepse adhurim do të thotë shprehja më e patëmetë e të qenit i Adhuruar i Zotit dhe rob i njeriut. Ai është i përbërë nga rregullimi i sjelljeve sipas ekuilibrit Krijues-krijesë.

Një tjetër anë e fesë, ka të bëjë me veprimet e njeriut. Jeta jashtë e njeriut që beson duhet të jetë e rregulluar në përputhje të plotë me kënaqësinë e Allahut. Morali dhe principet e tregtisë duhet të përshtaten në përputhje me kriteret e Tij. Sepse, vetëm kështu, duke braktisur dëshirat dhe kërkesat e egos së vet, njeriu mëson se si t'u përulet urdhrave dhe kërkesave të Allahut.

Me pak fjalë, feja është një tërësi, e cila nuk pranon as copëzim, as ndarje në pjesë. E ajo që pranon copëzim, apo ndarje në pjesë, asesi nuk mund të quhet fe. Ajo është si një pemë; çështjet që kanë të bëjnë me besimin janë rrënjët, çështjet lidhur me adhurimin degët, sjelljet lulet, qortimet e ndëshkimet mbrojtësit, e aspektet si uirdet dhe dhikri (shih: përmendja e Zotit) elementët që e ushqejnë atë nga poshtë dhe nga lart. Ja pra, feja, e cila përbën një tërësi të pandashme, është tërësisht e bërë e ditur nga Allahu dhe e shpallur e mësuar nga profetët.

Feja ka një metodologji (usul - kriteret e besimit) dhe rregulla anësore

(furu - që kanë të bëjnë dhe rregullojnë sjelljet dhe veprimet e njeriut). Në metodologji, kurrsesi nuk mund të bëhet fjalë për ndryshime. Përsa i përket asaj, mes kritereve të besimit në kohën e Ademit të nderuar (a.s.) dhe atyre tonave sot nuk ka asnjë dallim. Këto kritere janë të njëjta në të gjitha fetë qiellore. Madje, kjo njëjtësi ekziston njëfarësoj edhe tek adhurimi. Sepse nuk ka pasur asnjë fe të vërtetë, në të cilën të mos ketë pasur adhurim. Vetëm aspekti i formës së adhurimit, ka ndryshuar sipas periudhës. Allahu (xh.sh.) i ka ngarkuar njerëzit e çdo periudhe sipas kapacitetit dhe vetëdijes së tyre. Forma mund të ndryshojë, por përsa u përket kritereve të besimit, domethënia (shih: përmbajtja) e adhurimit nuk ndryshon.

Në çështjet që kanë të bëjnë me sjelljet njerëzore ka ndodhur që profetët t'i ndryshojnë ligjet dhe rregullat, ose thjesht një pjesë të tyre. Në këtë pikë gjithmonë ka pasur ndryshime. Dhe kjo lidhet me rrugëtimin e njerëzimit drejt përkryerjes, sa vjen e duke u pjekur.

Ky ndryshim ka ndodhur, në çdo periudhë, edhe në disa prej imtësive (shih: detaje) e agjërimit, që është një prej këtyre adhurimeve.

Fjalët në Kuran, “O ju që besuat! Agjërimi është detyrim edhe për ju, ashtu si për ata përpara jush, që ju të ruheni (nga mëkatet)” dhe përmendja e agjërimit të Daudit të nderuar (a.s.) e Profetit tonë (sal’lallahu alejhi ues’sel’lem) në një nga hadithet e Tij, janë ndër provat më të qarta, që adhurimi i agjërimit ka qenë i pranishëm edhe në fetë hyjnore që kanë sjellë profetët e mëparshëm.

Sipas transmetimit, agjërimi i parë ka nisur me Ademin e nderuar (a.s.). Ademi (a.s.) agjëronte në ditën 13, 14 dhe 15 të çdo muaji. Sulejmani (alejhis’selam) ka qenë në agjërime në fillim, në mes dhe në fund të çdo muaji; që ka agjëruar tri ditë çdo muaj thuhet edhe për Ibrahimin e nderuar (a.s.). Po ashtu dihet se edhe popujt e vjetër, si keltët, meksikanët, peruanët, babilonasit dhe asirët, i kanë kushtuar rëndësi agjërimit.

Te hebrenjtë agjërimi është tregues i pendesës ndaj mëkatit; pendimi kryhet duke agjëruar. Shpresohet që agjërimi i mbajtur të bëhet

shlyerje e mëkateve të kryera dhe në saje të kësaj pritjet edhe pastrimi syresh. Nganjëherë, kur mbi shoqërinë pllakos ndonjë farë fatkeqësie natyrore, agjërohet edhe me mendimin se fatkeqësia mund të ketë ardhur si pasojë e mëkateve të njerëzve. Në të njëjtën kohë, agjërimi është edhe një shenjë zie. Ditët më të kobshme të historisë së hebrenjve përmenden së bashku me agjërimin e mbajtur në to.

Adhurimin e agjërimin e hasim edhe në Krishterim - edhe pse jo si në Islam. Në Dhiatën e Re ka shumë të dhëna që Isai i nderuar (a.s.) dhe apostujt e tij kanë mbajtur agjërim. Të krishterët agjërojnë edhe që agjërimi i tyre të shërbejë si shlyerje e mëkateve, edhe që nëpërmjet tij të mbahen nën kontroll dëshirat egoiste të njeriut. Përveç të sëmureve, fëmijëve, ushtarëve dhe punëtorëve që bëjnë punë të rënda, çdo të krishteri tjetër i është ngarkuar agjërimi. Isai i nderuar (a.s.) u jep apostujve të tij këto këshilla në lidhje me agjërimin:

“Kur të mbani agjërim, mos e prishni fytyrën, duke i shtuar përvujtëni, siç bëjnë hipokritët. Sepse ata fytyrën e varin që t’u tregojnë njerëzve se janë duke agjëruar. Në të vërtetë, unë mund t’ju them se ata e kanë marrë shpërblimin që prisnin. Kurse ti, kur të mbash agjërim, laje dhe lyeje fytyrën me vajra. Asisoj që, agjërimin t’ia tregosh Atij që nuk duket dhe jo njerëzve dhe Ai që është i fshehtë e nuk duket, ka për të të dhënë ty një shpërblim të dallueshëm prej të gjithëve.”

Agjërim ka edhe në fetë e shfaqura në Gadishullin Indian, si ajo hinduiste, budiste, Zhain dhe Sih. Por agjërimi te këto fe është një adhurim që prek vetëm klasën e klerit.

Nocioni i agjërimin ka qenë i pranishëm edhe ndër arabët e Kohës së Injorancës. Madje, i Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ues’sel’lem) ka mbajtur syresh agjërimin e mbajtur në ditën e ashures, madje mbajtjen e tij ua ka urdhëruar edhe të tjerëve. Ja se si na e përcjell ibni Abasi (radijallahu anhuma):

“Kur mërgoi në Medinë, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ues’sel’lem) pa se hebrenjtë agjëronin gjatë ditës së ashures. Pyeti dhe i dhanë këtë përgjigje: ‘Sot është një ditë e mirë. Si sot, Allahu i Lartësuar

i shpëtoi Musain (alejhis'selam) dhe hebrenjtë nga armiqtë. Prandaj, ditën e sotme Musai (alejhis'selam) e ka kaluar duke agjëruar. Aty, i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) tha: 'Unë jam më afër Musait sesa ju' - dhe urdhëroi që në ditën e ashures të agjërohej."<sup>1</sup>

Ndërsa, një transmetim tjetër është kështu:

"Në periudhën e injorancës, Kurejsi agjëronte në ditën e ashures. Para se të shpallej i detyruar agjërimi i Ramazanit Profeti ynë i Nderuar (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) u pati urdhëruar sahabëve të Tij, që edhe ata të agjëronin në ditën e ashures, njësoj siç bënte edhe Ai. Kur u bë i detyrueshëm agjërimi i muajit të Ramazanit, për ditën e ashures i pati këshilluar: 'Kush të dojë të agjërojë, kush të dojë të mos agjërojë.'"<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> Buhari, *saum* 69, menakibu'l-ensar, *tefsiru'sure* (10) 2, 1; Muslim, *sijam* 127, 128.

<sup>2</sup> Shih: Buhari, *saum* 113; *sijam* 113, 116



*PJESA E PARË*



*TRE MUAJT DHE RAMAZANI*





## A. TRE MUAJT

### *1. Tre muajt: Prerja e bekuar e kohës*

Tre muajt kanë një shije, një aromë, që është krejt e veçantë dhe i dallon ata nga muajt e tjerë të vitit... megjithëse të gjithë muajt ne i ndiejmë dhe i jetojmë secilin sipas bukurive dhe frymës së vet, kjo prerje e veçantë e kohës jetohet me zemër dhe ndjenjat më të thella të brendshme. Njerëzit që i drejtohen botës së zemrës në këta muaj, sikur depërtojnë nëpër perden e ekzistencës me dritat që rrjedhin nga besimi dhe bindja e tyre ndaj Allahut, aq sa në ndjenja bëhen sikur të kenë arritur e të jenë zgjuar në parajsat e Firdeusit ku do të jetojnë një përjetësi. Për ta, edhe ditët, netët, madje edhe orët dhe minutat e këtyre muajve, sikur vijnë dhe ikin me një magji të tjetërfartë; vijnë dhe ikin dhe sipas gradës së secilit, i pëshpërisin diçka gjithkujt.

Në këta muaj koha është përherë e veshur me ngjyrat e amshimit... njerëzit bëhen fare të butë, sikur të ishin banorët e jetës së përtejme dhe arrijnë një thellësi të mistershme. Të gjithë, ehe nga thellësia e vetes, por edhe nga zemra e ekzistencës, sikur dëgjojnë një poezi me përmasën e përjetësisë dhe në grumbuj, shëtisin nëpër lindjen dhe perëndimin e sa e sa ëndrrave, kujtimeve, pritshmërive. Herë-herë të trishtuar, herë-herë të gëzuar, këta tre muaj na kujtojnë, edhe mallin e Parajsës së humbur, edhe na kaplojnë në tërë qenien tonë me shpresën se mund ta gjejmë sërish atë. Po, kujtimet dhe nxitjet e këtyre ditëve që mund ta shndërrojnë në një tjetër gëzim, në një tjetër hare, në një tjetër tension dhe në një tjetër aksion çdo minutë të jetës, i shndërrojnë ndjenjat tona në një poezi të heshtur, ndërsa jetët në nga një bukuri të magjishme.

Me përfshirjen e zemrave nga drita e këtyre muajve, dritat e rrugës, zërat e ëmbël që vijnë nga minaretë, gjallëria shpirtërore që mbizotëron ngadodhe butësia në fytyrat e njerëzve që ngarendin drejt faltoreve, kjo prerje plot dritë e kohës të kujton kohët e Xhenetit, duke u paraqitur njerëzve që ia dinë vlerën shije e kënaqësi të veçanta shpirtërore. Po, na përqafojnë të gjithëve me atë flladin e ëmbël të një kënaqësie që nuk njih të shterur, grumbulluar nga tërë ngjyrat e dritës që e ka burimin në valë të ndryshme, në delikatesën e erës që fryn butë-butë dhe në zërat e kohës që ka kaluar duke i magjepsur sakaq të gjithë, e cila i mbështjell dhe i përkëdhel të gjitha ato shpirtra që i kuptojnë dhe i ndiejnë, besimin, Islamin, faltoren dhe adhurimet; që janë të hapura kah kënaqësitë e thellësishme të njohjes së Allahut dhe të dashurisë për Allahun.

Pothuajse çdo vit, kur arrijmë ta kuptojmë këtë prerje të artë të kohës, ne bëhemi sikur të jemi rikthyer edhe njëherë në ato ditë të gëzueshme, të kaltra dhe aq të dashura të jetës së vërtetë. Po, përpara syve tanë shpërfaqet tyli i një pranvere të gjithkashme... në çdo anë shkumëzon sërish jeta... gjelbëron mali dhe fusha dhe sikur lëshojnë të qeshura të forta në gjallërinë e tyre... lulet nisin të vallëzojnë, bilbilat nisin të këndojnë këngët e tyre... dhe ndienjat bëhen sikur të kenë marrë flakë nga trëndafilave dhe tulipanëve. Asisoj që kjo atmosferë e përgjithshme, e cila frymon ngado, na i mbështjell zemrat me një premtim lumturie dhe na pëshpërisin sa e sa gjëra të panjohura, të pandjera më parë. Madje edhe njerëzit që e kanë jetën të izoluar në fatkeqësi dhe pesimizëm marrin diçka nga kjo festë qiellore. Madje, ditët, kur i bëjnë orët që janë thelluar me adhurime të lëvizin si shigjeta mbi zemra, prej andej nis poezia e pastër sa cicërimat e zogjve dhe me atë shijen e gëzimit femënor, me një ndikim po aq të fortë sa bukuritë e Xhenetit në minutat e ezanit dhe e pjekur po aq sa zemrat e dashuruara pas kësi bukurish dhe orët e adhurimeve të kryera me pjekuri, dhe na i entuziazmon zemrat me dhikrin dhe mendimin për Allahut, që frymon aromën e të qenit bashkëbisedues i Zotit... fillon dhe perdja në fytyrën e ekzistencës ikën dhe minutat e kaltra, të ngrohta dhe plot shije të paqes dhe bindjes së veçantë të afrisë me Allahun bëhen tonat.

Pesë herë në ditë, më së paku tridhjetë herë në javë, shëtisim si nëpër një rreze drite, shkrihemi në mundësitë e përjetimit të miraxhit në zemra dhe kalojmë nga njëra ëndërr që të bëhemi njerëz të përsosur në tjetrën.

Edhe pse hëna shfaqet disa ditë më parë, fillimi i tre muajve na thotë “përsëritje” në një të enjte të mvëshur me ndihmesën e hapur ndaj çdo thirrjeje dhe zbret në zemrat tona si një penzë. Ndjenjat tona që janë gati për akordin me ato ditë të larta dhe për atë ditën, që është më e larta, është një zë që thotë “Regaip”, që na i zgjon dhe entuziazmon zemrat edhe njëherë, porsì një provë instrumentale. Miraxhi, që vjen njëzet e ca ditë më pas, vjen së bashku me mendime qiellore, me zhurmën e hapjes së portave të qiellit dhe me frymimet e amshimit për të gjitha shpirtrat e përgatitura e në tension për ta përjetuar atë. Berati u flet zemrave me sihariqet e shpëtimit duke pritur i gatshëm për të na bërë paralajmërimet e radhës. Dhe, kur vjen nata e Kadrit, ajo i përqafton këta njerëz që ia dinë gjërave vlerën me një dritë dhe begati që nuk mund të arrihet vetëmse vetëm me përpjekje të jashtëzakonshme dhe përtej imagjinatës, e cila mund të realizohet vetëm në njëmijë muaj dhe i mbështjell ata me erëtimet e faljes dhe mëshirës.

Kjo ngrohtësia e ëmbël dhe kaq zilepsëse e tre muajve vazhdon ditë e natë për zemrat e besimtarëve. Çdo ditë, pasi zbraz mbi kryet tona tërë atë begati me shkëlqimin dhe gjallërinë e vet, shkon e mbyllet në horizont dhe pas saj vjen një agim i ri, me tërë bukuritë e tij të ëmbla, të buta dhe sylëbyrëse... një agim plot ëndrra për zemrat e përmalluara, duke i mbushur ato dhe botët tona të brendshme me sa e sa bukuri të fshehta e të mistershme.

Shpirtrat e zgjuara kah lutja, përgjërimi, falënderimi i Allahut dhe në gatishmëri të plotë ne hyrjen e muajit Rexhep, drejt fundit të muajit, arrijnë një kënaqësi të plotë dëshmie të zgjuar kah e përtej mja... arrijnë dhe të gjithëve u ndryshon gjuha, qëndrimi dhe qasja që kanë ndaj çdo gjëje, në fytyrat e tyre zë të mbizotërojë një farë madhështie, frike dhe respekti të dukshëm karshi Allahut dhe pa dyshim, gëzimi i shpresës. Çdonjëri fillon e flet pak më shumë me gjuhën e zemrës... ngurtësia

njerëzore zbutet... dhe sa e sa njerëz i hedhin tej peshat e jetës së kësaj bote, njësoj sikur të ishin duke u përgatitur për miraxh dhe arrijnë lehtësinë e shpirtit. Aq sa drita dhe delikatesa plot dritë e ngjyra ngjyra që rrjedh nga zemrat e këtyre njerëzve të drejtuar kah Ai, që është më i Drejti, kanë arritur në shkallë të atilla që mund të zbutin e të bëjnë të pendohen edhe zemrat më të ngurta.

Netët e veshura me një thellësi ndryshe me hyrjen e muajit të Rexhepit, marrin një trajtë edhe më të magjishme dhe i frymëzojnë të gjithë me sa e sa mendime gjeniale. Sidomos ato copëza kohe të bekuara të këtyre netëve, që janë të hapura kah e përtej, në çdo kohë, na injektojnë ëndrra të entuziazmit të ndjesive tona për Xhenetin dhe dëshirave që na ngajnë me zemrën... na i injektojnë dhe na përfaqon dëshirat tona për përjetësi dhe prekin t'u hapin shpirtave tona portat e ëndrrave. Na i zgjojnë ndjenjat që rrinë të heshtura e të topitura në qenien tonë pothuajse çdo natë dhe na frymëzojnë me mendime të një lumturie edhe më të thellë sesa ajo që po përjetojmë në këtë botë.

Muajin Shaban, i cili nëpër libra përmendet edhe si “Muaji Madhështor i Allahut”, e ndiejmë si një kënaqësi të veçantë, e cila është shkrirë me krejt qenien dhe ekzistencën tonë dhe na vjen sikur ndiejmë se zemrat tona po rrëshkasin kah shpresa, pritshmëria dhe bukuritë e amshimit. Ai, me natën dhe ditën e vet, ndikon te njeriu me atë melodinë e vet të magjishme, që i ngjason kompozimit të Ramazanit... dhe na përfaqon me krahët e vet qiellorë, të gjithë sa njerëz jemi që kërkojmë mbrojtje... na përfaqojnë me dhembshurinë e një nëne dhe na shtëpisin nëpër thellësitë e mëshirës. Për ata që e kanë kuptuar atë më së miri në shpirtin e vet, koha bëhet sikur të jetë çarë dhe mbi ndjenjat tona të jetë duke rrjedhur diçka nga përtej kohës. Aq sa, çdokush, sikur të hedhë edhe një hap të vetëm nëpër minutat e tij të ndritura apo thellësitë e të ndjerit të tij, veten do ta gjejë duke ecur nëpër një palë shkallë magjike. Thuajse çdo ditë, çdo natë, çdo orë dhe çdo minutë, ndien nevojën tonë për të përtejmen nga dëshira dhe mendimet për përjetësi që fshihen në natyrën tonë dhe ne ngarendim të shohim ato që dëshirojmë vërtet nga dritaret që na ka çelur ky muaj i Allahut.

Sakaq, në horizont ia beh Ramazani me minutat e tij të ngrohta, kaq të buta e plot mistere... ndërgjegjet kalojnë në gatishmëri të plotë, të gjitha zemrat zgjohen dhe tërë ndjenjat i kaplon entuziazmi... njerëzit rrjedhin drejt faltores në grumbuj; së andejmi ecin drejt Krijuesit të tyre. Me ardhjen e Ramazanit përforcohen lidhjet e shpirtit... dëshirat dhe kërkesat për amshim shkumëzojnë; shkumëzojnë dhe një mendim Ramazani që bie e ngrihet si një penzë mbi ndjenjat, i entuziazmon zemrat besimtare me dashuri dhe dëshirë, aq sa në shpirtat e tyre ndizet flaka. Për Ramazanin mund të thuhet se ai zbret në tërë qenien tonë si një dinamizëm i rëndësishëm i jetës sonë shpirtërore, me ato ditët e tij të ndritura, të përshpirtshme dhe aq të bukura, duke na bërë të përrjetojmë kënaqësi amshimi të njëpasnjëshme. Peizazhi i pazarit dhe rrugëve shkumëzon nga ndjenjat për të përtejmen. Frymimet e minareve jehojnë në zemra me melankolinë e Kuranit... faltoret i mbulon drita dhe kumbojnë nga e qara me tërë fuqinë e zërit të zemrave besimtare. Kudo, nga shtëpia në faltore, nga faltorja në shkollë, në çdo vend përjetohen gëzimi dhe ngopja shpirtërore që të fal drejtimi kah Allahu i Madhërishëm... kraharorët e fryrë nga adhurimi, shfaqin tërë bukuritë faqeza... dhe ulërasin dashurinë, pasionin që shkëputet e vjen nga bota e tyre e brendshme me notat e një intimiteti krejt ndryshe. Këta njerëz, njësoj sikur të kenë marrë urdhrin, “bëhuni gati për ritakimin” dhe e quajnë atë si një vigjilje të “natës së parë të ritakimit”, çka bën që çdo ditë të kalojë me ndjesinë e thellë të ritakimit.

Po, në çdo zë të Ramazanit është premtimi i një fillimi, në çdo frymëmarrje është e pranishme shpresa e shpëtimit. Iftaret na pëshpërisin ca të fshehta dhe ato shfaqen në horizontin tonë m thirrjet e takimit të madh... vetëm ta dini ç’i premtojnë botës sonë të shpresës teravitë... netët, njësoj si një nuse me naze, na hapin portën e dhomës intime të ritakimit dhe bëhet dritë në valët e çdo zhvillimi shpirtëror dhe rrjedhin në zemrat tona... agimet gumëzhijnë si zhurma e borisë së vaporëve, zhurma e avionëve dhe raketave dhe rrokjezojnë udhëtimin e një nate drejt ritakimit me Mikun... Derisa, më në fund, vjen e na mbështjell në çdo anë një ditë e stërgjatë, e mbushur me orët e kujdesshme, plot shpresë dhe emocione, të kapluara nga shqetësimi i

atij takimi të ëmbël.

Gjatë Ramazanit, jeta është aq e thellë dhe kuptimplotë, sa që çdo fjalë e thënë, çdo zë që dëgjohej, i vjen njeriut si një kompozim që rrjedh nga zemra; i vjen dhe depërton nëpër ndjenjat tona në trajtën e melodive më të ëmbla. Ramazani, i cili bëhet shkas që shpirti ynë të çelë pors i një syth dhe ndjenjat që flenë në thellësitë e qenies të zgjohen dhe na shëtin nëpër botët më të bukura dhe marramendëse të imagjinatës, na formon të gjithë me një nevojë për ritakim dhe dëshirën dhe dashurinë për atë ritakim, të cilat i ndiejmë gjer në palcë dhe në zemra në ndiejmë freskinë e jetës së vërtetë.

Ata që dinë të përgatiten plotësisht për jetën gjatë Ramazanit, përtej çdo gjëje që kanë fituar këtu, kupton se në fund të kësaj rruge plot dritë, por pak me mjegull, ka një lumturi të përjetshme dhe me tërë qenien e tyre, drejtohen kah Ai. Po, në çdo iftar dhe çdo agim, njeriu ndien sikur është hapur një portë e re e ritakimit dhe dy hapa tej ndien nevojën dhe shpresën e një takimi edhe më të gjerë, më magjepsës; e ndien dhe nga njëra anë ndien mall dhe vetmi, nga ana tjetër pritmeritë dhe ëndrrat i kaplon ata me një farë magjie më të thellë, duke i tërhequr kah thellësitë e dashurisë së vërtetë. Asisoj që ata ndiejnë se çdo gjë në pafundësinë e hapësirës shtillet rreth dashurisë, njësoj siç çdo gjë ndihodh rreth dashurisë në zemrat e tyre dhe ata ekzaltohen. Burra e gra, të rinj e të vjetër, të pasur dhe të varfër, të gjithë sipas aftësisë së vet të të kuptuarit, përjetojnë një periudhë të një përgatitjeje të veçantë gjatë Ramazanit; mandej, ndiejnë sikur ecin vetëm drejt Allahut, me ndjesinë e një rruge që nuk do të mbarojë kurrë...<sup>3</sup>

## 2. *Virtyti i tre muajve*

Tre muajt janë një prerje e bekuar e kohës dhe zënë një vend të veçantë në jetën e besimtarëve. Çdo besimtar e pret, dhe duhet ta presë, me emocion tejet të veçantë ardhjen e kësaj prerjeje të kohës. Kjo pritje

<sup>3</sup> M. Fethullah Gylen, “Prerja e bekuar e kohës: tre muajt”, “Mendime që lulëzojnë” (Yeşeren Düşünceler), fq.

neve na ka mbetur trashëgim nga Profeti ynë i Nderuar (sa'lallahu alejhi ues'sel'lem). Ai (pçmT) mezi e pristje ardhjen e tre muajve dhe kur ata vinin, Ai lutej duke thënë:

*“O Zot! Bekoje për ne Rexhepin dhe Shabanin dhe çona ne në Ramazan.”*<sup>4</sup>

### ***Muaji Rexhep***

Rexhepi është fillimi i tre muajve dhe një nga katër muajt që Allahu i ka shpallur si muajt e ndaluar (muajt, në të cilët është e ndaluar të luftohet) në Kuranin Fisnik:

*“Që nga koha kur Allahu krijoi qiejt dhe tokën, numri i muajve është dymbëdhjetë. Katër prej tyre janë muaj të ndaluar.”*<sup>5</sup>

Në muajin Rexhep, shpërblimet rrjedhin si shiu, prandaj edhe ky muaj është quajtur si “Rexhepi i bollshëm”. Me një fjalë ai është muaji kur entuziazmohet mëshira hyjnore dhe qerasjet dhe mirësitë e Allahut rrjedhin me bollëk mbi robërit e Tij.

Këtë muaj e kanë quajtur edhe si “Rexhepi i shurdhët”. Duke qenë se ai është një muaj që është e ndaluar të luftohet, në këtë muaj armët heshtin dhe nuk dëgjoen thirrjet e luftës, por mbizotëron paqja dhe qetësia në çdo anë. Prandaj edhe ia kanë vënë këtë emër.

Miqtë e Allahut, muajin e Rexhepit e kanë përngjasuar me periudhën kur hidhet fara në tokë. Muajin Shaban me kujdesjen për farat dhe kallinjte e parë, ndërsa Ramazani është si një farë stine e korryes. Nga ky këndvështrim, nëse një besimtar ka dalë në rrugë për të fituar prej të mbjellave që korren në ahiret, duhet që pikë së pari ta hedhë farën mirë. Punët e mira që do të bëjë dhe qëllimi i tyre do të jenë farat më të mira të frutave që do të marrin në ahiret.

Edhe Bediuzamani i nderuar përdor këto fjalë për virtytin e tre

<sup>4</sup> Ahmed bin Hanbel, *el-Musned* 1/259; et-Taberani, *el-Mu'xhemu'l-eusat* 4/189.

<sup>5</sup> Teube, 9/36.

muajve: “Nëse shpërblimi për çdo punë është dhjetë në kohë të tjera, në Rexhepin e bekuar bëhet njëqind, në Shabanin Madhështor më shumë se treqind, ndërsa në Ramazanin e Bekuar, shkon në njëmijë, gjersa bëhet njëmijë në netët e së premtes dhe tridhjetëmijë në Natën e Kadrit.”<sup>6</sup>

Nata e së premtes së parë të muajit Rexhep njihet ndryshe edhe si nata e Regaipit. Allahu u fal mirësi të gjithëllojshme besimtarëve në këtë natë. Edhe ata janë të interesuar për këto mirësi. Zaten ky është edhe kuptimi i fjalës “*regaip*”, interesim. Allahu i trajton me mëshirën e tij, të gjithë ata që tregojnë respekt ndaj kësaj nate. Prandaj duhen bërë përpjekje që kjo natë të shfrytëzohet e të vlerësohet me sa më shumë punë të mira, gjatë ditës dhe gjatë natës. Të falë namaz, të agjërojë, të japë sadaka dhe të lexojë bukur Kuran me sa të ketë mundësi; të përpiqet të kënaqë sa më shumë të sëmure, të moshuar dhe të varfër.

Një nga netët e mira që gjendet në muajin Rexhep është edhe nata e Miraxhit. Ngjarja e Miraxhit, kur i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ues’sel’lem) u hap drejt botëve përtej qiejve dhe u takua me Allahun e Madhërishëm, ka ndodhur në natën e njëzeteshtatë të muajit Rexhep, afërisht një vit para mërgimit. Atë natë, Profeti ynë i Nderuar (pqmT) u çua fillimisht në Faltoren e Ndaluar në Jerusalem. Në Kuranin Fisnik këtë ngjarje përmendet edhe me fjalën “*isra*”, e cila ka kuptimin e “*ecjes së natës*”. Nga këtej Ai u ftua drejt katit të lartë të Allahut, me udhëtimin nën cilësinë e “*miraxhit*”. Në Miraxh Allahu i dha Profetit tonë të Nderuar sihariqin se kushdo nga umeti i Tij që nuk bën idhujtari, do të hyjë në Xhenet; i shpalli Atij ajetet e fundit të sures “*Bakara*” dhe i bëri të ditur shpalljen detyrim të faljes së pesë kohëve të namazit.

### ***Muaji Shaban***

I dyti i tre muajve, Shabani, është po aq i rëndësishëm dhe me virtyte. Në lidhje me këtë Profeti ynë i Nderuar (paqja qoftë mbi Të) ka thënë:

*“Veprat i paraqiten Zotit të Botëve në muajin Shaban. Dhe unë dua*

<sup>6</sup> Bediuzaman Said Nursi, *Rrezet* fq. 483 (Rrezja e Katërmbëdhjetë).



*që veprat e mia t'i paraqiten kur unë të jem duke agjëruar.*"<sup>7</sup>

Gjatë këtij muaji, Profeti ynë i Nderuar agjëronte shumë. Madje, nëna jonë, Aishja e nderuar (radijallahu anha) na ka transmetuar:

*"Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem), nganjëherë agjëronte aq shumë, saqë ne thoshim: 'Me gjasë, kësaj here nuk do ta ndërpresë më agjërimin.' - Ndërsa, nganjëherë, bënte aq shumë pushim pa agjëruar, sa që ne thoshim: 'Me gjasë, nuk do të mbajë më agjërim.' - Unë nuk kam parë Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) të ketë kaluar me agjërim ndonjë muaj tjetër të plotë, përveç Ramazanit. Dhe nuk kam parë që të ketë agjëruar në ndonjë muaj tjetër sa në muajin Shaban."*<sup>8</sup>

Siç ka mbajtur vetë shumë agjërim gjatë këtij muaji, ai ka këshilluar edhe umetin e Tij që të veprojnë edhe ata si ai. Pyetjes, "*cili është agjërimi më i virtytshëm pas agjërimit të Ramazanit*", Krenaria e Njerëzimit (paqja qoftë mbi Të) është përgjigjur duke thënë: "*Është agjërimi i mbajtur për të respektuar Ramazanin në muajin Shaban.*"<sup>9</sup>

Nata që lidh katërmbëdhjetën e muajit Shaban me pesëmbëdhjetën është nata e Beraetit. Kjo fjalë e ka prejardhjen nga kuptimi i pastrimit, i të qenit i pafajshëm. Ky emër i është vënë ngaqë shpresohet që besimtarët të dalin prej saj krejtësisht të pastruar nga të gjitha mëkatet e tyre.

Sipas disa dijetarëve nata e Beraetit është nata e bekuar për të cilën bëhet fjalë në ajetet e para të sures "Duhan":

*"Ha-Mim. Beto hem në këtë libër që është i qartë dhe tregon të vërtetën se ne e zbritëm atë në një natë të bekuar. Sepse ne i paralajmërojmë ata që largohen nga e drejta. Ajo është një natë që pikërisht në atë kohë ndahet çdo punë e urtë."*<sup>10</sup>

Sipas dijetarëve të parë, ndarja e punëve të urta nga njëra-tjetra do të thotë: "engjëjt shkruajnë në librat e fatit të gjitha ngjarjet që do të ndodhin

<sup>7</sup> Nesai, *sijam* 70; Ahmed bin Hanbel, *el-Musned* 5/201.

<sup>8</sup> Buhariu, *saum* 52; Muslim, *saum* 173, 174, 176, 177.

<sup>9</sup> Tirmidhi, *zekat* 28; Ibn Ebi Shejbe, *el-Musannef* 2/346.

<sup>10</sup> Duhan, 44/1-4.

nga kjo natë gjer në vitin e ardhshëm. Asisoj që të gjitha, ushqimi, exheli, pasuria, varfëria, vdekja, lindja, përcaktohen në këtë natë.

Ndërsa, për sa i përket çështjes së zbritjes së Kuranit në këtë natë, dijetarët që mendojnë se bëhet fjalë pikërisht për natën e Beraetit thonë se Kurani Fisnik është zbritur nga Libri i Madh i Çdo Gjëje në qiejt e tokës pikërisht në natën e Beraetit, dhe kjo emërtohet me termin “*inzal*” (zbritja). Ndërsa, në natën e Kadrit, ai i është zbritur Profetit tonë (sal’lallahu alejhi ues’sel’lem) për herë të parë, duke filluar t’i zbritet pjesë-pjesë në vijimësi dhe kjo është quajtur “*tenzil*”.

Në një prej haditheve të bekuara të Tij Profeti ynë i Nderuar (paqja qoftë mbi Të) e përshkruan me këto fjalë dritën dhe begatinë e natës së Beraetit:

*“Natën e ditës së pesëmbëdhjetë të Shabanit, kalojeni me adhurim, ndërsa ditën duke agjëruar. Pasi perëndon dielli, atë natë, Allahu zbret me mëshirën e Tij gjer në qiellin e tokës dhe drejtohet me fjalët: “A nuk ka ndonjë që më kërkon falje, ta fal! A nuk ka nuk ka ndonjë që kërkon që ta furnizoj, ta furnizoj! A nuk ka ndonjë që i ka ndodhur ndonjë fatkeqësi, apo që kërkon shëndet e mirëqenia, t’ia jap!” - Dhe ky zë vazhdon kështu gjer në të zbardhur mbi sipërfaqen e rruzullit tokësor.”<sup>11</sup>*

Siç transmetohet, Aishja e nderuar (radijallahu anha), një natë Beraeti, nuk e gjen pranë të Dërguarin e Allahut (pqmT) dhe del ta kërkojë. Në fund ajo e gjen Atë në varrezën e Parajsës së Përjetshme me kokën ngritur nga qielli, i zhytur në meditim dhe lutje. Profeti ynë i Nderuar (sal’lallahu alejhi ues’sel’lem) ia përshkruan bashkëshortes së tij të pastër virtytin e kësaj nate me këto fjalë:

*“Allahu i Lartësuar shfaqet me mëshirën e Tij mbi qiellin e tokës në natën e pesëmbëdhjetës së muajit Shaban dhe atë natë, falen mëkate të njerëzve aq sa kanë qime tërë delet e fisit të Beni Kelbit.”<sup>12</sup>*

Bediuzamani i nderuar, pikëpamjen e tij në lidhje me virtytin e kësaj

<sup>11</sup> Ibni Maxhe, *ikame* 191.

<sup>12</sup> Tirmidhi, *saum* 39; Ibni Maxhe, *ikame* 191. (Fisi i Beni Kelbit njihej në mesin e gjithë fiseve arabe pikërisht për numrin e madh të kokëve dele që kishin në pronësi.)

nate e shpreh me këto fjalë: “Kjo natë e Beraetit që po vjen, është si një farë e shenjtë e tërë vitit dhe është si një lloj programi i së ardhmes së njeriut, andaj është në lartësinë e natës së Kadrit si natë e mirë. Njësoj siç çdo punë e mirë në natën e Kadrit vlerësohet me tridhjetëmijë shpërblime, edhe në natën e Beraetit, shpërblimi i çdo pune të mirë dhe çdo shkronje të Kuranit të lexuar shkruhen me njëzetmijë. Nëse në kohë të tjera ato shkruhen me dhjetë, gjatë tre muajve ato ngjiten gjer në njëqind apo njëmijë. Këto netë mund të vlejnjë sa pesëdhjetë vite adhurime. Prandaj, me sa të kemi mundësi, nëse i kalojmë ato duke lexuar Kuran, duke kërkuar falje dhe duke përshëndetur me salavate të Dërguarin e Allahut, për ne do të jetë një fitim shumë i madh.”<sup>13</sup>

Vetëm se, në këtë natë kur Allahu na trajton me mëshirën e Tij - brenda përshkrimit të të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue'ssel'lem) - disa njerëz do të mbeten të privuar nga mëshira:

*“Allahu (xhel'le xhelaluhu) na sheh me mëshirë në natën e pesëmbëdhjetës së Shabanit dhe i fal të gjitha krijesat e Tij. Vetëm këta bëjnë përjashtim: idhujtarët, ata që kanë shumë mlllef, (dhe sipas një transmetimi) ata që shkëpusin lidhjet farefisnore, që lëndojnë nënën dhe babain, si dhe ata që janë të dhënë pas pijes.”<sup>14</sup>*

### **3. Të përfitosh nga tre muajt**

Tre muajt janë prerje të bekuara të kohës, kur njeriu mund të jetë më afër se kurrë me Allahun, mund të bëhet i denjë për të përfituar nga mëshira e Tij e thellë, largohet nga mëkatet dhe të udhëtojë nëpër horizontin e zemrës dhe shpirtit. Zaten edhe njeriu ka nevojë për një periudhë të tillë rehabilitimi qiellor, të paktën njëherë në vit, si për të pastruar egon e tij, ashtu edhe për të edukuar shpirtin, apo për të kontrolluar edhe njëherë gjendjen e zemrës. Prandaj, këto prerje të bekuara të kohës janë shkaqe më se të rëndësishme për realizimin e një rehabilitimi të këtillë.

<sup>13</sup> Bediuzaman Said Nursi, *Rrezet* fq. 495 (Rrezja e Katërmbëdhjetë).

<sup>14</sup> Ibni Maxhe, *ikame* 191; Ibni Ebi Shejbe, *el-Musannef* 6/108.

Që njeriu të mund të shpëtojë nga peshat trupore dhe egoiste në këto kohë të begata, në mënyrë që të ngjitet drejt një niveli dhe horizonti të caktuar, atij i nevojitet meditimi. Por, kur e bën këtë, ai duhet t'i mbajë të hapura kah shpirtërorja, edhe zemrën, edhe shpirtin. Pra, gjatë këtyre muajve, ndërkohë që nga njëra anë do të përdor të gjitha fakultetet e mendjes dhe të arsyes për të kuptuar çështjet që kanë të bëjnë me besimin dhe Kuranin, nga ana tjetër, ai do të përpiqet të përdorë edhe rrugën e bashkëbisedimit, dhe do të përpiqet që medoemos ta tërheqë drejt vetes këtë shi të dritës dhe shpirtërores.

Gjer më sot, secili sipas horizontit të vet, sa e sa njerëz kanë thënë fjalët më të bukura në lidhje me këto prerje të kohës, duke e tërhequr vëmendjen drejt bukurive që mund t'i përftojnë jetës së besimtarit me ditët dhe netët e tyre. Leximi i këtyre veprave që vlejnë thesare duke u ndalur në grupe dhe duke i analizuar gërmë për gërmë, përvetësimi i tyre përmes metodës së bashkëbisedimit, janë shumë të rëndësishme për të kuptuar dhe ndjerë shkëlqimin dhe frymëzimet shpirtërore që i përftojnë njeriut këta muaj. Po, për të përfituar sa më shumë nga gjithë ç'janë shkruar në lidhje me këta tre muaj, ne duhet të largohemi nga leximi i cekët dhe sipërfaqësor i tyre dhe të dimë se si të thellohemi në çështjet e trajtuara prej tyre. Dhe pa u zhvilluar ndjenjat dhe mendimet e nevojshme do të jetë e pamundur që të përfitohet sa duhet, si nga ato që lexojmë, ashtu edhe nga ato çfarë dëgjojmë.

Që të mund t'i shijojmë dhe ndiejmë në mënyrë të përsosur bukuritë e veçanta të këtyre tre muajve, si dhe kënaqësinë dhe shijet që reflektojnë në zemrën. njeriut, ne duhet të dimë që këta janë muajt e "mbledhjes" së fryteve, ndaj duhen shfrytëzuar pa humbur qoftë edhe një sekondë të vetme nga koha e tyre. Një njeri që nuk çohet gjatë natës për t'iu drejtuar Allahut me vullnet dhe vendosmëri, që nuk shijon prej fryteve shpirtërore të natës, është e pamundur që të mund ta përkapë dot shijen dhe thellësinë e bukurive të shprehura me shkrim ose me gojë. Nëse njeriu nuk hyn në këta muaj me një farë tensioni metafizik të caktuar, nuk ia kushton veten njëfarësoj adhurimit me një vetëdije të fortë robërie dhe nuk e lëshon veten në brendësi të çështjes, edhe

sikur të derdhet si uji nga gotat domethënia e këtyre pjesëve të begata të kohës, ai nuk përfiton asgjë. Madje ai mund t'i peshojë me peshoren e vet të aftësisë kuptuese dhe kapacitetit të vet edhe shprehjet më të mrekullueshme të të tjerëve dhe t'i konsiderojë ato si diçka luksi dhe fantazi, madje ato fjalë shumë të gjalla dhe të ndritura, atij t'i duken të vdekura dhe të zbehta tërësej. Asisoj që as fjalët e Ibn Rexhep el-Hanbelit, të cilat të prekin në zemër, as fjalët që frymëzojnë veç dëshirë e dashuri të Imam Gazaliut, nuk reflektojnë asgjë në zemrën e tij. Thjesht thotë: “Ç’thonë kështu këta njerëz!” - dhe e anashkalon çdo gjë. Sepse, në mënyrë që këto fjalë të kenë një farë ndikimi, aq sa vlera e fjalëve të thëna, rëndësi mjaft të madhe kanë edhe këndvështrimi, qëllimi, aftësia për të kuptuar dhe zemra, nëse e ka të hapur apo të mbyllur ndaj këtyre të vërtetave, të atij që i dëgjon.

Po, në mënyrë që të mund t'i ndiejmë frytet e arritjeve shpirtërore që sjellin me vete këto ditë të bekuara, fillimisht ne duhet të kemi besuar dhe t'i drejtohem Allahut. Sepse vetëm prirjes i përgjigjet me prirje. Nëse ju nuk u drejtoheni shpirtit dhe domethënieve të këtyre muajve, atëherë as ata nuk do t’jua hapin juve portat e tyre.

Prandaj njeriu duhet t'i dalë asisoj për zot kësaj çështjeje, sa që të bëhet njësh me muajin e Rexhepit, njësh me muajin e Shabanit dhe njësh me muajin e bekuar të Ramazanit. Po, ai duhet të bëhet aq njësh me këta muaj, sa që ta ndiejë e ta dëgjojë vetë se çfarë i thonë shpirtit njerëzor këta muaj. Nga kjo pikëpamje, njerëzit që nuk shpëtojnë dot nga sipërfaqësorja, qëndrojnë të hapur kah kotësia, nuk bëjnë asnjë përpjekje për t’u rinovuar në një stinë si kjo e mbledhjes së fryteve shpirtërore më të arrira, nuk e arrijnë dot seriozitetin në sjelljet dhe veprimet e tyre, vështirë se mund të përfitojnë dot prej këtyre muajve.

### ***Programe të përshtatshme për shpirtin e fesë***

Në anën tjetër qëndron edhe çështja e pranimit të përgjithshëm në shoqëri. Sepse, vetëm njerëzit e thellë për nga horizonti i shpirtit dhe zemrës janë të denjë për ta ndjerë thellësinë që shprehin këta muaj.

Megjithatë, tani, myslimanët sikur po e kuptojnë në një farë mase vlerën dhe begatinë e këtyre muajve, kanë filluar të drejtohen drejt xhamive dhe po drejtohen kah Allahu i Madhërishëm. Kështu që, duke u përdorur mirë kjo situatë, në shpirtat e njerëzve mund të fryhen mesazhe të ndryshme duke organizuar aktivitete dhe programe të ndryshme edhe gjatë këtyre tre muajve. Kësisoj ne do t'i kemi vlerësuar dhe shfrytëzuar mirë këto netë të bekuara, si për t'i afruar njerëzit me Zotin, ashtu edhe për të përçuar në zemra të vërtetën e fesë. Ashtu siç disa të vërteta mund të përçohen në zemrat e atyre që vijnë në xhami, takime dhe bashkëbisedime të ndryshme mund të organizohen edhe nëpër ambiente të tjera. Në këtë mënyrë do të shfrytëzohen drejt edhe interesi dhe pritshmëritë e besimtarëve për domethënien e këtyre muajve për ta.

Meqë ky është edhe vendi, ka diçka që mua më duket mjaft e rëndësishme në lidhje me këto programe, tek e cila dua të tërheq edhe vëmendjen tuaj: Në të gjitha aktivitetet që ne zhvillojmë duke shfrytëzuar arsye të ndryshme, si qëllim ne duhet të kemi vetëm afrimin në ndjenja dhe në mendime të njerëzve me Allahun, sikur edhe një hap të vetëm më shumë. Nëse ne nuk u japim dot zë disa të vërtetave në lidhje me Krijuesin, nëse nuk i afrojmë dot ata sadopak me Profetin e profetëve (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem), por organizojmë thjesht programe që u drejtohen epshit dhe kënaqësive të zakonshme të njerëzve, duke mos kaluar më tej se sa t'i bëjmë ata thjesht të thonë: "Kaluam minuta të bukura!" - atëherë ne nuk kemi bërë asgjë veçse kemi humbur kohë dhe për më tepër, kemi hyrë edhe në mëkat. Sepse çdo rrugë që nuk të çon tek Allahu (xhel'le xhelaluhu) dhe nuk ka si destinacion Profetin e Nderuar, nuk është veçse zhgënjim. Zaten, argëtimi i njerëzve duke organizuar spektakle apo aktivitete karnavaleske nuk është detyrë e jona.

Veç kësaj, ne duhet ta dimë mirë se njerëzit e sotëm kanë tashmë një stil jetese të prirur kah argëtimi. Prandaj, interesimi i tyre edhe mund t'ju gënjejë. Asisoj që ju shikoni gëzimin e tyre dhe pandehni se keni bërë diçka të mirë. Kur, në fakt, më shumë se sa interesimi i tyre,

i rëndësishëm është nëse organizimi është sipas kritereve të Kuranit dhe Sunetit. Për rrjedhojë, edhe nëse nuk ka interesim të mjaftueshëm për organizimin e mbajtur, edhe nëse pjesëmarrja nuk është e gjerë, ju duhet të ngarendni vetëmse pas asaj që është e drejtë. E thënë me fjalë të tjera, të rëndësishme nuk janë vlerësimi dhe duartrokitjet e njerëzve, por domethënia që ka aktiviteti i organizuar për jetën tonë të zemrës dhe të shpirtit.

Rrjedhimisht, në një prerje të këtyllë të kohës, e cila është kaq e begatë, qiellin e pushton drita, rruzulli tokësor shtrohet me sofrë qiellore, ne duhet t'i drejtojmë njerëzit kah thellimi i jetës së tyre të zemrës dhe të shpirtit dhe çdo punë që bëjmë, ta lidhim me qëllimet më të epërme dhe mendimet më të thella. Asisoj që përherë të injektojmë një domethënie, një shpirt të ri, në zemrat e njerëzve që i kemi zgjedhur si bashkëbisedues. T'i bëjmë ata të hapin velat drejt një pangopësie për shpirtëroren. Dhe, për ta arritur këtë, ndaç duke kënduar ilahi, elegji apo lutje të trashëguara që herët nga e shkuara, ndaç t'i shprehim nëpërmjet kompozimesh dhe melodish të reja këto domethënie, por mjaft që të nxitim te njerëzit dëshirën për përjetësinë, në zemra dashurinë për të fituar lumturinë e përjetshme dhe të vëmë në lëvizje shqetësimin se mos dalim të humbur, pra, me pak fjalë, t'i zgjojmë njerëzit edhe njëherë për shpirtin e fesë.

Nëse do të duhej ta përmbledhim në pak fjalë, xhamitë, bashkësitë, ditët e xhuma, Rexhebët, Shabanët, Ramazanët, Regaipet, Kadret, duhet të bëhen medoemos arsye për t'i ndihmuar njerëzit që të drejtohen kah Allahu i Madhërishëm dhe të gjitha këto aktivitete, të organizuara në prerjet e bekuara të kohës, kur çdo çast është i gatshëm të lindë përjetësinë, duhet të synojnë veçse realizimin e qëllimeve të larta e të epërme.

## B. MUAJI I RAMAZANIT DHE VIRTYTI I TIJ

### *1. Adhurimi i veshur me falje*

Nëse ka një muaj, që mbruhet me një hare që nuk ka të shuar, një kënaqësi që s'mbaron dhe me një dashuri që nuk di të pakësuar, ai është Ramazani. Ditët dhe netët e Ramazanit, që t'i ofron me shijen më të ëmbël të gjithë thelbin, shpirtin dhe përmbajtjen e të gjitha muajve dhe stinëve që kalojnë gjithë naze përgjatë gjithë vitit; çdo çast, i mbështjellin zemrat me një kënaqësi dhe me një ëmbëlsi aq të rrallë, i përqafojnë ato me dhembshuri, i përkëdhel me dashuri dhe u fal entuziazmin e dëshirës për të jetuar.

Në çdo anë të botës, por veçanërisht në vendet myslymane dhe sidomos në botën tonë, ditët e Ramazanit bëhen epiqendra e çdo interesimi, sheshi i tërë kënaqësive shpirtërore, skena e gjithë emocioneve të mundshme, një spirale drite për çdo lartësim dhe një mundësi e hapur kah zgjerimi dhe thellimi i të gjitha vetive njerëzore, një hapësirë ku fitimi është shumë i madh.

Ditët e Ramazanit, me netët kapluar nga ndjenjat më të veçanta dhe ditët që lindin me një dritë të veçantë, frymojnë një frymë të pashoqe ndër zemra... dhe i përbashkon edhe njëherë të gjitha pjesët e shkëputura nga njëra-tjetra të shoqërisë, i bën një, u hap rrugën e bashkësisë gjithë njerëzve të veçuar dhe u jep fund mërgimit të tyre... i shtron secilit, në dimensione të ndryshme, nga një gosti të veçantë ndjesish dhe mendimesh duke i zgjuar të gjithë edhe njëherë t'i çelin sytë kah jeta.

Ramazani është i mbështjellë nga një aurë drite në çdo vend, duke filluar që nga kulmi i minaresë, deri te abazhurët e stolisur brenda xhamisë, nga llambat e shtrira përskaaj në të djathtë dhe të majtë të rrugëve që zgjaten drejt faltoreve, e deri te dritat e shtëpisë, e nga qashtërsia që ndrit në fytyrat e besimtarëve, deri te ndriçimi që mbizotëron në zemrat e tyre. Sidomos në ditët e sotme, kur feja i është



rikthyer edhe njëherë rinisë së saj, ai vjen dhe i ledhaton zemrat me një atmosferë, një dritë dhe një aromë krejt të veçantë, aq sa vetëm flatrimi me krahët e dashurisë së përmalluar mund të jetë aq tërheqës, aq zilepsëse. Sikur pa ardhur muaji i Ramazanit mes njeriut dhe dëshirës së shpirtit njerëzor për pafundësi të ish veç një perde që i ndante dhe ja, tani, sikur ajo perde hapet... dhe gjithë dashuria e dëshira që deri në atë çast kish fjetur qetësisht në ndonjë nga qoshet e zemrës, merr jetë, kapardiset, shkumon; mbështjell tërë qenien dhe shndërrohet pa pra në një dëshirë të pakapërcyeshme për ritakimin e përmallshëm. Dhe, për ta plotësuar këtë dëshirë të madhërishme, kërkojnë agimet në të cilat shfaqen flladitshëm, njëra pas tjetrës, erërat e pasqyrimin, dhe vlerësohet çdo namaz, i kthyer në nga një dritare e hapur kah e përtejnjma për çdokënd... shpirtat entuziazmohen me teravitë, që janë frymë e jetë për shpirtin... ndjenjave u jepen gota të tëra me frymëzime hyjnore... dhe, saora, sipas gradës secili sikur përjetësohet, thellohet në përbrendësi, duke marrë një farë trajte engjëllore.

Duke qenë se Ramazani është muaji i Kuranit, edhe ata që kanë mbetur larg Kuranit për një vit të tërë, e gjejnë veten në atë atmosferë rrëzëllitëse me një etje të madhe... dhe Kurani i ujit të gjitha luginat e qenies që kanë zënë të thahen, me tërë shpirtin, domethënien, misteret dhe mirësitë që ka derdhur vrullshëm mbi kryet e tyre... i kthen botët e zemrave të tyre në kopshtije të mbushura me lule, duke u falur kënaqësinë e madhe të ekzistencës. Në Kuran ata ndiejnë dhe dëgjojnë krejt ekzistencën; bëhen me krahë nga ndjenjat dhe mendimet e përfuara prej tij.. ndiejnë se si në Kuran merr frymë i tërë krijimi mbarë dhe drithërohen... herë-herë ekzaltohen në drithërima; herë-herë marrin frymë me lot, e me lotët zbrazen, gjersa ndiejnë se perdet janë ngritur e ata janë më pranë Allahut se kurrë duke e gjetur sakaq veten të përfshirë nën një melodi të veçantë kënaqësie.

Përmbajtjen e thellë të Kuranit vetëm ata që arrijnë të ndiejnë në Të gjithë zërin e ekzistencës dhe njëkohësisht të tërë atë muzikë të frikës dhe shpresës, shqetësimit dhe gëzimit, vuajtjes dhe haresë. Shpirtat e mbikohshëm, që arrijnë ta dëgjojnë Kuranin sikur t'u ishte zbritur

atyre vetë, dëshmojnë mes fjalëve të Tij shijen e frutave të Xhenetit, larushinë dhe bukurinë e kopshtijeve të Firdeusit dhe peizazhet e ujëvarat e majave të Rej'janit dhe kjo i bën që të gurgullojnë edhe ata së brendshmi. Zemrat e kulluara, që ngrenë velat drejt thellësive të Tij duke e trajtuar atë me tërë tejdukshmërinë karakteristike të Ramazanit dhe duke përdorur kriteret vlerëçmuese të zemrës, ndiejnë se janë çdo çast duke fituar një farë vlere përjetësie dhe duke njohur sa herë nga një dimension të ndryshëm të pafundësisë. Në mendimet dhe jetët e këtyre njerëzve “metafizika” bëhet plotësuese e “fizikës”, shpirtërorja bëhet vlere dhe përmbajtja e vërtetë e lëndës, e çdo gjë del në pah me të gjitha vlerat e veta në prapaskenë. Dhe poende, në fytyrat e këtyre njerëzve vërehet një ndijim i mistershëm, një botëkuptim i thellë dhe ndryshe, sikur të frymëzuara nga qenia hapur kah rrethi i thellë i emrave dhe cilësive hyjnore, por edhe sikur buron një pjekuri, një ngopje, një qashtërsi, një përzemërsi dhe ndjeshmëri e ushqyer me kënaqësitë e arta të besimit. Edhe sikur të mos flasin fare, të mos tregojnë asgjë, nga ato qëndrime, sjellje, shikime, reagime dhe pozita e tyre kuptimplotë këto kuptime dalin, kuptohen dhe jehojnë në të gjitha anët.

Nuk ka asnjë muaj tjetër që të ketë krahët e përmasën e Kuranit, si muaji i bekuar i Ramazanit, që i ka të ndritura me një nur të veçantë, si natën, ashtu edhe ditën. Çdo Ramazan, njeriu sheh, ndien dhe kupton Kuranin me tërë freskinë e tij dhe burimin e tij të përtejquajve, njohjen hyjnore me të cilën është i veshur ai, shenjat e tij të shpërndara kudo nëpër gjithnjajën e kohë-hapësirës, dashurinë e Allahut dhe shenjat e ndritura që shkëlqejnë në fytyrat e atyre që i kanë besuar Atij.

Po, gjatë Ramazanit, Kurani shndrit me një përjetësi të pashoqe në të gjithë sytë plot shkëlqim të këtyre fytyrave të thadruara prej kaderit, të cilët janë dëshmitarët e thellësisë së brendshme të tërë shpirtërores... gra e burra, të moshuar e të rinj, të pasur e të varfër, të ditur e të paditur, aristokratë e popuj, në këtë prerje të bekuar të kohës, pothuajse të gjithë bëhen njësh me muajin e Ramazanit dhe frymon veç përmbajtjen hyjnore që vjen bashkë me të...

Po, me të të gjithë, secili sipas aftësisë dhe kapacitetit të vet, në një

dimension krejt të veçantë, pastrohen nga çdo sjellje e papërshtatshme, çdo veprim që mund ta përmbysë e poshtërojë njeriun, apo çdo papastërti shpirtërore qoftë ajo... duke e shndërruar në një prej njerëzve të Xhenetit. Për nga begatia dhe prurja e çdo të mire muaji i Ramazanit është aq i pasur, sa që çdonjëri që strehohet nën hijen e tij mund të përfitojë nga pasuria dhe ngopja që ai sjell dhe mund të arrijë në mbretëritë e përjetësisë: të rinj e të moshuar, besimtarë të shëndoshë a problematikë, të zgjuar a të mefshtë, inteligjentë a të çmendur, të atillë që u është hapur shikimi përtej perdeve a të atillë që i kanë sytë të mbyllur, të dobishëm a të padobishëm, njerëz që e kapin çdo gjë në ajër a njerëz që nuk lagen as nën shi, të lindur në këtë botë për të sunduar a të lindur për t'u sunduar, nga ata që rrinë në këmbë edhe mes njëmijë e një problemesh a ata që nuk durojnë dot as lëkundjen më të vogël e rrokullisen dhe e çojnë jetën me pesimizëm e duke vajtuar apo ata që arrijnë të këndojnë muzikën e shpresës edhe brenda ferrit, apo ata që nuk gjejnë dot asnjëherë zgjidhje, por e shtyjnë jetën duke u mbështetur te të tjerët - vullnetet zëri i të cilëve kumbon shpresën edhe teksa janë duke u përballur me vështirësitë më të pazgjdhshme, apo edhe ata njerëz që duan më së shumti rehatinë e trupit të tyre e që e kanë programuar jetën vetëmse te të ngrënë, të pirët dhe të fjeturit dhe ata njerëz që e kanë tejkaluar njëherë e mirë të ngrënë, të pirët dhe gjumin... Po, tërë këto klasa, secila me njerëz krejt të ndryshëm nga njëri-tjetri, edhe pse secili në përmasa të ndryshme dhe sipas gjendjes dhe aftësive të veta, të gjithë tjetërsohen, pësojnë shndërrime dhe arrijnë në të tjera lartësi medoemos kur hyjnë në atmosferën e këtij muaji...

Në saje të frekuencave në valën e kësaj fshehtësie të mistershme që lëshon mbi grupe të ndryshme njerëzish bukuria dhe drita e Ramazanit dhe për rrjedhojë, edhe madhështia plot domethënie shpirtërore e ekzistencës, e cila reflekton në sytë e hapur kah ajo dritë, ky muaj zbret e shkrihet ndër zemra me atë shijen, atmosferën, frymën dhe shpirtin karakteristik të tij, sa që edhe mendjet më kokëforta e inatçore nuk i bëjnë dot rezistencë dhe dorëzohen tek ai.

Përgjatë Ramazanit, netët që e mbulojnë çdo gjë me misteret e

tyre dhe ditët që i përqafojnë ndjenjat dhe mendimet e njerëzve me butësinë e ëmbëlsinë e tyre, janë aq të ngrohta dhe të buta, sa që çehret që kanë besuar kaplohen aq shumë nga ndjenjat dhe bëhen të thella në mendim, zërat që ftojnë për tek Allahu bëhen aq të dhembshur dhe tërë domethënia e mesazheve që japin këto të gjitha bashkë, janë aq prekëse, sa që ata që mund t'ia hapin zemrat e tyre këtij muaji të faljes, largohen nga shqetësimet dhe vuajtjet, sikur edhe për një farë kohe, dhe mund të ndiejnë lumturinë e Xhenetit.

## **2. Kuptimi i fjalës Ramazan**

Për kuptimin e fjalës Ramazan ka pasur mendime të ndryshme. Këto janë:

1. Fjalët *er-Ramaz* dhe *er-Ramza*, kanë kuptimin “jashtëzakonisht nxehtë”. Nëse mendohet prejardhja prej këtyre fjalëve, atëherë muaji i Ramazanit fiton domethënien, “muaji që i djeg dhe i zhbën mëkatet”. Veç kësaj, këtë emër mund ta ketë marrë edhe nga nxehtësia që ndodh te njerëzit prej qëndrimit të etur dhe të uritur gjatë agjërimit të mbajtur në këtë muaj.

2. Fjala *er-Ramaz* ka edhe kuptimin e shiut që bie në fund të verës ose në fillim të vjeshtës dhe i jep jetë tokës së tharë nga të nxehtët dhe e pastron tokën nga pluhuri i verës. Sipas kësaj, Ramazanit i përftohet kuptimi i “muajit që freskon zemrat e përvëluara dhe pastron mëkatet”.

## **3. Virtyti i muajit të Ramazanit**

Në një hutbe të mbajtur me rastin e afrimit të muajit të Ramazanit, Profeti ynë i Nderuar (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) u pati thënë sahabëve të Tij:

*“O njerëz! Hija e një muaji të lartë dhe të bekuar mbërriti gjer mbi kryet tona. Ky është një muaj i atillë, në të cilin gjendet nata e Kadrit, që është më e mirë dhe e mbarë edhe se njëmijë muaj. Allahu ju ka caktuar*

*që këtë muaj ta kaloni duke agjëruar gjatë ditës dhe duke bërë adhurime nafile (shitesë) gjatë natës. Ai që bën një të mirë nga vetja gjatë këtij muaji, fiton shpërblim sikur të ketë bërë një të mirë që është e detyruar në muajt e tjerë. Ai që bën një të mirë që është e detyruar gjatë këtij muaji, fiton shpërblime sikur të ketë kryer shtatëdhjetë të mira që janë të detyruar në muajt e tjerë. Ky është muaji i durimit. Dhe shpërblimi i durimit është Parajsa. Ky është muaji i ndarjes me të tjerët dhe i mbështetjes te njëritjetri. Kush i shtron iftar një agjëruesi, kjo bëhet shkas që ai të falet dhe të shpëtojë nga Xhehenemi. Fiton edhe shpërblim sa ai agjërues, pa iu pakësuar as atij asgjë nga shpërblimet e tij.”*

Disa nga sahabët thanë: “O i Dërguar i Allahut, po jo të gjithë ne kemi mundësi t’i shtrojmë iftar një agjëruesi.” - I Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi Të), i dëgjoi këto fjalë dhe tha: “Këtë shpërblim Allahu ia jep edhe atij që jep iftar sikur edhe me një hurmë apo një gllënjë ujë ose qumësht të vetme.”

Në vazhdim, Profeti ynë tha: “Ky është një muaj që fillimin e ka mëshirë, mesin falje dhe fundin shpëtim nga Xhehenemi. Kushdo që ia lehtëson punën punëtorit apo shërbyesit të tij gjatë këtij muaji, edhe Allahu e fal atë duke e shpëtuar nga Xhehenemi. Në këtë muaj, katër gjëra t’i bëni sa më shumë. Me dy të parat fitoni kënaqësinë e Zotit tuaj, ndërsa me dy të tjerat nuk mund të ngeleni mospritës. Dy punët, me të cilat mund të fitoni kënaqësinë e Zotit janë: të thoni Fjalën e Dëshmisë dhe të kërkonit falje pa ndërprerë. Kurse dy punët, nga të cilat nuk mund të jeni mospritës, janë: t’i kërkonit Allahut Xhenetin dhe t’i kërkonit që t’ju mbrojnë nga Xhehenemi. Kush i jep të hajë e të pijë dikujt që ka agjëruar, Allahu i jep atij të pijë në Xhenet një ujë të atillë nga burimi im, aq sa ai nuk ndien më etje gjersa të hyjë në Xhenet.”<sup>15</sup>

Çdo ditë e Allahut është e bekuar. Mirëpo, nga mënyra se si i vlerësojnë njerëzit këto ditë, ato fitojnë një begati të veçantë, duke u kthyer në prerje të arta të kohës. Kurse muaji i Ramazanit është një prerje e bërë e artë që në krye nga Allahu i Madhërishëm. Sepse ai është kryekëput muaji i mëshirës dhe faljes.

<sup>15</sup> Ibni Huzejme, *es-Sahih* 3/191; el-Bejhaki, *Shuabu’l-iman* 3/306.

Po, muaji i bekuar i Ramazanit bart një rëndësi të veçantë dhe të posaçme për të gjithë myslimanët. Prandaj, çdo mysliman do që ta vlerësojë sa më mirë këtë muaj. Me këtë rast, disa shkojnë nëpër vendet e shenjta, në Mekë dhe në Medinë, disa duke shtuar adhurimet atje ku gjendet, duke u përfutur atyre një thellësi të re, ndërsa dikush tjetër përpiqet me rrugë të tjera dhe sipas shkallës së sinqeritetit të vet, bëhet i denjë për mirësitë e Allahut.

Ramazani i duket njeriut si një muaj në vit kur ai mund të ndihet sikur shëtiti në kodrinat e Parajsës, edhe pse është ende në këtë botë. Njësoj sikur të jetë duke vrapuar për të parë bukurinë e Allahut në kodrinat e Parajsës, nguti për të prituri iftarin zgjon tek ai njëherazi ndjesinë e pritjes për të parë një orë e më parë bukurinë e Allahut. Zgjimi çdo natë, përgjatë një muaji, për të ngrënë syfy, ndihet në ndërgjegje si të ishte ngritja për t'u ringjallur. Prandaj bajramët e Ramazanit, edhe pse janë ditë gëzimi të veçanta, gjatë këtyre ditëve të gjitha këto ndjenja janë të mbështjella nga një farë trishtimi, sikur të thuhej: "Ah sikur të mos mbaronte Ramazani!"

Nga ana tjetër, megjithëse Ramazani është një kohë e shkurtër sa një muaj, ai fiton mbi të gjitha zakonet e përfutura prej nesh gjatë njëmbëdhjetë muajve të tjerë dhe na bën që t'i harrojmë tërësej ato. Sikur të thoshte, "unë jam prerja më e vyer e kohës" dhe lë te ne gjurmë më shumë sesa të njëmbëdhjetë muajt e tjerë të vitit bashkë, duke sunduar mbi kohën në tërësi. Dhe ai vlerën nuk e fiton vetëm se është muaji i agjërimit dhe teravive. Në të njëjtën kohë, ai është muaji i Kuranit, prandaj, në një përmasë krejt tjetër, ai është edhe muaji i afrimit tonë me Allahun. Në një kohë të caktuar, Allahu reflekton në qiellin e rruzullit tokës dhe thotë: "Nuk ka asnjë që të më lutet, që Unë t'i përgjigjem lutjes së tij! Nuk ka ndonjë njeri që të më kërkojë diçka dhe Unë t'ia plotësoj atij kërkesën! Nuk ka ndonjë njeri që të më kërkojë ta fal dhe unë ta fal atë..."<sup>16</sup> - kështu thotë dhe çdo natë, na i mbështjell ndërgjegjen, ndjeshmëritë tona të holla hyjnore, shqisat dhe vetëdijet tërësej dhe me gjuhën e misticizmit, na bëjnë të përjetojmë një afrim

<sup>16</sup> Buhariu, *teuhid* 35, *tehexhud* 14, *daauat* 13; Muslim, *musafirin* 166.

me Krijuesin. Të gjitha këto gjendje na bëjnë të përjetojmë dëshmimin e vërtetë dhe të bëhemi bashkëbisedues me Zotin.

Muaji i Ramazanit është muaji më i nderuar pranë Allahut. Prandaj edhe ai është përmendur gjithmonë si mbreti i muajve. Ai ka një epërsi të dukshme ndaj të gjithë muajve të tjerë të vitit. Edhe muajt e tjerë Allahu i ka krijuar, por Ramazanit i ka falur një virtyt të rrallë. Ai fillimin e ka mëshirë, mesin falje, ndërsa fundin çlirim nga Xhehenemi. Kurani Fisnik, i cili është fjala e lartësuar e Allahut të Madhërishëm dhe që do të shërbejë gjer në ditën e kiametit si udhërrëfyes për mbarë njerëzimin, ka zbritur në qiellin e botës pikërisht në muajin e Ramazanit, ndaj ai është edhe muaji i Kuranit. Gjatë këtij muaji besimtarët kalojnë kohë vazhdimisht me Kuranin dhe bëjnë çdo përpjekje për ta lexuar atë me herë të tëra nga fillimi gjer në fund, për ta mësuar përmendësh atë dhe që t'ia kuptojnë sa më mirë domethënien e ajeteve në të. Dhe siç e thotë vetë Allahu në Kuran, edhe nata e Kadrit, që është “më e mirë edhe se njëmijë muaj”,<sup>17</sup> gjendet pikërisht në këtë muaj. Por dhe ky hadith i bekuar i Profetit tonë (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) e shpjegon mjaft bukur virtytin e këtij muaj:

*“Nëse do t'ia dinin virtytet muajit të Ramazanit, robërit e Allahut do të luteshin që i gjithë viti të ishte Ramazan.”*<sup>18</sup>

Pranë Allahut, të gjitha veprimet, bëmat dhe punët e bëra gjatë Ramazanit janë shumë herë më të vyera se çdo punë e bërë muajt e tjerë. Për këtë arsye, duhen bërë përpjekje të jashtëzakonshme që as edhe një çast i vetëm i Ramazanit të mos kalojë kot. Çdo besimtarë duhet të përpiqet të ngarendë më shumë për çdo lloj të mire që mund të bëjë, për shembull, nëse çdo ditë ka falur pesë kohët e namazit, t'u shtojë atyre edhe pesë të tjera, nëse çdo ditë ka lexuar nga një xhuz të Kuranit, t'u shtojë atyre edhe nga disa xhuze të tjera në ditë, të shpërndajë sa më shumë sadaka dhe t'i forcojë edhe më shumë lidhjet me familjen e tij. Nga Abdullah bin Abasi (radijallahu anhuma) na është transmetuar që Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) ka thënë:

<sup>17</sup> Kadr, 97/3.

<sup>18</sup> et-Taberani, *el-Mu'xhemu'l-kebir* 2/388; el-Hejthemi, *Mexhmeu'z-zeuaid* 3/141.

*“Një umre, një haxh i bërë gjatë muajit të Ramazanit bëhet i denjë për të fituar shpërblim sa një umre apo një haxh i bërë bashkë me mua.”<sup>19</sup>*

Çdo vit të jetës së tij, besimtari dëshmon periudhën shpirtërore të këtyre tre muajve. Kjo periudhë nis me muajin e Rexhepit dhe me një farë doze në rritje, arrin majën në Ramazan. Me Ramazanin njeriu sikur fillon t'i përkasë tëresisht amshimit. E si të mos i përkasë? Ebu Hurejreja (radijallahu anh) na ka transmetuar se i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) ka thënë kështu:

*“Kur hyn muaji i bekuar i Ramazanit, hapen portat e Xhenetit (sipas një transmetimi tjetër thuhet portat e mëshirës së Allahut), mbyllen portat e xhehenemit dhe shejtanëve u vihen zinxhirët.”<sup>20</sup>*

Duket sikur Zoti u vë prangat djajve dhe mbyll të gjithë koridorët që shkojnë drejt Xhehenemit, vetëm që njeriu të kthehet në engjëll, madje duke i hapur edhe tërë koridorët që të çojnë në Xhenet. Njeriu vetëdijshëm për tërë këto mirësi që fal Ramazani, e përdor gjer në fund këtë mundësi duke u përpjekur të bëhet sa më i denjë për parajsën. Sepse kështu ka vepruar edhe vetë Udhërrëfyesi ynë i Përkryer (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem). Që, siç na e tregon bashkëshortja e Tij e kulluar, Aishja e nderuar (radijallahu anha):

*“Me të ardhur dhjetëditëshi i fundit i muajit të Ramazanit, i Dërguari i Allahut i gjallëronte netët me adhurim, zgjonte edhe familjen, hiqte dorë krejtësisht nga bota dhe ia kushtonte veten robërimit karshi Allahut.”<sup>21</sup>*

Ai (pqmT) nuk mjaftohej vetëm me adhurimet, por bënte çdo përpjekje që të bënte çdo të mirë që mund të bëhej dhe të përparonte në rrugën e afrimit me Allahut. Ibni Abasi ka thënë:

*“I Dërguari i Allahut ishte më bujari ndër njerëz. Ndërsa koha kur bujaria e Tij arrinte maja, ishte koha kur takohej me Xhebrailin (alejhis'selam). Çdo natë të Ramazanit, Xhebraili (alejhis'selam) takohej me të Dërguarin e Allahut dhe lexonin Kuran me njëri-tjetrin*

19 Buhariu, *xhezau's-sajd* 26; Muslim, *haxh* 222.

20 Buhariu, *saum* 5; Muslim, *sijam* 1.

21 Buhariu, *fadlu lejleti'l-kadr* 5; Muslim, *itikaf* 7.



(mukabele). *Gjatë kësaj periudhe, Ai (pqmT) bëhej më bujar edhe se një erë e begatë që fryn më shpejtësi pa u penguar askund.*<sup>22</sup>

Një virtyt tjetër i muajit të Ramazanit është që ai e pastron çdo mëkat të njeriut. E patëm shprehur edhe më parë, që ky kuptim është edhe në rrënjën e fjalës së tij. Këtë domethënie e mbështet edhe transmetimi i Ebu Hurejres (radijallahu anh), sipas të cilit i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) ka thënë:

*“Nëse u shmangeni mëkateve të mëdha, pesë kohët e namazit, namazi i xhumasë dhe muajt e Ramazanit të kaluar me adhurime të shumta, janë falje për mëkatet (e kryera ndërmjet).”<sup>23</sup>*

Allahu i Madhërishëm (xhel'le xhelaluhu) e ka caktuar detyrim adhurimin e agjërimit, shpërblimin e të cilit e ka marrë përsipër Vetë, pikërisht në muajin e Ramazanit. Agjërimet e mbajtura gjatë një muaji të tërë i përftojnë një vlerë edhe më të veçantë Ramazanit, për të fituar kënaqësinë e Allahut. Profeti ynë i Nderuar (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) ka thënë kështu në lidhje me agjërimin e mbajtur gjatë këtij muaji:

*“Njeriu që humbet pa pasur kurrfarë arsyeje një ditë pa agjëruar nga Ramazani, sikur një vit të tërë të agjërojë më pas, ende nuk e fiton dot shpërblimin e asaj një dite të tij.”<sup>24</sup>*

Në çdo natë të këtij muaji, me mijëra, ndoshta me miliona robër mëkatarë të Zotit bëhen të denjë për faljen dhe mëshirën e Allahut; bëhen të denjë për Xhenetin, ndërkohë që ajo që meritojnë është Xhehenemi. Në këtë muaj hapen portat e mëshirës, punët e bëra vlerësohen shumëfish herë më shumë. Poende, kush i jep të hajë iftar një personi, në librin e jetës së tij shtohet edhe shpërblimi i agjërimit të mbajtur prej atij personi. Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) ka thënë:

*“Kush i shtron të hajë iftar një agjëruesi, fiton shpërblime sa ai që ka*

<sup>22</sup> Buhariu, *bed'u'l-uahj* 5, *saum* 7; Muslim, *fedail* 50.

<sup>23</sup> Muslim, *taharet* 16; Ahmed bin Hanbel, *el-Musned* 2/359.

<sup>24</sup> Buhariu, *saum* 29; Tirmidhi, *saum* 27; Ebu Daud, *saum* 38; Ibni Maxhe, *sijam* 14.

agjëruar. Dhe nuk pakësohet asgjë nga shpërblimi i atij që ka agjëruar.”<sup>25</sup>

### ***Tre vetë e humbasin mundësinë***

Në një hadith na thuhet se njëherë Profeti ynë i Nderuar (paqja goftë mbi Të) qe ngjitur në minber për të mbajtur hutben dhe në çdo tri shkallë pati thënë “amin”. Kur mbaroi hutbeja, sahabët e nderuar e pyetën: “O i Dërguari i Allahut! Ne sot dëgjuam nga goja jote diçka që nuk e kishim dëgjuar kurrë më parë; teksa ngjiteshin në minber, thatë tri herë “amin”. Cila është urtësia e kësaj?” - Dhe Profeti ynë i Nderuar u përgjigj me këto fjalë:

“Në atë kohë erdhi Xhebraili (alejhisselam) dhe tha: ‘Turp t’u vijë dhe vuajtje paçin ata që nëna dhe babai u ka arritur në moshën e pleqërisë dhe ata nuk kujdesen për të drejtat e tyre, nuk i trajtojnë ata mirë dhe nuk e vlerësojnë siç duhet mundësinë që të falen.’ - ndaj unë thashë “amin!” Pastaj Xhebraili tha: “O i Dërguari i Allahut! Turp t’u vijë dhe vuajtje paçin edhe ata që dëgjojnë të përmendet emri Yt, por nuk të dërgojnë Ty përshëndetje!” - dhe unë thashë “amin!” - Dhe në shkallën e fundit Xhebraili tha sërish: ‘Turp t’u vijë edhe njerëzve që e kanë kuptuar Ramazanin, por nuk kanë fituar dot faljen e Allahut!’ - dhe unë thashë sërish “amin!”<sup>26</sup>

Allahu u ngarkon njerëzve përgjegjësi nëpërmjet disa përgjegjësave që kanë një farë barre dhe vështirësie. Pavarësisht dimensionit të sprovës që ka secila syresh, urtësia dhe qëllimi hyjnor i secilës prej këtyre përgjegjësave është që robi të bëhet i denjë për të merituar faljen e Allahut. Mirëpo, nëse robi nuk e kryen detyrën e tij, jo vetëm që nuk përfiton dot nga mundësia që i ka ofruar Allahu si mirësi, por mund të meritojë edhe ndëshkimin, sipas rastit. Edhe në hadithin e përmendur më sipër janë përmendur tre nga përgjegjësitë që Allahu u ka ngarkuar njerëzve.

E para është përgjegjësia e njeriut për t’i shërbyer nënës dhe babait,

<sup>25</sup> Tirmidhi, *saum* 82; Ibnî Maxhe, *sijam* 45.

<sup>26</sup> et-Taberani, *el-Mu’xhemu’l-kebir* 19/144; el-Bejhaki, *Shuabu’l-iman* 2/215.

të cilët janë bërë shkas për ardhjen e tij në jetë; e dyta, përgjegjësia e shprehjes së falënderimit dhe mirënjohjes ndaj Profetit, nga i Cili kanë mësuar çdo gjë të fesë; e treta, përgjegjësia e shfrytëzimit të muajit të Ramazanit, i cili është një mirësi që Allahu ua ka falur njerëzve, në mënyrë që ata të mund të pastrohen nga mëkatet.

Po, të tria këto përgjegjësi kanë disa vështirësi. Mirëpo, po të krahasohen me shpërblimin e premtuar për to, ato mbeten fare të vogla. Në këmbim të tyre ka shpërblime shumë të shtrenjta, siç janë shpëtimi nga Xhehenemi, Xheneti vetë, apo edhe vështrimi i bukurisë së Allahut të Madhërishëm. Andaj ato nuk duhet kurrsesi të shihen si vështirësi të mëdha. Pastaj edhe të kuptuarit e vlerave të nënës dhe babait, përmendjes së Emrit të Madh të Dërguarit të Allahut pranë Tij dhe arritjes së muajit të Ramazanit, janë të gjitha mirësi hyjnore tejet të rëndësishme më vete. Por, prapëseprapë, njeriu që nuk e kupton vlerën e këtyre mirësive, pavarësisht kësaj, e meriton ndëshkimin nga fillimi deri në fund.

Kjo është arsyeja që Xhebraili (alejhis'selam) përdor shprehjen “*vuajtje paçin*”, si për të treguar se sa të mjerë dhe të humbur janë ata që nuk përballojnë dot as një përgjegjësi të vogël, edhe pse në këmbim të saj ka shpërblime tejet të mëdha; dhe Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem), si për ta aprovuar të drejtën, u ka thënë këtyre lutjeve “*amin*”.

## C. Vlerësimi i Ramazanit

### 1. Përgatitja me mendim për Ramazanin

Që të mund të vlerësohet në më të mirën e mundshme Ramazani, siç e theksuam edhe më parë, fillimisht duhet që ne ta dimë sa më mirë vlerën e tij të vërtetë. Njeriu nuk di se si ta vlerësojë diçka që nuk ia di vlerën. Të themi se keni në dorë një unazë metalike, por me një vlerë shumë të lartë antikuari. Nëse e çoni atë në tregun e hekurpunuesve, për

ta shitur, në këmbim të saj ata do t'ju japin një çmim shumë më të ulët sesa vlera e saj e vërtetë. Por, nëse e çoni atë në pazarin e antikuarëve, ata do t'ju thonë menjëherë vlerën e vërtetë të saj. Prandaj, fillimisht duhet që ju të kuptoni natyrën dhe vlerën e vërtetë të asaj unaze. Po kështu, një person që nuk ia di vlerën muajit të Ramazanit, do të jetë i pamjaftueshëm për ta vlerësuar atë. Kurse ai që ia di do të përpiqet që të mos e çojë dëm as edhe një çast të vetëm të tij. Nga kjo pikëpamje, përparësi për këtë ka që të lexohen dhe të kuptohen sa më mirë të gjitha temat që kanë të bëjnë me agjërimin dhe muajin e Ramazanit, si në Kuranin Famëlartë, ashtu edhe në hadithet e bekuara. Ai që e bën këtë, do të thotë se e ka hedhur hapin e parë në rrugën e vlerësimit të Ramazanit.

Veç kësaj, vlerën që bart Ramazani ai duhet ta mësojë nga ata që e dinë dhe e kanë kuptuar më së miri vlerën e tij. Prandaj është shumë i rëndësishëm leximi i shkrimeve të miqve të Allahut dhe njerëzve të virtytshëm dhe të ditur në lidhje me këtë çështje. Një udhërrëfyes mjaft i mirë për ne janë edhe vlerësimet që kanë për Ramazanin dhe agjërimin personalitete si Imam Gazaliu, Imam Rabaniu, Mujidin ibni Arabiu dhe Bediuzaman Said Nursiu. Veçmas, të dish edhe se si e kanë kaluar muajin e Ramazanit në rrugëtimin e tyre të jetës këta miq të Zotit do të jetë një dinamikë e jashtëzakonshme motivimi dhe rehabilitimi për sa i përket kësaj çështjeje.

## **2. Mbajtja e agjërimit**

Veçoria më e madhe e muajit të Ramazanit është agjërimi i mbajtur përgjatë këtij muaji. Me fillimin e tre muajve, besimtarët bëjnë përgatitje për agjërimin që do të mbajnë gjatë muajit të Ramazanit dhe përpiqen që të përgatisin, qoftë mendjen, qoftë trupin. Këtu është shumë i rëndësishëm edhe roli që luajnë agjërimet e mbajtura *nafile* gjatë muajve Rexhep dhe Shaban në mësimin me agjërimin, që është i detyruar gjatë Ramazanit. Sepse çdo besimtar që e arrin muajin e Ramazanit - nëse nuk ka asnjë justifikim - nuk ka asnjë alternativë tjetër

pos agjërimit. Sepse, siç e trajtuam edhe më parë, i Dërguari i Allahut (sal)lallahu alejhi ues)sel)lem) ka thënë se një ditë agjërimi e Ramazanit e pa mbajtur pa kurrfarë justifikimi nuk mund të zëvendësohet as me agjërimin e një viti të tërë në ditët e tjera të vitit.<sup>27</sup> Rrjedhimisht, mund të themi se në krye të të gjitha gjërave që duhet të bëhen gjatë muajit të Ramazanit vjen mbajtja e agjërimit.

Duke qenë se çështjen e mbajtjes së agjërimit do ta trajtojmë gjerësisht në pjesët e ardhshme të librit, këtu do të mjaftohemi me kaq.

### ***3. Kalimi i kohës duke qenë i zënë me Kuranin***

Kurani Fisnik është zbritur në muajin e Ramazanit. Nga kjo pikëpamje, kjo është arsyeja që muaji i Ramazanit cilësohet ndryshe edhe si “muaji i Kuranit”. Kurani është burimi i udhëzimit të besimtarëve, ndaj është një libër që duhet të lexohet pa ndërprerje dhe të mendohet rreth tij, si dhe të meditohet sa më shumë në lidhje me trajtesat e ofruara në të. Sepse më shumë se për çdo gjë, besimtari ka nevojë për Kuranin. Kurani ka për jetën shpirtërore të njeriut kuptimin që kanë buka, uji, ajri, për mëkëmbjen e jetës së tij fizike. I Dërguari Fisnik (paqja qoftë mbi Të), të gjithë jetën e ka kaluar duke i thirrur njerëzit drejt Kuranit dhe duke u siguruar që ata ta jetojnë jetën në përputhje me Kuranin. Sahabët fisnikë tregojnë se veçanërisht në namaz, Profeti ynë lexonte shumë Kuran. Veç kësaj, përveçse këndonte vetë, Ai ua këndonte Kuranin edhe sahabëve të Tij. Koha që kalonte me Kuranin shtohet edhe më shumë me ardhjen e Ramazanit duke fituar një rëndësi të posaçme për Të.

Neve na janë transmetuar shumë hadithe në lidhje me virtytin e kalimit kohë me Kuranin. Për shembull, Ebu Umameja i nderuar (radijallahu anh) na transmeton se i Dërguari i Allahut (pqmT) ka thënë:

*“Lexoni Kuran. Sepse, në ditën e Gjykimit, Kurani do të bëhet*

<sup>27</sup> Buhariu, *saum* 29; Tirmidhi, *saum* 27; Ebu Daud, *saum* 38; Ibni Maxhe, *sijam* 14.

*ndërmjetësues për ata që e kanë lexuar.*<sup>28</sup>

Njëherë, Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) ka thënë kështu:

*“Ka shpërblim për çdo shkronjë të vetme të lexuar nga Kurani Fisnik dhe këto shpërblime shkruhen dhjetëfish në librin e shpërblimeve të njeriut. Për shembull, Elif-Lam-Mim nuk janë një gërmë e vetme; Elif është një gërmë, lam një gërmë, mim një gërmë tjetër.”*<sup>29</sup>

Sipas një transmetimi që vjen nga Aishja e nderuar (radijallahu anha), Profeti Fisnik (paqja qoftë mbi Të) ka thënë:

*“Kush është i mirë në leximin e Kuranit dhe e lexon atë bukur dhe ashtu siç duhet është bashkë me engjëjt e nderuar dhe të bindur me të cilët është zbritur shpallja. Në anën tjetër, ata që nuk janë të mirë në të, që kanë vështirësi në leximin e Kuranit dhe që mund ta lexojnë atë duke belbëzuar, marrin dyfish shpërblim (sepsepavarësisht kësaj vazhdojnë të lexojnë e këndojnë Kuran).”*<sup>30</sup>

Pranë Allahut, një vlerë të veçantë ka edhe që t'ua mësosh edhe të tjerëve leximin dhe këndimin e Kuranit, krahas leximit dhe këndimit vetë. Siç na transmetohet prej Osman bin Afanit (radijallahu anh), Profeti ynë (pqmT) ka thënë:

*“Më të mbarët ndër ju janë ata që e mësojnë Kuranin vetë dhe ua mësojnë atë edhe të tjerëve.”*<sup>31</sup>

Një nga dy njerëzit që do të shihen me zili nga të gjithë është ai që kalon kohën duke qenë i zënë me Kuranin Famëlartë. Nga ibni Omeri na është transmetuar se i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) ka thënë:

*“Vetëm dy njerëz janë të denjë për t'u pasur zili: Njëri është ai që Allahu i ka dhënë (dijen) e Kuranit dhe merret me të ditë e natë, ndërsa tjetri është ai që Allahu i ka dhënë pasuri dhe ai, ditë e natë, e shpenzon*

<sup>28</sup> Muslim, *salatu'l-musafirin* 252; Ahmed bin Hanbel, *el-Musned* 5/249, 257.

<sup>29</sup> Tirmidhi, *fedailu'l-Kuran* 16; el-Bejhaki, *Shuabu'l-Iman* 2/342.

<sup>30</sup> Muslim, *salatu'l-musafirin* 244; Ibni Maxhe, *edeb* 52.

<sup>31</sup> Buhariu, *fedailu'l-Kuran* 21; Tirmidhi, *fedailu'l-Kuran* 15.

*atë në rrugën e Tij.*<sup>32</sup>

Kurse nga një hadith tjetër që na e ka transmetuar Abdullah bin Amri (radijallahu anh) thuhet se shkalla e njeriut në amshim do të jetë sipas Kuranit që ka lexuar:

*“Atij që është marrë në çdo kohë me leximin e Kuranit do t’i thuhet: ‘Lexo dhe lartësohu, lexoje me saktësi dhe bukuri edhe këtu, njësoj siç e lexoje me saktësi dhe bukuri edhe në atë botë. Nuk ka dyshim, që shkalla jote është pranë ajetit të fundit që lexove.’”*<sup>33</sup>

Shtëpitë, në të cilat lexohet Kuran dhe diskutohet rreth Kuranit, i mbështjell mëshira e Allahut. Siç transmetohet edhe prej Ebu Hurejres (radijallahu anh), i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ues’sel’lem) ka thënë kështu:

*“Nëse një grup njerëzish mbledhet në një prej shtëpive të Allahut, lexojnë Kuran dhe diskutojnë rreth Tij mes veti, mbi ta bie një qetësi, ata i mbështjell një mëshirë dhe rrethohen nga engjëjt. Allahu i përmend ata njerëz me ata që gjenden pranë Tij.”*<sup>34</sup>

Krahas leximit shumë të Kuranit dhe mësimit të tij përmendësh, thelbësore është që të dish domethëniet që fshihen brenda tij. Sepse edhe pse leximi pa kuptuar asgjë ka shpërblimin e tij, Allahu e ka zbritur atë që ta kuptojmë dhe të veprojmë në përputhje me urdhëresat që janë brenda tij. Në një hadith, i cili bart pikërisht këtë përmbajtje, Profeti ynë (pqmT) e ka portretizuar me këto fjalë gjendjen në ditën e kiametit të atyre që kanë lexuar Kuran dhe kanë vepruar në përputhje me ato çfarë kanë lexuar:

*“Kush e lexon Kuranin Fisnik dhe vepron sipas tij, në ditën e kiametit, prindit të tij i vihet mbi krye një kurorë. Imagjinoni se sa dritë do të krijohej nëse futej dielli brenda një shtëpie, më e madhe dhe më e bukur do të jetë edhe drita që lëshon kjo kurorë. Kur gjendja e prindit është e këtyllë, e imagjinoni se sa e fortë do të jetë drita e vetë atij që ka*

<sup>32</sup> Buhariu, *fedailu’l-Kuran* 20, *teuhid* 45; Muslim, *salatu’l-musafirin* 266-267.

<sup>33</sup> Tirmidhiu, *fedailu’l-Kuran* 18; Ebu Daud, *uitr* 20.

<sup>34</sup> Muslim, *dhikr* 38; Ebu Daud, *uitr* 14; Ibni Maxhe, *mukaddime* 17.

vepruar me Kuranin?”<sup>35</sup>

Në një hadith tjetër i Dërguari i Allahut (pqmT) thotë kështu:

“Kush e lexon Kuranin, e mëson atë mirë përmendësh, e pranon të lejuarën si të lejuar, të ndaluarën si të ndaluar dhe u bindet këtyre, në saje të kësaj Allahu e vë në Xhenet robin e Tij. Veç kësaj, i jep të drejtën e ndërmjetësimit për dhjetë pjesëtarë të familjes së tij, edhe nëse ata e kanë pasur hak Xhehenemin.”<sup>36</sup>

Veç përshkrimit të virtyteve të kalimit të kohës me Kuranin, Profeti ynë i Nderuar (pqmT) e përngjason zemrën, në të cilën nuk ka vend Kurani, si një shtëpi të mbetur rrënojë. Na është transmetuar edhe nga ibni Abasi (radijallahu anh), se i Dërguari i Allahut (pqmT) ka thënë:

“Njeriu, në zemrën e të cilit nuk gjendet asgjë prej Kuranit, është si një shtëpi e mbetur rrënojë.”<sup>37</sup>

### ***Mukabeleja e Ramazanit***

Edhe ata që kanë qëndruar larg Kuranit përgjatë një viti të tërë, në klimën ndriçuese të Kuranit kanë mundësi të pijnë me etje të madhe prej burimit të Fjalës hyjnore. Një nga rrugët më të rëndësishme të realizimit të kësaj janë edhe *mukabele*-të që realizohen kudo përgjatë këtij muaji, që është edhe muaji i faljes.

Xhebraili (alejhis'selam) zbriste çdo vit, në çdo ditë të muajit të Ramazanit - sipas një transmetimi tjetër, çdo natë të muajit të Ramazanit - pranë të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem), për të parë që Kurani ruhet i pandryshuar, ashtu siç është zbritur nga Allahu dhe suret janë të organizuara në mënyrën e duhur; i Dërguari Fisnik (alejhi ekmelu'tehaja) ia këndonte Xhebrailit ajetet një e nga një, ndërsa Xhebraili i nderuar ia dëgjonte këndimin me kujdes.

Dhe ja, këndimi (leximi) i ndërsjellë në këtë mënyrë i Kuranit Fisnik mes Krenarisë së Njerëzimit dhe Xhebrailit të Besuar është

<sup>35</sup> Ebu Daud, *uitr* 14.

<sup>36</sup> Tirmidhi, *fedailu'l-Kuran* 13; Ahmed bin Hanbel, *el-Musned* 1/148, 149.

<sup>37</sup> Tirmidhi, *fedailu'l-Kuran* 18; Darimi, *fedailu'l-Kuran* 1.



quajtur *mukabele*. Për këtë arsye besimtarët e kanë kthyer tashmë në një traditë mbledhjen përgjatë Ramazanit nëpër xhami ose shtëpi, për ta lexuar Kuranin me mukabele, por edhe për të bërë hatme të tij, edhe në shenjë respekti ndaj atij kujtimi të shenjtë, edhe meqë Kurani është zbritur pikërisht në muajin e Ramazanit dhe veçanërisht, meqë ekziston sihariqi se leximi pikërisht gjatë këtij muaji do të shpërblehet shumëfish herë.

Të parët tanë të mirë, leximin e Kuranit të plotë, të paktën njëherë në muaj, e kanë konsideruar si kufirin më të ulët të respektit dhe besnikërisë ndaj tij, duke theksuar se kush nuk e lexon atë të plotë, të paktën njëherë në muaj, do të konsiderohet jo si besnik ndaj tij dhe se e ka braktisur atë. Në këtë këndvështrim ne duhet t'i vlerësojmë më së miri ditët e Ramazanit dhe ta mësojmë veten që ta lexojmë Kuranin të paktën njëherë në muaj, dhe të jetë ky një fillim i ri për ne, që të jemi edhe në vazhdim besnikë ndaj fjalës hyjnore.

Në fakt, edhe ata që nuk e dinë duhet të jenë përherë në kërkim të mësimit dhe kuptimit të tij, ndërsa ata që dinë ta përqendrojnë të gjithë forcën te përthithja dhe mësimi i thellë i tij, na mënyrë që të dinë ta shprehin atë më mirë dhe ta bëjnë më të përhapur, si leximin, ashtu edhe kuptimet e tij. Sepse ai është dhurata më e madhe që mëshira hyjnore u ka bërë mendjes dhe aftësisë njohëse të njeriut, që ai të kuptohet dhe t'u mësohet edhe të tjerëve. Të mësosh ta lexosh atë, por edhe ta kuptosh pasi të kesh mësuar ta lexosh, janë, edhe detyrë, edhe njohje e vlerave të tij; kurse t'ua shpjegosh atë edhe të tjerëve është një tregues i respektit dhe mirënjohjes edhe ndaj zemrave që kanë nevojë për dritën e tij.

Për rrjedhojë, nëse nuk dimë të lexojmë Kuran, ta bëjmë Ramazanin e bekuar arsye dhe të vihemi në kërkim të rrugëve për mësimin e tij. Nëse arrijmë që ta lexojmë fjalën hyjnore, por nuk e kuptojmë dot atë, atëherë t'u drejtohem kuptimit të ajeteve në gjuhën tonë dhe interpretimeve të tyre, ose diçka që është edhe më e bukur, të lexojmë një libër të mirë *tefsiri*. Vetëm kështu do të mund ta trajtojmë këtë muaj si muaj i Kuranit. Për shembull, pas leximit të një faqeje Kuran, mund

të ndalemi te kuptimi i ajeteve në atë faqe. Këtë është e mundur që ta bësh lehtësisht edhe duke e ndarë nëpër orë të ndryshme të ditës. Bie fjala, një xhuz i Kuranit mund të lexohet i ndarë në tri pjesë, një në drekë, një në ikindi dhe një gjatë teravive. Po, të paktën të përpiqemi t'i japim sadopak nga vlera e merituar në këtë formë. Çfarë kërkon Allahu prej nesh në Kuranin Fisnik? Cilat janë synimet e Tij të patëmeta? Ne duhet t'i drejtohem Kuranit me gjithë zemër, për t'i parë ato, t'i hapim gjer në fund portat e zemrës ndaj fjalës së Allahut dhe të bëjmë një përpjekje të denjë për bekimin e Ramazanit, për të kuptuar “se cilat janë ato që e bëjnë Allahun të jetë i kënaqur me ne, në fjalën e Tij”.

### ***Kurani Famëllartë duhet të lexohet siç e meriton ai***

Kur lexojmë Kuran, shqiptimi i drejtë i fjalëve është shumë i rëndësishëm. Nganjëherë, megjithëse e ka mësuar mirë leximin e Kuranit, disa fjalë ai mund t'i lexojë gabim. Allahu nuk e bën atë përgjegjës për këtë - dashtë Zoti i Madh. Por, kur është mundësia për një përpjekje pak më të madhe, për ta lexuar saktë, dhe qëndrohet shpërfillës duke mos i kushtuar rëndësinë e nevojshme, atëherë kjo është mungesë respekti ndaj Tij. Besimtari duhet të përpiqet që ta lexojë Kuranin, që është fjalë e Allahut, me tonin më plot respekt dhe me një gjendje shpirtërore të kapluar nga ndjenja dhe melodi respekti.

Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) thotë: “(Duke lexuar Kuran) në namaz personi i lutet Zotit, i zbraz çfarë ka në shpirt (flet me Të duke pëshpëritur, nëse më lejohet ta them kështu). Për rrjedhojë, të bëjë kujdes se si e bën këtë. Mos lexoni Kuran duke i bërë titull njëri-tjetrit.”<sup>38</sup>

Ai që është i vetëdijshëm se është duke komunikuar me Allahun teksa lexon Kuran, do të përpiqet të jetë pak më i rregullt në çdo qëndrim dhe sjellje të tij. Njësoj si ushtari, i cili qëndron gatitur përpara komandantit të tij, duke përsëritur fjalët që thotë ai, edhe ai

<sup>38</sup> Muvatta, salat 264; Ahmed bin Hanbel, *el-Musned* 2/67, 4/344; et-Taberani, *el-Mu'xhemu'l-eusat* 5/41.

do ta theksojë çdo fjalë sipas nivelit të vet shpirtëror, duke marrë pa pra kënaqësi syresh dhe me një këndim të përpiktë, sikur të ishte duke i pirë ato fjalë dhe të gjitha këto janë tregues i respektit ndaj Kuranit dhe Zotëruesit të Kuranit Famëlartë, që është Allahu i Madhërishëm.

Një besimtar që ka mangësi në këndimin e duhur të Kuranit duhet t'i vlerësojë sa më mirë mundësitë dhe të mësojë më shumë duke qëndruar pranë dikujt që di t'i shqiptojë mirë të gjitha fjalët e Kuranit dhe t'i këndojë sa më shumë gjatë faljes së namazit të gjitha ajetet e mësuara.

Po, Kurani duhet të lexohet e të këndohet si fjalë e Allahut. Sa bukur e thekson Mevlana Halidi këtë çështje, kur na tregon një shembull nga jeta e tij: “Unë lexoja shpesh Kuran. Pavarësisht, babai më thoshte gjithmonë: ‘Lexo Kuran, o bir!’ - Një ditë nuk durova dot dhe i thashë: ‘Baba, po unë nuk po e heq nga duart për asnjë çast këtë fjalë të bekuar.’ - Aty babai më tha këto fjalë: ‘O bir! Mos e lexo Kuranin si Kurani që i është zbritur të Dërguarit të nderuar të Allahut, Muhamedit (pqmT), por lexoje sikur të jesh duke e dëgjuar atë drejtpërsëdrejti nga Folësi i Pakohë i Asaj fjale, pra sikur të jesh duke e dëgjuar drejt e nga Allahu (xhel’le xhelaluhu)!’ Ja, kjo është mënyra se si duhet të lexohet Kurani.

Edhe Bediuzamani i nderuar flet se Kurani duhet të lexohet sikur të jesh duke e dëgjuar drejtpërsëdrejti nga Allahu ose Xhebraili i Besuar, apo nga Besniku i Besuar, Profeti Muhamed (pqmT).<sup>39</sup> Ta lexosh dhe ta këndosh Kuranin njësoj sikur të ishe duke e dëgjuar atë drejtpërsëdrejti nga Allahu është një çështje tejet serioze dhe e rëndësishme. Dikush që ndien brenda vetes ndjesi të këtilla karshi Kuranit, e rrotullon atë nja dhjetë herë nëpër mendje dhe mandej, ia lë amanet gjithë neuroneve të trurit. I thotë korteksit: ‘Ti prit një minutë, se do të vij sërish te ti.’ E kalon atë edhe njëherë nëpër mendje, njësoj siç kontrollon ndonjëherë dokumentat brenda një dosjeje. Kur shihet me këtë sy, ne e kuptojmë se të gjitha problemet në jetën tonë personale, familjare, shoqërore dhe kulturore, janë të përmendura në Kuranin Famëlartë, së bashku edhe me rrugëzgjdhjet për to.

<sup>39</sup> Shih: Bediuzaman Said Nursi, *Letrat*, fq. 451 (Letra e Njëzetënentë, Pika e Gjashtë).

Më duhet ta theksoj edhe njëherë se Kurani duhet të lexohet me kujdes, duke zbritur në domethëniet e tij dhe me vetëdijen se ajo që po lexojmë është fjala e Allahut, me një farë ngurrimi në gjuhë dhe me një drithërimë që na kaplon në shpirt. Sepse, Lajmëtari i Besuar (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) thotë: “*Kurani është zbritur me trishtim (melankoli). Prandaj, qani, kur të lexoni Kuran. Nëse nuk arrini të qani dot, detyrojeni veten të qani.*”<sup>40</sup>

Kurani u ngjason melodive të drejtimit nga Allahu dhe përgjërimit të një njeriu të vuajtur apo të dikujt që ecën nëpër shkretëtirë të vetëm. Ky libër, i cili u është zbritur si mik zemrave të përvuajtura, është zbritur me trishtim dhe po me një ndjesi të këtille trishtimi duhet të lexohet. Por kjo është diçka që varet një gjendja e ndërgegjeve, nëse ato arrijnë dot ose jo që ta ndiejnë atë. Në të nuk ka asnjë kuptim që mund të kuptohet prej zemrave të vdekura.

#### 4. *Namazi i teravive*

Nazai i teravive është një lloj namazi i veçantë për muajin e Ramazanit, i cili falet pas namazit të jatsisë si namaz *sunet-i muekede*<sup>41</sup>.

Profeti ynë i Nderuar (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) ua ka drejtuar sahabëve faljen e teravive për disa net me radhë, pastaj i shqetësuar se myslimanët mund të mos kenë fuqi për t'ia dalë faljes së tyre bashkë me Të, ka zgjedhur faljen e tyre vetëm. Por i ka nxitur sahabët drejt këtij namazi duke i këshilluar: “*Kush i kalon netët e agjërimit me adhurime duke e shpresuar shpërblimin vetëmse nga Allahu, atij i falen të gjitha mëkatet e shkuara.*”<sup>42</sup>

Më vonë, në periudhën e kalifatit të tij, Omeri i nderuar pati menduar se falja e këtij namazi me xhemat në xhami do t'i nxiste njerëzit më shumë drejt këtij namazi, pati caktuar disa nga sahabët që të shërbenin

<sup>40</sup> et-Taberani, *el-Mu'xhemu'l-eusat* 3/193; Për një hadith në një kuptim të përafërt, shih: Ibnî Maxhe, *ikamet* 176; Ebu Ja'la, *el-Musned* 2/50.

<sup>41</sup> Tek suneti muekkede bëjnë pjesë të gjitha gjërat, veprimet a aktet që Profeti ynë (pqmT) i ka bërë rregullisht, por që në kohë të caktuara mund të mos i ketë kryer me të njëjtën vazhdimësi.

<sup>42</sup> Buhariu, *salatu't-teraviv* 1; Muslim, *salatu'l-musafirin* 173.

si imamë për faljen e teravive në bashkësi. Domethënë themeluesi këtij zakoni të bukur në çdo anë të botës islame është Profeti ynë (paqja qoftë mbi Të), ndërsa shkaku i vazhdimësisë dhe përhapjes së saj është Omeri i nderuar (radijallahu anh).

Një besimtar, krahas faljes së pesë kohëve të namazit, duhet të bëjë përpjekje që të falë edhe namazet e tjera që janë *nafile*. E thënë me fjalët e hadithit, kur të ngrihet peshorja matanë, nëse namazet e detyruara të rob-it janë të mangëta, Allahu do të thotë: “*Shikoni, a ka namaze nafile robi im? Merrini dhe mbushini me nafile-t boshllëkun e krijuar nga mungesa e farz-eve!*”<sup>43</sup>

Një çështje tjetër, mbi të cilën lipset të ndalet është edhe ajo që numri i rekateve të namazit të teravive është po njëzet, pikërisht sa çështje edhe numri i rekateve të pesë namazeve të një dite gjithsej. Njësoj si namazet sunete që ekzistojnë mes namazeve të detyruara të një dite, njëzet rekatet e namazit të teravive mund të shikohen si plotësuese të mangësive në ato që janë të detyruara. Nëse ka diçka të metë e të mangët në namazet e detyruara; i kemi falur namazet të përhumbur; kemi lënë diçka të mangët në abdesin e marrë... këto do të arnohen e mbështillen me namazet sunet dhe nafile, dhe edhe kjo e ka burimin te thellësia e mëshirës së Allahut të Madhërishëm.

Falja e namazit të teravive me bashkësi është shumë e rëndësishme edhe për bashkëveprimin në çështjet që kanë të bëjnë me amshimin. Falja e tij duke dhënë selam në çdo dy rekate është më i virtytshmi. Mes tyre mund të lexohen edhe lutje të ndryshme, si *Xheusheni*, *Esmau’l-Husna*, dhe *Hizbul-hasinapo Hizbu’l-masun*.

Dijetarët kanë theksuar se falja e namazit të teravive duke e bërë Kuranin hatme të paktën njëherë gjatë muajit është sunet, ndërsa falja e tij duke e bërë më hatme më shumë se një herë është virtyt. Të parët tanë të mirë, ose e kanë kënduar vetë të gjithë Kuranin nga fillimi deri në fund, ose kanë falur namaz pas dikujt që e ka kënduar me hatme atë.

Kur falet namazi i teravive, qoftë duke u kënduar suret e shkurtra,

<sup>43</sup> Ebu Daud, *salat* 148; Tirmidhi, *salat* 188; Nesai, *salat* 9; Ibni Maxhe, *ikame* 202.

qoftë duke u bërë hatme, e qenësishme është që ato që këndohen të këndohen me saktësi dhe namazi të falet sipas të gjithë mënyrës së përsosur të faljes së tij. Përndryshe, këndimi i ajeteve shumë shpejt, sikur të jesh duke garuar me kohën, apo ulja në ruku dhe në sexhde sikur do që t'i heqësh qafe një orë e më parë, nuk janë kurrsesi të drejta dhe mund të konsiderohen edhe si mungesë respekti ndaj shpirtit të namazit. Besimtarët duhet të tregohen më se të matur në këtë çështje; duhet ta shohin edhe namazin e teravive si të gjitha adhurimet dhe namazet e tjera, ta konsiderojnë atë si një kafshë transporti shpirtëror në rrugën e afrimit me Allahun dhe ta pranojnë atë si një mënyrë mjaft të mirë për t'u afruar me Allahun. Për rrjedhojë, ne duhet ta vlerësojmë më së miri këtë mundësi që Zoti na e ka falur si mirësi, dhe të mos i falim sa për të kaluar radhën ato rekate, por duke i përmbushur siç duhet.

## 5. *Itikaf-i*

*Itikaf-i*, si fjalë, bart kuptimet e tërheqjes në izolim, t'i kushtohesh diçkaje dhe të mbyllesh diku, por në terminologji ai është akti i tërheqjes së një myslimani në një vend a faltore ku pesë kohët e namazit falen me bashkësinë dhe ku të gjithë ia kanë kushtuar veten dhe kohën kryerjes së adhurimeve, forcimit të devotshmërisë, mendimit dhe përmendjes së Allahut dhe lutjes e përgjërimit ndaj Tij.

Për *itikaf-in* na flet edhe ky ajet i Kuranit Fisnik, në të cilin thuhet:

*“Mos iu afroni bashkëshorteve tuaja kur jeni në itikaf nëpër faltore.”*<sup>44</sup>

Ndërsa, në një ajet tjetër ka shenja se *itikaf-i* ka qenë i pranishëm edhe në umetet e tjera:

*“Ibrahimin dhe Ismailin i patëm urdhëruar: ‘Mbajeni më se të pastër shtëpinë Time (Qaben) për ata që i vijnë përreth e rrotull, ata që hyjnë në itikaf dhe ata që bien në ruku dhe në sexhde!’”*<sup>45</sup>

<sup>44</sup> Bakara, 2/187.

<sup>45</sup> Bakara, 2/125.

Profeti ynë i Nderuar (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem), pas vitit të dytë të mërgimit, çdo vit, dhjetë ditët e fundit të muajit Ramazanit i ka kaluar duke qëndruar në *itikaf* në faltore.<sup>46</sup> Një vit, kishte qenë në rrugë dhe nuk kishte gjetur mundësi që të izolohej, por edhe ato ditë i pati zëvendësuar në Ramazanin e vitit të ardhshëm, duke qëndruar në *itikaf* për njëzet ditë me radhë.<sup>47</sup>

Aishja e nderuar (radijallahu anha) i përshkruan me këto fjalë emocionet e të Dërguarit të Allahut gjatë këtyre ditëve:

*“(I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem), gjatë muajit të Ramazanit kryente më shumë adhurime krahasuar me muajt e tjerë të vitit.) Dhjetë netët e fundit të Ramazanit i mbante shumë më të gjalla sesa netët e mëparshme, madje i zgjonte të gjithë pjesëtarët e familjes që t'i mbanin edhe ata sa më të gjalla. I drejtohej adhurimit me seriozitet.”<sup>48</sup>*

Përpos shumë prej sahabëve, sunetin e *itikaf*-it e kanë kryer edhe bashkëshortet e Profetit tonë të Nderuar nëpër vende të caktuara, të organizuara brenda shtëpive të tyre. Siç shprehen ato vetë, edhe pas mërgimit të Profetit në amshim, ato nuk e kanë lënë asnjëherë pa e kryer këtë sunet.<sup>49</sup>

Profeti ynë i Nderuar, kur do të hynte në *itikaf*, njërin cep të faltores e rrethonte me hasra dhe i mbyllur atje e ka kaluar kohën duke kryer adhurime dhe pa qenë nevoja nuk është ka dalë jashtë faltores. Madje, njëherë, kur ka dashur të lante flokun e bekuar, që nga vendi ku gjendej vetëm sa ka zgjatur kokën drejt dhomës së tij dhe Aishja e nderuar ia ka larë dhe krehur flokun pa hyrë në shtëpi.<sup>50</sup>

Ndërkohë që hyrja e burrave në *itikaf* ka qenë e domosdoshme, ky kusht nuk është vendosur edhe për gratë, por është thënë se ishte më e përshtatshme që ato të organizonin një pjesë të shtëpisë dhe

<sup>46</sup> Buhariu, *itikaf* 17; Tirmidhi, *saum* 79; Ebu Daud, *saum* 78; Ibni Maxhe, *sijam* 58.

<sup>47</sup> Ibni Maxhe, *sijam* 58; Ibni Hudhejme, *es-Sahih* 3/346; el-Bejhaki, *es-Sunenu'l-kubra* 4/314.

<sup>48</sup> Buhariu, *fadlu lejleti'l-kadr* 5; Muslim, *itikaf* 7.

<sup>49</sup> Buhariu, *itikaf* 2; Muslim, *itikaf* 5.

<sup>50</sup> Buhariu, *itikaf* 3; Muslim, *itikaf* 6, 7.

të tërhiqeshin atje në adhurime. Krahas kësaj, nëse kushtet janë të arritshme në përputhje me shpirtin e fesë, nuk ka asnjë ndalesë që edhe ato ta kryejnë *itikaf*-in duke u izoluar nëpër faltore.

Gjatë qëndrimit në *itikaf* duhet treguar një kujdes maksimal që të mos flitet asnjë fjalë përveç fjalëve të mira. Edhe pse nuk ka asnjë ndalesë për foljen e fjalëve që nuk janë mëkat, e përshtatshme për shpirtin e përgjithshëm të *itikaf*-it është, ose të flitet mirë, ose të heshtet. Veçanërisht duhet qëndruar larg çdo gjëje që përbën mëkat, siç janë thashethemet, shpifjet, përgojimi apo bartja e thënieve të të tjerëve. Veprat që përputhen më së shumti me shpirtin dhe domethënien e këtij adhurimi janë leximi i Kuranit Fisnik, përmendja pa ndërprerje e Allahut dhe gjithë punët e tjera që e bëjnë shikimit të të anojë vetëm kah jeta e përtejme. Veç kësaj, në ato ditë mund të lexohen libra rreth jetës së Profetit tonë të Nderuar, profetëve të tjerë dhe personaliteteve të tjera të mëdha; mund të diskutohen çështje të ndryshme të fesë dhe besimit.

*Itikaf*-i e largon personin nga një varg dëshirash dhe kërkesash njerëzore dhe egoiste, dhe përgatit terrenin që ai të ngjitet në gradët e jetës së zemrës dhe të shpirtit. Besimtari, bashkë me fillimin e tre muajve, hyn në një atmosferë shpirtërore të veçantë dhe me agjërimin e namazit dhe faljen e teravive, kjo atmosfere i ngjason edhe më shumë amshimit. Ndërsa *itikaf*-i që do të kryejë gjatë dhjetë ditëve të fundit të Ramazanit, ai e largon atë edhe nga një varg nevojash që janë të lejuara dhe e kthen atë në një farë engjëlli. Sepse gjatë kësaj kohe, ai vë në kontroll të ngrënin dhe të pirin, braktis çdo çështje të kësaj bote, mbyllet krejtësisht ndaj mëkateve dhe nuk merret veçse me adhurime dhe vepra që forcojnë devotshmërinë.

Disa personalitete të mëdha e kanë përngjasuar *itikaf*-in me gjendjen e dikujt që ngulet te porta e një njeriu të madh dhe thotë: “Pa më përmbushur këtë nevojë nuk kam për t’u larguar nga kjo portë.” Robi, për dhjetë ditë me radhë, nuk largohet nga porta e Allahut dhe afrohet edhe më shumë kah Ai me punët e tij të mira, i lutet dhe përgjërohet Atij pa pra dhe ngjan sikur me gjuhën e gjendjes shpirtërore, thotë: “Pa



më falur e pa më mëshiruar Ti unë e kam vendosur, nuk largohem.”

Profeti ynë i Nderuar (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) na ka këshilluar që natën e Kadrit ta kërkojmë në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit.<sup>51</sup> Nata e Kadrit, e cila mund të humbet nga përhumbja gjatë netëve të tjera, ka më shumë gjasa që të vlerësohet siç duhet nga besimtarët që kanë hyrë në *itikaf*. Ai që i kalon dhjetët ditët e fundit të Ramazanit në *itikaf* dhe e kalon kohën vazhdimisht vetëm duke adhuruar Allahun, gjen mundësinë që të përfitojë edhe shpërblimin e natës së Kadrit, e cila është më e mirë edhe sesa njëmijë muaj.

Në anën tjetër, *itikaf*-i mundëson që njeriu të largohet nga të gjitha barrët e kësaj bote dhe të ballafaqohet me veten, të meditojë dhe të bëjë një llogari të jetës së tij. Ndërkohë që në pjesën tjetër të kohës, shqetësimi i jetesës dhe problemet e kësaj bote e mbajnë atë të zënë, kur është në *itikaf*, qoftë edhe për një farë kohe, ai mund të shpëtojë syresh. Për dhjetë ditë me radhë, njeriu kupton madhësitinë e Allahut të Madhërishëm, pafundësinë e mirësive, se sa të shumta i ka mëkatet, se sa pak e ka falënderuar Allahun dhe e kalon nëpër sy edhe njëherë të gjithë jetën e vet, pas *itikaf*-it mund të hapë një faqe të re në jetën e tij. Edhe nga kjo pikëpamje *itikaf*-i i ofron njeriut një mundësi të madhe, të cilën nuk e arrin dot edhe aq lehtë në kohë të tjera.

Besimtari që hyn në *itikaf*, në një farë kuptimi është pritje të namazit të radhës. Siç thuhet edhe në hadithet e bekuara, njeriu që pret namazin e radhës pasi ka falur një namaz, fiton shpërblime sikur të jetë duke falur namaz përgjatë gjithë kohës që është me abdes.<sup>52</sup> Ja pra, besimtari që nuk e braktis vendin e *itikaf*-it dhe përpiqet që të jetë me abdes gjatë gjithë kohës, ka fituar edhe mundësinë e përfitimit nga ky shpërblim i premtuar në hadithe.

Fatkeqësisht, *itikaf*-i është ndër sunetet që ka filluar të harrohet në ditët e sotme. Edhe pse ka ende pak njerëz që e kryejnë këtë sunet, vështirë të thuhet edhe se ata e kryejnë *itikaf*-in në përputhje të plotë

<sup>51</sup> Shih: Buhariu, *fadlu lejleti'l-kadr* 3; Muslim, *sijam* 205.

<sup>52</sup> Buhariu, *buju'* 49; Muslim, *mesaxhid* 272-273.

me shpirtin e tij. Sepse në *itikaf* thelbësore është bërja e një jetese të thelluar në devotshmëri duke u larguar tërësej nga kjo botë dhe ta ndiesh thellësisht mendimin se je duke u parë nga Allahu i Madhërishëm (xhel'le xhelaluhu). Në të thelbësore është të hash pak, të pish pak, të habitesh, të bëhesh kalimtar dhe të gjesh Allahun (xhel'le xhelaluhu).

Ah sikur të ishin mundësitë dhe të ndërtoheshin xhami me pjesë të ideuara enkas për të bërë *itikaf* gjatë muajit të bekuar të Ramazanit. Xhami që të kenë pjesë të ndara, si për burrat, edhe për gratë, ku ata do të mund t'i përmbushin lehtësisht gjithë nevojat e tyre, ku do të mund të merrnin abdes lehtësisht dhe ku të mund të bënin *itikaf* njëqind apo dyqind vetë dhe të gjithë të mund të qëndronin në dhoma të ndara për tre-a katër vetë...

## 6. Të ndash në rrugën e Allahut

Ramazani është një muaj që duhet vlerësuar në mënyrën më frytdhënëse të mundshme, si gjatë ditës, ashtu edhe gjatë natës. Një nga rrugët e vlerësimit të tij është edhe që të ndash sa më shumë nga çështë e jotja në rrugën e Allahut.

Siç e transmetuam edhe më herët, ibni Abasi, kur përshkruan Ramazanin e të Dërguarit të Allahut (paqja qoftë mbi Të), thotë kështu:

*“I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) ishte më bujari ndër njerëz. Dhe koha kur Ai ishte më bujar se kurdoherë, ishte koha kur me të takohej Xhebraili i Nderuar (alejhis'selam), takoheshin me Profetin tonë çdo natë dhe këndonin Kuran përballë njëri-tjetrit. Prandaj, gjatë këtyre ditëve, i Dërguari i Allahut bëhej më bujar edhe se erërat bujare që fryjnë pa njohur pengesë.”*<sup>53</sup>

Besimtarët, të cilët e merrnin Profetin tonë të Nderuar (pqmT) shembull në çdo veprim të Tij, përpiqeshin që të jepnin sa më shumë në rrugën e Allahut edhe ata gjatë këtij muaji. Po, megjithëse zekati sipas masës së karatëve të arit ishte detyrim një vit më pas, besimtarët

<sup>53</sup> Buhariu, *bed'u'l-uahj* 5, *saum* 7; Muslim, *fedail* 50.

tregoheshin shumë të kujdesshëm që ta jepnin zekatin gjatë këtij muaji, në mënyrë që të fitonin sa më shumë prej shpërblimeve të tij. Me sadakatë e shumta dhe të mirat e dhëna në rrugën e Allahut gjatë këtij muaji, bëheshin përpjekje që t'u fitohej zemra sa shumë njerëzve në radhët e të varfërve, jetimëve, nxënësve, të moshuarve dhe atyre që ishin në nevojë. Sepse, siç e nënvizuar edhe më parë, shpërblimi i punëve të kryera gjatë këtij muaji do të jepet shumëfish herë më shumë.

Një nga punët që duhen kryer medoemos gjatë muajit të Ramazanit është edhe sadakaja e *fitr*-it, e cila për Hanefitë përbën një domosdoshmëri (*uaxhib*). Duke qenë se këtë temë do ta trajtojmë më gjerësisht në një pjesë tjetër të mëvetësishme të këtij libri, këtu dua që të ndalemi më shumë te një përvijim i përgjithshëm i konceptit të sadakasë dhe dhënies në rrugën e Allahut.

Në fakt, çdo punë e mirë, materiale apo shpirtërore, që kryhet për të fituar kënaqësinë e Allahut, është quajtur sadaka. Sadakaja, e cila është trajtuar mjaft gjerësisht në Islam, ka disa forma. Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) thotë kështu:

*“Çdo kyç i njeriut kërkon një falënderim të veçantë. Prandaj ia vlen sikur çdo ditë të jepet diçka për hir të falënderimit për të. Edhe të gjykosh drejt në mosmarrëveshjen mes dy vetëve është një lloj sadakaje. Edhe sikur t'i vish në ndihmë dikujt që kërkon të hipë në kafshën tënde të barrës dhe ti e merr atë mbi kafshën tënde, apo ia ngarkon barrët e tij mbi të, është një lloj sadakaje. Çdo fjalë e mirë që thua është një lloj sadakaje. Çdo hap që hedh drejt faltores për të falur namazin, është një lloj sadakaje. Edhe të largosh diçka nga rruga, e cila përndryshe do të pengonte dikë teksa do të kalonte atypari, është një lloj sadakaje...”<sup>54</sup>*

Siç shihet, domethënia e sadakasë është trajtuar shumë gjerë në këtë hadith të bekuar. Në ditët e sotme, kur thua sadaka, parasysh vjen më shumë lëmosha e dhënë në formën e një shume parash. Mirëpo besimtari duhet ta organizojë jetën në atë mënyrë që të bëjë sadaka në çdo rast dhe në çdo kusht të jetës së tij, duke e bërë atë një pjesë

<sup>54</sup> Buhariu, *sulh* 11, *xhihad* 72, 128; Muslim, *salatu'l-musafirin* 84; *zekat* 56.

të pandarë të jetës së vet. Siç transmetohet nga Ebu Musa el-Eshariu (radijallahu anh), njëherë, Profeti Fisnik ka thënë: “*Dhënia e sadakasë është detyrë për çdo mysliman.*” - Ata që ishin të pranishëm, e pyetën: “Po ata që nuk kanë asgjë për të dhënë, çfarë do të bëjnë, o i Dërguari i Allahut?” - Kësaj pyetjeje të tyre Profeti ynë i Nderuar iu përgjigj me fjalët: “*Do të punojë, do të fitojë me mundin e duarve të veta dhe do të bëhet i dobishëm edhe për veten, por do t’u japë edhe të tjerëve sadaka.*”

- Po nëse nuk bëjnë dot, as kaq, o i Dërguari i Allahut? - vijuan të pyesnin ata.

- *Ndihmon dikë që ka nevojë për ndihmë, atëherë.*

- Po sikur të mos ketë mundësi as për këtë?

- *T’i udhëzojë njerëzit për mirë.*

- Po sikur të mos ketë mundësi as për kaq?

- *Të paktën të mos i bëjë askujt keq. Edhe kjo është një lloj sadakaje, - u përgjigj në fund i Dërguari i Allahut.*<sup>55</sup>

Për të na e ndriçuar pak më shumë horizontin, që ta kuptojmë më mirë dhe drejt vlerën që ka dhënia e sadakasë pranë Allahut, do të na vinin në ndihmë edhe këto hadithe të bekuara:

“*Ruajuni nga Xhehenemi, sikur edhe me gjysmë hurme.*”<sup>56</sup>

“*Dhënia e sadakasë nuk e pakëson pasurinë.*”<sup>57</sup>

“*Dora që jep është më e mirë se dora që merr.*”<sup>58</sup>

“*Sadakaja e zbut ashpërsinë e Zotit dhe e mbron njeriun nga fundi i keq.*”<sup>59</sup>

Ka edhe shumë hadithe të tjera, të cilat tregojnë se sa e rëndësishme është dhënia e sadakasë për një mysliman. Çdo besimtar i vetëdijshëm

<sup>55</sup> Buhariu, *zekat* 30, *edeb* 33; Muslim, *zekat* 55.

<sup>56</sup> Buhariu, *zekat* 9, 10, *menakib* 25, *edeb* 34; Muslim, *zekat*

<sup>57</sup> Muslim, *birr* 69; Tirmidhi, *birr* 82.

<sup>58</sup> Buhariu, *zekat* 18, *uesaja* 9; Muslim, *zekat* 94-97.

<sup>59</sup> Tirmidhiu, *zekat* 28; Ibni Hibban, *es-Sahih* 8/103.

për këtë, veçanërisht në muajin e bekuar të Ramazanit, kur shumëfishohet shpërblimi i punëve të mira, duhet të përpiqet që të japë sa më shumë sadaka.

Gjithashtu, një lloj tjetër i sadakasë është edhe ajo që quhet “sadakaja e vijueshme”, që është shkak që në librin tonë të bëmave të jetës të shkruhen shpërblime edhe pas vdekjes. Ndërtimi i xhamive, shkollave, rrugëve, konvikteve, prej të cilave mund të përfitojnë të gjithë njerëzit; mbjellja e pemëve; lënia e veprave të dobishme, janë disa nga kategoritë e punëve që mund të përfshihen në këtë lloj sadakaje. Edhe në hadithin e të Dërguarit të Allahut (paqja qoftë mbi Të) që shenjon pikërisht këtë lloj të sadakasë thuhet:

*“Kur njeriu vdes, përveç tre bëmave, shpërblimi për bëmat e tij ndërpritet. Punët që e ndihmojnë njeriun t'i shkruhen shpërblime edhe pasi ka vdekur janë këto: “sadakaja e vijueshme”, dija e tij, nga e cila përfitojnë njerëzit dhe fëmija i mbarë që lutet nga pas.”<sup>60</sup>*

## **7. Shtimi i punëve të mira**

Adhurimet që Allahu i Madhërishtëm (xhel'le xhelaluhu) na i ka shpallur detyrim dhe na i ka ngarkuar të gjithëve si përgjegjësi, sipas cilësisë së kryerjes së tyre, do të përftojë gjendje të caktuara dhe do të dëshmojnë për ne pranë Allahut. Prandaj, ne duhet ta kënaqim sa më shumë këtë muaj të faljes, në mënyrë që edhe dëshmia e tij për ne të jetë e mirë dhe të kumbojë anakënd. Sepse, nëse Ramazani i bekuar vlerësohet siç duhet, kur të largohet prej nesh, ai do të dëshmojë në dobinë tonë dhe mbase do të thotë se ne jemi të denjë për të hyrë në Xhenet nga porta e Rejanit. Kështu që ne duhet të tregojmë respekt për adhurimet që Allahu i ka caktuar për ne, t'i vlerësojmë ato si shumë të çmuara dhe të jemi përherë në përpjekje për t'i vlerësuar maksimalisht ato.

Veç kësaj, në amshim njeriu do ta dijë se për çfarë është secila mirësi që po i fal Allahu, shpërblim për cilën punë të tij në këtë jetë, dhe kjo

<sup>60</sup> Muslim, *uasijet* 14; Tirmidhi, *ahkam* 36; Ebu Daud, *uesaja* 14.

mirësi do t'i falë atij një kënaqësi të tejskajshme. Ndoshta, i gjendur përballë tërë këtyre mirësive që janë konsideruar të denja për të, do të thotë: "Shyqyr, o Zot! Fillimisht Zoti më nderiu mua me punë të mira, kurse tani po më nderon me shpërblimin e tyre."

Po, atje njeriu do t'i njohë agjërimet e tij me gojë, me hundë dhe me veshë. Sipas cilësive dhe dimensioneve të jetës së përtëjme do t'i dijë dhe do t'i njohë menjëherë, qëndrimin e tij i etur dhe i uritur, lodhjen gjatë teravive, emocionet e zgjimit në syfyr dhe gostitë e shijshme të iftareve dhe do të ndiejë edhe njëherë kënaqësinë e tyre.

Disa adhurime e fitojnë thellësinë e tyre pikërisht nga forma e tyre. Kështu janë edhe adhurimet e kryera gjatë muajit të Ramazanit. Prandaj veprat e kryera gjatë muajit të Ramazanit do të fitojnë një vlerë shumë të veçantë. Gjatë këtij muaji njerëzit i afrohen Allahut shumë ndryshe. Nuk ka asnjë agjërim tjetër që mund t'i afrohet sadopak shpërblimit të mbajtur në muaj të tjerë. Njëzet rekate namaz të falura gjatë muajve të tjerë nuk e zëvendësojnë dot namazin e teravive. Po njësoj, syfyret e bëra në netët e muajve të tjerë, nuk të përftojnë dot shpërblimin që fitohet nga syfyret e muajit të Ramazanit. Ashtu si edhe pritjet që të thirret ezani i akshamit nuk mund të jenë kurrsesi si pritja e ezanit për të çelur iftarin gjatë muajit të Ramazanit. Me pak fjalë, punët e bëra në kohë të tjera nuk e arrijnë dot kurrsesi shpërblimin e arritur gjatë muajit të Ramazanit. Kjo është arsyeja që besimtarët e sinqertë, që e ndiejnë mjaft thellë në ndërgjegjen e tyre këtë të vërtetë, ndiejnë një trishtim të madh për ikjen e Ramazanit dhe ndiejnë mall për të gjer sa të vijë Ramazani i ardhshëm. Ku ta dimë, ndoshta ky mall u përfton atyre gjithë shpërblimin e një muaji Ramazani më vete.

Dihet dhe ne e kemi trajtuar, një varg muajsh, ditësh dhe netës kanë virtyte të veçanta. Për shembull, me fjalët e Kuranit, njeriu që i jep jetë natës së Kadrit fiton shpërblime sikur t'u kethë dhënë jetë njëmijë muajve të tërë.<sup>61</sup> Po ende edhe Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem), dikush që mban dezurn një ditë me qëllimin e mbrojtjes së atdheut, fiton shpërblime sikur të ketë kryer adhurime për ditë dhe muaj me

<sup>61</sup> Shih: Kadr, 97/3.

radhë.<sup>62</sup> Ashtu si njeriu që mediton, i cili bëhet sikur të ketë qenë duke kryer adhurime prej vitesh.<sup>63</sup> Domethënë, diçka shumë personale, mjaft e vogël dhe e pjesshme që mund të bëjë njeriu në një prerje shumë të ngushtë të kohës dhe në një vend që ka rëndësi jetike, fiton menjëherë tërësi, madje aq sa mund të dalë edhe prej saj dhe të shndërrohet në thelb, dhe pranë Allahut pranohet sikur të jetë kryer e plotë.

Nëse dikush i kalon netët e Ramazanit të bekuar me namaz dhe ditët duke mbajtur agjërim, domethënë e mban atë të gjallë ditë-natë, ai mund të fitojë edhe mirësitë hyjnore që janë premtuar se do të jepen në natën e Kadrit. Për rrjedhojë, ai do të jetë i hapur ndaj çdo mbarësie edhe përgjatë vitit, duke u përfshirë në rrugën e lëvizjes dhe veprimit vetëmse në rrugën e së mirës. Dhe kjo do të thotë se për atë njeri është ngritur një rreth i vijueshëm i së mirës. Mandej, çdo e mirë lind një të mirë tjetër, aq sa për të krijohet një rreth që lind vetëm të mirën dhe të mbarën. Një portë e këtyllë, që është potencial i mirësisë dhe mbarësisë, është e hapur për të gjithë.

### ***Ta mbash gjallë gjithë muajin e Ramazanit***

Për njeriun që e mban gjallë muajin e Ramazanit të plotë Profeti ynë (pqrT) ka thënë:

*“Kush e mban agjërimin e Ramazanit të bekuar duke besuar te shpërblimi i tij dhe duke e pritur shpërblimin vetëmse nga Allahu, atij i falen gjithë mëkatet e shkuara.”<sup>64</sup>*

Domethënë, në këto lloje adhurimesh qëllimi, sinqeriteti dhe bindja në besim janë shumë të rëndësishme, përderisa Allahu, sipas thellësisë së tyre, nganjëherë jep dhjetëfish, nganjëherë njëqindfish, e nganjëherë një milion dhe e bën shkas që njeriu të fitojë shpërblime që e kapërcejnë edhe jetëgjatësinë e tij.

<sup>62</sup> Muslim, *imaret* 163; Ahmed bin Hanbel, *el-Musned* 1/349.

<sup>63</sup> Shih: Ebu'sh-Shejh, *el-Azame* 1/299.

<sup>64</sup> Buhariu, *iman* 28; Muslim, *salatu'l-musafirin* 176.

Nëse do të duhej ta shpjegonim me një ilustrim, të themi që e kapët natën e Kadrit gjatë një muaji të Ramazanit dhe e jetësuar atë duke kryer adhurime të shumta. Sipas një përlloraritjeje në bazë të asaj që thuhet, me “njëmijë muaj”, ato bëjnë afërsisht tetëdhjetë vjet. Sipas kësaj ju do të fitoni shpërblime njësoj sikur të keni jetuar tetëdhjetë vite dhe të tetëdhjetë vitet t’i keni kaluar duke kryer adhurime. Kjo është një arritje dhe meritë shumë e madhe, të cilën njeriu e ka të vështirë ta përfshijë brenda jetës së tij të shkurtër.

Veçanërisht, ato janë njëmijë muaj ose tetëdhjetë vite të atilla që brenda tyre nuk ka, as vetëpëlqim, as dëshirë për t’u dukur. Sepse adhurimiin e kryer në një çast të natës dhe në një vend ku nuk ka asnjë njeri tjetër përveç teje, nuk mund ta marrë dot furtuna e vetëpëlqimit apo dëshirës për t’u dukur. Në të nuk ka mëkate të tjera; për shembull, nuk ke parë drejt së ndaluarës, nuk ke gënjer dhe nuk ke vepruar ndesh me asnjë nga kriteret e fesë së madhe të Islamit.

Ja, një muaj që lind mbarësi kaq të rëndësishme, i këtillë është Ramazani. Unë jam i mendimit se veçanërisht për ata që i shërbejnë besimit dhe Kuranit, muaji i Ramazanit, por edhe kohë të tjera, kanë një rëndësi të veçantë. Sepse, duke qenë se ata ia kanë kushtuar shërbimit jetën e tyre, ndoshta çdo minutë, çdo sekondë e jetës së tyre, do të begatohet si të ishte Ramazan. Nga ky këndvështrim, nëse një muaj Ramazani i kaluar me sinqeritet i përfiton njeriut tetëdhjetë vite jete në terma të adhurimit, atëherë besoj se është e pamundur të llogarisësh dot jetëgjatësinë e këtyre të fundit.

### ***8. Shtrimi i sofrave të iftarit edhe për të tjerët***

Muaji i Ramazanit, i cili shfaqet në horizontet tona me bukuritë e tij marramendëse, si agjërimi, iftari, syfyri, teravitë, dhe krijon një atmosferë të shenjtë, që është karakteristike e tij, edhe në kohërat kur tensionet ndjekin njëri-tjetrin, dhuna dhe ashpërsia ia lënë vendin njëra-tjetrës, konfliktet e krijuara njihen si meritë dhe në mes masave mbizotëron ftohtësia, ka një ndikim të veçantë, që shpirtrat të arrijnë



paqen edhe njëherë, zemrat, ndjenjat dhe mendimet të bëhen të qashtra dhe çdo ngërç, ngurtësi dhe ashpërsi të bëhet e paqtë. Zaten, një e vërtetë tjetër është edhe që në këtë muaj të bekuar, kur paqja, butësia dhe ëmbëlsia janë më të ndjeshme, te myslimanët mbizotëron një ndjenjë e thellë respekti. Nga kjo pikëpamje, edhe nëse tani ne jemi të rrethuar nga çdo anë nga të këqija nga më të ndryshmet, ne mund të përdorim vullnetin dhe t'i hapim zemrat ndaj kësaj prerjeje të bekuar të kohës, të besojmë me gjithë zemër te begatia e tij dhe t'i drejtohem me ndjenjat më të thella të respektit; edhe ai do të na përqafojë ne, do të na e zbrazë mbi krye gjithë begatinë e vet, do t'i dalë përpara ashpërsisë, egërsisë dhe inatit, e kësisoj, në shoqëri do të sundojë atmosfera e qetësisë dhe paqes.

Tani, nëse do të ndalemi tek ato që duhen bërë, për shembull, dikush që banon në një apartament, cilatdo që të jenë kultura dhe botëkuptimi i fqinjëve të tij, t'i ftojë ata në sofrën e vet të iftarit dhe me sa të ketë mundësi, të sillet me ta me bujari dhe si xhentilmen. Madje, pasi t'u japë për të ngrënë, t'u thotë: “Ju u munduat duke ardhur deri te ne. Nëse e pranoni, edhe kjo le të jetë si një farë qiraje për dhëmbët tuaj.” - dhe t'u japë nga një dhuratë të vogël të përgatitur më herët. Nëse i ka mundësitë, t'u japë nga një dhuratë të vogël edhe fëmijëve, në mënyrë që t'i kënaqë edhe ata të vegjël. Në të njëjtën mënyrë, dikush që është mësues në shkollë, apo dikush që është profesor në universitet ose dikush që punon në një institucion tjetër, mund të kontribuojë në paqen shoqërore duke ua hapur sofrën e tij të iftarit të gjithëve pa bërë dallime se cilës shtresë i përkasin ata që do të ftojë.

Ne duhet ta vlerësojmë aq mirë këtë muaj të bekuar e që vjen me shumë begati, aq sa nuk duhet të ketë asnjë sofër që nuk pret miq në iftarin e saj. Po, sofrat e iftarit duhet të pasurohen më shumë me praninë e sa më shumë miqve të shumëllojshëm, më shumë se sa me shumëllojshmëri ushqimesh. Ju e dini, Profeti ynë i Nderuar thotë: *“Ushqimi që është për një person u mjafton edhe dy vetëve, ushqimi që është për dy u mjafton edhe katër vetëve, ushqimi që është për katër vetë*

*u mjafton edhe tetë vetëve.*<sup>65</sup> Nga kjo pikëpamje, në Ramazan, i cili vjen me një begati krejt të veçantë, nuk duhet të ekzistojë shqetësimi se kanë ardhur shumë miq.

Një sjellje si kjo është një rrugë e rëndësishme diplomacie tejet e rëndësishme për mbylljen e humnerave që ekzistojnë mes shtresave të ndryshme të shoqërisë, por edhe për kapërcimin e paragjykimeve të shumta që e përçajnë shoqërinë. Ka shumë probleme, të cilat nuk zgjidhen dot me forcë dhe fuqi, por zgjidhen menjëherë me anë të kësaj rruge. Nëse ju ia hapni të gjithëve zemrën, hyni në zemrat e bashkëbiseduesve tuaj me njerëzinë tuaj, përgatitni në zemrat tuaja një vend ku mund të ulet gjithkush dhe kësisoj, zemrat njerëzore fillojnë t'ju ndjekin nga pas, atëherë nuk ka urrejtje, mllef, inat, gjakderdhje dhe humbje jete që nuk ndërpritet. Përgjatë historisë së njerëzimit, asnjëherë nuk është vërejtur që problemet të jenë zgjidhur, apo shqetësimet të jenë kapërcyer nëpërmjet kanosjes. Përkundrazi, njerëzit janë nxitur edhe më shumë nga kanosjet dhe janë organizuar edhe më shumë në boshtin e tyre të inatosjes dhe shkatërrimit.

E thotë edhe një fjalë e urtë, një kafe e ka hatrin dyzet vjet. Edhe një iftar që do të shtrojmë, do të ketë hatrin e vet për dyzet vjet me radhë. Prandaj, kjo është një bujari që duhet të kryhet, sepse kthimin e ka shumë ndryshe. Nuk e dimë, ndoshta këtu fshihet një pjesë e rëndësishme e begatisë së muajit të Ramazanit. Domethënë, ne mund të fitojmë shpërblime hyjnore duke agjëruar, duke falur teravitë, por fitojmë edhe më shumë duke hyrë në zemrat e njerëzve.

Nga ana tjetër, shërbëtorët e Kuranit, të cilët ngarendin në rrugën e shërbimit ndaj njerëzimit në të katër anët e botës, mund ta konsiderojnë Ramazanin si një shkas shumë të rëndësishëm për të hyrë në zemra. Njësoj siç vihen në pah ndjesitë e bujarisë në Bajramin e Kurbanit, kur kurbanët e prerë shpërndahen ngado, duke nisur që nga njerëzit në nevojë, dhe nëpërmjet kurbanit

<sup>65</sup> Buhariu, *et'ime* 11; Muslim, *eshribe* 179.

fitohen sa e sa zemra, por në to u vunë në lëvizje edhe sa e sa ndjenja besimi që mes tyre ekziston një farë vëllazërie. Po ashtu, duke ua hapur të gjithëve dyert e syfyrit dhe iftarit, mund të fitohen sa e sa zemra dhe ky muaj i bekuar të fitojë një cilësi të veçantë, me të cilën Allahu (xhel'le xhelaluhu) do të jetë i kënaqur. Veçanërisht ftesat e syfyrit dhe iftarit jashtë vendit, do të jenë mjaft të dobishme për të njohur njëri-tjetrin dhe për ndërtimin e paqes në mesin e njerëzimit. Sidomos ezanet e kënduara në çastin e iftarit do të jenë mjaft origjinale, sepse do të dëgjohen ngado si një zë surprizë. Prandaj, një mundësi e këtyllë duhet vlerësuar sa më mirë që të jetë e mundur, për t'u treguar bashkëbiseduesve bukurinë tonë, por edhe për t'i njohur ata me pasuritë tona.

Ndoshta këto aktivitete të bashkëbiseduesit tanë do të krijojnë thjesht një simpati ndaj Islamit. Mirëpo edhe një fitore e këtyllë nuk është për t'u nënvlerësuar. Kushedi, ata njerëz, që ndoshta e ndiejnë çdo gjë të njomë e të freskët, me kalimin e kohës do t'i ndiejnë bukuritë e Islamit dhe si në një trampolinë vertikale, do të lartësohen drejt fronit të përsosmërisë. Nga ky këndvështrim, që të arrihet ky rezultat, ia vlen të shtrohen nga tri-katër sofa në ditë, jo vetëm një sofër iftari.

Fatkeqësisht, njeriu i ditëve tona jetoi i privuar nga bukuritë e të qenit mysliman, nuk i dalloj dot sjelljet dhe qëndrimet e mirëfillta myslimane. Ja, kjo është detyra jonë më e rëndësishme, t'u tregojmë atyre cili është Islami i vërtetë, me strukturën tonë familjare, me marrëdhënien që ne kemi me nënën, babain dhe fëmijët, me ftesat tona, duke u treguar se sa xhentilmenë jemi. Nëse dikush i sheh myslimanët si armiqtë e vet, atëherë rruga e kapërcimit të kësaj është qëndrimi sa më afër me ta. Prandaj, në muajin e bekuar të Ramazanit, myslimanët duhet të bëjnë çdo përpjekje që ta bëjnë këtë punë në mënyrën më të arsyeshme, ashtu siç e kërkon pozicioni në të cilin gjenden dhe duke përdorur arsyen, logjikën, gjykimin dhe fuqinë e këshillimit me njëri-tjetrin.

## D. Nata e Kadrit

Një nga veçantitë e muajit të Ramazanit është që ka brenda tij edhe natën e Kadrit. Fjala “kadir”, nga e merr emrin kjo natë, nuk është e ndryshme nga fjala “kadir”, të cilën e përdorim në gjuhën turke. Si për nga prejardhja, ashtu edhe trajtën kuptimore të përdorur, ajo është e njëjta. Domethënë, në këtë natë zënë vend shpirti dhe përmbajtja e një vlerësimi, një njohjeje vlere të mirëfilltë. Ngjan sikur me të të na thuhet, “t’ia dini vlerën kësaj nate, që t’ju dihet edhe juve vlera që keni!” Veçantia më e rëndësishme e natës së Kadrit është që Kurani Fisnik, libri ynë i madh, që është një përkthim i pakohë i librit të gjithësisë dhe që premtion t’u falë njerëzve dhe xhindeve lumturinë në të dyja botët, është zbritur në qiellin e kësaj bote pikërisht në këtë natë. Në suren “Kadr” Allahu (xhel’le xhelaluhu) thotë:

*“Ne e zbritëm Kuranin në natën e Kadrit. E di ti se çfarë është nata e Kadrit? Është më e hairit se njëmijë muaj nata e Kadrit! Atë natë, me lejen e Zotit Shpirti dhe engjëjt zbresin e zbresin për çdo lloj gjëje. Në të vërtetë, është një paqe ajo natë, gjersa fillon të zbardhë.”<sup>66</sup>*

Kurani është zbritur në qiellin e botës si një i tërë në natën e Kadrit, e pastaj, sipas nevojës dhe ndodhive, i është zbritur Profetit tonë (sal’lallahu alejhi ues’sel’lem) dhe mbarë njerëzimit.

Në këtë ajet shprehet se kjo natë është më e hairit e më e mbarë edhe se njëmijë muaj. Në lidhje me këtë temë, në veprën me titull “Muuatta” të Imam Malikut përballemi me një të dhënë të tillë: “Të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ues’sel’lem) iu tregua jeta e popujve të parë, që kishin jetuar përpara Tij. Kur pa jetëgjatësinë e tyre dhe mendoi për shpërblimet që do të fitonin ata, Profetit tonë (pqmT) jeta e popullit të Tij iu duk e shkurtër dhe mendoi se ata nuk do të mund t’i arrinin dot atë shpërblime, me të cilat do të nderoheshin popujt që kishin jetuar para popullit të Tij. Për këtë arsye Allahu i fali Atij natën e Kadrit, që

<sup>66</sup> Kadr, 97/1-5.

është më e vyer se njëmijë muaj.”<sup>67</sup>

Sipas një transmetimi tjetër Profeti ynë i nderuar (sal’lallahu alejhi ue’sel’lem), një ditë, u pati treguar sahabëve të tij se katër vetë nga bijtë e Izraelit kishin kryer adhurime pa bërë asnjë mëkat për tetëdhjetë vite me radhë. Kjo i habiti shumë sahabët. Aty, në atë çast, erdhi Xhebraili (alejhi’selam) dhe tha: “O Muhamed! Populli yt u habit kur dëgjoji se si ata kryen adhurime për tetëdhjetë vjet me radhë. Allahu të ka zbritur Ty diçka më të mirë se kjo.” – dhe i këndoi aty suren “Kadr” dhe fill pas kësaj, i tha: “Ja, kjo po që është më e mirë e më e hairit për Ty dhe popullin Tënd sesa ajo që i habiti ata.”<sup>68</sup>

“Njëmijë muaj” është e barabartë me një kohë sa tetëdhjetë e tre vjet e katër muaj. Nata e Kadrit është një mundësi shumë e madhe, që një besimtar të marrë brenda një nate të vetme një fryt shpirtëror që vetëm gjatë gjithë jetës do të mund ta fitonte. Ai duhet të përpiqet e të bëjë çmos që të mos e humbasë këtë mundësi, e nëse është nevoja edhe të sakrifikojë. Ç’është e vërteta, ky është edhe kuptimi i asaj që quhet *itikaf*<sup>69</sup>, pra, izolimit përgjatë dhjetë ditëve të fundit të Ramazanit. Ai besimtar që i vlerëson siç duhet dhjetë ditët e *itikafit*, detyrimisht do të ketë vlerësuar mirë edhe natën e Kadrit.

Në ca kohë dhe gjendje të caktuara Allahu (xhel’le xhelaluhu) u jep vlerë të shumëfishtë edhe shumë pak veprave të mira. Për shembull, pritja një orë në kufi gjatë detyrës e një ushtari të kufirit shkon si një vit adhurim ndaj Zotit. Dikush që bie dëshmor në rrugën e Allahut, si të ishte hedhur në një trampolinë, ngjitet vertikalisht shumë lart drejt përsosurisë së më të mirës së të mirave. Po ashtu, një natë Kadri e vlerësuar siç duhet, bëhet e barabartë me tetëdhjetë e kusur vite adhurim. Siç shihet nga të gjitha këto punë të mira të realizuara, ai mund të fitojë në shkallë të atilla, që nuk i ka pritur, ato i shtohen dhe kthehen njëfarësoj në kallinj që japin njëmijë në një.

Sipas një këndvështrimi, të qenët më e mirë se njëmijë muaj është

<sup>67</sup> Muuatta, *itikaf* 15.

<sup>68</sup> Eth-Thalebi, *el-Keshf ue’l-bejan* 10/255; ibni Kethir, *Tefsiru’l-Kurani’l-adhim*4/531.

<sup>69</sup> Përshkrim se ç’është itikafi.

një metonimi që tregon madhësinë. Me një fjalë, në këtë ajet, më shumë sesa numri i përdorur, aty është theksuar se si ajo natë është një burim arritjesh shpirtërore aq të mëdha.

Ndërsa sipas një pikëpamjeje tjetër, kjo arritje nuk është për të gjithë, por vetëm për ata që e dinë natë “Kadri” çdo natë. Po, sikur ata ta kenë gjallëruar çdo natë dhe sikur mëshira ta ketë mbushur gotën pikërisht këtë natë dhe kështu, pikë pikë, ata të jenë hapur drejt një deti të tërë mëshire.

Këtu në mendje mund të vijë edhe një pyetje e këtillë: “Një mirësi si kjo, pse i është falur vetëm e vetëm *umetit* të Profetit Muhamed (pqmT)?” Kësaj pyetjeje mund t’i jepet përgjigje kështu: “*Umeti* i Profetit Muhamedit është në një pozitë të veçantë për sa i përket konceptimit të të vërtetave. Përpos kësaj, edhe Profeti i këtij populli është në majën më të lartë. Kështu që kjo natë është caktuar për këtë popull, së bashku me Profetin që u është dërguar atyre, dhe kjo është një mirësi bujare e Allahut të Madhërishëm.”

Një tjetër shkak mund të jetë edhe ky: Mrekullia e Fjalës, Kurani, është zbritur në natën e Kadrit. Kurani është predikuar nëpërmjet Profetit tonë (sal’lallahu alejhi ues’sel’lem), i Cili ishte i merituari i Emrit më të Madh, pra i shkallës më të lartë të emrave të Allahut (xh.sh.) dhe i destinuar për një popullsi, që ishte më e përkryera. Veç kësaj, Kurani ka ardhur nëpërmjet Xhebrailit të Besuar, që ishte i përzgjedhuri i fjalës hyjnore dhe në një farë kuptimi, një engjëll i madh që ishte si profet i engjëjve. Prandaj, nata në të cilën Kurani u zbrit në qiellin e botës dhe filloi t’i zbritet edhe Profetit tonë (sal’lallahu alejhi ues’sel’lem), është një natë shumë e rëndësishme në jetën e *umetit* të Profetit Muhamed dhe këtë natë Allahu i Madhërishëm e ka mbajtur mbi gjithë netët e tjera dhe e ka bërë të jetë e barabartë me njëmijë muaj.

## **1. Koha e natës së Kadrit**

Ashtu siç është mbajtur e fshehtë ajo që quhet “koha e pranimit” në ditën e premtë, pra ora kur pranohen të gjitha lutjet, apo robërit e

lartë në mesin e njerëzve, apo Emri i Madh mes Emrave të Bukur, edhe nata e Kadrit është mbajtur e fshehtë në dhjetë ditët e fundit të muajit Ramazan. Dhe kështu, nga besimtarët pritet që ata të jenë vazhdimisht të zgjuar dhe të kujdesshëm, ta kalojnë kohën me adhurime pa ndërprerë dhe të mos u ikë nga duart asnjë mundësi për të bërë mirë.

Nga nëna jonë, Aishja e nderuar (radijallahu anha) na është transmetuar se i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue'ssel'lem), dhjetë ditët e fundit të Ramazanit i kalonte i mbyllur në faltore duke ia dhënë veten krejtësisht adhurimit, fakt ky që e kemi treguar edhe më parë. Profeti ynë i Nderuar (paqja qoftë mbi Të) ka thënë: “Kërkojeni natën e Kadrit mes dhjetë ditëve të fundit të Ramazanit!”<sup>70</sup> Ndërsa, njëherë tjetër ka thënë: “Natën e Kadrit kërkojeni në netët teke të dhjetë ditëve të fundit të Ramazanit!”<sup>71</sup>

Siç na transmetohet nga Abdullah bin Omeri (radijallahu anh), një grup nga sahabët patën parë në ëndërr se nata e Kadrit ishte në një nga shtatë netët e fundit të Ramazanit. Kur e dëgjoji këtë, i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue'ssel'lem) u tha atyre: “Shoh se ëndrrat tuaja në lidhje me natën e Kadrit bashkohen në pikën që ajo është në shtatë netët e fundit. Atëherë, kushdo që kërkon natën e Kadrit, ta kërkojë atë në shtatë netët e fundit të Ramazanit!”<sup>72</sup> E në një transmetim tjetër, na këshillohet që atë ta kërkojmë veçanërisht në natën e njëzeteshtatë të Ramazanit.<sup>73</sup>

Profeti ynë, Krenaria e Njerëzimit, e dinte kohën e saktë të natës së Kadrit. Por, një ditë, pati thënë: “Mua më qe treguar se në cilën dite ishte nata e Kadrit. Dola jashtë për t’jua treguar, kur pashë dy njerëz që po debatonin me njëri-tjetrin. Teksa u mora me ta, Mua m’u harrua nata e Kadrit.”<sup>74</sup> Kështu pati thënë dhe me këto fjalë pati vënë theksin te fakti se sa shumë e kishte plagosur thellë edhe një mosmarrëveshje dhe përplasje e vogël mes besimtarëve, si dhe në atë se çfarë mund të

<sup>70</sup> Buhariu, *fadlu lejleti'l-kadr* 3; Muslim, *sijam* 205.

<sup>71</sup> Buhari, *fadlu lejleti'l-kadr* 3; Muslim, *sijam* 205.

<sup>72</sup> Buhariu, *lejleti'l-kadr* 2, *tabir* 8; Muslim, *sijam* 205, 209.

<sup>73</sup> Shih. Ahmed bin Hanbel, *el-Musned* 5/313, 319.

<sup>74</sup> Buhari, *iman* 25; Muslim, *salatu'l-musafirin* 176.

shkaktojë përplasja dhe mosmarrëveshja mes besimtarëve.

Edhe shprehja frazeologjike, “*Çdo natë ta dish Kadër, çdo njeri ta dish Hizër.*”, është një fjalë shumë kuptimplotë. Sepse, ashtu siç nata e Kadrit është e fshehur mes netësh, edhe Hizri (alejhis’selam) është i fshehur në mesin e njerëzve. Nëse ju tregoni respekt për çdokënd, i ndihmoni në çdo nevojë, e mbani çdokënd për dore dhe ia hapni zemrën që aty të mund të hyjnë të gjithë, një ditë përballë do t’ju dalë një Hizër dhe kopshti i zemrës suaj do të lulëzojë. Kështu, duke i fshehur këto të dyja Allahu i Madhërishëm (xhel’le xhelaluhu) na ka drejtuar të gjithëve ne që të sillemi vazhdimisht me shumë kujdes dhe të jemi pa ndërprerë të përfshirë në një tension metafizik, që të jemi përherë të zgjuar dhe të kujdesshëm.

Mirëpo, nëse nuk keni një lidhje kaq të fortë e të përzemërt me Allahun (xhel’le xhelaluhu), është shumë e vështirë që t’i gjeni, si natën e Kadrit, ashtu edhe Hizrin. Këto të dyja janë të mundura vetëm kur në zemrën tuaj të kapni shkallën e besimit dhe besnikërisë; jua hap juve perden e fshehtësive vetëm kur ju të kërkonin njëherë e ta gjeni në zemrën tuaj atë. Nëse ka te ju mendime të gjetjes së gjërave gati, “ta gjej menjëherë, ta shoh menjëherë, ta fitoj menjëherë” dhe jeni të varura nga ndjesi të këtilla, atëherë ta dini se do t’ju duhet të prisni shumë.

Në këtë këndvështrim, ata që janë në kërkim të gjërave të lira, nuk besoj se do të përfitojnë plotësisht nga nata e Kadrit. Ata le të presin përgjatë një viti të tërë; le të gjallërojnë vetëm natën e njëzeteshtatë të Ramazanit të Bekuar dhe të fitojnë mirësitë hyjnore që Allahu i Madhërishëm (xhel’le xhelaluhu) i ka falur për ata që e vlerësojnë siç duhet natën e Kadrit. Por, nëse nuk ka një mirësi hyjnore të rrafshit të së jashtëzakonshmes, kjo nuk është diçka që mund të ndodhë shumë. Andaj edhe Imam Ebu Hanifeja ka thënë: “Nata e Kadrit nuk është vetëm në netë të caktuara, por ajo duhet kërkuar në secilën prej treqind e gjashtëdhjetë e kusur netë e vitit. Nëse ju i mbani të gjalla me kujdesin më të përsosur të treqind e gjashtëdhjetë e kusur netë, nuk ka dyshim që Allahu i Lartësuar do t’i përgëzojë zemrat tuaja të sinqerta.”<sup>75</sup>

<sup>75</sup> Shih. Ibni Abdilberr, *et-Temhid* 2/208; en-Neueui, *Sherhu Sahihi Muslim* 8/57.



## 2. Vlerësimi i natës së Kadrit

Nata e Kadrit është një natë, kur Allahu (xhel'le xhelaluhu) do t'u falë njerëzve shpërblime të shumta. E thënë me fjalë të tjera, kjo natë është një prerje e bekuar e kohës kur Mbreti i Pafillimësisë dhe i Përjetësisë do t'u shpërndajë dhurata e shpërblime atyre që i besojnë Atij. Gjatë kësaj nate, pothuajse të gjithë atyre që hyjnë në atë atmosferë Allahu i Madhërishëm (xhel'le xhelaluhu) u fal secilit nga diçka sipas kuptimit dhe vlerës që ka tek Ai. Poende, atë natë, Allahu vepron me robërit e Tij si Sundues i Gjithësisë; nuk i shikon mëkatarët, skllëverit, lypësit dhe nevojtarët sipas rrënimit shpirtëror apo shprishjes fizike që mund të kenë përjetuar; nuk i vëren, por i trajton ata me mirësi sipas madhësisë së Vet. Për rrjedhojë, i Dërguari i Allahut, Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) thotë kështu në lidhje me këtë natë:

“Atij që e vlerëson natën e Kadrit siç duhet, duke besuar te virtyti i saj dhe duke e pritur shpërblimin vetëmse nga Allahu, i falen të gjitha mëkatet e shkuara.”<sup>76</sup>

Kuptimi dhe kapja e orës së bekuar, kur çdo gjë kthehet një me njëmijë, në Qabe, në Arafat, në Muzdelife, në Muuaxhehe, apo gjatë natës së Kadrit dhe në ditën e premte, përbëjnë një rëndësi shumë të madhe për sa i përket kapjes së të gjithë lartësisimit dhe shpërblimeve që do të vijnë nga Allahu i Madhërishëm (xhel'le xhelaluhu). Prandaj, kur i kupton plotësisht këtë hapësirë dhe kohë, njeriu duhet ta harrojë vetveten tërësisht dhe, për shembull, të lutet me këto fjalë:

“O Zot! Lartësoji edhe njëherë nëpër çdo anë të botës emrin Tënd të Lartë, të drejtën dhe të vërtetën. Na i hap edhe njëherë zemrat, si neve, ashtu edhe mbarë robërve të Tu nëpër botë, ndaj besimit, Islamit, Kuranit dhe shërbimit në besim dhe na mbaj neve të ngarkuar e në krye të kësaj detyre. Përhap mes robërve të Tu në qiell dhe në tokë dashuri dhe pranim për ne. Na bëj neve prej robërve të Tu të sinqertë, të pranuar me sinqeritet, të devotshëm, që kanë frikë të gabojnë ndaj

<sup>76</sup> Buhariu, *iman* 25; Muslim, *salatu'l-musafirin* 176.

Teje, të përkushtuar në adhurim dhe që meritojnë të jenë pranë me Ty, të kënaqur me Zotin e tyre dhe që Zoti i tyre është i kënaqur me ta, që të duan Ty dhe që duhen pranë Teje, që janë të përsëritshëm, të thjeshtë dhe që moral kanë moralin e Kuranit. Dërgoju o Zot, salavate pa fund Profetit tonë, Muhamedit (pqrnT), dhe paqe të gjithë sahabëve të Tij! Amin! Pafundësisht amin!”

Në një farë kuptimi ky horizont i “Nëse e shoh të shpëtuar besimin e popullit tim, jam i kënaqur edhe ta shoh veten mes flakëve të Ferrit.”<sup>77</sup> – duhet të quhet detyrë nga ana e çdo besimtari. Ky është një horizont, në të cilin njeriu e ka harruar tashmë vuajtjen e vet dhe nuk ndien asgjë tjetër veç vuajtjeve që kanë të tjerët.

Po, sot njerëzimi ka më shumë se kurrë nevojë për Allahun dhe për mesazhin e ndritur dhe të bekuar që Allahu ia pati dërguar me dorën e Profetit tonë të Nderuar (sal’lallahu alejhi ues’sel’lem). Prandaj, edhe pse mund të duken të vogla, përpjeket e bëra në këtë drejtim të ngadhënjimit dhe çlirimit të zemrave, ma merr mendja se kanë një rëndësi shumë të madhe pranë Allahut. Dhe të mendosh kështu, të përpiqesh në këtë çështje dhe të përgjërohesh me lutje pas lutjesh, është një sjellje profetike.

Veç kësaj, veçanërisht për këtë natë, ne duhet ta bëjmë sa më shumë këtë lutje që Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ues’sel’lem) na e ka mësuar nëpërmjet Aishes së nderuar (radijallahu anha):

“O Zot! Ti je shumë falës, Bujaria është e Jotja, e Ti e do që të falësh. Falmë edhe mua!”<sup>78</sup>

Këtë natë të ndritur deri në të zbardhur dhe gostinë hyjnore të saj e bëjnë të gëzueshme zbritja dhe prania në tokë e engjëjve dhe krijesave shpirtërore, me në krye Xhebrailin (alejhis’selam), i Cili ka sjellë edhe Kuranin Madhështor. Për çdo gërmë të lexuar nga Kurani në këtë natë, jepen tridhjetëmijë shpërblime. E po të njëjtën rritje të shumëfishtë

<sup>77</sup> Bediuzaman Said Nursi, *Tarihçe-i Hayat*, fq. 616 (Tahliller) (Bëhet fjalë për veprën “Jetëshkrimi”, pjesa “Analizat”, në origj. fq. 616).

<sup>78</sup> Tirmidhiu, *daauat* 84.

kanë edhe shpërblimet për adhurimet e tjera. Në këtë këndvështrim, për ta vlerësuar drejt natën dhe për ta shtuar përfitimin nga begatia dhe shkëlqimi i asaj kohe, falet namaz, lexohet Kuran dhe përmendet Allahu (xhel'le xhelaluhu) me *uirde* dhe *dhikre* nga më të shumtat, thuhet salavate, i lutemi dhe i përgjerohe mi të dorëzuar Allahut, si dhe u jepet të varfërve dhe njerëzve të vetmuar sa më shumë sadaka. Me pak fjalë, bëhet çdo përpjekje për t'u vlerësuar sa më shumë kjo natë.

## E. Sadakaja e Fitrit

Sadakaja që i është ngarkuar të japë çdo mysliman që i ka mundësitë gjatë muajit të Ramazanit për secilin prej pjesëtarëve të familjes së tij, quhet sadakaja e Fitrit. Në mesin e njerëzve kësaj i thuhet edhe "fitreja". Në thelb sadakaja e Fitrit, që jepet me qëllimin për të përfituar sa më shumë nga begatia e muajit të Ramazanit, ka një fitim tejet të rëndësishëm në jetën e përtejme. I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit goftë mbi Të), teksa tregonte begatinë hyjnore të sadakasë dhe të ndarjes prej pasurisë për të tjerët, ka thënë kështu:

"Nga një shkak i thjeshtë si ai i të dhënit dikujt një kafshatë bukë, një grusht hurma, apo diçka e ngjashme që mund t'i bëjë dobi të varfërit, Allahu vë në Xhennet tre persona: kryefamiljarin që urdhëron dhënien e lëmoshës, zonjën e shtëpisë që përgatit atë që do të jepet dhe shërbyesin që ia çon nevojtarit lëmoshën."<sup>79</sup>

Urdhëresa për dhënien e sadakasë së Fitrit ka ardhur në vitin e dytë të mërgimit, së bashku me shpalljen detyrim të mbajtjes së agjërimit të Ramazanit. Në një prej haditheve të Tij Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue'sel'lem) ka bërë të ditur se sadakaja e Fitrit duhet dhënë për çdo mysliman, i lirë, skllav, mashkull apo femër.<sup>80</sup> Mbështetur në këtë hadith, dijetarët Shafii, Maliki dhe Hanbeli, kanë thënë se sadakaja e

<sup>79</sup> Et-Taberani, *el-Mu'xhemu'l-eusat* 5/278; el-Hakim, *el-Mustedrek* 4/149.

<sup>80</sup> Buhariu, *zekat* 70, 71, 77, 78; Muslim, *zekat* 12, 13, 16.

fitrit është *farz* – detyrim. Ndërsa, sipas medhhebit Hanefi, ajo është *uaxhip* – domosdoshmëri.

Ibni Abasi (radijallahu anh) thotë kështu në lidhje me urtësitë e sadakasë së fitrit:

“I Dërguari i Allahut e ka urdhëruar sadakanë e fitrit, për ta pastruar agjëruesin nga sjelljet e kota e të shëmtuara dhe që të varfërit të kenë diçka për të ngrënë.”<sup>81</sup>

Nëse do të qëndrojmë te ky vlerësim i Ibni Abasit, sadakaja e fitrit është njëfarësoj si sexhdeja e *gabimit* në namaz; shërben si një shkas për faljen e gabimeve dhe mangësive që mund të kenë ndodhur gjatë mbajtjes së agjërimit përgjatë muajit të Ramazanit.

Në të njëjtën kohë, sadakaja e fitrit kontribuon edhe në përforcimin e solidaritetit në mesin e shoqërisë. Dhe është mjaft i rëndësishëm, duke qenë se u mundëson edhe atyre që janë nevojtarë, që të paktën në ditët e Bajramit, të mund të përmbushin ndonjë prej nevojave të tyre dhe të mund t’u mundësojnë fëmijëve që ta ndiejnë edhe ata gëzimin e festës së Bajramit.

## F. Dieta

*Dieta* është emërtim i ndihmës që bëjnë të gjithë ata që nuk e mbajnë dot agjërimit duke qenë se vuajnë nga një sëmundje kronike, pleqëria, shtatzënia apo ushqimi me gji i fëmijës, për çdo ditë që nuk kanë mundur të agjërojnë, duke i siguruar një të varfri të paktën sa për t’u ushqyer me dy vakte ushqimi të ditës.

*Dieta* është e caktuar me një ajet kuranor, në të cilin Allahu i Lartësuar thotë kështu:

“Agjërimi që ju është urdhëruar është me ditë të caktuara. Kushdo që është i sëmurë ose në udhëtim në ato ditë dhe nuk e mban dot

<sup>81</sup> Ebu Daud, *zekat* 17; Ibni Maxhe, *zekat* 21.

agjërimin, për aq ditë sa nuk e ka mbajtur dot, kur t'i kthehet shëndeti ose të mos jetë udhëtar, agjëron në ditë të tjera. Ata që nuk mund të agjërojnë nga pleqëria ose për arsye të tjera, si sëmundjet e rënda, ata duhet të japin dietë sa për të ngopur një të skamur...”<sup>82</sup>

## G. Bajrami i Ramazanit

### 1. Mendimet e Bajramit

Muajt që i prijnë Ramazanit, të cilat vijnë me mbarësi dhe begati, janë si shenjat dhe lajmëtarët se në horizont duken ditët e qeta, të heshtura, e të bekuara por plot e përplot me një shkëqim që do t'i mbështjellin zemrat. Çdo zemër që ka besuar, së bashku me ditën e parë të këtyre muajve, ndien se ka hyrë në territorin e Ramazanit, e përjeton këtë dhe, për ta vlerësuar sa më mirë muajin e begatisë që e pret disa hapa më tej, i kalon edhe njëherë nëpër sy të gjitha ndjenjat për sa i përket frymimeve dhe robërimit që do të shpërfaqë përpara Krijuesit.. sikur të mos i jenë hapur ende plotësisht qepallat nga gjumi dhe nuk është arritur ende përqendrimi në lidhje me ato që do të bëhen e do të thuhën, por me disa mëmërima dhe belbëzime, ndien sikur të jetë duke bërë disa përpjekje për të kapur melodinë e kësaj pune të madhe dhe këtij drejtimi të shenjtë, si e si për ta përkapur atë ritëm.

Kur zemrat mbushen plot emocion dhe shpirtrat vijnë në atë trajtën e tyre të pjekur, pas gjithë këtyre ditëve që vlejnë secila nga një agim më vete, me reflektimin e hënës së parë, por si një hënë e plotë, lind përnjëherësh Ramazani. Fryn gjithë frymë gjallërimi si erëra të ëmbla.. fryn e na i mbështjell zemrat; na i përkëdhel shpirtrat dhe lëkurën njësoj si mëndafshi dhe si kodrat në pranverë na i zgjon sytë drejt bukurive, e në zemra na zgjon dëshirën për t'u ngjitur lart në zemrat tona.. dhe porsi ujëvarat, kraharorët tanë i pushton një drithërimë e

---

<sup>82</sup> Bakara, 2/184.

butë dhe e ëmbël.

Në fund, mikpritja e një muaji përfundon, e ikën edhe Ramazani që erdhi me njëmijë e një arritje e shpërblime.. ikën, por shpirtrat që janë zgjuar e ringjallur nga drita e prurë prej tij, zemrat që kanë menduar vazhdimisht vetëm për të dhe janë drithëruar nga frika plot respekt ndaj Allahut, ndërgjegjet që kanë dalë në rrugë me dëshirën e madhe të ritakimit dhe kanë shkumëzuar ndjesish, kësaj here do të përqafohen me ditët aq të ngrohta të Bajramit. Po, ashtu si ata që e lëshojnë veten në det dhe pas një çasti ndiejnë ujin që i prek në çdo anë të trupit, edhe ne, pas tre muajve, e gjejmë veten në atmosferën larushane të Bajramit, në atë atmosferë të paqes dhe nginjjes shpirtërore.. e gjejmë dhe e ndiejmë atë me të gjitha shqisat tona, me tërë qenien, dhe e shpërndajmë me të gjitha kriteret e përvijuara nga gjendja jonë.

Pothuajse të gjitha zemrat që kanë besuar, nga të gjitha, namazet e falura gjatë Bajramit, tekbirët, sadakatë e fitrit, kurbanët dhe vizitat te njëri-tjetri, gjejnë një rrugëkalim, një dalje në imagjinatë dhe porsi vela të fryra nga erëra të brendshme, u duket sikur rrëshkasin drejt një bote ëndrrash të ëmbla. Po, me magjinë e atmosferës së përgjithshme, zërave, fjalëve dhe sjelljeve gjatë ditëve të Bajramit njeriu e ndien veten si të ishte ngjitur në një balonë fluturuese dhe sikur ngjitet pak e nga pak drejt qiellit, imagjinon sikur po largohet nga vendi në të cilin gjendej dhe përjeton aty një botë të magjishme, të cilën e kanë krijuar dritat e zbrazura nga një erë e çuditshme që ka sjellë Bajrami.

Në Bajram ne i ndiejmë të përfshira në njëra-tjetrën, të shkuarën, të ardhmen dhe të tashmen dhe kjo na fal kënaqësi. Njësoj sikur të kishte një farë magjie në zërat që dalin e ngrihen nëpër ajër nga faltoret, në ato shtëpitë ku shkojmë për vizitë apo në duart e bekuara që puthim, dhe me një prekje tonën sado të vogël, mbi të shkuarën sikur hapen dritare të njëpasnjëshme... dhe sakaq, ne na duket vetja sikur jemi në të njëjtën radhë në një faltore të vjetër së bashku me gjyshin, gjyshin e gjyshit dhe gjyshin e tij... me nxitjen që na jep kalimi i buzëve nga një dorë e pastër në tjetrën, njëra pas tjetrës, ndiejmë gëzimin e kalimit përpara fytyrës të sa e sa duarve të bekuara, sa e gjithë bota, njëra pas

tjetrës. Kur përqafojmë miqtë dhe të afërmit dhe i shtrëngojmë fort në kraharor, na bëhet sikur në atë çast të jemi duke shtrënguar në kraharor edhe të afërmit tanë që kanë jetuar shumë më herët, shumë shumë më herët dhe na duket sikur i erëmojmë të gjithë... na bëhet dhe çdo mendim, çdo imagjinatë, çdo fjalë dhe çdo sjellje që depërton nga Bajrami sikur ringjall një prerje kohe të ndritur të së shkuarës, që na e kaplon tërë horizontin, bëhet e jona, jeton bashkë me qenien tonë dhe u fal të gjithëve një shembull të “ringjalljes pas vdekjes” sipas gjerësisë së imagjinatës së vet.

Bajramet janë jehona melodike të të parëve tanë të lavdishëm dhe rrënjëve tona të bekuara, që kanë mbërritur deri sot e kësaj dite te ne. Me magjepsjen që shkaktojnë këto kumbime, ne shkojmë drejt botësh të pamundura për t'u arritur, hyjmë kudo me lehtësinë e hyrjes në ëndërr, e shëtisim çdo anë e kënd me shpejtësinë e imagjinatës dhe shumë shtresa të kohës mbivendosen, duket sikur iu mvishen njëra-tjetrës dhe ne i përjetojmë të gjitha në një të vetme. Po, për aq sa ne e lëshojmë veten në duart e fuqisë magjike të Ramazanit, e shkuara sikur rigjallërohet me tërë madhështinë e saj dhe kthehet edhe njëherë drejt nesh... çdo humbje e jona ringjallet dhe gjithë ç'kemi humbur e gjejmë edhe njëherë. I frymojmë edhe njëherë ato ditë të qashtra të së shkuarës, i thithim me një frymëmarrje më të fortë drejt mushkërive, pijmë me etje prej ujërave të kulluara që buçasin të së shkuarës dhe na ngjan vetja sikur të jemi në një ekskursion në një botë krejt të tjetërfartë... Dhe e pandehim aq thellë dhe aq sikur ta kemi lëshuar veten krejt në të, sa që na duket sikur të gjithë të vdekurit ringjallen në varret e tyre... të gjitha gjërat e kalbura e të shpërndara tashmë, mbliidhen edhe njëherë, fitojnë shpirt edhe njëherë... gjërat e copëtuara sa këtu atje, bashkohen dhe bëhen edhe njëherë njësh... prerjet e kohës të jetës sonë vijnë e na i përqafojnë edhe njëherë shpirtin... dhe krahas atyre kënaqësive të thella, shumë të thella, që kemi përjetuar dje dhe atyre që jemi duke përjetuar sot, me kujtimet e bukura të së shkuarës futemi në kënaqësi shpirtërore aq të magjishme, sa që në atë pikë ku kemi arritur, përbërësit e shijes dhe kënaqësisë, njësoj siç ndodh në ëndrra, ndryshojnë, risohen dhe marrin format që duam ne dhe kthehen nga një në njëmijë, duke

hyrë nëpër qëllimet, mendimet dhe zemrat tona. Gjithçka që shohim, dëgjojmë dhe ndiejmë, ndërron nga njëra formë në tjetrën me një magji që është e pamendueshme lehtë; prandaj ne kalojmë nga njëra ndjenjë, mendim dhe kënaqësi në ndjenjën, mendimin dhe kënaqësinë tjetër, sikur jeta jonë të ishte brenda një ylberi.

Kur vjen agimi i Bajramit dhe nga kryet e minareve fillojnë të kumbojnë lavdet e Zotit dhe gjithkrah mbështillet nga një ëmbëlsi shpirtërore, në ato minuta ndiejmë aq shumë gjëra të mistershme që na i entuziazmojnë ëndrrat, të cilat na marrin ne e na çojnë drejt thellësive, madje drejt thellësive më të thella se thellësitë dhe u pëshpërisin zemrave tona ndjesi të fshehta që nuk mund të thuhet asnjëherë dhe tregojnë për disa gjëra të pamundura për t'u shprehur, sidomos me gjuhën e përditshme, krejtësisht të pa pashpjegueshme.

Po, ajo atmosferë, ajo estetikë dhe ai stil i ezaneve, lavdërimeve të Zotit, tekbirëve, “*La ilahe il'lallah*”-eve, që shkëputen nga ndjenjat dhe mendimet e Itrive, Dede Efendive, është një zë dhe gjuhë e veçantë shumëdimensionale e botës së popullit tonë, një gjuhë e pakapshme e zemrës së tyre. Këto nota të zërit që të shkaktojnë drithërima janë shprehje e ndjenjave, melodi e zemrave tona, lënë në shpirtrat tona një gjurmë të fortë të përtejkohshme si një tog fjalësh të ardhura nga shumë përtej.

Nganjëherë klithmat e njëpasnjëshme, si të ishte duke ardhur ndonjë urdhër nga muezini, nganjëherë përvajtimi me melodi qiellore e imamit pas një farë kohe, nganjëherë kumbimi i tërë xhematit si në një kor, janë aq madhështore, aq drithëruese dhe i përkasin aq shumë botës sonë, aq sa ne të gjithë, ndërsa mërmërisim zërat që ngjiten nga faltorja drejt qiellit, e ndiejmë edhe njëherë gjithë atë të shkuar të gjatë e të lavdishme, madje edhe më tej, një të vërtetë të përbotshme, një të vërtetë që nis nga pakohësia dhe shkon drejt përjetësisë, me gjithë freskinë e saj të veçantë dhe përjetojmë atë tension të veçantë kënaqësie shpirtërore. Veçanërisht gjatë ditëve të Bajramit, faltorja na pëshpërit neve atë pastërtinë e ndjenjave aq të holla dhe të buta si mëndafshi dhe atë atmosferë aq të gjallë sa një çerdhe zogjsh, rehatinë e trupit, bindjen



e shpirtit, qëllimin e jetës, aventurën e saj, rrënjët shpirtërore të popullit tonë, themelet e kulturës, pavdekësinë e fesë sonë, muzikalitetin e gjuhës, botëkuptimin për jetën, bindjet, stilin dhe shijen tonë dhe na tregojnë rrugët për t'u bërë njeri i mirëfilltë.

Pothuajse në çdo kohë, mes këtyre zërave të ëmbël që jehojnë nëpër faltore, ne ndiejmë dhe na bëhet sikur e shohim me sy se si qiejt afrohen drejt tokës, toka kërkon të lartësohet e të bëhet njësh me qiejt, yjet që u shkelin syrin luleve në tokë dhe lulet që pulitin sytë ndaj banorëve të qiellit dhe se si përjetojnë gjithë këto vajtje-ardhje të mistershme e magjepsëse mes këtyre dy botëve.

Këta zëra, këto fjalë dhe këto imazhe, që i marrin të gjithë sipas thellësisë së tyre shpirtërore dhe të imagjinatës dhe i çojnë tej nëpër shumë botë të tjera, jo vetëm që jehojnë në zemrat që kanë besuar me bukuri që ndjellin zili, drithërimat, emocionet entuziazmuere dhe frymimet rigjallëruese, por, kur mbaron namazi, përmbushet edhe ai udhëtim qiellor dhe faltores i thuhet përkohesisht 'lamtumirë', për të "zbritur" kësaj here nga Më i Drejti te njerëzit, të gjithë kthehen te njerëzit me një tjetër lloj thellësie... përqafohet me ta, i uron për Bajramin dhe të gjitha ato që ka arritur në shpirt në atë rrugëtim drejt e nga faltorja, i ndan me të gjithë që takon në rrugë, në lagje, në shtëpi, në vendin e punës, në shkollë... kësisoj, copëzave të kufizuara kohës, të cilat janë të ndara në orë, u përfton pafundësi me aq sa ia lejojnë gjerësia e zemrës dhe pakohësia e shpirtit, aq sa duket sikur i kthen në përjetësi... dhe ende duke qenë në këtë botë, vë në pah se sa i lidhur është me gjithçka të përtejme, sa thellësisht është i lidhur me përjetësinë.

Të gjithë myslimanët pa përjashtim, që të mund të jehojnë kaq fort në shpirtrat e tyre dhe të mund t'i ndiejnë të gjitha sakaq këto ndjenja, këto ëndrra dhe këto emocione, lind nevoja për kushedi se sa kohë e organizime që mund të realizohen me rrugë të tjera. Gjithsesi, nuk mendoj se është e mundur që të arrihet dot njësoj po e njëjta atmosferë qiellore. Sepse gëzimi, lumturia, kënaqësia dhe emocionet e Bajrameve më shumë se sa nga ajo që përjetohet burimin e ka te dimensionin i

përjetësisë dhe të ardhmes, tek ajo që do të përjetohet edhe pas asaj që është duke u përjetuar tani. Të gjithë, me atë çfarë janë duke përjetuar tani, jetojnë magjinë e gjërave që do të ndiejnë zemrat e tyre në kullën e tyre të fildishtë... dhe më shumë se sa kjo jetë kalimtare që vjen e ikën, shëtisin nëpër ëndrrat e një të ardhmeje pa dyshim më të përshtatshme me botën e tyre shpirtërore, më të butë, më të ngrohtë. Në të vërtetë, njeriu është fëmija i një pritjeje. Një pjesë të mirë të jetës ai e kalon në kodrinat e një pritjeje të veshur me velin e shpresës. Pothuajse të gjithë ne kemi diç në thelbin tonë që është shumë fort e lidhur me Parajsën. Kjo pritje nuk është një pritje pasi nuk na kanë pëlqyer ato që kemi gjetur apo jetuar këtu; kjo pritje është pritja e surprizave hyjnore, për të cilat imagjinata jonë është shumë e ngushtë, edhe që të kuptojë në fytyrën e “paradhënieve” të shijuara veçanësinë e të qenit njeri, e sidomos privilegjin e të qenit njeri. Se sa e vërtetë është kjo dhe se sa me vend, Bajramet janë gjuhët më të pastra që e shprehin më së miri nga dritaret e mëdha të zemrës drejt thellësive të shpirtit tona.<sup>83</sup>

## 2. Dimension i shpirtëror i Bajramit

I ndjeri Nexhip Fazëll, besimtarin e vërtetë e përngjasonte me një formë karamelje të shtrënguar mirë e mirë. “Besimtari është si një karamelë e ngjeshur mirë, ka forcë ta ëmbëlsojë gjithë detin.” Po, sepse një besimtar që ka besuar mirë dhe ka arritur që besimin e tij ta reflektojë edhe në qëndrimet dhe sjelljet e tij është mëshirë për gjithë ç’ka përreth; njëfarësoj ai e ëmbëlson çdo gjë e çdo kënd përreth tij. Ai është si një formë karamelje, që edhe sikur në det, që është ujë me një masë të përqendruar kripe, ta hidhni, ai ka aq shumë ëmbëlsi sa që mund edhe detin e paanë mund ta bëjë sherbet.

Po ashtu, edhe Bajrami, megjithëse është i shkurtër, ai është një prerje e kohës që fsheh brenda saj arritjet, mbarësinë, begatinë dhe gëzimin e javëve të tëra, madje muajve. Në Bajram drejtimi dhe

<sup>83</sup> Fethullah Gylen, “Mendime rreth Bajramit (1)”, në: “Kur ditët frymojnë pranverën” (origj. Günler Baharı Soluklarken), fq. 57-61.

mirësitë surprizë të Allahut janë të atilla që mund të mos arrihen dot as në dhjetë ditë, një muaj, ndoshta as në dhjetë muaj apo disa vjet njëherësh. Sepse të mirat dhe mirësitë e bëra fitojnë vlerë vetëmse me drejtimin e përgjigjen e Allahut ndaj tyre. Dhe ja, Bajrami është një nga shkaqet më të rëndësishme të një drejtimi të këtyllë; sikur është pikërisht koha që mund të ta ëmbëlsojë gjithë jetën, sepse është koha e mundur për të arritur mirësitë hyjnore më të thella.

Patjetër, një arritje e këtyllë është vetëm për ata njerëz që i kanë vlerësuar më së miri arritjet e mundshme të Ramazanit dhe nuk janë përfshirë në kotësi gjatë Bajramit. Është shumë e vështirë që të përfitojnë prej të mirave të veçanta dhe arritjeve shpirtërore të Bajramit ata që e shohin Bajramin thjesht si një ditë pushimi, apo që hanë atë ditë dhe hedhin në bark çdo gjë që u del përpara, si të ishin duke marrë hakun e një muaji që kanë qëndruar pa ngrënë e pa pirë, apo që u rikthehen mëkateve pas një vargu ditësh të bekuara. Vetëm njerëzit që arrijnë ta ruajnë kujdesin dhe vigjilencën, si në Ramazan, edhe në Bajram, që qëndrojnë të distancuar nga mëkatet përgjatë gjithë jetës ashtu siç kanë qëndruar larg gjërave të dyshimta (*mubah*) gjatë Ramazanit dhe që kanë një koncept të plotë të robërisë ndaj Allahut, arrijnë që të meritojnë një mbarësi dhe të mira të mbledhura kaq dendur në pak kohë. Për ta Bajrami është trashëgimtari i vërtetë i Ramazanit; pra ato shpërblime dhe çmime të premtuara për në Ramazan është e mundur që t'i gjesh dhe t'i marrësh edhe në Bajram ato fryte. Njësoj si nata e Kadrit, që mban të ngërthyer në vete mirësitë dhe të mirat e një jete të plotë, ashtu është edhe Bajrami. Por, ndërkohë që ditët e Ramazanit dhe nata e Kadrit shihen si mundësi afrimi dhe afërsie me Allahun, në Bajram thelbësore është shpresa e afrimit. Bëhet fjalë për një shpresë që mund të shprehet me fjalët: “Me lejen e Allahut ne e arritëm atë afërsi; ishim ushtarë, u bëmë mareshalë.”

Në asnjë mënyrë, Bajrami nuk është gëzim për daljen nga Ramazani, që i le tashmë pas ditët e agjërimin dhe tani je i lirë të hash e të pish lirshëm ç'të duash. Ai është një farë çlirimi i zemrës që tashmë e ke kryer detyrën e robërisë dhe adhurimit ndaj Zotit dhe me shpresën që

je bërë më i mirë për të fituar faljen e Tij. Ne nuk festojmë Bajram meqë e lamë pas Ramazanin dhe ditët e agjërimit, por Bajramin si festë të shpresës që kemi shpëtuar nga pesha e rëndë e gabimeve dhe mëkateve. Sa bukur e shprehin ndjenjën dhe mendimin tonë këto fjalë të imamit të Allvarit:

*“Zoti të na falë, Bajrami atë ditë është Bajram*

*Të ikën gabim’ e mëkate, Bajrami atë ditë është Bajram.”*

Po, për ne Bajram do të thotë trajtimi më së miri dhe drejt i muajit të bekuar të Ramazanit, i cili fillimin e ka mëshirë, mesin falje dhe fundin shpëtim nga zjarri i Xhehenemit, pra është një festë e ngritur mbi shpresën e shpëtimit njëherë e mirë nga flakët; një festë e ndërtuar mbi pritmerinë e përfitimit sadopak prej thellësisë së mëshirës së Allahut dhe asaj shprese.

E vërteta është se ne ende nuk jemi ndalur te gjërat e premtuara që do të na ofrohen në fund të agjërimit. Dhe është e pamundur që ta vlerësojmë dot me receptorët tanë fizikë dhe kriteret tona të kësibotshme drejtimin e veçantë të Allahut. Cilido të jetë shpërblimi i theksuar në premtimin e patëmetë të Allahut që është i Patëmetë: *“Agjërimi është vetëm për Mua; shpërblimin e Tij vetëm Unë do ta jap.”*<sup>84</sup> – ne nuk mund ta dimë – por ne ende nuk e kemi marrë atë. Mirëpo ne besojmë aq fort te premtimi i Allahut dhe Ai do të na e japë dhe do të jetë shumë përtej pritshmërive tona; Ai do të na falë mirësi sipas madhësisë së thesareve të Tij që nuk njohin të mbaruar. Ne besojmë se i Gjithëmëshirshmi Mëshirues, Allahu që është Rahman dhe Rahim, që na ka mundësuar ta arrijmë Ramazanin, që na ka falur mundësinë për të thurur një thurimë të bukur robërie mes syfyrit dhe iftarit përgjatë një muaji të tërë, por duke na dhënë edhe forcën dhe fuqinë për të kryer detyrat tona me aq sa kemi mundësi, ka për të na falur një ditë edhe ato ditë të lumtura, në të cilat gëzimi do të jetë edhe shumë herë më i madh sesa gëzimi i sotëm. Ja pra, kështu e kuptojmë Bajramin me besim dhe jemi të mbushur plot e

<sup>84</sup> Buhari, *teuhid* 35; Muslim, *sijam* 160.

përplot me ëndrrat për Bajramet e vërteta që do të festojmë në sarajet e lumturisë së përjetshme.

Po, njëlloj siç shpresojmë se do të arrijmë një ditë në majat e gëzimit në Parajsë, pavarësisht të gjitha vështirësive, mundimeve dhe vuajtjeve që na presin rrugën drejt Xhenetit përgjatë gjithë jetës dhe përpjekjes së përditshme me lloj-lloj dëshirash, oreksesh dhe epshesh, që na tërheqin drejt Xhehenemit, është më se normale që të kemi disa pritmëri me dimensionin e mëshirës brenda nesh prej Atij që na e mundësoi të kalojmë një Ramazan me përpjekje për t'i kaluar të gjitha ato ditë në vijën e “kënaqësisë së Zotit”, me mendimin se na u dha mundësia të bëjmë investime të rëndësishme për sa i përket jetës së përtejme. Madje këto pritmëri janë një domosdoshmëri e besimit tek Allahu (xhel’le xheshanuhu). Për rrjedhojë, për ne Bajrami është edhe një ditë e çlirimit dhe frymëzimit shpirtëror, me të cilin i kemi lidhur të gjitha shpresat dhe pritmëritë tona për lumturi të përjetshme.

### ***Bajramet tona***

Parë nga një anë tjetër Bajramet tona janë shumë ndryshe festimeve, festivaleve apo karnavaleve që janë në shumë kultura të tjera. As në Bajram te besimtarët nuk mund të vërehen kurrsesi sjellje apo veprime të kota, anarki apo çekuilibre. Tek ata vëren vetëm një seriozitet që e ka zanafillën te dëgjimi dhe bindja ndaj Kuranit, në çdo sjellje të ekuilibruar të tyre, në qëndrimet e tyre serioze apo shikimet e tyre të thella. Si në çdo ditë tjetër edhe në Bajram ata qëndrojnë të hapur ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij; marrëdhëniet me të tjerët i mbajnë mbi ekuilibrin e boshtit të respektit, dashurisë dhe dhembshurisë. Ata përpiqen që të mos e çojnë dëm sikur edhe një grimëçast të vetëm të atyre ditëve të bekuara.

Me aq sa dihet, në kohën e Profetit tonë të Nderuar (sal’lallahu alejhi ues’sel’lem) puna nuk bëhej pushim në ditët e Bajramit. Njerëzit vijonin t’i kryenin po njëlloj të gjitha punët e tyre të përditshme. Atë ditë e prisnin pak më ndryshe me namazin dhe hutben e Bajramit;

mandej u buzëqeshnin të gjithë njëri-tjetrit, vraponin kush të kujdesej më shumë për të varfërit dhe nevojtarët dhe u shtronin për të ngrënë shokëve dhe miqve.

*PJESA E DYTË*



**AGJËRIMI NË RAMAZAN**





## A. Rëndësia e agjërimit në Islam

Agjërimi është një nga adhurimet e rëndësishme, me të cilat Allahu e ka ngarkuar me përgjegjësi njeriun. Fjala përkatëse në gjuhën arabe që përdoret për të shenjuar agjërimin, *saum*, në kuptimin absolut në fjalor do të thotë të braktisësh e të mos e bësh diçka. Ndërsa, nga pikëpamja terminologjike, ajo do të thotë që ata njerëz që mund të agjërojnë të qëndrojnë larg ngrënies, të pirit dhe marrëdhënieve intime nga çasti i parë i agimit e deri në përfundim të diellit me qëllimin e adhurimit. Agjërimi është shpallur si *farz*, pra detyrim, në periudhën e Medinës, në muajin Shaban të vitit të dytë të mërgimit.

Agjërimi është një adhurim shumë i rëndësishëm në Islam. Prandaj mbi të është ndalur në shumë ajete fisnike në Kuranin Famëlartë, madje ai është konsideruar edhe si një shpagim në shumë forma dënimesh të ndryshme. Siç do të mund ta shohim edhe më gjerësisht në faqet në vijim, në të cilat do të ndalemi më imtësisht në lidhje me agjërimin, do të vërejmë se për shumë gabime apo krime të jenë dhënë edhe ndëshkime me gjashtëdhjetë ditë agjërimit, nganjëherë dhjetë, e disa herë të tjera si shpagim me vetëm tri ditë agjërimit. Me sa duket ai është një adhurim tejet i rëndësishëm, që i shkrin gabimet dhe mëkatet, e një veprim që e pastron njeriun, madje edhe e ndihmon drejt lartësisimit.

Në të vërtetë, agjërimi – njësoj siç ndodh edhe në adhurimet e tjera – është një detyrë që duhet kryer vetëmse si një detyrim ndaj Allahut të Madhërishëm (xhel'le xhelaluhu) me vetëdijen e plotë të adhurimit si rob i Tij dhe pa u lidhur me mendime të dobive fizike a metafizike të tilla, që mund t'i ofrojë njeriut. Patjetër që çdo adhurim ngërthen në vetvete shumë urtësi dhe mirësi të tjera, të cilat vijnë natyrshëm bashkë me të. Por Allahu, me veprime që i përkasin sferës së adhurimit si rob, do të vërë në pah te robi atë që nevojitet për të treguar shkallën e trajtës prej robi që ka vlerë përpara Tij, si dhe di se cila është masa e kësaj trajtje pjekurie, që është e nevojshme për hyrjen e një njeriu në Xhenet. Parë në këtë këndvështrim, adhurimet janë caktuar si të tilla, në mënyrë që robi të fitojë meritë për të qenë afër me Allahun dhe të

jetë i denjë për lumturinë e përjetshme dhe për të qenë prej banorëve të Xhenetit. Kështu që, edhe nëse te adhurimet ndijohen dhe vërehen disa dobi të kësibotshme, të mira dhe urtësi, ato kanë urtësi, ndikim dhe pasoja edhe më të thella e të rëndësishme, të cilat ne nuk i shohim e nuk i dimë dot.

Njëherë për njëherë, adhurimet e bëjnë njeriun, i cili është kalimtar, të denjë për përjetësinë. Njeriun, mes të cilit dhe Allahut Më të Lartit të çdo lartësie ka shtatëdhjetëmijë perde dhe ai e ka të pamundur që ta shohë Atë, e lartësojnë drejt cilësisë që të mund ta dëshmojë Zotin e tij nëpërmjet horizontit të zemrës dhe të shpirtit. I japin njeriut mundësinë për të fituar kënaqësinë e Allahut, që nuk ka pasuri të kësaj bote që të mund ta ketë njeriu e të mund t'i mjaftojë për të fituar kënaqësinë e Allahut. Dhe ja pra, edhe agjërimin me një mendim të këfillë duhet ta konsiderojmë. Domethënë ai është një mirësi tejet e rëndësishme që njeriu të bëhet i denjë për të qenë në Xhenet dhe një domosdoshmëri në rrugën që të çon drejt dëshmimit të Bukurisë së Allahut (xhel'le xhelaluhu).

Po, në të gjitha adhurimet mund të vërehen disa dobi, të mira dhe urtësi që në jetën e kësaj bote. Për shembull, zekati është një urë. Sepse ai është një mënyrë mjaft e mirë lidhjeje mes shtresës së të pasurve dhe shtresës së të varfërve. Po ashtu edhe haxhi, që është si një kongres shumë i gjerë; në ato takime e mbledhje mund të lindin edhe shumë dobi e rezultate të tjera që i përkasin kësaj bote. Kurse agjërimi është pak më ndryshe se këto. Edhe pse ai mund të ketë shumë më shumë të mira e dobi për njeriun dhe shoqërinë, tek ai këto cilësi nuk janë të dukshme haptas sa ç'janë në adhurimet e tjera. Duke qenë që është shumë e vështirë që të kuptohet apo të dihet me sy që dikush është duke agjëruar apo jo, ai i përket tërësej vetëm Allahut. Dhe shpërblim ka faljen. Ja se si e ka shprehur këtë veçanësi të agjërimin Profeti ynë i Nderuar (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem):

*“Kushdo që e mban agjërimin e Ramazanit duke besuar te shpërblimi për të dhe e pret prej Allahut shpërblimin për të, i falen mëkatet e*

*shkuara.*”<sup>85</sup>

Ja pra, nëse me agjërimin e mbajtur çdo vit njeriut i falen mëkatet e shkuara, atëherë i bie që ky njeri ka fituar. Ai nuk del i poshtëruar; as këtu, as në varr e as në ditën e gjykimit... Mund ta thoni edhe me fjalët: “Nuk bie në pozita poshtëruese në këto ambiente, në këto vendqëndrime.”

### **Ramazani dhe ribati**

Sidomos atyre që ngarendin sa këtu atje për t’u kujdesur për brezin e ri, kushedi se ç’dhurata u fal atyre Ramazani! Ata që bëjnë syfyer në rrugën e shërbimit ndaj fesë dhe njerëzve, që nuk dinë çështje iftari në shtëpi, por udhëtojnë nëpër vende të ndryshme, kushedi se ç’fryte të mijëra viteve fitojnë përgjatë Ramazanit.

*Ribat* do të thotë, me pak fjalë, të përmbushësh kushtet për të pasur cilësinë e të “vetëdedikuarit”, duke qenë përherë vigjilent e i kujdesshëm për të gjitha problemet e fatkeqësitë që mund t’u vijnë fesë dhe njerëzve duke përmbushur çdo kusht të misionit ku beson. Një njeriu të dedikuar i shënohet shpërblimi i *ribat*-it, çdo hap që hedh në drejtim të qëllimit dhe synimit të tij në këtë rrugë. Po sikur ky shpërblim të jetë sipas begatisë së vetë muajit të Ramazanit? Po, secili mund të përfitojë nga ky shpërblim sipas sinqeritetit që ka në zemër, thellësisë në qëllim dhe sipas nivelit të lidhjes që ka me Allahun e Madhërishëm.

Të gjitha këto janë begati e Ramazanit. Një njeri që i vlerëson mirë këto mundësi që vijnë bashkë me Ramazanin dhe që janë potencialisht të gatshme përgjatë gjithë Ramazanit, nuk ka se për çfarë të qahet apo ankohet pas mbarimit të këtij muaji. Sepse ai fiton një trajtë të denjë në rrugëtimin për t’u bërë njeri i përsosur. Ai e ka vlerësuar siç duhet muajin e Ramazanit dhe është kandidat për të fituar edhe faljen e Allahut. Njërin prej gëzimeve e ka jetuar çdo mbrëmje në sofrën e iftarit, ndërsa tjetrën do ta shijojë kur të kthehet te Zoti i tij.

---

<sup>85</sup> Buhariu, *iman* 28; Muslim, *salatu’l-musafirin* 176.

## B. Përshkallëzimi i urdhërimeve të agjërimit

Shumë prej urdhëresave të fesë islame kanë zbritur shkallë-shkallë. Me një fjalë nuk kanë zbritur të gjitha njëherë e mirë, por etapë pas etape. Kësisoj ato kanë qenë më të lehta për t'u pranuar prej njerëzve dhe këta të fundit e kanë pasur më të lehtë që t'i braktisnin zakonet e tyre, me të cilat ishin mësuar të jetonin deri atë ditë. Dhe i këtillë, i zbritur shkallë-shkallë është edhe urdhërimi për të agjëruar. Muadh bin Xhebeli (radijallahu anh) tregon:

“Kur erdhi në Medinë, i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) agjëronte çdo muaj nga tri ditë, si dhe ditën e Ashures. Pastaj Allahu i Lartësuar e bëri detyrim agjërimin duke na zbritur ajetet 183 dhe 184 të sures “Bakara”. Shprehja *“kush ka mundësi, ngop një të varfër”* kishte kuptimin që kush kishte mundësi dhe donte agjëronte, kush donte, ushqente një të varfër dhe kjo vlente si të kishte agjëruar. Derisa Allahu zbriti ajetin: *“Kushdo që e arrin atë muaj (Ramazanin), të agjërojë! Kush sëmuret ose është në udhëtim, të mbajë po aq agjërim në ditë të tjera.”*<sup>86</sup> Kështu, ndërkohë që Allahu urdhëronte prerazi mbajtjen e agjërimit për ata që ishin të shëndetshëm dhe nuk ishin në udhëtim, u lejoi të sëmureve dhe udhëtarëve që ta zëvendësonin agjëronin në ditë të tjera. Ndërsa gjykimi për të ushqyer e për të ngopur një të varfër në vend të agjërimit, mbeti i kufizuar tek ata që ishin të moshuar dhe plotësisht të pamundur për të agjëruar. Për rrjedhojë, këto gjykime morën formën përfundimtare në dy etapa.”

Ndërkaq, Muadhi i deruar flet edhe për dy etapa në lidhje me gjykimet rreth brendisë së agjërimit:

“Në periudhën e parë kur u shpall i detyruar agjërimi, gjykimi ishte kështu: Nga mbrëmja derisa binim për të fjetur, ngrënia, pirja dhe marrëdhëniet në familje ishin të lejuara, e pasi flinim e gjatë ditës riktheheshin sërish ndalimet e agjërimit. Një ditë, një prej ensarëve që e quanin Sirme, kishte punuar gjatë gjithë ditës edhe pse me agjërim

<sup>86</sup> Bakara, 2/185.

dhe kur ishte kthyer në shtëpi, kishte falur namazin dhe nga lodhja e pafuqia kishte rënë të flinte pa ngrënë e pa pirë dot asgjë. Në mëngjes, kur ishte zgjuar, e kishte vazhduar ditën sërish duke agjëruar. Profeti ynë Fisnik (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem), kur e pa ashtu të lodhur e të rraskapitur, “Çështë kjo gjendje?” – e pyeti. I shkreti ia tregoi se si qëndronte puna. Një gjë e ngjashme i kishte ndodhur edhe Omerit të nderuar (radijallahu anh). Edhe atë e kishte zënë gjumi dhe kur ishte zgjuar, i kishte shkëlur ndalesat e agjërimit dhe i kishte treguar edhe Profetit tonë për këtë. Me këto ndodhi pati zbritur ajeti 187 i sures “Bakara”, që bënte të ditur se deri në çastin e parë të agimit, lejohej absolutisht që të hahej, të pihej apo të kryheshin marrëdhënie në familje.”<sup>87</sup>

Ky përshkallëzim dhe shumë të tjera si ky, që na tregohen nëpër transmetime të ndryshme, janë mëshirë e Allahut për besimtarët. Allahu e ka vendosur

## C. Agjërimi në Kuranin Fisnik

Agjërimi është një adhurim që u është shpallur detyrim të gjithë besimtarëve me urdhër të hapur të Kuranit Fisnik. Në suren “Bakara” Allahu thotë:

*“O ju që keni besuar! Njësoj siç u qe shpallur detyrim atyre përpara jush, edhe juve ju është bërë detyrim agjërimi, që ju të ruheni (nga mëkatet).”*<sup>88</sup>

*“Kush nga ju ta arrijë atë muaj (Ramazanin), të agjërojë.”*<sup>89</sup>

Siç kuptohet, mjaft haptas, edhe nga ajetet, çdo besimtar që e arrin muajin e Ramazanit – nëse nuk ka ndonjë justifikim të vlefshëm në

<sup>87</sup> Ahmed bin Hanbel, *el-Musned* 5/246; et-Taberani, *el-Mu'xhemu'l-kebir* 20/133.

<sup>88</sup> Bakara, 2/183.

<sup>89</sup> Bakara, 2/185.

aspektin fetar – ka përgjegjësinë që të agjërojë. Në Kuranin Fisnik bëhet e ditur që agjërimi është i detyrueshëm për të gjithë, por nuk i jepet vend gjykimeve në lidhje me të. Pasi janë vënë në pah disa nga urdhëresat kryesore, pjesa tjetër i është lënë Sunetit të Profetit tonë të Nderuar (paqja qoftë mbi Të). Disa nga urdhëresat dhe gjykimet në lidhje me mbajtjen e agjërimin në Kuran janë:

### ***Ata që nuk agjërojnë dot***

*“Ditët e agjërimin janë të numëruara. Nëse ndonjëri nga ju është i sëmurë, apo është udhëtar, agjëron në ditë të tjerë për aq ditë sa nuk e ka mbajtur dot agjërimin. Ata që nuk e përballojnë dot agjërimin nga ndonjë dobësi e trupit, apo vuajnë nga ndonjë sëmundje që nuk ka shpresë për shërim, atëherë ata duhet të japin një dietë sa për të ngopur një të varfër. Nëse ndokush bën ndonjë të mirë nga vetja dhe jep më shumë, kjo është më e mbarë për të. Sikur ta dinit, agjërimi është më i hairit për ju.”<sup>90</sup>*

### ***Marrëdhëniet familjare në natën e agjërimin***

*“Marrëdhëniet me bashkëshortët tuaj ju janë bërë të lejuara në natën e agjërimin. Ata/o janë për ju një veshje që ju mbron nga mëkati, e edhe ju jeni një veshje për ta. Allahu e di që ju nuk mund t'i besoni dot egos suaj, prandaj jua pranoi pendesën dhe jua fali mëkatet. Prandaj këndeje e tutje ju mund t'u afroheni atyre dhe të kërkoni atë që ka caktuar Allahu për ju.”<sup>91</sup>*

### ***Koha për të filluar agjërimin***

*“Hani dhe pini deri në kohën e agimit të parë, pikërisht atëherë kur ndriçimi i ditës fillon të ndajë nga errësira e natës. Pastaj plotësojeni agjërimin, derisa të vijë mbrëmja sërish.”<sup>92</sup>*

<sup>90</sup> Po aty, 2/184.

<sup>91</sup> Bakara, 2/187.

<sup>92</sup> Po aty.

## ***Zëvendësimi i agjërimit dhe e vërteta historike***

Krahas trajtimit të disa gjykimeve në lidhje me agjërimin, në Kuranin Fisnik është ndalur edhe në trajtimin e të vërtetës së tij historike, natyrën e muajit të Ramazanit, rëndësinë që ka ai dhe shkallët që do të fitojnë ata që e kryejnë këtë adhurim:

*“Ai muaj i Ramazanit, që u tregon njerëzve rrugën e drejtë, që bart haptasi argumentet e udhëzimit dhe në atë muaj është zbritur edhe Kurani që ndan të drejtën nga e rremja. Kush ta arrijë këtë muaj, të agjërojë. Kush është i sëmurë apo në rrugë, të agjërojë në ditë të tjera për aq ditë sa nuk ka agjëruar dot. Allahu do për ju lehtësinë, nuk do vështirësinë. Që ju t’i plotësoni ditët e agjërimit”<sup>93</sup>*

## ***Shpërblimi i agjërimit***

Në Kuranin Fisnik agjërimi është renditur si një nga punët më të mira dhe një nga adhurimet më të mëdha. Teksa rendit njerëzit, me të cilët do të jetë i kënaqur, që do t’i falë dhe do t’i shpërblejë me shpërblime jashtëzakonisht të mëdha, Allahu ka bërë të ditur se prej tyre do të jenë edhe “burrat që agjërojnë dhe gratë që agjërojnë”:

*“Për burrat dhe gratë myslimanë, burrat dhe gratë besimtare, burrat dhe gratë që janë të përhershëm dhe të qëndrueshëm në adhurime dhe devotshmëri ndaj Allahut, burrat dhe gratë që flasin fjalë të drejta, burrat dhe gratë që durojnë, burrat dhe gratë që janë të përlura nga respekti që kanë për Allahun, burrat dhe gratë që e ruajnë nderin e tyre, burrat dhe gratë që e përmendin shumë Allahun, Allahu ka përgatitur faljen dhe një shpërblim shumë të madh.”<sup>94</sup>*

## **D. Pranimi i agjërimit si dietë a shlyerje e gabimeve**

---

<sup>93</sup> Bakara, 2/185.

<sup>94</sup> Ahdhab, 33/35.

Agjërimi ka një vlerë shumë të madhe pranë Allahut. Kjo është arsyeja që ndonjëherë Islami e ka pranuar atë herë si një çmim në vend të një pune të rëndësishme, herë si shlyerje të një gabimi, e herë si shlyerje të një mëkati a një mangësie në një punë të caktuar.

Për shembull, rruajtja dhe qethja kur je i veshur me *ihramnë* haxh është e ndaluar, prandaj nëse dikujt i duhet që të rruhet e qethet për ndonjë arsye të caktuar, ai duhet ta shlyejë këtë të metë të tij duke therur kurban, duke ushqyer nga të varfërit ose duke agjëruar vetë. Këtu agjërimi është si një vepër që e zhbën mangësinë e personit. Ja se si thuhet edhe në ajetin kuranor në lidhje me këtë çështje:

*“Kryeni haxhin dhe umren për hir të Allahut! Nëse në këtë rrugë pengoheni, atëherë thorni kurban, sipas mundësisë, dhe mos i rruani kokat tuaja, derisa të arrijë kurbanin në vend! Cilido prej jush që është i sëmurë ose që ka ndonjë plagë në kokë (dhe si i tillë, nuk mund ta rruajë kokën), le ta zëvendësojë me agjërim, lëmoshë ose kurban. Kur të jeni të sigurt (nga armiqtë), ai që prej jush kryen umren deri në haxh, le të therë kurban, sipas mundësisë. Ndërsa ai që nuk ka mundësi, është i detyruar të agjërojë tri ditë në haxh dhe shtatë ditë pas kthimit nga haxhi; këto janë dhjetë ditë të plota. Kjo është për ata që nuk banojnë në Mekë. Ta keni frikë Allahun dhe dijeni se Ai dënon ashpër.”<sup>95</sup>*

Një rast tjetër që agjërimi ofrohet dhe kërkohet si një shlyerje për mëkatin e bërë është edhe situata e vrasjes së një besimtari pa dashje. Në një rast si ky, besimtari, përpos dietës që duhet të paguajë, ai duhet të lirojë një skllav dhe nëse nuk ka mundësi ta bëjë këtë, atëherë ai do të mbajë agjërim për dy muaj me radhë:

*“Nuk bën që besimtari të vrasë besimtarin, përveçse gabimisht. Kush vret një besimtar gabimisht, duhet të lirojë një besimtar të robëruar dhe t’u paguajë gjakun trashëgimtarëve të të vrarit, përpos rastit kur familja e të vrarit ia fal gjakun. Nëse i vrari është nga një popull që e keni armik e njëkohësisht është besimtar, duhet të lirohet një besimtar i robëruar. Nëse*

<sup>95</sup> Bakara, 2/196.



*i vrari është nga një popull me të cilin ju keni lidhur marrëveshje, i duhet paguar gjaku familjes së tij, duke liruar edhe një besimtar të robëruar. Ai që s'mund të gjejë rob, duhet të agjërojë dy muaj rresht. (Kjo është bërë) në shenjë pendimi para Allahut. Se Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë.»<sup>96</sup>*

Gjithashtu, agjërimi zë vend edhe në shlyerjen e shkeljes së premtimit. Ai njeri që shkel premtimin, nëse nuk gjen dot të varfër që t'i ushqejë, nuk gjen dot një skllav për ta veshur apo liruar, atëherë në vend të këtyre ai agjëron për tri ditë:

*“Allahu nuk ju ndëshkon për betimin që e bëni pa qëllim, por ju ndëshkon për betimin e bërë me qëllim. Larja e gjnahut për thyerjen e betimit është: ushqyerja e dhjetë të varfërve me mesataren e ushqimit të familjes suaj ose t'i vishni ata, ose të lironi një skllav. Ai që nuk gjen mundësi për këto, le të agjërojë tri ditë. Kjo është shlyerja për thyerjen e betimeve tuaja, nëse betoheni. Mbani betimet tuaja! Kështu jua shpjegon Allahu Fjalët dhe ligjet e Veta, që të jeni mirënjohës.»<sup>97</sup>*

Poende ka edhe një gjykim tjetër, i cili është për njeriun që gjuan për gjueti kur është i veshur në *ihram* gjatë haxhit. Siç dihet, gjuetia kur je i veshur në *ihram* është e ndaluar. Për ata që e shkelin këtë ndalesë, dënimi është ose të therin një kurban që konsiderohet i barabartë me gjënë e gjuajtur, ose do të ushqejë nevojtarët ose do të agjërojë. Edhe këtu, siç e vërejmë, agjërimi është konsideruar si një shpagim në një nivel me ushqimin e nevojtarëve apo therjen e kurbanit:

*“O besimtarë! Mos gjuani, duke qenë në ihram! Kushdo që e vret gjahun me paramendim, për dënim duhet të therë si kurban në Qabe një kafshë shtëpiake të ngjashme me kafshën e gjuajtur, sipas vlerësimit të dy njerëzve të drejtë midis jush; ose të ushqejë disa të varfër për të larë gjnahun; ose të agjërojë në atë masë, që ta ndiejë ndëshkimin për gjynahun e bërë. Allahu e fal atë që ka kaluar (para ndalimit). Ndërsa atë që vepron pas ndalimit, Allahu do ta ndëshkojë. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Zoti*

---

<sup>96</sup> Nisa, 4/92.

<sup>97</sup> Maide, 5/89.

*për shpagim.*<sup>98</sup>

Dhe, në fund, një shlyerje tjetër është edhe ajo për një nga zakonet e kohës së *inJORANCËS*, siç është ai që quhet me emrin “*dhihar*”:

*“Ata që i ndajnë gratë e veta në këtë mënyrë e pastaj duan të kthejnë mbrapsht atë që thanë, duhet të lirojnë një skllav (apo skllave), para se të preken përsëri. Kështu ju urdhërohet. Allahu i di të gjitha ato që bëni ju. Ai që nuk gjen (ndonjë skllav për të liruar), duhet që të agjërojë dy muaj rresht, para se të preken si bashkëshortë. E, nëse nuk mund ta mbajë agjërimin, atëherë duhet të ushqejë gjashtëdhjetë të varfër. Kjo, që të tregoni besimin në Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Këta janë kufijtë e Allahut. Ndërsa për jobesimtarët ka vuajtje të mundimshme.”<sup>99</sup>*

## E. Agjërimi në hadithe

Kurani Fisnik, shumë prej çështjeve i trajton në mënyrë të përmbledhur. Ai që do t'i shpjegojë dhe do t'ua mësojë ato njerëzve është i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi Të), të Cilit iu zbrit Kurani Famëlartë. Sepse pas Kuranit, interpretuesi më i madh i tij është vetë i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem). Ai e ka trajtuar agjërimin me tërë imtësitë e tij duke na e shpjeguar me fjalët e Tij të ndritura. Këtu, pasi të rendisim disa nga fjalët profetike në lidhje me shpalljen e agjërimin si detyrim për mbarë besimtarët, do të përpiqemi të transmetojmë edhe disa nga hadithet e përçuara deri më sot të Resulullahut në lidhje me rëndësinë dhe virtytet e agjërimin. I Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi Të) ka thënë:

*“Islami është i ngritur mbi pesë kritere: Të dëshmosh se nuk ka zot tjetër, përpos Allahut dhe Muhamedi i nderuar është robi dhe i dërguari i Tij, të falësh namazin, të japësh zekatin, të kryesh haxhin dhe të mbash agjërimin e Ramazanit. (Në kohën e kësaj ngjarjeje, haxhi ende nuk ishte*

<sup>98</sup> Po aty, 5/95.

<sup>99</sup> Muxhadele, 58/3-4.

*shpallur detyrim.*)<sup>100</sup>

Ndërsa në një hadith tjetër, te Profeti ynë (paqja qoftë mbi Të) erdhi Xhebraili i nderuar (alejhis'selam) në trajtan e njeriut dhe i drejton disa pyetje: “Çështë Islami?” – dhe Profeti i profetëve (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) i kthen këtë përgjigje:

*“Islami është të adhurosh Allahun dhe të mos njohësh të adhurueshëm tjetër, përveç Tij; të falësh namazin, të japësh zekatin dhe të agjërosh.”*<sup>101</sup>

Siç kuptohet dhe nga hadithet e lartpërmendura, agjërimi është një nga kriteret themelore të Islamit dhe është *detyrim* për të gjithë besimtarët. Ndër dijetarët e *Ehli Sunetit* nuk ka asnjë kundërshti për sa i përket kësaj çështjeje. Tashmë këtë e dëshmon më së miri edhe praktika e Profetit tonë (pqmT), e cila ka kaluar nëpër plot katërmëdhjetë shekuj dhe ka ardhur te ne e paprekur.

### ***Shpërblimin e agjërimit e ka në dorë Allahu***

Për të treguar vlerën që bart agjërimi pranë Allahut, Profeti ynë i Nderuar (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) thotë:

*“Allahu tha: ‘Çdo punë që bën i biri i Ademit, e bën për vete. Përveç agjërimit, sepse ai është për Mua. Shpërblimin e tij e jap Unë. Era e gojës së agjëruesit, pranë Allahut është më e këndshme edhe se erëtimi i miskut.’”*<sup>102</sup>

Ata që durojnë çdo lloj vështirësie, duke përmendur në krye që agjërimit, tek Allahu do të kenë një shpërblim të pamatë. Kurani Fisnik thotë:

*“Ata që durojnë shpërblimin do ta kenë të pamatshëm.”*<sup>103</sup>

Agjërimi e ka edhe këtë si pjesë të përmbajtjes së tij. Në ahiret, kur të

<sup>100</sup> Buhariu, *iman* 1, *tefsiru sure* (1) 30; Muslim, *iman* 19-21.

<sup>101</sup> Buhariu, *iman* 36; Muslim, *iman* 5.

<sup>102</sup> Buhariu, *saum* 2; Muslim, *sijam* 160.

<sup>103</sup> Zumer, 39/10.

ngrihet peshorja dhe librat e jetës të fluturojnë sa andej këndeje, kjo nuk do të jetë e vlefshme edhe për agjërimin. Sepse Allahu, kur garanton çështjen e agjërit, për shpërblimin e tij thotë se ai do të jepet pa u vënë në peshore dhe nga Ai Vetë. Tek agjërimi ka përkushtim ndaj Allahut dhe braktisje të dëshirave njerëzore vetëmse për hir të Allahut. Në të ka një lloj frenimi ndaj sofrave gjithë mirësi që i janë shtruar përpara syve. Të gjitha këto besimtari i bën pa pasur asnjë lloj detyrimi me forcë, por duke përdorur forcën e vullnetit. Dhe shpërblimin e një pune të tillë Allahu nuk ia lë askujt, por e ka marrë përsipër Vetë.

Në vijim të hadithit thuhet se era e gojës së agjëruetit, pranë Allahut është më e këndshme edhe sesa era e miskut. Era e gojës e agjëruetit vjen nga uria. Pranë Allahut kjo erë është më e ëmbël, më e këndshme dhe e pastër edhe sesa misku. Ka disa aroma që engjëjt, të cilët janë shpirtra të pastra, i pëlqejnë jashtëzakonisht shumë. Në Lartësitë e Epërme erëtimet e mira janë si çelësa që hapin thesare plot mistere. Edhe era e gojës e agjëruetit është si këto erëtime të mira. Dhe kjo vjen ngaqë agjërimi është një adhurim me përmasën e lidhjes së fortë mes Allahut dhe robit të Tij. Në këtë pikëpamje, agjërimi duhet trajtuar në tërë thellësinë e tij. Përndryshe, era e gojës nuk është diçka e këndshme në vetvete.

Ka disa gjëra, që edhe pse mund të duken si të shëmtuara së jashtmi, rezultatin e kanë shumë të këndshëm, shumë të çmuar. Për shembull, plaga në trupin e dëshmorit është, ndoshta, një trëndafil në vështrimin e Allahut. Edhe era e gjakut që rrjedh nga trupi i tij, pranë Allahut mund të jetë erëtimi më i mirë e i veçantë. Kjo është arsyeja se pse dëshmorët varrosen pa u larë. Megjithëse, njerëzit mund ta shohin këtë si diçka të shëmtuar.

E këtillë është edhe aroma e gojës e agjëruetit. Kjo erë, e cila vjen nga uria dhe është njëfarësoj e shëmtuar, duke qenë se bart domethënien e fitimit të pëlqimit të Allahut, pranë Tij ajo është e mirë. Në këmbim të mundimeve me të cilat përballet besimtari, Zoti e bën të vyer deri edhe erëtimin e gojës së tij, duke e mbajtur më lart edhe se erëtimet më të mira. Veç kësaj, kjo vlen tejmasë shumë për të treguar se sa i

vyer mund të jetë tek Allahu edhe mundimi më i lehtë i përballuar në rrugën e Allahut.

Me pak fjalë, në çdo orë të çdo dite që agjëron, ndihet sikur të jetë në një Miraxh duke u ngjitur mbi një palë shkallë që i janë vënë përpara, vetëm sepse ndien brenda vetes të gjitha këto domethënie, dhe kjo ngjitje vazhdon deri në momentin që ai ta marrë nga Allahu shpërblimin.

### ***Agjërimi është zekati i trupit***

Në një hadith të transmetuar nga Ebu Hurejreja i nderuar (radijallahu anh), i Dërguari Fisnik i Allahut (paqja qoftë mbi Të) ka thënë:

*“Çdo gjë ka zekatin e saj. Dhe zekati i trupit është agjërimi. Agjërimi është gjysma e durimit.”*<sup>104</sup>

Si fjalë, *zekat* do të thotë: pastërti, shtim, që diçka të jetë e begatë. Duke dhënë zekatin besimtari e pastron pasurinë e tij nga ndotjet e ndonjë mëkati që mund ta ketë ndotur. Në një këndvështrim tjetër, nëpërmjet tij pastrohen edhe disa cilësi të shëmtuara që strehohen te njeriu, siç është kopracia, apo mundësitë e një përplasjeje të ashpër mes të kamurve dhe të varfërve në shoqëri. I Dërguari Fisnik (paqja qoftë mbi Të) thotë se çdo gjë ka zekatin e vet, që e pastron atë nga ndotjet dhe ndryshkja. Dhe ajo gjë që e pastron trupin është agjërimi. Sepse, ndërsa nga njëra anë agjërimi e pastron trupin materialisht, duke i mfalur shëndet, ai e pastron atë edhe shpirtërisht, nga mëkatet, dhe e shpëton kësisoj nga vuajtjet e Xhehenemit. Në këtë pikëpamje, po atë kuptim që ka zekati për pasurinë, ka edhe agjërimi për trupin.

Në pjesën e dytë të hadithit thuhet: *“Agjërimi është gjysma e durimit.”* Të mbash mbi shpinë barrën e përgjegjësisë së adhurimit, që të ka ngarkuar Allahu, duke mos u tronditur përballë gjërave që vijnë prej Tij, por duke qëndruar i palëkundur, duke mos u larguar nga porta

<sup>104</sup> Buhariu, *saum* 22; Muslim, *sijam* 160.

e Tij, duke shtrënguar dhëmbët me durim... këto përbëjnë gjysmën e fesë. “Kështu, agjërimi është gjysma e durimit.” Sepse gjysma tjetër e durimit është shpërndarë në të tjera gjëra. Duke qenë se tek agjërimi ka një frenim karshi epsheve të egos, tek ai gjendet njëfarësoj durim ndaj mëkateve, nga ana tjetër (sidomos në ditët e nxehta) në të ka një durim si ai i vijimësisë së adhurimeve duke marrë përsipër diçka si qëndrimi pa ngrënë e pa pirë asgjë. Kësisoj agjërimi kthehet kështu në një të katërtën e fesë. Ai është, me pak fjalë, një nga katër kriteret më të mëdha dhe më të rëndësishme të Islamit. Veç kësaj, tek agjërimi, siç e theksuam edhe më sipër, qëndron i brendashkruar një qëndrim i palëkundur ndaj adhurimit dhe devotshmërisë ndaj Allahut, por edhe ndaj kapriçove egoiste dhe ndjenjave e ngasjeve epshore të njeriut.

### ***Agjërimi nuk ka të barabartë***

Çdo gjë që kryhet për hir të Allahut e ka medoemos një shpërblim, një kundërvlerë të caktuar. Kur vjen puna tek agjërimi, si agjërimi nuk ka tjetër kur vjen puna te shpërblimi i tij. Ebu Umameja (radijallahu anh) transmeton se:

*“I kërkova të Dërguarit të Allahut një këshillë. ‘Agjëro. Sepse agjërimi nuk ka të barabartë.’ – më tha. I kërkova sërish një këshillë. Ai, sërish, më tha: ‘Agjëro, sepse nuk ka të barabartë me agjërimin.’”<sup>105</sup>*

Ebu Umameja i nderuar (radijallahu anh) e përqafoi aq fort këtë këshillë që kishte marrë nga Profeti ynë i Nderuar (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem), sa që, që prej asaj dite, ai, e shoqja dhe shërbyesja e tij ishin gjithmonë duke agjëruar. Madje, nëse shikonte ndokush që nga shtëpia e tij të dilte tym, thuhej menjëherë: *“Duhet të kenë miq në shtëpi.”*<sup>106</sup>

Megjithatë, këtë pjesë le ta mbyllim duke përmendur edhe disa

<sup>105</sup> Nesai, *sijam* 43; Ahmed bin Hanbel, *el-Musned* 5/248, 249, 257; Abdurrezak, *el-Musanef* 4/309.

<sup>106</sup> Ahmed bin Hanbel, *el-Musned* 36/455.

hadithe të tjera të të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) në lidhje me virtytin e agjërimit:

*“Në Xhenet gjendet një portë që quhet porta e Rej’janit, nga e cila do të mund të hyjnë vetëm ata që kanë agjëruar; askush, përveç tyre, nuk do të mund të hyjë prej saj.”<sup>107</sup>*

*“Çdokënd që mban një ditë agjërim për Allahun, Allahu e largon atë shtatëdhjetë vite larg prej Xhehenemit.”<sup>108</sup>*

*“Agjërimi dhe Kurani, në ditën e kiametit, do të ndërmjetësojnë për faljen e mëkateve të robit të Allahut. Agjërimi do të thotë kështu: ‘O Zot, unë e mbajta atë gjatë ditës larg të ngrënit e të pirit dhe të gjithë kënaqësive të tjera. Prandaj, pranoje ndërmjetësimin tim për të.’ – Kurse Kurani do të thotë kështu: ‘O Zot, unë e mbajta atë netëve larg gjumit. Prandaj, pranoje ndërmjetësimin tim për të.’ – Dhe ndërmjetësimi i këtyre të dyjave është një ndërmjetësim që pranohet.”<sup>109</sup>*

## F. Llojet e agjërimit

### 1. Agjërimet e detyrueshëm

#### a. Agjërimi i Ramazanit

Agjërimi është një nga adhurimet e rëndësishme në Islam, që u është urdhëruar të gjithë atyre që janë të ngarkuar me një përgjegjësi të tillë. Agjërimi i Ramazanit është bërë i detyrueshëm në vitin e dytë të mërgimit. Për të gjithë besimtarët që nuk kanë ndonjë sëmundje, nuk janë në udhëtim apo nuk kanë ndonjë gjendje tjetër të justifikueshme, agjërimi i plotë i muajit të Ramazanit është *detyrim për të gjithë* (farz-i ajn), pra është një adhurim që duhet ta kryejnë të gjithë, secili prej besimtarëve.

<sup>107</sup> Buhariu, *saum* 4; Muslim, *sijam* 166.

<sup>108</sup> Buhariu, *xhihad* 36; Muslim, *sijam* 167, 168.

<sup>109</sup> Ahmed bin Hanbel, *el-Musned* 2/174; Ibnu'l-Mubarek, *ez-Zuhd* 2/114; el-Bejhaki, *Shuabu'l-iman* 2/346.

### ***b. Zëvendësimi i agjërimit të Ramazanit***

Një person, i cili e ka detyrim agjërimit, të gjitha ditët e agjërimit që nuk i ka mbajtur dot përgjatë muajit të Ramazanit, për një arsye të caktuar ose pa arsye të justifikueshme, apo që i ka nisur, por e ka prishur agjërimit, i zëvendëson ato pas muajit të Ramazanit, duke agjëruar një ditë tjetër në vend të ditës së pambajtur të agjërimit përgjatë Ramazanit. Këtë e shpreh fare mirë edhe ajeti kuranor:

*“Të sëmurët dhe udhëtarët, agjërojnë në ditë të tjera po aq ditë të agjërimit, të cilat nuk i kanë mbajtur dot.”<sup>110</sup>*

### ***c. Agjërimi i faljes së agjërimit të prishur***

Në Islam thelbësore është përfundimi medoemos i një adhurimi të nisur. Sepse, në të vërtetë, adhurim do të thotë që të jesh në praninë e Allahut duke shfaqur një sjellje karshi Tij. Të adhuosh do të thotë t'i shprehësh Allahut respektin dhe përlartësimin që ndien për Të duke shprehur me të gjithë veten se je robi i Tij. Për këtë arsye nuk duhet bërë asgjë që bie ndesh me edukatën e të qenit në praninë e Tij. Dhe, për rrjedhojë, kjo ka edhe një ndëshkim të caktuar nga vetë Allahu. Dhe ja për shembull, nëse dikush që agjëron gjatë Ramazanit e prish agjërimit vetë me dashje dhe duke e ditur dhe pa pasur asnjë farë justifikimi, si ndëshkim ai duhet të agjërojë për dy muaj me radhë pa ndërprerje. Njësoj siç agjërimi gjatë muajit të Ramazanit është i detyrueshëm, edhe zëvendësimi apo agjërimi për faljen e agjërimit të prishur, janë po ashtu *farz*, pra detyrim, për besimtarët. Në lidhje me këtë ne na është transmetuar nga Ebu Hurejreja (radijallahu anh) ky hadith:

“Tek i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi Të) erdhi një burrë dhe tha: “O i Dërguari i Allahut! Unë mora fund.” Profeti ynë e pyeti: “Çfarë të ka bërë ty të marrësh fund?” dhe ai iu përgjigj: “Unë kam kryer marrëdhënie me gruan gjatë Ramazanit.” Atëherë, Profeti ynë

<sup>110</sup> Bakara, 2/184.



i Nderuar (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) tha këto fjalë: “A mund të gjesh plaçkë sa për të liruar një skllav?” – “Jo,” – u përgjigj burri. – “A mund të agjërosh për dy muaj me radhë pa ndërprerje?” – e pyeti sërish Profeti ynë. – “Jo,” – u përgjigj ai njeri. Atëherë, Profeti ynë e pyeti edhe njëherë: “A mund të gjesh plaçkë sa për të ngopur gjashtëdhjetë të varfër?” – “Jo,” – ishte po prapë përgjigjja. Pastaj ai burrë u ul në një qoshe. Në atë kohë, Profetit tonë i sollën ca hurma në një torbë. Profeti ynë i mori hurmat dhe ia zgjati atij burri duke i thënë: “Merri këto dhe shpërndaji si lëmshë.” – Aty, ai tha: “Po ku ka më të varfër se ne! Në të gjithë Medinën nuk gjen familje më në nevojë se e jona.” – Kur dëgjoji këto fjalë, Profeti ynë i Nderuar buzëqeshi sa iu dukën edhe dhëmbët dhe tha kështu: “Shko e çoja këto hurma familjes, t'i hanë.”<sup>111</sup>

## 2. Agjërimet e domosdoshme

### a. Agjërimi i kushtimit

*Kushtimi*, për të cilin në gjuhën turke përdoret fjala “*adak*”, ka kuptimin e marrjes përsipër si një përgjegjësi e detyrim të një pune që nuk është e ndaluar, për të treguar respekt karshi Allahut të Madhërishëm dhe për të arritur kënaqësinë e Tij. “*Ja kushtoj Allahut, që nesër do të agjëroj për Allahun, apo që do të fal kaç namaz.*” Këto janë *kushtimet*. Për sa kohë që nuk bëhet fjalë për diçka që është e ndaluar, njeriu është i detyruar që ta përmbushë atë që ia ka kushtuar Allahut. Allahu i Lartësuar thotë: “*Dhe le ta mbajnë fjalën kur bëjnë një kushtim.*”<sup>112</sup> Në lidhje me këtë çështje i Dërguari i Allahut ka thënë:

“*Kushdo që bën një kushtim (premtim) ndaj Allahut për diçka që është në bindje ndaj Allahut, le ta përmbushë atë; kushdo që bën një kushtim ndaj Allahut për diçka që do të thotë të ngresh krye ndaj Allahut, le të mos e përmbushë atë.*”<sup>113</sup>

<sup>111</sup> Buhari, *saum* 30-31, *hibe* 20, *nafakat* 13, *edeb* 78, 95, *keffarat* 2-4, *hudud* 26; Muslim, *sijam* 81-82.

<sup>112</sup> Haxh, 22/29.

<sup>113</sup> Buhari, *ejman* 28, 31; Tirmidhi, *nuzur* 2; Ebu Daud, *ejman* 22.

## b. Zëvendësimi i agjërimit *nafile*

Nëse priset një agjërim që po mbahet si *nafile*, atëherë mbajtja e tij sërish në një ditë tjetër është kësaj here një domosdoshmëri. Nëse një namaz apo agjërim nisët si *nafile*, por për një arsye apo një tjetër lihet në mes pa u plotësuar, atëherë ai duhet zëvendësuar. Nëna jonë, aishja e nderuar (radijallahu anha) na ka transmetuar një ndodhi në lidhje me këtë:

*“Një ditë unë dhe Hafsaja ishim duke agjëruar dhe na sollën një ushqim. Na shkoi mendja për të ngrënë dhe hëngrëm prej tij. Pas pak, erdhi i Dërguari i Allahut. Hafsaja u tregua më e shpejtë se unë dhe i tha të Dërguarit të Allahut kështu: ‘O i Dërguari i Allahut! Ne ishim me agjërim. Na sollën diçka për të ngrënë. Na shkoi mendja dhe e hëngrëm.’ – Atëherë, Profeti ynë (pqqmT) tha: “Në vend të kësaj do të mbani agjërim një ditë tjetër si zëvendësim.”<sup>114</sup>*

## 3. Agjërimit *nafile*

Besimtari afrohet me Allahun duke bërë ato që ka urdhëruar Allahu dhe duke iu larguar atyre çfarë ka ndaluar Ai. Kësisoj ai krijon një lidhje shpirtërore me Të. Dhe punët që e afrojnë besimtarin me Allahun nuk janë të kufizuara vetëm me ato që janë të detyrueshme dhe ato që janë të domosdoshme. Shumë të vyera janë edhe adhurimet *nafile* për sa i përket përparimit në rrugën e “*afrisë*” me Zotin. Në një nga hadithet kuds, Allahu i Lartësuar e ka shprehur me këto fjalë rëndësinë që kanë *nafile*-t:

*“Mua robi nuk mund të më afrohet me asgjë që të jetë më e dashur për Mua sesa ato që unë i kam shpallur detyrim. Robi vazhdon të më afrohet duke kryer *nafile*. Derisa Unë e dua atë. Dhe kur Unë e dua robin Tim, atëherë unë bëhem veshi që dëgjon për të, syri që sheh, dora që mban dhe e mbaj atë të ecë përherë vetëm në të drejtë.”<sup>115</sup>*

<sup>114</sup> Tirmidhi, *saum* 36.

<sup>115</sup> Buhari, *rikak* 38; Ahmed bin Hanbel, *el-Musned* 6/256.

Tashmë le të ndalemi paksa mbi llojet e agjërimeve *nafile*:

### **a. Agjërimi i Daudit (a.s.)**

Daudi (alejhis'selam) prekej aq shumë nga madhështia e Allahut dhe qante aq shumë sa që fillonin t'i shfaqeshin shenja në fytyrë. Kur ligjëronte ai, qante edhe ai vetë, edhe të gjithë sa ishin të pranishëm; në kuvendin e tij kishte sa e sa njerëz që u plaste zemra vetëm nga dashuria për Allahun. Me fjalët e Kuranit, ai ishte *'euuab'* (që e kishte fytyrën përherë të kthyer nga Allahu, që është Më i Drejti, i drejtuar tërësisht kah Ai).<sup>116</sup> Ishte bërë shenjë dalluese e Tij, që përgjatë gjithë jetës, kishte qëndruar i drejtuar vetëm kah Zoti pa i larguar për asnjë çast sytë nga Ai dhe pa u ndalur në asnjë çast pa e shprehur robërinë ndaj Tij. Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) ka thënë se agjërimi më i virtytshëm, pas agjërimit të detyrueshëm, është agjërimi i identifikuar me Daudin (alejhis'selam), i cili agjëronte një ditë po e një ditë jo.

E transmeton Abdullah bin Amri: “E kishin njoftuar të Dërguarin e Allahut (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) që unë kisha thënë: “Për sa të kem jetë, netët do t'i kaloj duke falur namaz, ndërsa ditët duke mbajtur agjërime.” – E kishte marrë vesh dhe më pyeti: “Ti e ke thënë këtë?” – “Po, e kam thënë, o i Dërguari i Allahut!” – u përgjigja unë. Aty i Dërguari i Allahut më tha: “Po ti nuk e bën dot këtë. Ti më mirë nganjëherë agjëro, nganjëherë mos agjëro, herë fli, herë ngrihu dhe fal namaz. Si dhe agjëro tri ditë nga çdo muaj. Sepse për çdo punë të mirë shkruhen dhjetë shpërblime si të tilla. Dhe këto tri ditë janë sikur të kesh agjëruar përgjatë gjithë vitit.” – “Po unë kam mundësi të bëj më tepër,” – thashë unë. I Dërguari i Allahut më dëgjoi dhe tha: “Atëherë, një ditë agjëro, një ditë mos agjëro.” – “Po unë mund të bëj edhe më shumë,” – thashë unë. – “Tashmë, më të virtytshme se kjo nuk ka,” – ishin fjalët e fundit të të Dërguarit të Allahut.”<sup>117</sup>

Ndërsa, në një hadith tjetër të Tij i Dërguari i Allahut (sal'lallahu

<sup>116</sup> Sad, 38/17.

<sup>117</sup> Buhariu, *saum*, 59; Muslim, *sijam* 187.

alejhi ues'sel'lem) ka thënë: “Agjërimi më i virtytshëm është agjërimi që mbante Daudi (alejhis'selam). Ai, një ditë mbante agjërim, një ditë nuk mbante.” – duke e vënë kështu theksin te virtyti i agjërimit.<sup>118</sup>

### **b. Agjërimi të hënë-të enjte**

Një ndër agjërimet e tjera *nafile* është edhe agjërimi që mbahet gjatë ditëve të hëna dhe të enjte. Aishja e nderuar (radijallahu anha) ka thënë kështu në lidhje me këtë agjërim:

“I Dërguari i Allahut tregonte një kujdes shumë të veçantë, që të agjëronte ditëve të hënë e të enjte.”<sup>119</sup>

Usameja i nderuar (radijallahu anh) ka transmetuar: “Unë, kur pashë që Profeti ynë i Nderuar agjëronte gjatë ditëve të hëna dhe të enjte, e pyeta se cila ishte arsyeja. Ai më dha mua këtë përgjigje:

“Punët e bëra i paraqiten Allahut në ditën e hënë dhe të enjte. Dhe unë desha që të jem me agjërim kur t'i paraqiten Allahut punët e mia.”<sup>120</sup>

Ndërsa, në një transmetim tjetër thuhet se kur është pyetur se cila është urtësia e agjërimin në ditën e hënë, i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) është përgjigjur me këto fjalë:

“Unë atë ditë kam ardhur në këtë botë dhe po në atë ditë m'u dha profetësia (ose filloi të më zbriste shpallja).”<sup>121</sup>

### **c. Agjërimi tri ditë në çdo muaj**

Një ndër këshillat për mbajtjen e agjërimin *nafile* të Profetit tonë (paqja qoftë mbi Të) është edhe që një njeri t'i kalojë me agjërim tri ditë të çdo muaji. Dhe ditët me më shumë virtyt për t'u agjëruar janë ato që bien të jenë dita 13, 14 dhe 15 të çdo muaj sipas kalendarit të

<sup>118</sup> Buhariu, *tehexhud* 7; *saum* 59; Muslim, *sijam* 182.

<sup>119</sup> Ebu Daud, *saum* 53; Tirmidhi, *saum* 44; Nesai, *sijam* 70.

<sup>120</sup> Tirmidhi, *saum* 44.

<sup>121</sup> Ebu Daud, *saum* 53; Nesai, *sijam* 70.

Hixhrit. Arabët, këto ditë i kanë emërtuar si “*ejjam-i bijd*” (ditët e ndritura). Arsyeja se pse u kanë vënë këtë emër është se në to ditët janë të ndriçuara fort nga dielli dhe netët të ndriçuara fort nga hëna. Siç përmendet edhe në hadithin e Abdullah bin Amrit, Profeti ynë ka thënë kështu në lidhje me agjërimin që mbahet gjatë këtyre tri ditëve:

*“Dhe agjëro në tri ditë të çdo muaji. Sepse për çdo punë të mbarë shkruhen dhjetëfish shpërblime. Këto tri ditë agjërim janë si agjërimi i një viti të plotë.”*<sup>122</sup>

Po nga Ebu Hurejreja (radijallahu anh) dhe po në lidhje me këtë lloj agjërimi, na është transmetuar se:

*“Shpirti i shpirtit tim, Muhamedi i nderuar (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) më këshilloi për tri gjëra. Që të agjëroja tri ditë çdo muaj, të falja namazin e kohës së mëngjesit dhe para se të bija për të fjetur, të falja namazin e uitrit.”*<sup>123</sup>

E në një hadith tjetër që na është transmetuar nga ana e Ebu Dherit (radijallahu anh) i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi Të) ka thënë: “O Eba Dher! Nëse do të agjërosh tri ditë të çdo muaji, mbaje agjërimin në ditën e 13, 14 dhe 15 të muajit.”<sup>124</sup>

#### ***d. Agjërimi i Dhulhixhes dhe i ditës së Arefesë***

Një tjetër agjërim *nafile* që e ka mbajtur Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) dhe na e ka këshilluar edhe neve, që ta mbajmë, është agjërimi dhjetëditor që mbahet në muajin e Dhulhixhes. Nëna jonë, Hafsaja (radijallahu anha) ka thënë:

*“Profeti i nderuar (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem), katër gjëra nuk i ka braktisur kurrë. Këto janë: agjërimi në ditën e Ashures, agjërimi në nëntë ditë e para të muajit të Dhulhixhes dhe tri ditë agjërim në çdo muaj, si*

<sup>122</sup> Buhariu, *saum* 55; Muslim, *sijam* 183.

<sup>123</sup> Buhariu, *tehexhud* 33, *saum* 60; Muslim, *musafirin* 85.

<sup>124</sup> Tirmidhi, *saum* 54; Ibni Hudhejme, *es-Sahih* 3/302; el-Bejhaki, *es-Sunenu'l-kubra* 4/294.

*dhe suneti i namazit të sabahut.*<sup>125</sup>

Dita e nëntë e Dhulhixhes është dita e pritjes së Kurban Bajramit. Veçanërisht agjërimi i mbajtur në këtë ditë është shumë i çmuar pranë Allahut. Vetë i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi Të) ka thënë kështu lidhur me të:

*“Nuk ka ditë që i shpëton njerëzit nga zjarri i Xhehenemit tek Allahu më shumë sesa dita e pritjes së Kurban Bajramit (arefesë).”*<sup>126</sup>

Dhe në një hadith tjetër Ai ka njoftuar se agjërimi i mbajtur në ditën e *arefesë* do të jetë falje për të gjitha mëkatet e shkuara dhe të ardhme të nga një viti.<sup>127</sup>

Mirëpo, i Dërguari Fisnik ua ka ndaluar atyre që janë duke kryer detyrimin e haxhit që të agjërojnë në ditën e *arefesë*.<sup>128</sup> Sepse ai që agjëron në këtë ditë, do të ketë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të adhurimit të haxhit e nuk i përmbush dot ato me tërë përmbajtjen, duke e shtyrë kësisoj në një plan të dytë atë që duhet ta kryejë me përparësi. Por nuk ka asnjë pengesë për ata që nuk ndiejnë asnjë dobësi apo humbje në forcë a fuqi gjatë agjërimit, edhe nëse do të agjërojnë gjatë kohës që janë në Arafat.

### ***e. Agjërimi i Sheualit***

Të agjërosh gjashtë ditë në muajit e Sheualit, i cili vjen menjëherë pas Ramazanit sipas kalendarit Hixhri, është sunet. Profeti ynë i Nderuar (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) e ka shprehur virtytin e këtij agjërimi me këto fjalë:

*“Kushdo që mban agjërimin e Ramazanit dhe pastaj i shton atij edhe gjashtë ditë agjërim nga muaji Sheual, është sikur ta ketë kaluar i agjëruar të gjithë vitin.”*<sup>129</sup>

<sup>125</sup> Nesai, *sijam* 83; Ahmed bin Hanbel, *el-Musned* 6/287.

<sup>126</sup> Muslim, *haxh* 79; Nesai, *menasik* 194; Ibni Maxhe, *menasik* 56.

<sup>127</sup> Shih: Muslim, *sijam* 196, 197.

<sup>128</sup> Ebu Daud, *saum* 63; Ibni Maxhe, *sijam* 40.

<sup>129</sup> Muslim, *sijam* 13; Tirmidhi, *saum* 53; Ebu Daud, *saum* 33.

### **f. Agjërimi i ditës së Ashures**

Edhe agjërimi gjatë ditës së Ashures është një tjetër nga llojet e agjëremeve *nafile*. Në lidhje me këtë agjërim thuhet se Profeti ynë (paqja qoftë mbi Të) e ka mbajtur gjithmonë derisa u shpall i detyruar agjërimi i muajit të Ramazanit. Pasi u shpall detyrim (*farz*) agjërimi i Ramazanit, e patëm thënë edhe më parë, që pati thënë: “*kush të dojë ta mbajë, kush të dojë të mos e mbajë*”. Sipas disa dijetarëve ky agjërim mbahet vetëm në ditën e Ashures. Kurse sipas pjesës tjetër, thuhet se atij i shtohet edhe një tjetër, duke u bërë dy ditë agjërim, dhe kjo është sunet. Sepse, kur sahabët patën shkuar tek i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ues’sel’lem), për t’i thënë: “O i Dërguari i Allahut! Hebrenjtë dhe të krishterët e respektojnë jashtëzakonisht shumë këtë ditë,” – Profeti ynë u qe përgjigjur duke u thënë: “*Vitin e ardhshëm, nëse e agjërojmë, do ta agjërojmë edhe nëntën.*”<sup>130</sup> Me pak fjalë, u pati thënë që ditës së Ashures do t’i shtojmë edhe një ditë tjetër dhe do të agjërojmë dy ditë. Mirëpo, vitin tjetër, i Dërguari i Allahut pati ndërruar jetë pa e mbajtur dot agjërimin e ditës së Ashures.

### **g. Agjërimi i mbajtur gjatë muajve “Haram”**

Muajt *Zhulkade*, *Dhulhixhe* dhe *Muharrem*, dhe muaji *Rexhep*, pranë Allahut janë pranuar si muajt *haram*. Ndër agjërimet më të virtytshme që mbahen në këta muaj, në krye vjen ai i mbajtur në Muharrem, mandej ai i Rexhepit dhe më tej agjërimet e mbajtura në muajt e tjerë.

Në burimet e hadithit, në lidhje me agjërimin e mbajtur në këta muaj, ka transmetime si ky:

“Dikush nga sahabët erdhi tek i Dërguari i Allahut (pqmT) dhe e pyeti: ‘O i Dërguari i Allahut! Unë jam ai që pata ardhur edhe vjet te Ti.’ – ‘Po pse je dobësuar kështu?’ – e pyeti i Dërguari i Allahut. – ‘O i Dërguari i Allahut! Gjatë ditës nuk kam ngrënë ushqim; kam

<sup>130</sup> Muslim, *sijam* 133, 134; Ebu Daud, *saum* 65; Ahmed bin Hanbel, *el-Musned* 1/224, 1/344.

ngrënë vetëm në mbrëmje (duke dashur të thoshte se kishte agjëruar vazhdimisht). Atëherë, i Dërguari i Allahut i tha: *‘Kush ta urdhëroi që ta mundosh veten?’* – ‘Po unë jam i fortë ende,’ – u përgjigj ai. – ‘Agjëro në muajin e Durimit, pastaj agjëro dy ditë çdo muaj.’ – ‘Po unë jam ende i fortë,’ – tha sërish sahabi. – Kësaj here, i Dërguari i Allahut e këshilloi: *‘Agjëro në muajin e Durimit, pastaj agjëro tri ditë çdo muaj. Si dhe agjëro në muajt haram.’*<sup>131</sup>

### ***h. Agjërimi i mbajtur në muajin Shaban***

Një nga sunetet e të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ues’sel’lem) janë edhe agjërimet që ka mbajtur gjatë muajit Shaban. Ai jepej më shumë pas agjërimit në këtë muaj, madje e bashkonte Shabanin me Ramazanin. Nëna jonë, Selemeja, transmeton kështu:

*“Përveç muajit të Shabanit nuk ka asnjë muaj që i Dërguari i Allahut ta ketë kaluar të gjithin duke agjëruar. Ai e bashkonte muajin e Shabanit me atë të Ramazanit.”*<sup>132</sup>

*“Profeti ynë i Nderuar (sal’lallahu alejhi ues’sel’lem), në asnjë muaj nuk agjëronte më shumë sesa në muajin Shaban. Nganjëherë ai e kalonte të gjithë muajin Shaban duke agjëruar, e nganjëherë i mbetej vetëm shumë pak ditë pa agjëruar.”*<sup>133</sup>

## **4. Agjërimet e ndaluara**

### ***a. Agjërimet e mbajtura rresht***

Ky agjërim, i cili në *fikh* emërtohet si “*saum-i uisal*”, ka kuptimin e agjërimit të dy a më shumë ditëve rresht pa bërë asfare iftar në mes. Profeti ynë i Nderuar (sal’lallahu alejhi ues’sel’lem), që ishte shembull i dhembshurisë dhe mëshirës njerëzore, i pati qortuar ata që agjëronin në

<sup>131</sup> Ebu Daud, *saum* 54; Ibni Maxhe, *sijam* 43.

<sup>132</sup> Ebu Daud, *saum* 11; Nesai, *sijam* 70.

<sup>133</sup> Buhariu, *saum* 52; Muslim, *sijam* 167.



këtë mënyrë duke u këshilluar që të mos mbanin *agjërime të pandërprerë*. Kur, në fakt, Ai vetë, sidomos në ditët e fundit të Ramazanit, nëse mund të shprehemi me këto fjalë, i përvishte mëngët dhe e kalonte të gjithë ditën duke adhuruar. Sidomos gjatë këtyre ditëve, Ai mbante agjërime të këtyrë, domethënë pa bërë iftar për disa ditë me radhë. Sahabët e nderuar i magjepste ky agjërime i Tij dhe donin që të bënin edhe ata si Ai, por kjo ishte shumë e vështirë. Njëherë e kishin vendosur edhe ata që do të bënin po njësoj, mirëpo ditët ishin zgjatur shumë e atyre nuk kishte mbetur më forcë. Pati ardhur begatia, Bajrami dhe ata ishin gëzuar të gjithë. I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi Të) kishte buzëqeshur kur kishte parë gjendjen e tyre dhe pati thënë: “*Sikur të ishte vonuar bajrami, unë prapë do të vazhdoja të agjëroja.*” Dhe, në vijim, duke thënë: “*Sepse mua më jep Allahu për të ngrënë e për të pirë asisoj që ju nuk e kuptoni dot.*” – kishte shprehur se ata e kishin të pamundur që t’ia dilnin dot me forcën e tyre të kryenit të njëjtat adhurime, për të cilat Atij i mjaftonte përherë fuqia.

Nëna jonë, Aishja e nderuar (radijallahu anha), thotë kështu në një fjalë të saj që e shpreh më së miri këtë gjendje: “*Profeti ynë i Nderuar (sal’lallahu alejhi ues’sel’lem) e ka ndaluar agjërimin e njëpasnjëshëm.*”<sup>134</sup>

### ***b. Agjërimi i mbajtur përditë***

Islami është një fe që mund ta jetojë lehtësisht çdokush. Në të nuk ka asnjë urdhëresë apo gjykim që për ta do të jetë i pamundur, apo që ata do të mbeten të shtypur nën peshën e tij. Në të nuk ka vend as për mangësi, as për teprim; në të çdo gjë zë vend me një masë të caktuar. Agjërimi i një personi përditë mund të sjellë një varg pasojash negative. Dobësimi në trup mund të bëjë që ata të mos i përmbushin dot të gjitha detyrimet që kanë dhe kësajsoj, ta kenë të pamundur që të përshtaten siç duhet në shoqëri. Ose mund të mësohen me gjendjen e agjërimit. Dhe, kësimeynre humbasin shumë prej dobive që përfitohen enkas nga agjërimi.

<sup>134</sup> Buhariu, *saum* 20; Muslim, *sijam* 56.

Ja pra, këto janë shkaqet që i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue'ssel'lem) e ka ndaluar që njerëzit të agjërojnë vazhdimisht për çdo ditë rresht.<sup>135</sup>

### ***c. Agjërimi i mbajtur në ditën e dyshimit se ka hyrë Ramazani***

Dita që dyshohet se mund të jetë dita e parë e Ramazanit është dita që i bie të jetë e tridhjeta e muajit të Shabanit. I Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi Të) e ka ndaluar që të kalohet duke agjëruarkjo ditë. Dhe për këtë mund të jenë pasur parasysh një varg urtësish, si për shembull, që myslimanët të hyjnë të gjallëruar në muajin e Ramazanit, t'i kërkojnë mirë se kur janë kohët e fillimit dhe të mbarimit të Ramazanit, si dhe për t'i parandaluar mundësitë e ngatërimit në lidhje me fillimin e agjërimimit.

Amar bin Jathiri (radijallahu anhuma) thotë kështu lidhur me këtë çështje:

“Kush agjëron në këtë ditë (të pritjes së Ramazanit), ka dalë kundër Ebu'l-Kasemit (Profetit tonë sal'lallahu alejhi ue'ssel'lem).<sup>136</sup>

Në një transmetim tjetër thuhet që Profeti ynë (paqja qoftë mbi Të) të ketë thënë kështu:

“Ndonjë nga ju të mos agjërojë një ose dy ditë para Ramazanit. Vetëm nëse ka ndonjë agjërim tjetër, që ka qenë duke e mbajtur dhe është në vazhdim, le ta mbajë.”<sup>137</sup>

Siç mund të kuptohet edhe nga ky hadith i fundit, nëse ndokush ka qenë duke mbajtur ndonjë agjërim tjetër të vazhdueshëm dhe vazhdimi i tij përkon edhe me ditën e pritjes së Ramazanit, atëherë nuk ka asnjë pengesë që ai ta mbajë agjërim edhe këtë ditë.

<sup>135</sup> Shih: Buhariu, *saum* 57; Muslim, *sijam* 186-187.

<sup>136</sup> Buhariu, *saum* 11; Muslim, *mesaxhid* 258-259.

<sup>137</sup> Buhari, *saum* 14; Muslim, *sijam* 139, 141.

#### ***d. Agjërimi i mbajtur në ditët e bajramit dhe ato të teshrikut***

Gjithashtu, agjërimi është i ndaluar edhe në ditët e bajramit. Në ditën e parë të bajramit të Ramazanit dhe katër ditët e Kurban Bajramit, agjërimi është ndaluar. Sepse ditët e bajramit janë ditë për të ngrënë e për të pirë, ditët kur myslimanët jetojnë gëzimin e këtyre ditëve dhe ulen në sofra të përbashkët me njëri-tjetrin. Në këto ditë, myslimani nuk mund të agjërojë, por duhet të përpiqet që të ndajë të njëjtat gjëra edhe me myslimanët e tjerë. Kjo është arsyeja që i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) e ka ndaluar mbajtjen e agjëritimit në këto ditë, duke bërë të ditur se këto ditë janë ditët kur Allahu shtron një sofër gostie të veçantë për njerëzit. Ebu Said el-Hudriu (radijallahu anh) thotë që:

*“I Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi Të) e ndaloi që të agjërohet në ditët e bajramit të Ramazanit dhe atë të Kurban Bajramit.”<sup>138</sup>*

#### ***e. Agjërimi i mbajtur vetëm ditën e premte***

Dita e premte është një ditë feste për myslimanët. Allahu (xhel'le xhelaluhu) i ka falur një vlerë të veçantë ditës së premte, duke e bërë ditë të veçantë të myslimanëve. Një herë në javë, në këtë ditë, myslimanët bëhen të gjithë bashkë, takohen e bisedojnë me njëri-tjetrin; përpiqen të ndajnë me njëri-tjetrin si shqetësimet, ashtu edhe gëzimet e tyre. Ky përbashkim, nganjëherë, realizohet edhe rreth së njëjtës sofër. Prandaj

një mysliman nuk mund t'i ndajë agjëritimit veçanërisht këtë ditë dhe Profeti ynë (paqja qoftë mbi Të) e ka ndaluar:

*“Mes netëve, adhurimit mos i ndani vetëm natën e së premtes, njësoj siç, për të agjëruar, mos i ndani agjëritimit veçanërisht ditën e premte. Përveç atyre që kanë ndonjë agjërim të vazhdueshëm e të bërë zakon.”<sup>139</sup>*

<sup>138</sup> Buhariu, *edahi* 16; Muslim, *sijam* 139, 141.

<sup>139</sup> Muslim, *sijam* 148; Ahmed bin Hanbel, *el-Musned* 6/444.

### ***f. Agjërimi në periudhat e menstruacioneve dhe lehonisë***

Gratë, në periudhat e menstruacioneve dhe të lehonisë, janë falur nga moskryerja e disa adhurimeve, si namazi dhe agjërimi. Duke pasur parasysh mëshirën e thellë që ka Allahu për robërit e Tij, në këto periudha që janë njëfarësoj të mundimshme për to, gjatë këtyre ditëve, Ai nuk i ka ngarkuar ato me adhurime. Një grua që është në këto ditë, as nuk fal namaz, as nuk e zëvendëson atë më vonë duke e bërë *kaza*. Kurse gjatë muajit të Ramazanit, ajo nuk agjëron, por për aq ditë sa nuk ka agjëruar, ajo i zëvendëson ato pas muajit të Ramazanit.

Në një transmetim Muadhi (radijallahu anh) ka thënë:

“Unë e pyeta Aishen e nderuar (radijallahu anha) se cila ishte arsyeja që një grua në ditët e saj duhet të zëvendësonte vetëm agjërimin e pambajtur dhe jo namazin. Ajo më dha këtë përgjigje: ‘Ne, kur ishim me të Dërguarin e Allahut dhe ishim në ato ditë, Ai na thoshte që t’i zëvendësonim vetëm ditët që nuk kishim agjëruar, ndërsa për namazin nuk na thoshte asgjë.’”<sup>140</sup>

## **G. Çështjet që duhet të ketë kujdes një agjëruesi**

Si në çdo çështje, edhe kur bëhet fjalë për agjërimin, ka disa aspekte për të cilat agjëruesi duhet të tregojë shumë kujdes. Këto janë çështje për të cilat lipset treguar kujdes, në mënyrë që me agjërimin të arrihen të gjitha çfarë synohen me mbajtjen e tij.

### ***1. Çështjet që duhet treguar kujdes në syfyri***

Syfyri e ka prejardhjen nga e njëjta rrënjë me “*agimin*”, që përkon pikërisht me çastin kur fundi i horizontit zë të tregojë lindjen e një dite të re. Kjo kohë është edhe një ndër prerjet më të begata të kohës. Duke

<sup>140</sup> Muslim, *sijam* 69; Ebu Daud, *taharet* 102.

u ngritur në syfy, besimtari përfiton nga begatia e saj, ndërsa nga ana tjetër mund të hajë diçka dhe të fitojë forcë dhe fuqi të mjaftueshme të trupit, që të mund t'i kryejë denjësisht, si agjërimin, ashtu edhe adhurimet e tjera të ditës. Kjo kohë e agimit, është pikërisht ajo prerje e kohës kur adhurimet e kryera i çohen Allahut të Madhërishëm (xhel'le xhelaluhu).

Ushqimi i syfyrit është një ndër këshillat e të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem), i Cili ka theksuar se në kohën e tij ka begati dhe se engjëjt luten për ata që janë ngritur në syfy. Profeti ynë i Nderuar ka thënë:

*“Në syfy ka begati. Bëni syfy, sikur edhe një gllënjë ujë të pini. Sepse Allahu (xhel'le xhelaluhu) i trajton me mëshirë ata që ngrihen në syfy; kurse engjëjt luten për ta dhe faljen e tyre.”<sup>141</sup>*

Një nga çështjet e lidhura me syfyrin, për të cilën kërkohet të tregohet kujdes është edhe që koha e ngrënies të shtyhet sa më shumë drejt kohës së përfundimit të kësaj prerjeje kohe. Profeti ynë (paqja qoftë mbi Të), i Cili ishte i pari në mëshirë dhe dhembshuri ndaj bashkësisë së Tij, ka thënë edhe se kjo është më e virtytshme. Kësisoj, koha e agjërimit është disi më e shkurtër dhe veçanërisht për të sëmuret dhe të moshuarit, ajo merr një trajtë paksa më të durueshme e të përbalueshme për ta. Veç kësaj, kryerja e syfyrit shumë herët çon që njeriu të bjerë në përhumbje e të përgjimet, aq sa mund të ndodhë edhe që të humbë namazin e sabahut. Ndërsa syfyri i bërë në një kohë shumë afër kohës së faljes së namazit të sabahut është shumë i rëndësishëm edhe për të bërë që ky namaz të falet në kohën e duhur. Në lidhje me këtë temë Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) ka thënë:

*“Për sa kohë që nxitojnë në iftar dhe e shtyjnë syfyrin, umeti im është në mbarësi.”<sup>142</sup>*

Në librat e hadithit ne hasim edhe një transmetim që ka të bëjë pikërisht me kohën mes syfyrit dhe namazit të sabahut:

<sup>141</sup> Buhariu, *saum* 20; Ahmed bin Hanbel, *el-Musned* 3/12, 44, 17/150.

<sup>142</sup> Ahmed bin Hanbel, *el-Musned* 5/147; et-Taberani, *el-Mu'xhemu'l-Kebir* 25/163.

“Në një kuvend, kur Zejd bin Thabiti (radijallahu anh) tha: ‘*Hëngrëm njëherë syfyri me të Dërguarin e Allahut, pastaj falëm namazin e sabahut.*’ – një nga të pranishmit e pyeti: ‘*Sa kohë kaloi mes ngrënies së syfyrit dhe faljes së namazit të sabahut?*’ – Zejdi u përgjigj me këto fjalë: ‘*Sa për të lexuar pesëdhjetë ajete.*’”<sup>143</sup>

## 2. Çfarë duhet pasur kujdes në iftar

Profeti ynë i Nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ka renditur edhe se çfarë duhet të ketë kujdes një besimtar teksa bën iftar. Sipas kësaj, kur çel iftarin, një besimtar duhet të bëjë kujdes me:

Është sunet, që kur hyn koha e akshamit, besimtari menjëherë të bëjë iftar. Duke qenë se koha në iftar është shumë e kufizuar dhe namazi duhet të falet me të hyrë koha, i Dërguari Fisnik (paqja qoftë mbi Të) bënte njëherë iftar, mandej falte namazin e akshamit. Te këshilla e Tij për të bërë iftar sa më parë, menjëherë sapo të hyjë koha e akshamit, janë më se të qarta shenjat e dhembshurisë dhe mëshirës që ndiente Ai për njerëzit. Është e vështirë që të mund t'i shpjegosh e arsyetosh dot me shpirtin e dhembshurisë që ka feja islame, të vijosh t'i privosh edhe për më shumë kohë të gjithë ata njerëz që kanë qëndruar të etur e të uritur e të kufizuar përgjatë gjithë ditës. Prandaj Profeti ynë e ka nxitur umetin e Tij që të nxitojë për të bërë iftar sapo të hyjë koha, duke e vënë ata më përpara edhe se namazi, që për Të ishte si drita e syve. Ja se si thotë Ai:

“*Për sa kohë që i ftojnë njerëzit që të nxitojnë (për të bërë njëherë iftar), ata do të jenë në mbarësi.*”<sup>144</sup>

Edhe në një transmetim tjetër nëna jonë, Aishja (radijallahu anha), na tregon neve edhe më shumë në lidhje me qëndrimin e të Dërguarit të Allahut (pqqmT) në lidhje me këtë çështje. Ebu Atijeja tregon:

“Unë dhe Mesruku kishim shkuar tek Aishja e nderuar (radijallahu

<sup>143</sup> Buhariu, *meuakit* 27, *saum* 19; Muslim, *sijam* 47.

<sup>144</sup> Buhariu, *saum* 45; Muslim, *sijam* 48.

anha). Mesruku tha: ‘Janë dy burra nga sahabët e Muhamedit (sal’ lallahu alejhi ues’sel’lem), të cilët garojnë për të qenë përherë në mbarësi. Njëri nxiton për të bërë iftar dhe për të falur namazin e akshamit, ndërsa tjetri që i shtyn të dyja, si akshamin, ashtu edhe iftarin.’ – Kur i dëgjoi këto fjalë, Aishja e nderuar pyeti: ‘Kush është ai që nxiton për iftarin dhe kohën e namazit të akshamit?’ – ‘Abdullah ibni Mesudi,’ – u përgjigj Mesruku. Atëherë, Aishja e nderuar na tha: ‘Ja, kështu bënte edhe i Dërguari i Allahut.’”<sup>145</sup>

Gjithashtu, sunet është edhe që besimtari ta çelë iftarin me hurma ose ujë. Enesi i nderuar (radijallahu anh) thotë kështu lidhur me këtë çështje:

“I Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi Të), para se të falte namazin, e çelte iftarin me disa hurma të njoma dhe nëse nuk do të kishte hurma të njoma, me hurma të thata. Nëse qëllonte që nuk kishte as hurma të thata, atëherë pinte disa gllënjka ujë.”<sup>146</sup>

Sipas një transmetimi prej Sulejman ibni Amirit, i Dërguari i Allahut ka dhënë këtë këshillë:

“Kur të agjërojë ndonjëri prej jush, le të bëjë iftar me hurma. Sepse hurma është begati. Nëse nuk gjen dot hurma, atëherë të çelë iftar me ujë. Sepse uji është shumë pastrues.”<sup>147</sup>

Një njeriu që qëndron pa ngrënë gjatë një dite të tërë agjërimi, i bie sheqeri në gjak. Dhe që të mund ta kryejë adhurimin e tij me një mendje më të kulluar, atij i duhet që ta ekuilibrojë disi sheqerin në gjak veçanërisht me një ushqim të ëmbël. Një tjetër aspekt është edhe se uria e madhe, e përforcuar gjatë gjithë ditës, do të bënte që ai të kryente një adhurim në një gjendje të rraskapitur dhe është e pamundur që të arrijë përkushtimin e nevojshëm. Ndoshta kjo është edhe arsyeja e këshillimit që iftari të bëhet para faljes së namazit të akshamit.

Diçka tjetër që duhet bërë në kohën e iftarit është edhe lutja e shumtë.

<sup>145</sup> Muslim, *sijam* 49; Tirmidhiu, *saum* 13; Ebu Daud, *saum* 20; Nesai, *sijam* 23.

<sup>146</sup> Tirmidhiu, *saum* 10; Ebu Daud, *saum* 21.

<sup>147</sup> Tirmidhiu, *zekat* 26, *saum* 10; Ebu Daud, *saum* 21; Ibni Maxhe, *sijam* 25.

Sepse Allahu i Madhërishëm thotë: *“Lutmuni, që t’ju përgjigjem.”*<sup>148</sup> Dhe lutja e bërë në kohën e iftarit ka një vlerë krejtësisht të veçantë në lartësitë e Allahut (xhel’le xhelaluhu). Një besimtar që ka qëndruar përgjatë gjithë ditës i etur dhe i uritur për hir të Allahut, që është përpjekur ta ruajë veten me çdo kusht prej çdo mëkati të mundshëm po për hir të Allahut, si shpërblim, Allahu i pranon atij lutjet që do të bëjë në kohën e iftarit.

Një besimtar që mban agjërime nuk duhet ta humbasë këtë përgëzim të veçantë që i ka mundësuar Allahu, por, çdo nevojë t’ia shprehë Atij duke iu përgjëruar në kohën e iftarit. Ja se si ishte një nga lutjet që bënte Profeti ynë në kohën e iftarit:

*“O Zot! Unë agjërova për kënaqësinë Tënde. Te Ti u dorëzova. Me riskun që më ke falur Ti e çela iftarin. Pranoje Ti agjërimin tim. Nuk ka dyshim, Ti je Gjithëdëgjues, i Gjithëditur. Etja iku, damarët u njomën. Inshaallah u fiksua edhe shpërblimi.”*<sup>149</sup>

Kur ishte si i ftuar diku, Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ues’sel’lem) lutej me këto fjalë:

*“Ushqimin t’jua hanë njerëz të mirë. Në sofrat tuaja të çelin iftar agjëruesit. Dhe engjët të luten për faljen tuaj.”*<sup>150</sup>

Gjithashtu, një çështje tjetër, për të cilën lipset kujdes për sa i përket iftarit është edhe që sofrat të mbahet përherë në pritje të mysafirëve dhe duhet bërë përpjekje që në të të ketë vend edhe për të tjerë, e veçanërisht për të varfërit. Kësodore njeriu jo vetëm u përkëdhel të varfërve zemrat, por edhe do të fitojë shpërblime për aq njerëz sa u ka mundësuar iftarin. Për sa i përket kësaj, Profeti ynë (paqja qoftë mbi Të) ka thënë:

*“Kush i jep iftar një agjëruesi, fiton shpërblime po aq sa fiton edhe ai që ka mbajtur agjërimin. Dhe nuk pakësohet asgjë nga agjërimi i*

<sup>148</sup> Mu’min, 40/60.

<sup>149</sup> Ebu Daud, *saum* 22; Ibni Ebi Shejbe, *el-Musannef* 2/344.

<sup>150</sup> Ahmed bin Hanbel, *el-Musned* 3/138; el-Bejhaki, *es-Sunenu’l-Kubra* 4/240, 7/287.



*agjëruesit.*”<sup>151</sup>

### 3. Qëndrimi larg të këqijave

Agjërimi duhet të mbahet pikërisht ashtu siç e ka shpallur Allahu i Lartësuar dhe pikërisht ashtu si ajo çfarë quan “agjërimit” Allahu. Në mënyrë që të marrë rezultatin e synuar nga agjërimi i tij, ashtu siç e kufizon veten nga të ngrënët dhe të pirët, besimtari duhet të kufizojë edhe gjuhën nga thënia e gjërave pa lidhje, pa kuptim e për më tepër të pahijshme. Madje duhet ta hapë gojën vetëm për të folur bukur e për gjëra të mbara, duke mos folur për asgjë të panevojshme, e ta zbulurojë gjuhën me bashkëbisedime të përshpirtshme. Po ashtu ai duhet të vërë nën kontroll edhe sytë. Ai duhet t’i mbyllë sytë e të mos e shohë të ndaluarën, t’i shohë mirë gjërat që sheh, t’i interpretojë siç duhet dhe të nxjerrë nga çdo gjë kuptime e domethënie sa më të mira.

Krahas këtyre, një besimtar duhet t’i mbajë veshët larg gjërave të kota e të ulëta, e t’i hapë ata vetëm për të Kuranin, hadithet e bekuara dhe fjalët e bukura të më të mëdhenjve ndër njerëz. Dhe, kësisoj, ashtu siç do të vërë në agjërimit trupin e vet, duke e mbajtur të kufizuar nga uji dhe ushqimi, do të qëndrojë i mbyllur ndaj çdo gjëje të padobishme – që siç e kanë thënë të vjetërit – t’i bëjë që ta shijojnë të gjitha agjërimitin, me gjymtyrë, me organe e me gjithë shqisa e aftësi ndijuese të jashtme e të brendshme. Thënë me këto fjalë, njeriu që agjëron duhet t’i mbyllë të gjitha portat karshi të këqijave e të mos u lejojë atyre asnjë shteg nga të mund të kalojnë dot, dhe për këtë duhet treguar mjaft kujdes me aspektet e mëposhtme:

#### a. Ruajtja e syve

Një nga mirësitë më të mëdha që i ka falur njeriut Allahu është syri. Syri është mjeti më i madh me të cilin njeriu krijon lidhje me botën e jashtme. Edhe në mënyrë që të meditojë e të kuptojë madhësitinë e

<sup>151</sup> Tirmidhiu, *saum* 82; Ibni Maxhe, *sijam* 45.

Allahut, njeriu ka nevojë që t'i shohë njëherë krijimet e Tij. Në saje të syve njeriu arrin që ta dëshmojë gjithësinë dhe mrekullitë që ka krijuar Allahu mbi gjithësinë. Gjithçka që hyn në zemër dhe në shpirt depërton brenda kryesisht nëpërmjet syve. Veçanërisht kur është duke agjëruar, njeriu duhet t'i ruajë sytë nga gjërat e ndaluara dhe veten nga çdo gjë që mund të hedhë helm në zemrën e tij. Sepse i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue'ssel'lem) ka thënë kështu në një *hadith kudsî*:

*“(Allahu thotë:) Mos e shiko të ndaluarën, sepse ajo është një shigjetë e helmatisur e hedhur nga djalli. Kushdo që e braktis atë, sepse ka frikë nga Mua, Unë i fal atij robit Tim një besim që do t'ia ndiejë gjer zemër ëmbëlsinë.”*<sup>152</sup>

Në Kuranin Fisnik Allahu ua ndalon besimtarëve që të shohin nga e ndaluara në një mënyrë fare të qartë e të hapur, duke urdhëruar:

*“(I Dërguari Im!) Thuaju burrave besimtarë, t'i ruajnë sytë nga shikimi i mëkatit dhe ta ruajnë nderin e tyre. Kjo është më e përshtatshme dhe më e pastra për ta. Allahu ka dijeni për çdo gjë që bëjnë ata. Thuaju gjithashtu edhe grabe besimtare, t'i ruajnë sytë e të mos e shohin të ndaluarin dhe ta ruajnë nderin e tyre...”*<sup>153</sup>

## **b. Ruajtja e gjuhës**

Organi ndoshta më i rëndësishëm që duhet ta ruajë çdokush që agjëron është gjuha e tij. Sepse Profeti ynë i Nderuar (sal'lallahu alejhi ue'ssel'lem) ka thënë kështu në lidhje me çështjen e ruajtjes së gjuhës:

*“Kushdo që më jep mua garanci për atë që ka brenda nofullës së tij dhe atë që ka midis dy këmbëve, edhe unë i garantoj se ai do të shkojë në Xhenet.”*<sup>154</sup>

Patjetër që gjuha, për të cilën ka pasur nxitje edhe shumë herë të tjera, duhet të ruhet edhe më mirë kur bëhet fjala për agjërimin.

<sup>152</sup> Et-Taberani, *el-Mu'xhemu'l-kebir* 10/173; el-Hakim, *el-Mustedrek* 4/349.

<sup>153</sup> Nur, 24/30-31.

<sup>154</sup> Buhariu, *rikak* 23; Tirmidhiu, *zuhd* 61.

Sidomos kur është duke agjëruar, njeriu duhet ta ruajë gjuhën nga gënjeshttra, përgojimi, ngacmimi i të tjerëve, të folurit e çështjeve të ndaluara, zënkat dhe shkaktimi i zhurmës. Nëse do të kemi parasysh fjalët e bekuara të Profetit tonë të Nderuar (paqja qoftë mbi Të), ai nuk duhet të flasë asgjë vetëmse për mirë:

*“Kush i ka besuar Allahut dhe ditës së gjykimit, ose të flasë për mirë, ose të heshtë.”*<sup>155</sup>

Ai besimtar që e bën kriter të vetes këtë hadith të bekuar të të Dërguarit tonë Fisnik, përherë duhet të jetë i zënë me Kuran dhe duke përmendur Allahun e Madhërishëm, duke folur vetëm për ato gjëra që të kujtojnë jetën e pëртеjme e që do të bëheshin shkas për meditim. Veçanërisht duhet t’u shmangët zhurmës dhe zënkave, pra të jetë i padorë ndaj kujtdo që e qëllon dhe i pagjuhë ndaj atij që do ta shajë, për të mos iu përgjigjur kurrsesi. Nëse ka ndonjë përplasje që i ofrohet, ai mund të thotë se është me agjërim dhe se e ka të pamundur që të përgjigjet. Profeti ynë (pqmT) ka këshilluar kështu në lidhje me këtë çështje:

*“Agjërimi është një mburojë për besimtarin. Mos veproni me injorancë dhe të flisni gjëra të këqija, kur jeni me agjërim. Nëse vjen ndokush t’i thotë ndonjë gjë të keqe, apo të sillet keq me të, t’i thotë, ‘unë jam me agjërim’ dhe të mos përgjigjet (po njësoj).”*<sup>156</sup>

Njeriu që nuk e kontrollon dot gjuhën e vet, megjithëse është me agjërim dhe i mban agjërim vetëm stomaku, nuk mund ta arrijë dot shpërblimin e mirëfilltë të agjërimit. Ajo çfarë fiton ai mbetet vetëm etja dhe uria. Sepse i Dërguari i Allahut (pqmT) thotë:

*“Allahu nuk ka nevojë, as për etjen, as për urinë e askujt, nëse ai nuk heq dorë nga gënjeshttra dhe fjalët e sjelljet e këqija.”*<sup>157</sup>

Ndërsa, në një vend tjetër thotë kështu:

*“Ka sa e sa që agjërojnë, që ajo çfarë fitojnë nuk është veçse uria dhe*

<sup>155</sup> Buhariu, *edeb* 31, 85, *rikak* 23; Muslim, *iman* 74, *edahi* 19.

<sup>156</sup> Buhariu, *saum* 9; Muslim, *sijam* 163.

<sup>157</sup> Buhariu, *saum* 8, *edeb* 51; Tirmidhiu, *saum* 16; Ebu Daud, *saum* 25.

*etja. Ka sa e sa që e kalojnë natën duke kryer adhurime, që ajo çfarë fitojnë nuk është veçse pagjumësia.”<sup>158</sup>*

### **c. Ruajtja e veshëve**

Si të gjitha organet, edhe veshët janë një organ që Allahu na i ka lënë neve amanet dhe ne duhet t’i dalim zot edhe këtij amaneti. Ruajtja e veshëve bëhet duke i mbajtur ata të mbyllur ndaj të gjitha gjërave të shëmtuara, si gënjeshttra, përgojimi, thashethemet. Sidomos kur është duke agjëruar besimtari duhet të largohet menjëherë nga çdo ambient ku fliten kësi gjërash. Sepse edhe dëgjimi i diçkaje është po aq i shëmtuar sa çështë edhe që ajo të flitet. Kurani Fisnik e shpreh mjaft qartë se sa veprim i shëmtuar është që t’u vësh veshin fjalëve të shëmtuara pikërisht në këtë ajet të bekuar:

*“Ata, vazhdimisht u vënë veshin gënjeshtres dhe hanë nga e ndaluara.”<sup>159</sup>*

### **d. Ruajtja e të gjitha shqisave të jashtme dhe të brendshme**

Më sipër ne përmendëm tri nga organet që i janë lënë njeriut amanet. Sepse njeriu hyn në mëkat kryesisht ngaqë nuk i ruan dot siç duhet këto organe. Dhe kur arrin që t’i ruajë ato, ai bëhet i denjë për të hyrë në Xhenet. Njeriu hapet ndaj botës së jashtme nëpërmjet këtyre organeve. Për rrjedhojë, për të mos rënë pre e gjërave që do ta ndotin shpirtin dhe ndërgjegjen nga jashtë, duhet treguar një kujdes tejet i veçantë për ruajtjen e tyre.

Ndërgjegjia është e përbërë nga katër elemente kryesore, ndërsa shpirti nga katër gjendje të rëndësishme. Këto janë, vullneti, mendja, ndjenjat dhe aftësitë ndijuese hyjnore. Besimtari është i detyruar të tregojë kujdes që t’i ruajë ato të pastra, duke u shmangur nga çdo gjë që mund t’i ndotë ato dhe të dijë se si t’i ruajë shqisat e tij të jashtme

<sup>158</sup> Ibni Maxhe, *sijam* 21; Ahmed bin Hanbel, *el-Musned* 2/373.

<sup>159</sup> Maide, 5/42.

dhe të brendshme. Ai duhet të jetë i kapluar nga vullneti për përpjekje që t'i vërë të agjërojnë, njësoj si stomakun, edhe syrin, veshin, gjuhën, zemrën, imagjimatën dhe mendimet, e së bashku me to të gjithë përbërësit njerëzorë, që e bëjnë atë të veçantë si njeri.

Miqtë e të Drejtit e kanë ndarë agjërimin në tri lloje:

*Agjërimi i masës:* Ky është agjërimi i njerëzve të zakonshëm, që u mban agjërim vetëm stomaku dhe u qëndrojnë larg vetëm atyre gjërave që do ta prishnin së jashtmi agjërimin. Në këtë lloj agjërimi shihen si të mjaftueshme edhe vetëm qëndrimi larg nga të ngrënët, të pirët dhe marrëdhëniet seksuale.

*Agjërimi i elitës:* Ky është agjërimi i robërve të zgjedhur, që përpiqen ta shijojnë çdo grimë të begatisë dhe dritës së agjërimin, të cilët ndërkojnë që u mban agjërim stomaku, ata i ruajnë nga çdo gjë e shëmtuar edhe duart, gjuhën, sytë dhe veshët, madje tërë organet dhe gjymtyrët e tyre. Të këtillët janë të padorë ndaj kujtdo që i godet, të pagojë ndaj kujtdo që i shan. Edhe kur flasin, ata flasin vetëm në qerthullin e kënaqësisë hyjnore. Veshët i kanë të mbyllur ndaj dëgjimit të gjërave të shëmtuara. As sytë, kurrë nuk u shohin kurrë nga e ndaluara.

*Agjërimi i elitës së elitës:* Përtej agjërimin të elitës, ky është agjërimi i atyre njerëzve të devotshëm ndaj Allahut, që i mbajnë larg vetes edhe ato gjëra që mund të mos ngajnë të bukura për zemrën, imagjimatën dhe mendimet e tyre, të cilat për ta janë njëfarësoj si banesa të Allahut. Në këtë lloj agjërimi, thelbësore është që të nxirret nga zemra çdo gjë tjetër, përveç Allahut (xhel'le xhelaluhu). Çdo mendim i kësibotshëm, që nuk është në boshtin e kënaqësisë së Zotit, shpirtërisht e prish këtë lloj agjërimi.<sup>160</sup>

#### **4. Mbajtja e përsinqertë e agjërimin**

Ka edhe një aspekt tjetër të agjërimin, për të cilin duhet treguar një kujdes i jashtëzakonshëm, që është se robi duhet të bëjë çdo përpjekje

<sup>160</sup> El-Gazzali, *Ihjaw ulumi'd-din* 1/234.

që agjërimi i tij të jetë i sinqertë dhe vetëm e vetëm për hir të kënaqësisë së Allahut. Robi duhet të jetë i fiksuar në sinqeritet, kur agjëron; duhet ta konsiderojë agjërimin si një dhuratë e rrallë që ia ka falur Allahu vetë, ndaj nuk duhet të përfshijë në të asgjë tjetër, përpos kënaqësisë së Tij. Për më tepër, ai duhet të jetë gjithmonë i mbërthyer nga mendime të llojit: “Nuk e mbajta dot agjërimin siç duhej, nuk e kreqa dot detyrën time ashtu siç duhej dhe nuk e vlerësova dot Ramazanin sa ç’duhej.” Përndryshe, nëse e kap vetëpëlqimi, që ‘unë diçka jam duke e bërë’, si për shembull, ‘unë e mbaj agjërimin kështu, e mbaj ashtu...’, duke u mburrur, shprehur vetëpëlqim dhe mendjemadhësi e vetëpëlqim, e gjithçka që bëhet për t’i bërë të tjerët se adhurimi yt është tejet i thellë është pengesë për sinqeritetin.

Kështu që agjërimi duhet lidhur tërësej vetëm e vetëm me Allahun dhe synimin e arritjes së kënaqësisë së Tij. Dhe, zaten kjo bie ndesh me urtësinë e shpalljes së agjërimit, që njeriu t’ia marrë Allahut agjërimin dhe t’ia atribuojë atë vetes, duke u përpjekur që të nxjerrë një përfitim vetjak prej tij. Sepse Allahu i Madhërishëm (xhel’le xhelaluhu) thotë:

*“Agjërimi mbahet vetëm e vetëm për kënaqësinë Time dhe shpërblimin për të e caktoj, e jap vetëm Unë.”*<sup>161</sup>

<sup>161</sup> Buhariu, *teuhid* 35; Muslim, *sijam* 160.

*PJESA E TRETË*



**PËRFITIMET E AGJËRIMIT**





Allahu i Madhërishëm, qenies njerëzore i ka falur dhe e ka bërë të denjë për të mira e mirësi të panumërta. Dhe një ndër mirësitë që i ka dhënë Mëshira e Pasosur njeriut është që nuk e ka lënë atë vetëm për vetëm me mendjen e tij, por u ka dërguar edhe udhërrëfyes, si profetët dhe librat. Nëpërmjet tyre, në vend se të vërtitej më kot nëpër gjirizet djallëzore, njeriu mund të rrahë flatra në horizontet e engjëjlore dhe të veprojë në përputhje të plotë me qëllimin e krijimit të tij si njeri.

Këtë qëllim, Kurani na e bën neve të ditur përmes ajetit: *“Unë xhindet dhe njerëzit i krijova vetëmse që të më adhurojnë Mua.”*<sup>162</sup> Me një fjalë, qëllimi i ekzistencës së njeriut është që ai të adhurojë dhe t'i shpërfaqë robërinë e tij Allahut. Dhe shpërblimi i tërë këtyre adhurimeve duhet pritur vetëm e vetëmse nga Allahu. Frytet e adhurimit janë të përtej kësaj bote dhe dobia e tyre do të shfaqet në jetën e përtejme. Kjo është arsyeja se si, nëpërmjet adhurimeve, njeriu bëhet një rob i përsosur, të cilit i peshon më tepër ajo anë e prirur kah jeta e përtejme. Por edhe ruajtja e kësaj gjendjeje bëhet po nëpërmjet adhurimeve. Por, le ta shprehim këtu në parantezë, se si disa dobi të kësibotshme që janë pjesë e pandarë e disa adhurimeve, nuk mund të jenë kurrsesi qëllim e arsye kryesore e kryerjes së tyre. Nuk ka nevojë as për diskutim, që shumë dobi dhe të mira që vijnë bashkë me adhurimet, që në këtë botë, janë rrjedhojë e emrit i Gjithëurtë të Allahut (xhel'le xhelaluhu). Po, në çdo gjë që Ai na ka ngarkuar me përgjegjësi ka sa e sa urtësi, të cilat ne i shohim apo nuk i shohim dot me syrin tonë. Të zëmë adhurimet si namazi apo agjërimi, me to vijnë shumë dobi të kësibotshme, por edhe ato duhen vlerësuar po nga e njëjta perspektivë. Pas trajtimit të çështjes në këtë mënyrë, mund të ndalemi e të shohim disa nga dobitë e të mirat që vijnë bashkë me agjërimit, apo shprehur me fjalë të tjera, të flasim rreth përfitimeve që na sjell agjërimi.

## A. Përfitimet e individit

### 1. Të mëson durimin

Durimi është kriteri më i rëndësishëm i arritjes së virtytit dhe

---

<sup>162</sup> Dhariat, 51/56.

lartësimit, dhe njëherazi ngadhënjimi i vullnetit. Pa të nuk mund të bëhet fjalë, as për zhvillimin e shpirtit, as për lartësimin dhe arritjen në fshehtësitë e qenies. Me durim njeriu shpëton nga vargonjtë e mishit dhe kockave dhe po me durim, shndërrohet në një engjëll të denjë për t'u shkruar me botët e epërme.

Pesë kohët e namazit në ditë, agjërimi për më së paku një muaj në vit, dhënia e zekatit në një kohë të caktuar të vitit, vajtja të paktën njëherë gjatë jetës në haxh dhe përmbushja e gjithë urdhëresave të tjera në lidhje me jetën e adhurimit, nuk mund të realizohen përveçse nëpërmjet durimit. Njëherazi, ato e disiplinojnë jetën e njeriut dhe i hedhin përsipër një ngjyrë nga ajo e përtejësive. Dhe një jetë si kjo shkon veçse në vijën e dritës, begatohet dhe më në fund – me mirësinë e Allahut – jep Xhenetin si fryt. Prandaj, njeriu do të shtrëngojë dhëmbët, do të bëjë durim ndaj adhurimeve, duke e bërë jetën e tij të përndritur.

Edhe *sabir-i*, që shenjon një lëndë të hidhur helm që përdoret në industrinë farmaceutike prej vitesh, e ka prejardhjen po nga fjala *sabr* – durim. Prandaj ndoshta edhe durimi është si të kapërdish atë *sabirin* e stërhidhur, kur bën durim, shtrëngon dhëmbët, tregon zgjuarsi, nuk lëkundesh, nuk bie në paralizë të vullnetit, por i përballon dhe i tërheq njëherë thellë në kraharor. Vetëm se kjo hidhtësi ka të bëjë me çastin e parë. Sepse përfundimin dihet, përherë e ka pasur më të ëmbël edhe se sherbeti.

Nuk ka dyshim, që një nga dobitë më të mëdha të agjërimit është që ai e bën njeriun të mësohet. Përmes agjërimit njeriu merr një mësim tejet të madh durimi. Sepse atë e merr uria, por ai duron pa ngrënë; e zë etja dhe ai duron pa pirë; i bëhen sjellje të pahijshme, por ai sërish duron pa reaguat me të njëjtën monedhë e thjesht thotë, '*jam me agjërim*'. Për të shpjeguar këtë anë, Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue'ssel'lem) ka thënë: "*Agjërimi është gjysma e durimit*."<sup>163</sup> Po, agjërimi është gjysma e durimit. Teksa ia lidh vetes duart, këmbët, gjuhën, buzët,

<sup>163</sup> Tirmidhiu, *daauat* 87; Ibni Maxhe, *sijam* 44.

veshët dhe rreh flatrat drejt Zotit, nëse i bën vetes *kalë* edhe durimin, atëherë njeriu bëhet si me dy krahë që do ta çojnë drejt e në shkrirje me lumturinë e pranisë së Allahut (xh.xh.).

Në Kuranin Fisnik ka shumë ajete fisnike në lidhje me virtytet dhe shpërblimet për durimin. Por, duke ia lënë këtë çështje atyre hapësirave ku ajo është trajtuar veçanësisht, këtu do të mjaftohemi duke renditur vetëm disa syresh:

*“Për ata që durojnë dhe bëjnë punë të mira, ka një falje dhe shpërblim të madh.”*<sup>164</sup>

*“Bëj durim, sepse Allahu nuk e çon dëm shpërblimin për ata që veprojnë mirë.”*<sup>165</sup>

*“Atyre që durojnë, shpërblimi do t’u paguhet pa llogari.”*<sup>166</sup>

Një njeri që bën një jetë të rehatshme mes mirësish të gjithëfarëllojshme, nuk ka asnjë garanci që kjo jetë do të vazhdojë përherë e këtyllë. Herë-herë, në një kohë fare të papritur, mund të vijë varfëria. Të jesh i pasur, por të falimentosh, - Zoti na ruajtë – ndodh një fatkeqësi dhe mund të humbasësh gjithçka, ndodh një luftë dhe mund të përballësh me lloj lloj vështirësish. Sepse Allahu është zotëruesi i vërtetë i çdo pasurie; ia jep atë kujt të dojë dhe kujt të dojë, ia merr nga duart atë.

*“Thuaj: O Zot, që je zotërues i pasurisë! Ti ia jep pasurinë (ç’ka në gjithësi) kujt të duash; kujt të duash, ia merr; kë të duash e lartëson, këtë duash e poshtëron. Jo, (pasuria) në dorën Tënde është. Ti je i Fuqishëm për çdo gjë.”*<sup>167</sup>

Duhet të jesh i përgatitur që më parë dhe ta kesh të përgatitur edhe trupin, edhe mendjen, edhe shpirtin, për çdo gjë që sjellin kohë të këtylla, në mënyrë që të mund t’i përballosh e të mos lëkundesh, kur

---

<sup>164</sup> Hud, 11/11.

<sup>165</sup> Hud, 11/115.

<sup>166</sup> Dhumer, 39/10.

<sup>167</sup> Al-i Imran, 3/26.

këto kohë të vijnë te dera.

Japra, adhurimi i agjërimit i jep njeriut një mësim të mirë përshtatjeje, që të mos e ketë të vështirë e të bjerë në pesimizëm me ardhjen e këtyre kohëve apo vështirësive të ngjashme. Njëfarësoj, duke agjëruar, agjërimi e ka përgatitur njeriun për vështirësi të shumëllojshme që mund t'i vijnë papritur thjesht duke i mësuar atij durimin ndaj disa nevojash tejet bazike, siç janë të ngrënët dhe të pirët. Kësisoj, njeriu mund të rezistojë më lehtë dhe me më pak mundim ndaj vështirësish, mundimesh dhe barrësh më të mëdha, të cilat mund të vijnë gjatë jetës së kësaj bote.

Veç kësaj, shumë herë, shumica e njerëzve bëhen të varur nga uria. Në një rast si ky, kur përballet me diçka të tillë, njeriu duhet ta mësojë veten nëpërmjet urisë dhe ushqyerjes së përkorë, në mënyrë që të mund të durojë. Gjatë Ramazanit të Bekuar – edhe pse mund të ketë ndryshime sipas vendit dhe kohës – agjërimi zë thuasje gjysmën e ditës dhe bëhet kësimmënyre durim, përballim, përkorje dhe trainim për urinë. Domethënë agjërimi është edhe ilaç i padurimit që i shumëzon me dy të gjitha vështirësitë që mund të përballet njeriu.

Në të njëjtën kohë, agjërimi është një përgatitës mjaft i mirë i terrenit për formimin e njerëzve idealë, të cilët asnjëherë nuk lëkunden para vështirësive dhe vuajtjeve, e nuk i sakrifikojnë kursesi ato principe që i konsiderojnë si të drejta e të vërteta për asgjë të kësibotshme që mund t'u ofrohet.

## ***2. Edukon egon***

Siç e shpreh edhe Bediuzamani i nderuar në “Traktatin e Ramazanit”, me agjërimit duhet të synohet edhe edukimi i vetjes (egos). Një besimtar që agjëron, duhet të thotë: “T’ia ul edhe pak kokën egos sime, ta bëj të priret edhe pak më tepër kah Allahu i Lartësuar. Ta mësoj atë të hajë pak, të flasë pak, të flejë pak. Të përpiqem të nxjerr prej tij ato virtyte, shkallë dhe aftësi, që në rrugëtimin e lartësimit shpirtëror arrihen nëpërmjet vuajtjes.” – dhe ta shohë Ramazanin edhe si një stinë

të volitshme për përkorje. Zaten edhe një anë e ushqyerjes së përkorë të *rijazet*-it i ngjan agjërimin. Duke ngrënë e pirë pak dhe duke duruar një varg vështirësish njeriu mund të bëhet i denjë për disa gjëra të jashtëzakonshme; sheh se si metafizika sundon mbi fizikën. Këto janë gjëra shumë të rëndësishme për sa i takon përfitimt shpirtit të forcës së tij. Por, nëse ajo që synohet nuk është kënaqësia e Allahut, atëherë nuk ka asnjë kuptim që të përballësh e të durosh mundimin dhe vështirësitë, me të cilat të duhet të përballësh.

Po, qëndrimi i uritur dhe të ngrënë pak janë dinamika serioze për sa i përket frenimit të egos. Kjo është arsyeja se pse shumë njerëz të Zotit kanë bërë *rijazet*, duke u përpjekur të ruajnë një farë mase të pjekurisë shpirtërore të tyre. Por edhe rastet e jogive, që kanë qëndruar të etur dhe të uritur, dhe disa mistikëve, të cilët u kanë shkaktuar vetes vuajtje e mundime të ndryshme, që u kanë përfutur edhe më shumë forcë shpirttrave të tyre, janë ngjarje të vërteta që i dimë prej shumë kohësh. Mirëpo, nga ajo çfarë kanë bërë ata nuk ka asgjë që mund të presin në emër të ahiretit. Sepse qëndrimi etur dhe uritur dhe bërja e *rijazetit* (ushqyerjes tejet të përkorë rituale), fitojnë vlerë dhe kuptim vetëmse kur bëhen me qëllimin e adhurimit. Kënaqësia e Allahut arrihet nëpërmjet kryerjes së adhurimeve për të fituar kënaqësinë e Tij.

Agjërimi është një frer i vënë ndaj egos. Kështu ai e thyen faraonësinë e egos. Edhe nëse është i dyshimtë për nga vërtetësia dhe rrjedhja, ka një transmetim, që thelbi dhe mësimi që do të japë janë shumë kuptimplotë, në të cilin thuhet:

*“Allahu i dha ndëshkime të ndryshme egos për ta edukuar. Pastaj e pyeti: ‘Kush je ti, kush jam Unë?’ – Egoja tha: ‘Ti je ti, unë jam unë.’ – Atëherë Allahu e edukoi atë duke e lënë të uritur. Si përfundim, kur e pyeti, ‘Kush jam ti, kush jam Unë?’ – përgjigjja e egos ishte: ‘Ti je Zoti i botëve, ndërsa unë jam një rob i Yti i përrulur.’”*

Për njerëzit është një nevojë e pashmangshme që t’i mbajnë në duar frerët e egos. Sepse dëshirat dhe zakonet e egos janë helme vrastare për njeriun dhe u ngjajnë barrëve të rënda që të tërheqin për poshtë.

Egoja nuk e urdhëron njeriun vetëmse për të keq. Jusufi i nderuar (alejhis'selam) ka thënë:

*“Në të vërtetë, unë nuk e justifikoj dot egon time dhe nuk them dot që ajo është e pastër nga të metat. Sepse, pos atyre që i ka mëshiruar dhe i ruan Allahu, egoja të urdhëron dhe të shtyn veç për të keq. Në të vërtetë, Zoti im është falës, i mëshirshëm (i ka të gjera faljen dhe mëshirën).”*<sup>168</sup>  
– duke na bërë një prezantim, ndoshta më të bukurin, të egos. Egoja ka një natyrë që sa më shumë t’i japësh, aq më shumë të kërkon; sa më shumë të marrë, aq më shumë llastohet. Edhe Profeti ynë i Nderuar (paqja qoftë mbi Të), në lutjet e Tij kërkonte mbrojtje tek Allahu nga egoja që s’kishte të ngopur:

*“O Zot! Të kërkoj Ty të më mbrosh nga dobësia dhe përtesa, frika dhe kopracia, pleqëria dhe vuajtjet e varrit. O Zot! Fali egos sime devotshmëri. Bëje atë të pastër. Sepse Ti je më i mbari i Pastruesve. Ti je Zotëruesi i egos sime. O Zot! Të kërkoj Ty të më mbrosh nga dija që nuk të jep dobi, zemra që nuk drithërohet nga frika, egoja që nuk di të ngopur dhe lutja që nuk pranohet.”*<sup>169</sup>

Në një lutje tjetër të Tij Ai i ka kërkuar Allahut mbrojtje nga e keqja, ligësitë dhe gjithë fatkeqësitë që mund t’i sjellë njeriut egoja.

*“O Zoti im që i di më së miri botët e së fshehtës dhe dëshmisë, e që i krijove qiejt dhe dheun nga hiçi! Unë dëshmoj se nuk ka zot tjetër veç Teje. Te Ty kërkoj mbrojtje nga e keqja e egos sime, e keqja e shejtanit dhe mashtrimet e tij.”*<sup>170</sup>

E thënë me fjalët e të parëve, *“braktisja e zakoneve, varësive, i vret, i shkatërron njerëzit.”* Prandaj, njeriu e ka të vështirë të heqë dorë nga të ngrënët dhe të pirët atëherë kur duhet, pak edhe nga varësia që ka krijuar ndaj tyre nga ajo çfarë është mësuar me sy. Por, besimtari duhet ta mësojë egon e tij asisoj, që ai mund të jetojë edhe në kushtet më të rënda. Dhe ja, nëpërmjet agjërimit ai mund t’i braktisë zakonet dhe

<sup>168</sup> Jusuf, 12/53.

<sup>169</sup> Muslim, *dhikr* 73; Ebu Daud, *uitr* 32; Tirmidhiu, *daauat* 68.

<sup>170</sup> Tirmidhiu, *deauat* 14, *fadlu't-tesbih* 95; Ebu Daud, *neum* 8.

veset që i është mësuar egoja dhe të fillojë njëfarësoj të jetojë i pavarur prej tyre. Ai që mësohet me urinë dhe etjen, di mjaft mirë që ta durojë dhe përballojë atë edhe në ditët kur është i detyruar që të jetojë me to.

### 3. Është mburojë ndaj mëkateve

Mëkati është një rrënim i brendshëm, një mbrapshti dhe një kundërvënie ndaj natyrës së tij e njeriut. Një njeri që hyn në mëkat është njëherazi një i pafat që vuajtjeve të ndërgjegjes dhe vështirësive të zemrës dhe një viktimë që i ka dorëzuar në dorë të djallit të gjitha aftësitë dhe shqisat e tij shpirtërore. Sidomos, nëse vijon që t'i kryejë atë mëkat, ai e humb tërësej nga duart fillin dhe tanimë në vullnetin e tij as që mund të bëhet më fjalë për rezistencë dhe ai nuk ka më fuqi për t'u rinovuar.

Të shumta e grumbuj grumbuj janë mëkatet nëpër rrugët nga i duhet të kalojë njeriu dhe porsi kobra, vështrojnë andej nga do të kalojë ai. Edhe pse mund të shpëtojë nga njëra, është shumë e vështirë që ai ta vijojë rrugëtimin pa u mbërthyer të paktën nga njëra. Për t'u kapërcyer këto rrugë duhet një vullnet i shëndoshë dhe i çeliktë.

Ja, pikërisht për të të mbrojtur kundër këtij rreziku, agjërimi është si një garant dhe garanci më vete. Për disa njerëz, ai është si një perde mbrojtëse nga zhgënjimi. Është si një udhëzim kundër mëkateve dhe gabimeve. Porsi një mburojë, ai e mbron të zotin duke ia lehtësuar rrugën drejt parajsës.

I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) ka thënë:

*“O ju të rinj! Kush prej jush ka mundësi që të martohet, të martohet. Kush nuk i ka mundësitë, të agjërojë. Sepse agjërimi është një mburojë (që ju mbron) ndaj mëkatit.”*<sup>171</sup>

Agjërimi është një ushtrim; ai zhvillon tek individi mekanizmin shpirtëror të rezistencës ndaj dëshirave trupore. Ashtu siç agjërimi

<sup>171</sup> Buhariu, *nikah* 2, 3; Muslim, *nikah* 1.

mund të jetë një pengesë ndaj dëshirave dhe prirjeve ndaj çdo gjëje negative, me rezistencën e fituar gjatë kohës që ka qenë me agjërime njeriu mund ta fitojë atë edhe në ditët që nuk është me agjërime. Sepse agjërime nuk do të thotë vetëm lënie e stomakut të uritur. Përkundrazi, njëherazi ai do të thotë që së bashku me stomakun të vësh në agjërime edhe gjithë ndjenjat; syrin, veshin, mendjen, zemrën, imagjinatën dhe tërë shqisat e tjera njerëzore, t'i tërheqësh ato nga mëkati dhe gjërat e kota e të përkohshme, duke e shtyrë secilën prej tyre drejt formash të posaçme të adhurimit. Dikush që agjëron në këtë mënyrë, do të thotë se është duke jetuar një jetë brenda boshtit të së lejuarës.

Është rruga më efektive e mbajtjes së egos nën kontroll, agjërimi. Sepse, kur stomaku është përherë plot, ai i bën të gjitha organet dhe gjymtyrët që të punojnë me kapacitetin e tyre maksimal të energjisë. Vetëm kur shikoni që njeriu e ka të vështirë që ta mbajë nën kontroll vetveten, aq sa as gjuhën nuk e kontrollon dot për të mos thënë gjëra të pahijshme. Andaj ai duhet të marrë një vendim në parim; për shembull, duke e ushtruar gjuhën me recitim të Kuranit, *dhikr, tesbih, salavatet*, ai mund ta ruajë atë nga gënjeshttrat, përgojimet dhe fjalët e këqija. Madje, nganjëherë, duke thënë: “nëse më del nga goja ndonjë gjë që përbën përgojim, do të mbajë kaq kohë agjërim pa ndërprerë”, duke i mbyllur kështu të gjitha rrugët që të çojnë kah përgojimi. Ndoshta, duke i dhënë një ndëshkim të këtyllë egoja mund të bëhet zap dhe të mundësohet që të jetë arsyeja që kontrollon dhe egoja të jetë e kontrolluara e saj. Kushedi, pas kësaj Zoti mund të bëjë që mospërgojimi të bëhet pjesë e pandarë e natyrës sonë.

Po, gjuha pa kontroll është një nga rreziqet më të mëdha që i kanoset njeriut për sa i përket jetës së amshuar. Dhe rruga e vetme e marrjes nën kontroll të saj është kufizimi i kërkesave dhe dëshirave të egos. Agjërimi është një recetë e çmuar, me gjasë më e rëndësishmja, për sa i përket përmbushjes së këtij funksioni. Pastaj, këtë e përforcon edhe Profeti ynë i Nderuar (paqja qoftë mbi Të) në një hadith të Tij:

*“Kush nuk heq dorë nga të folurit gënjeshtrore dhe bërja e përgojimit teksa është duke agjëruar, ta dijë që Allahu nuk ka nevojë për ndenjen e*



*tij të etur e të uritur.*<sup>172</sup>

Njeriu i agjëruar, krahas mbrojtjes së gjuhës duhet të pengojë edhe syrin nga të shikuarit e së ndaluarës dhe veshin nga dëgjimi i gjërave të këqija; syrin duhet ta drejtojë nga shembujt e mirë dhe veshin ta drejtojë kah dëgjimi i fjalës së drejtë dhe Kuranit Famëlartë.

Me pak fjalë, agjërimi më i përsosur është ai që bashkë me stomakun vihen të mbajnë agjërim edhe syri, veshi, zemra, imagjinata, mendja dhe tërë organet e tjera; agjërimi që edhe ato pengohen dhe largohen nga gjërat e ndaluara e të kota, duke u drejtuar nga një lloj adhurimi i posaçëm i tyre. Dhe rruga drejt kësaj kalon nga mbajtja nën kontroll nëpërmjet agjërimit e stomakut, që është sikur një fabrikë gjigante brenda trupit njerëzor. Sepse, nëse mbahet ai nën kontroll, të gjitha gjymtyrët e tjera i binden fare lehtësisht stomakut.

Profeti ynë i Nderuar (pqmT), në lidhje me këtë çështje, ka thënë kështu në një hadith të Tij: *“Çdo njeri ka një pjesë në zina (imoralitet) dhe është shumë e vështirë që të shpëtojë prej saj. Zinaja e syrit është të shohë (drejt së ndaluarës); e gjuhës të flasë (të ndaluarën). Egoja vuan ta bëjë këtë. Ndërsa organet, ose e pranojnë, ose e refuzojnë këtë kërkesë të saj.”*<sup>173</sup>

Fatkeqësisht, sot, këto mëkate janë të përhapura jashtëzakonisht shumë. Mirëpo, mëkati, me çdo anë, çdo aspekt, çdo fakultet dhe çdo institucion të tij, i shërben djallit. Islami ka vendosur një sërë kriteresh dhe principesh kundër mëkateve. Besimtarët, për sa kohë që u drejtohen këtyre principeve, nuk do të bien në batakun e mëkatisht dhe nuk do të zhduken duke u marrë nga rrjedha e tufanit të mëkatisht. Por, nëse nuk ndiqen me përpikëri këto kritere të Islamit, atëherë edhe njerëzit do t'i marrë rrjedha e përmbytjeve që shkakton mëkati, njësoj sikur të mos ishin njerëz, por trungje të thara druri. Këtë këndvështrim që ofron Islami mund ta përmbledhim në këtë mënyrë:

Fillimisht, Islami i konsideron si një realitet, të gjitha çështjet që e kanë burimin te qenie njerëzore. Për shembull, prania ndjenjave të

<sup>172</sup> Buhariu, *saum* 8, *edeb* 51; Tirmidhiu, *saum* 16; Ebu Daud, *saum* 25.

<sup>173</sup> Buhariu, *isti'zan* 12, *kader* 9; Muslim, *kader* 5.

mllefit, inatit dhe ambicies, që janë të pranishme te njeriu është një realitet. Mirëpo, ndërkohë që ato mund të jenë një shkas për shumë mbarësi, bekime e begati, kur përdoren siç duhet, nëse nuk përdoren, ato mund të të çojnë drejt së keqes. Në të njëjtën mënyrë, Islami e pranon si një realitet edhe praninë e epshit te njeriu. Për më tepër, epshin (dëshirën dhe oreksin) ai e konsideron si një avancë, një dhuratë hyjnore, e cila është e domosdoshme për vijimësinë, si të jetës individuale të njeriut, ashtu edhe të brezave të ardhshëm njerëzorë. Duke e vlerësuar siç duhet këtë avancë që i është dhënë, njeriu mund të bëhet shkas për shumimin e umetit të Profetit Muhamed, të cilët janë trashëgimtarët e së mirëstë rruzullit tokësor. Megjithatë, qëndrimi brenda vijave të lejuara për sa i përket kësaj çështjeje dhe mosrënia në mëkat, janë një kriter i patjetërsueshëm dhe i pazëvendësueshëm në Islam. Dhe rruga e kësaj është martesë.

Ata që nuk i kanë mundësitë për t'u martuar, ndjekin këshillën e të Dërguarit të Allahut dhe mbajnë agjërim. Vetëmse edhe agjërimi duhet të mbahet duke i realizuar të gjitha kushtet e tij, në mënyrë që të mund të përmbushet me vend edhe funksioni i tij i pengimit në rënie në mëkat. Nëse do ta shohim nga ky pikëvështrim, nëse njeriu qëndron gjatë gjithë ditës i etur dhe i uritur, që të hajë me sa të mundë në mbrëmje, kur të hyjë koha e iftarit, apo që pasi ka ngrënë sa ka mundur në mbrëmje, të presë kohën e syfyrit, për të ngrënë sërish sa të mundë, si në iftar, patjetër që ai do ta ketë të vështirë të marrë rezultatin e pritur nga agjërimi i mbajtur. Sepse një nga synimet më të rëndësishme të agjërit është thyerja e epshit. Dhe, nëse merr një sasi kalorish të caktuar, që është më shumë se norma ditore, ushqimet e konsumuara jo vetëm që nuk lejojnë thyerjen e epshit, por mund të bëhen shkas edhe për përforsimin edhe më të tij. Rrjedhimisht është e pamundur që një njeri që ha dhe pi kështu të fitojë ndonjë dobi nga agjërimi. Vetvetiu, njeriu duhet të bëjë kujdes, që të hajë e të pijë në kohë të caktuara. Të ngrënë pak, të pirët pak dhe të folurit pak janë secili nga një princip islam i patjetërsueshëm.

Kështu, është shumë e rëndësishme që të mbyllen pak rubinetat e

ushqimit të egos, duke e përdorur siç duhet fuqinë e vullnetit. Në të kundërt egoja përherë do të jetë si një portë e hapur nga ku shejtani mund të hyjë lirshëm. Njësoj si shejtani, as egoja nuk mund të bëhet mikeshë e njeriut. Egoja është një armik i ethshëm që të çon veç nga e keqja dhe ndaj së cilës duhet bërë *“lufta më e madhe”*, dhe shpëtimi prej saj dhe djallit është një hap i rëndësishëm i hedhur në drejtim të afrimit me Allahun. Njëherë, Profeti ynë i Nderuar (sa'lallahu alejhi ue'ssel'lem) ka thënë: *“Tani ju u kthyet nga lufta e vogël drejt luftës (xhihad) së madhe.”* – dhe kur e pyetën se çfarë do të thoshte *“luftë e madhe”*, Ai u përgjigj duke thënë: *“Që robi t'u hapë luftë dëshirave të egos së tij.”*<sup>174</sup> Këto janë mësimë shumë të rëndësishme për ne, që t'i frikësohemi egos sonë dhe të jemi përherë vigilentë kundër saj.

Po, metoda që aplikohet për të mbajtur nën kontroll egon është agjërimi. Prandaj ai është bërë një prej shtyllave themelore të fesë dhe është renditur si një nga rrugët që të çojnë drejt devotshmërisë, e cila është praktika e aplikimit të Islamit tek egoja.

Si përfundim, duke agjëruar njeriu e shpëton egon nga kryengritja ndaj Allahut të Madhërishëm, duke e futur atë në rrugën e të qenit rob i bindur ndaj Tij. Kushdo që agjëron arrin ta ndiejë se si i afrohet një farë engjëlloreje brenda vetes, krahasuar me ditët kur nuk është me agjërim. Dhe poende, gjithkush e kupton se nuk mund ta bëjë diçka, kur nuk ka leje për ta bërë atë, madje as dorën e vet nuk e zgjat dot drejt një gote me ujë... dhe kështu kupton se ai nuk është zotërues, por i zotëruar. Dhe si rezultat, sheh dobësinë, varfërinë dhe mangësinë e tij të pafund dhe me dorën e falënderimit shpirtëror bëhet gati që të trokasë në portën e mëshirës. Mjaft që agjërimin ta mbajë përbrenda kritereve të përcaktuara nga feja.

#### **4. E bën shpirtin të fitojë pjekuri**

Njeriu është një krijesë e përftuar nga trupi dhe shpirti. Ashtu siç vetëm trupi, pa shpirtin, nuk ka asnjë kuptim, edhe shpirti pa trupin nuk kanë asnjë kuptim për sa i përket kufijve të botës së vullnetit të lirë.

<sup>174</sup> El-Bejhaki, *ez-Zuhd*, fq. 165; Hatib el-Bagdadi, *Tarihu Bagdad* 13/523.

Ato çfarë ha dhe pi njeriu, veprimet që bën dhe adhurimet që përpiqet të kryejë, kanë një farë ndikimi të caktuar, si në trupin, ashtu edhe në shpirtin e tij. Një kafshatë që e fut në gojë, edhe pse në pamje të jashtme dhe fizikisht ajo shkon në stomak, ajo ka një ndikim të caktuar edhe te shpirti. Po njësoj, veprimet e kryera ndikojnë, si te trupi, ashtu edhe te shpirti. Nga ky këndvështrim, një vend të rëndësishëm në zhvillimin dhe pjekurinë e jetës shpirtërore të njeriut zënë edhe ato çfarë ha edhe pi ai.

Tek agjërimi është i pranishëm, po ashtu, edhe përmbajtja e tregimit të një kujdesi maksimal ndaj gjërave që ha ose pi, të cilin ia kanë dhënë edhe mistikët në praktikën e *rijazetit* (ushqyerjes fare të përkorë). Një njeri që i drejtohet shpesh agjërimit, e ka fare të lehtë që t'i dëshmojë edhe vetë të gjitha aftësitë dhe virtytet e veçanta që fillojnë të lindin brenda tij. Ndërsa te njeriu që mendon në çdo kohë dhe çdo vend vetëm për se çfarë do të hajë dhe çfarë do të pijë, është shumë e vështirë që të jetë të pranishme një shpirt i pastër dhe një zemër e kulluar.

Njësoj si trupi, i cili ka një varg nevojash dhe dëshirash të caktuara, edhe shpirti ka kërkesat e veta. Për nga truporja njeriu është një krijesë tejet e vogël; por, nëse do të kemi parasysh mekanizmat shpirtërorë të tij, ai është një krijesë e hapur kah pafundësia (përjetësia). Ai ka prirje, dëshira, kërkesa, ndjesi, imagjinatë, mendime dhe mendje të prirur kah pafundësia dhe nga kjo pikëpamje, ai është si një përmbledhje e vogël e gjithësisë.

Kështu, adhurimi është e vetmja dhe e vetmja punë më e lartë dhe më e vyer që mund të bëjë njeriu, i cili është ky, si për nga pozicioni, ashtu edhe gjendjet e tij, në mënyrë që të mund t'i zhvillojë anët dhe aftësitë e tij shpirtërore, që mundëson realizimin e dëshirave dhe kërkesave të tij të mirëfillta, që mund t'i vërë nën kontroll ndjenjat e tij si epshi dhe ashpërsia dhe e afron atë me Allahun duke e vënë në komunikim me të. Dhe këto veçori janë të pranishme të gjitha tek agjërimi, që është një adhurim tejet i rëndësishëm.

Nëse do të lëmë mënjanë dallimet që ekzistojnë në formë, agjërimi

është një kriter i rëndësishëm në të gjitha fetë që kanë si synim zhvillimin dhe përparimin shpirtëror të njeriut. Madje të gjithë profetët që janë ngarkuar me misionin e udhërrëfimit për arritjen e pjekurisë shpirtërore të njerëzisë, periudhat e përgatitjes për të marrë përsipër këtë mision përherë i kanë kaluar duke mbajtur agjërim. Edhe ky është një argument i mëvetësishëm, që tregon se çfarë ndikimi ka agjërimi në arritjen e pjekurisë të njeriut.

Kur nisi që t'i zbritej Teurati, Musai i nderuar (alejhis'selam) kishte plotësuar mbajtjen e agjërimit dyzetditor. Kur iu zbritën ajetet e para Isait të nderuar (alejhis'selam), kushedi se sa ditë ishin bërë që ky profet i madh kishte qenë duke mbajtur agjërim. Edhe Krenaria e Njerëzimit, ditët para se t'i jepej profetësia duke agjëruar i kishte kaluar. Njëfarësoj Ai ishte si të kishte hyrë në *izolim për adhurim* (itikaf). Zaten në një prej ditëve të Ramazanit pati filluar të zbritej edhe shpallja e parë. Nëse do të kihet parasysh edhe fakti që *izolimi për adhurim* është brenda muajit të Ramazanit, është shumë domethënës përkimi edhe me tërheqjen e Profetit tonë në Hira pikërisht në këtë kohë të po këtij muaji.

Po, shumë herë shpirti njerëzor zhvillohet përmes trupit dhe trupi zhvillohet përmes shpirtit. Duhet medoemos të agjërojnë të gjithë ata që duan të zhvillohen shpirtërisht. Apo ta themi kështu: ata që nuk agjërojnë mbeten nën peshën e barrës së trupit dhe nuk mund ta arrijnë dot pjekurinë e pritur shpirtërore.

Edhe Bediuzamani i nderuar është shprehur me këto fjalë në lidhje me këtë çështje:

*“Fabrika e stomakut ka shumë shërbëtorë dhe shumë ndjenja njerëzore që janë të lidhura ngushtësisht me të. Nëse nuk bëjnë pushim gjatë ditëve të një muaji në vit, këta shërbëtorë dhe këto ndjenja e harrojnë detyrën e adhurimit dhe ai e bën njeriun të merret vetëm me të, e fut atë nën sundimin e vet dhe e bën që të gjithë vëmendjen ta drejtojë kah vetja, duke i bërë që t'harrojnë detyrën e tyre të lartë. Dhe organet e tjera, për hir të argëtimit të kota të asaj fabrike, marrin kënaqësi nga ato në rrafshit engjëllor dhe shpirtëror në Ramazan, duke e ngulur vështrimin vetëm drejt atyre kënaqësive shpirtërore. Prandaj edhe gjatë muajit të bekuar të Ramazanit, besimtarët bëhen të denjë, secili sipas shkallës së vet, për*

*ndriçime, dritësime dhe kënaqësi të ndryshme shpirtërore. Nëpërmjet agjërimit në atë muaj të bekuar, shumë aftësi, si shpirti, mendja dhe fshehtësira, zhvillohen së tepërmi dhe përkundër të qarës së stomakut, ato qeshin plot pafajësi.”<sup>175</sup>*

## **5. E lartëson njeriun drejt engjëllorës**

Te njeriu janë të përfshira dy anë, njëra ajo engjëllore dhe tjetra, ajo kafshërore. Pra, siç ka një anë të prirur kah fizikja, ai ka edhe një natyrë tërësisht të hapur kah ajo çfarë fshihet përtej fizikes. Pra, nga njëra anë qëndron një anë e tij kafshërore, e cila përbëhet nga ndjesitë kafshërore si epshet, mllfet, ashpërsia, urrejtjet dhe në anën tjetër, një anë engjëllore, e cila përbëhet nga bindja, njohja e Zotit dhe e së vërtetës, dashuria, robëria dhe thjeshtësia.

Allahu (xhel'le xhelaluhu), kur e ka krijuar njeriun, ka vendosur tek ai, si ndjenja të mira, ashtu edhe ndjenja të këqija. Nga kjo pikëpamje njeriu, edhe mund të engjëllorizohet, edhe mund të djallëzohet. Ashtu siç mund të fitojë një shkallë shumë të lartë shpirtërore, aq sa për të lënë pas edhe vetë engjëjt, ashtu edhe mund të bjerë në një gjendje që të të vijë keq edhe për djallin vetë.

Po, njeriu, i cili është krijuar në formën më të bukur, ka edhe një anë të hapur kah ndjenjat e këqija që mund ta çojnë atë edhe më poshtë se poshtërsia, por që janë krijuar me një varg urtësish të caktuara. Ai, gjithmonë, nën efektin e këtyre ndjenjave mund të bjerë nga më e mira e së mirës në më poshtë edhe se poshtërsia vetë.

Në lidhje me këtë në Kuranin Famëlartë thuhet:

*“Ne e krijuam njeriun në formën më të mirë. Pastaj e hodhëm atë më poshtë edhe më poshtë. Përveç atyre që besuan dhe bëjnë punë të mira. Për ata ka një shpërblim të pandërprerë.”<sup>176</sup>*

Ja pra, lartësimi i njeriut nga njerëzia potenciale drejt horizontit

<sup>175</sup> Shih: Bediuzaman Said Nursi, *Mektubat* fq. 454 (Letra e Njëzetentë, Pika e tetë).

<sup>176</sup> Tin, 95/4-6.

të të qenit njeri i vërtetë do të mund të bëhet i mundur vetëmse nëpërmjet zhvillimit të këtij aspekti engjëllor të tij. Përndryshe, për sa kohë që qëndron i lidhur me trupin dhe jeton nën frerët e kafshërores; domethënë vetëm ha e pi dhe qëndron i fjetur, ai do të qëndrojë i izoluar në ngushtësinë e botës fizike; do të mbetet dhe ndërkohë që është një krijesë e denjë për të qenë më e mira e krijesave, të bjerë në një pozitë më të ulët sesa ajo e kafshëve. Mirëpo, nëse ai del nga kafshërorja dhe e braktis truporen, domethënë nëse pastrohet nga papastërtitë egoiste, kafshërore dhe trupore, dhe ndriçohet me emrat hyjnorë të Allahut, me cilësitë e Tij të patëmeta dhe gjendjeve të qashtra hyjnore, atëherë ai arrin një natyrë ndryshe dhe fiton një natyrë të veçantë.

Një ndër urtësitë se pse engjëjt përmenden aq shpesh nëpër ajetet fisnike dhe hadithet e bekuara është edhe synimi i vënies në lëvizje të kësaj ane engjëllore që është e pranishme si potencial te njeriu. Për ta nxitur atë, për të bërë të mundur zhvillimin e saj dhe për ta çuar atë drejt horizontit të përfuturit të një gjendjeje engjëllore për të. Po, duke u vënë theksi te gjendja e engjëjve bëhet njëkohësisht një nxitje dhe thirrje për t'u ngjarë engjëjve, për t'u bërë si ata dhe na kërkohet që ne t'i zhvillojmë këto aftësi të pranishme në natyrën tonë, të cilat mund të na bëjnë të jemi si engjëjt.

Një nga veçoritë më të rëndësishme që e dallojnë nga engjëjt njeriun është edhe që ai ka kontroll mbi egon e tij. Tek engjëjt nuk mund të bëhet fjalë, as për ngrënie, as për pirje, as për martesë, as për sjellje si mëkati. Ato janë të krijuara si të pafajshme dhe janë krijesa që në çdo çast janë vetëm e vetëmse duke i bërë *tesbih* Allahut dhe duke e adhuruar Atë. Allahu i Madhërishëm thotë:

*“(Disa nga njerëzit) Dolën dhe pretenduan se (engjëjt) janë fëmijët e të Gjithëmëshirshmit. Përkundrazi, ata janë robërit e Tij të nderuar. Ata nuk i dalin kundër fjalës së Tij, por veprojnë vetëmse me urdhrin e Tij. (Allahu) i di të gjitha (gjendjet e tyre) ç’kanë ata përpara dhe pas. Ata nuk mund të ndërmjetësojnë për askënd, përveç atyre me të cilët është i kënaqur Ai. Nga frika e Allahut dhe përulja që kanë ndaj Tij, ata janë në*

*çdo çast vigjilentë.*<sup>177</sup>

Ndërsa njeriut i duhet të ushqehet, që të mund të qëndrojë i gjallë dhe ta vijojë jetën. Në çdo çast ai ka gjasë që të ndjekë egon dhe të hyjë në mëkat. Vetëm besimtari që agjëron, mund t'i vërë një pengesë ngrënies dhe pirjes, të vihet në kontroll të epshittë tij, të ruhet nga çdo lloj mëkati dhe të bëjë një jetë si ajo e engjëjve. Asisoj që Allahu i Madhërishëm krenohet përpara engjëjve me robërit e Tij të tillë, duke ua treguar ata si shembuj.

Po, ka njerëz të atillë që janë si engjëjt. Ky lloj njeriu, vetëm me mendimin se “Zoti do të më kërkojë llogari”, nuk e hedhin këmbën as mbi milingonat. Nëse shohin dikë që është më nevojtar se ata vetë, ia japin atij gjithë ç’kanë në duar. Kur bëhen gati për të falur namazin, iu dridhen këmbët teksa vijnë për t’iu drejtuar Zotit. U dridhen këmbët dhe përkulen në dysh duke menduar se do të japin llogari përpara Allahut. Ka edhe njerëz që janë si djalli. Ata janë më të rrezikshëm edhe se përbindëshat në pyll. Ja pra, në saje të agjërimit njeriu mund të shpëtojë nga gjirizi i poshtërsisë dhe të ngjitet drejt horizontit të engjëjve, madje të fitojë të drejtën për të qenë i denjë për të hedhur hapa edhe më tej.

## **6. Të mëson vlerën e mirësive**

Allahu i Madhërishëm e ka pajisur rruzullin tokësor me njëmijë e një lloje të mirash dhe ia ka dhënë atë njeriut në dorë. Çdo ditë, nga qiejt na zbritet e na shtrohet një sofër e re dhe ngrihet një sofër e vjetër. Pemët japin vazhdimisht fruta dhe mbi sipërfaqen e tokës mbijnë mirësi të shumëllojshme. Në shumë prej ajeteve të tij Kurani Fisnik na kujton mirësitë e Zotit. Ja disa syresh:

*“Në qiell janë rrisiku juaj dhe gjërat që ju janë premtuar.”*<sup>178</sup>

*“Ne zbritëm një masë të caktuar uji nga qiejt dhe e mbajtëm atë mbi*

<sup>177</sup> Enbija, 21/26-28.

<sup>178</sup> Dharijat, 51/22.



*Tokë. Dhe Ne kemi fuqi edhe që ta kthejmë mbrapsht atë ujë. Me atë ujë krijuam për ju kopshte hurmash dhe vreshta me rrush; ju përfitoni dhe hani prej frutave të tyre.*<sup>179</sup>

*“Të mendohet njëherë njeriu për ato me të cilat ushqehet. Ne zbritëm ujin nga qielli. Pastaj e çamë tokën, rruzullin dhe bëmë të mbinin në të frutat, rrushi, ulliri, hurmat dhe sa e sa të mbira të tjera me pemë të dendura dhe të shumta dhe përrenj. Që t’ju bëjnë dobi juve dhe kafshëve tuaja.”*<sup>180</sup>

Allahu, si tokën, ashtu edhe qiellin, i ka shtruar në dobi të njeriut. Por ç’do që njeriu është shumë mosmirënjohës me Zotin e tij. Megjithëse notojnë mes shumë e shumë mirësish, që edhe për ata vetë janë të panumërueshme, shumica prej tyre nuk janë as të vetëdijshëm. Njësoj si në shprehjen, “*Ata të marrë, që në det notojnë, por detin s’ë dinë.*” – jetojnë të paditur sikur peshqit që jetojnë në ujë, por janë të pavetëdijshëm për ujin. Ndërsa agjërimi vë njëfarë rregulli në këtë sjellje të njeriut. Njeriu jeton si të ishte duke notuar mes mirësive dhe duke agjëruar kupton vlerën dhe rëndësinë që kanë këto mirësi, e për rrjedhojë përpiqet edhe që të falënderojë për to.

Vetëm në saje të agjërimin arrin ta kuptojë njeriu se ç’mirësi e madhe është një vesh rrushi që i buzëqesh i varur në degë. Veçanërisht në ditët e verës, ai kujton vlerën e vërtetë të ujit, të cilën e ka harruar se ç’mirësi e madhe është uji teksa e pinte me ëndje në ditët e nxehta. Teksa e kapërdin atë ujë në kohën e iftarit ai thotë: “O Zot! Vallë kështu janë edhe burimet e tua në Xhenet?” dhe arrin që ta shijojë që sa është në këtë botë ujin e burimeve të parajsës. Dhe një kujtesë e këtyllë bëhet shkas që njeriu të fitojë një besim të atillë që është e pamundur të ta falë dot ndonjë gjë tjetër. Domethënë, ajo që u krijuaka në ndërgjegje nga mbyllja e gojës edhe ndaj gjërave të lejuara të Zotit – vetëm sepse është urdhëresë e Tij dhe për një farë kohe – qenka besimi në tërësinë e tij. Ai besim, që ndihet në ndërgjegje, në zemra dhe falë të cilit mund të arrihet paqja e synuar.

<sup>179</sup> Muminun, 23/18-19.

<sup>180</sup> Abese, 80/24-32.

Po, mirësitë janë të Allahut dhe Ai kërkon prej nesh falënderim në këmbim të këtyre mirësive. Ç'gabim dhe ç'mosmirënjohje e madhe, ta harrosh Allahun pavarësisht gjithë këtyre mirësive! Dhe ja, agjërimi, duke e ndërprerë përfitimin prej këtyre mirësive me vullnet, e shpëton njeriun nga harresa. Duke ua kthyer përkohësisht shpinën mirësive dhe duke e ndërprerë interesimin për to, robi sikur thotë: “Po, o Zot! Shiu, azoti që zbret bashkë me të, ajri, rrufeja, shkrepëtima, rënia në tokë e shiut, breshërit, borës, ekzistenca e tokës vetë dhe farat që nxjerrin kryet mbi syprinën e saj... të gjitha këto paskan qenë secila nga një mirësi shumë e madhe. Ne këtë e ndiem vetëmse duke qëndruar përkohësisht të kufizuar prej mirësive të Tua. Tani të kërkojmë Ty, të kujtojmë Ty dhe vetëm Ty të falënderojmë.” – Dhe këtyre fjalëve të tij Allahu i përgjigjet kështu:

*“Përmendmëni mua, që edhe Unë t’ju përmend ju; falënderomëni Mua dhe kurrësi mos u bëni mosmirënjohës.”*<sup>181</sup>

*“Nëse më falënderoni, edhe Unë jua shtoj të mirat, por nëse m’i mohoni të mirat, nuk ka dyshim që ndëshkimi Im është shumë i ashpër.”*<sup>182</sup>

## 7. Forcon lidhjen me Allahun

Njeriu quhet se ka hyrë në rrugën e kthimit në njeri të përsosur për aq sa çështë e fortë lidhja që ai ka me Zotin. Nuk mund të hasësh asgjë që të mos jetë e plotësuar në jetën e një besimtari që e ka të fortë lidhjen me Allahun. Ai, njësoj siç thuhet në ajetin kuranor:

*“Çohen nga shtretërit dhe adhurojnë Zotin me ndjenjat e frikës dhe shpresës.”*<sup>183</sup> – ngrihet në njërën prej gjysmave të mbrëmjes, pa i kushtuar rëndësi nëse është e gjatë apo e shkurtër dhe i shqetësuar nga ndëshkimi i ashpër i Allahut, por edhe duke shpresuar te mëshira e Tij, qëndron i gatitur në *kijam* përpara Allahut. Gjatë Ramazanit, braktis shtratin e ngrohtë në mes të natës, që të mund të bëjë syfyf për hir të

<sup>181</sup> Bakara, 2/152.

<sup>182</sup> Ibrahim, 14/7.

<sup>183</sup> Sexhde, 31/16.

Allahut. Dhe vetëm e vetëm për të fituar kënaqësinë e Tij, duron të qëndrojë i uritur dhe i etur gjatë gjithë ditës. Dhe kështu, kjo sakrificë bën që mes Allahut dhe atij robi të Tij të krijohet një lidhje shumë e fortë. Në këmbim të kësaj sakrifice, në amshim Allahu do t'i thotë atij:

*“Hani dhe pini në shëndet të mirë në këmbim të punëve të mira që bëtë në të shkuarën.”*<sup>184</sup>

Siç thuhet edhe në një hadith kudsî, Allahu nuk të bën që t'i përjetosh bashkë dy frikëra dhe dy siguri. Ata që nuk bëjnë dot lëshim nga rehatia në këtë botë, që nuk durojnë ca pak vështirësi në emër të fesë, që nuk përballen me diçka të vështirë, do të përballen në ahiret me të gjitha këto. Krejt e kundërta do të ndodhë me atë që çohet në mesnatë nga shtrati i tij i ngrohtë, që gjatë gjithë ditës duron vështirësitë e urisë dhe etjes, ai do të jetë i sigurt e nuk do të përballen me vështirësitë dhe mundimet e jetës së përtejme.

## **8. Të kujton takimin me Allahun**

Çdo çast i agjërimit është jashtëzakonisht i vyer edhe për faktin që i kujton njeriut Allahun dhe mirësitë e Tij dhe për rrjedhojë, i sjell ndërmend atij edhe takimin edhe njëherë me Allahun, çka është mirësia më e madhe. Edhe nëse në dukje njeriu kalon nëpër vështirësi duke qëndruar larg dëshirave dhe nevojave të trupit të tij nga mëngjesi gjer në mbrëmje, të mirat që do t'i vijnë prej kësaj në amshim bëjnë që ai t'i harrojë tërësej të gjitha vështirësitë. Besimtari i agjëruar, përgjatë gjithë ditës kujton vetëm takimin me Zotin, për të Cilin i ka lënë, epshin, të ngrënin dhe të pirin. Falë këtij mendimi, e gjithë jeta e tij shkon brenda rrethit të drejtpeshimit. I Dërguari Fisnik (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem), për të treguar frytet e agjërimit, njëri për sa i përket amshimit dhe tjetri për sa i përket jetës në këtë botë, thotë:

*“Për agjëruetin ka dy gëzime. Njëri është gëzimi që ndien kur do të çelë iftarin, ndërsa tjetri është gëzimi që do të ndiejë kur të takohet me*

<sup>184</sup> Hakka, 69/24.

*Zotin e tij në saje të agjërimit.*<sup>185</sup>

Besimtari i vërtetë e kalon jetën me ndjesitë dhe mendimet se një ditë do të takohet me Allahut dhe dëshiron që kjo të ndodhë një çast e më parë. Kur ai sillet me kaq shumë dëshirë, Allahu i përgjigjet kësaj dëshire të tij.

*“Kushdo që dëshiron takimin me Allahun, edhe Allahu dëshiron takimin me të. Kushdo që nuk i pëlqen të takohet me Allahun, as Allahut nuk i pëlqen takimi me të.”*<sup>186</sup>

## **9. Është i mirë për shëndetin**

Deri më sot janë thënë shumë gjëra në lidhje me dobitë që sjell agjërimi në shëndetin e shpirtit dhe trupit, janë botuar sa e sa artikuj dhe sa e sa libra. Dobia që ka ngrënia pak në shëndetin e njeriut është një e vërtetë shkencore e ditur prej shumë kohësh. Për rrjedhojë, duhet qëndruar sa më larg nga ngrëniet kohë e pa kohë dhe nga mbushja e stomakut me gjithfarë ushqimesh me vlera apo pa vlera ushqyese, me kushtin që të konsumohen vaktet që shërbejnë për t'i dhënë trupit sasinë e duhur të kalorive dhe energjisë së nevojshme. Dhe kjo është një nga dobitë më të mëdha të agjërimit për trupin e njeriut. Sepse një njeri që agjëron, i cili gjatë ditës nuk çon dot as edhe një kafshatë të vetme në gojë, edhe në iftar, ai mjaftohet me pak ushqim. E këtillë është edhe tradita e Profetit tonë të Nderuar (paqja qoftë mbi Të) për sa i përket agjërimit.

Sot, të gjithë profesionistët e mjekësisë thonë se mbingrënia është e dëmshme për shëndetin. Dhe është tashmë një realitet i pamohueshëm, që ngrënia shumë është i lidhur drejtpërsëdrejti me shumë sëmundje, si ato të zemrës, diabeti dhe tensioni. Mbjajtja e trupit larg nga ushqimi për një farë kohe është një ndër metodat natyrale që janë përdorur vazhdimisht në kurimin e shumë sëmundjeve. Nisur nga kjo mund të

<sup>185</sup> Buhariu, *saum* 22; Muslim, *sijam* 163.

<sup>186</sup> Buhariu, *rikak* 41; Muslim, *dhikr* 14, *xhenet* 63.

themi se agjërimi ka një rëndësi të posaçme për sa i përket mjekësisë parandaluese dhe vënia e stomakut në pushim për të paktën gjatë një muaji në vit, është një rrugë e rëndësishëm edhe për shumë të sëmurë që u mjaftojnë fuqitë për të agjëruar.

Një e vërtetë tjetër është edhe se me fillimin e muajit të Ramazanit ka një rënie të ndjeshme edhe në shumë vese, si për shembull pirja e duhanit, që shkaktojnë sëmundje nga më të ndryshmet, me në krye ngurtësimin e enëve të gjakut. Madje, disa të varur e konsiderojnë si një shkak mjaft të mirë muajin e Ramazanit dhe e lënë pirjen e duhanit tërësej. Pra, përpos dobive të drejtpërdrejta, për agjërimin mund të thuhet se ai sjell edhe një sërë dobish të tërthorta si kjo.

Nga një anë tjetër, një e vërtetë e pranuar dhe e mbrojtur fort në qarqet mjekësore është edhe se ende sa pa ardhur në jetë, ende që në barkun e nënës, organet dhe sistemet e trupit tonë dhe veçanërisht sistemi tretës, herë-herë kanë nevojë për pushim. Kësisoj, agjërimi, i cili bart edhe kuptimin e vënies së trupit në pushim gjatë një muaji të vitit, është mjaft i dobishëm për trupin e njeriut edhe në këtë aspekt.

Çdo makineri që punon, pas një farë kohe, ka nevojë për pushim dhe mirëmbajtje. Nëse kjo nuk bëhet, atëherë asaj makinerie ose i shkurtohet jetëgjatësia, ose prishet. Nxënësve, pas një periudhe mësimi, u jepen pushime. Një punëtor, i cili punon nga mëngjesi gjer në mbrëmje, në darkë kthehet në shtëpi që të pushojë. Ai nuk mund të punojë dot me të njëjtin ritëm dhe të njëjtën cilësi, nëse nuk kalon përmes një periudhe pushimi. Edhe trupin e njeriut, ne mund ta mendojmë si një fabrikë dhe organet, që janë pajisjet e kësaj fabrike. Kështu, agjërimi është një mundësi që fabrika e trupit tonë të pushojë, të mos vjetërohet dhe të mund të punojë vazhdimisht në mënyrë të përsosur.

Në saje të agjërimit njeriu shpëton edhe nga tepritë dhe lëndët e rrezikshme që janë mbledhur në trupin e tij. Për rrjedhojë, ai e ndien veten më të qetësuar në shpirt. Tek e fundit njeriu i sotëm nuk po lë derë pa shkuar të ankohet e të kërkojë ndihmë për të shpëtuar nga

kilogramët e tepërt. Në qarqet mjekësore kjo është një e vërtetë e pranuar, që kilogramët e tepërt janë të dëmshme për shumë organe dhe sisteme në trupin tonë, veçanërisht për ndikimin që kanë në qarkullimin e gjakut dhe në një organ tejet të rëndësishëm, siç është truri. Dhe ja pra, agjërimi nuk është vetëm një mjet i mirë për të fituar shpërblime dhe në krye të tyre, arrijten e kënaqësisë së Allahut, por edhe zgjidhje për shumë shqetësime fizike të njeriut.

### **10. Të mëson me ekonominë**

Si Kurani Fisnik, ashtu edhe hadithet e bekuara, na nxisin ne që të bëjmë ekonomi dhe na e ndalojnë që të bëjmë shpenzime të pavetëdijshme pa e menduar përfundimin. Në Kuranin Fisnik thuhet këto fjalë:

*“Mos u bëj as nga ata kopracët që e lidhin dorën pas qafës, e as nga ata që nuk dinë të përmbahen, në mënyrë që të mos jesh i turpëruar nga të gjithë dhe të mos biesh në gjendjen që të ndiesh mall për gjërat e humbura.”<sup>187</sup>*

Me fjalët e Kuranit, ata që tregohen kopracë dhe nuk ndajnë me të tjerët nga ajo që u ka falur Allahu, janë si t'u kishin vënë kyçin duarve dhe t'i kishin lidhur ato pas qafës. Përkundër këtyre, ata që e shpërdorojnë çdo gjë dhe shpenzimet i bëjnë duke iu përshtatur dëshirave dhe epsheve të tyre, në mënyrë krejt të pavetëdijshme, në fund bien në një gjendje pendese, e cila nuk përbën më kurrfarë dobie. Kurani, asnjërin syresh nuk e sheh me sy të mirë dhe duke theksuar se, as shpërdorimi, as kopracia nuk do të sjellin kurrfarë dobie, i këshillon besimtarët që të ndjekin rrugën e mesme (ekonominë):

*“Ata, që kur harxhojnë, as nuk shpërdorojnë, as nuk tregohen kopracë. Ndjekin një rrugë të mesme midis të dyjave.”<sup>188</sup>*

*“Ai i ka krijuar kopshtet dhe bahçet me streha dhe pa streha, hurmat*

<sup>187</sup> Isra, 17/29.

<sup>188</sup> Furkan, 25/67.

*dhe të mbjellat lloje lloje, ullinjtë që ngjajnë dhe ullinjtë që nuk ngjajnë me njëri-tjetrin, shegët (frutat e shumëllojshme). Hani nga prodhimi, kur japin të mbjellat. Dhe kur të mblidhen, jepni atë që është e drejtë prej tyre. Mos shpërdoroni, sepse Allahu nuk i do shpërdoruesit.”<sup>189</sup>*

Ndërsa ata që nuk e kryejnë falënderimin për mirësitë që u janë falur, Allahu i paralajmëron me këto fjalë:

*“Allahu dha si shembull një rrethinë: ishin të qetë dhe të sigurt. U vinte furnizim i bollshëm nga të gjitha anët. Mirëpo ata u treguan mosmirënjohës me mirësitë e Allahut dhe për këtë, Allahu i bëri ata të shijonin vuajtjen e urisë dhe frikës.”<sup>190</sup>*

Veç këtyre ka edhe shumë ajete të tjera, të cilat i shtyjnë besimtarët të priren nga ekonomia.

Edhe i Dërguari Fisnik (sal’allahu alejhi ues’sel’lem) i ka këshilluar besimtarët që të sillen me sa më shumë ekonomi, në adhurimet e tyre, në sjellje dhe në qëndrime, në shpenzimet materiale, në të ngrënë dhe në të pirë, pra, me pak fjalë, në të gjitha fushat e jetës dhe ta bëjnë ekonominë parim të jetës së tyre:

*“Ai që vepron me ekonomi (individit dhe shoqëria), nuk bëhet kurrë i varfër.”<sup>191</sup>*

*“Allahu e pasuron atë që bën ekonomi. Kurse atë që hedh e shpërdoron më kot, e varfëron.”<sup>192</sup>*

*“Rruga e mirë, sjellja e mirë dhe ekonomia janë një pjesë nga njëzet e pesë rrugët e profetësisë.”<sup>193</sup>*

Shikoni se si adhurimi i agjërimit në Islam është si një mësues që të mëson parimin e ekonomisë. Njeriu që është mësuar të bëjë ç’të dojë, me t’i ardhur në mendje dhe pa pasur kurrfarë kufizimi në vete, kur agjëron,

<sup>189</sup> En’am, 6/141.

<sup>190</sup> Nahl, 16/112.

<sup>191</sup> Ahmed bin Hanbel, *el-Musned* 1/447; Ibni Ebi Shejbe, *el-Musannef* 5/331.

<sup>192</sup> El-Bezzar, *el-Musned* 3/161.

<sup>193</sup> Ebu Daud, *edeb* 2; Ahmed bin Hanbel, *el-Musned* 1/296.

është i detyruar e nuk mund ta bëjë këtë. Për shembull, kush ha sa herë që t'i dojë zemra, që u bindet të gjitha dëshirave fizike të trupit të vet, kur agjëron, i duhet të presë mbrëmjen, kështu që bashkë me pritjen do të mësojë edhe ekonominë dhe do të largohet nga jetesa e papërgjegjshme.

### **11. Përfton meritën për mirësi të përjetshme**

Arritjet materiale dhe shpirtërore janë të lidhura me përballimin e disa kufizimeve, si materiale, ashtu edhe shpirtërore. Njeriu që nuk ka asnjë mungesë, asnjë kufizim, përgjatë gjithë jetës, edhe pse mund të duket sikur ka disa arritje të caktuara, është në humbje për sa i përket amshimit. Për një njeri është e pamundur që të arrijë diku në emër të Islamit pa kaluar ca vuajtje dhe vështirësi. Po të shikojmë jetën e profetëve, do të vërejmë se kjo ka qenë gjithmonë e këtillë. Si ata vetë, edhe sahabët e tyre, që të mund të jetonin fenë e tyre u është dashur të përballen me shumë mungesa e kufizime dhe të durojnë sa e sa mundime dhe tortura nga ana e njerëzve të tjerë. Nuk do të ishte e pavend nëse do të thuhej se përballja me një varg mungesash dhe kufizimesh e një besimtar i që do të jetojë fenë e vet është një ligj hyjnor.

Me kufizimin nga disa mirësi në këtë botë njeriu përgatit mirësitë e përjetshme të amshimit. Ndërsa njeriu që mendon vetëm si të shijojë çdo gjë të kësaj bote, shumë herë edhe duke mos bërë asnjë ndarje e lejuar-e ndaluar, ai do t'i shkatërrojë, si jetën në këtë botë, ashtu edhe jetën e përtejme. Sepse është e pamundur edhe ta mendosh, që njeriu i mësuar të hajë e të pijë lirshëm e në mesin e rehatisë të tregohet i kujdesshëm e të ndajë të lejuarën nga ajo çfarë nuk është e lejuar. Kjo është e shprehur edhe në Kuranin Famëlartë:

*“Mohuesit duan t'i jetojnë në (këtë) botë të gjitha kënaqësitë, hanë dhe pijnë si kafshët.”*<sup>194</sup>

Kësisoj, duke përdorur vullnetin e tyre siç duhet dhe duke qëndruar të etur e të uritur besimtarët do të fitojnë virtyte dhe në saje të këtyre virtyteve, jo që nuk do ta zgjasin dorën nga e ndaluara, por do ta pengojnë veten që t'u afrohen qoftë edhe disa gjërave që nuk janë, as

<sup>194</sup> Muhammed, 47/12.



të lejuara, as të ndaluara. Në këtë mënyrë do të mëkëmbin, si jetën e kësaj bote, ashtu edhe jetën e amshuar duke fituar meritë për mirësitë e përjetshme që do të falë Allahu i Madhërishëm.

Çdo gjendje që mund të fitojë njeriu është e varur nga disa gjendje dhe cilësi të caktuara. Ta zëmë dikush që ftohet në një gosti në një pallat mbretëror, para se të shkojë atje ai do të kujdeset që të mësojë rregullat dhe zakonet e mirësjelljes në atë pallat. Po ashtu edhe njeriu, nëse mendon të shkojë pranë Allahut, të fitojë meritën për të pasur ndërmjetësimin e të Dërguarit Fisnik (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem), apo që të hyjë në Xhenet, ai duhet që më parë t'i fitojë njëherë vetë këto gjendje dhe cilësi. Dhe adhurimet, me në krye agjërimin në këtë rast, e përgatitin njeriun duke e bërë të denjë për këto mirësi dhe për t'u ngjitur nëpër këto lartësi.

## ***12. Të mëson besnikërinë ndaj amanetit***

Një ndër cilësitë që duhet të bartë medoemos një besimtar është edhe besnikëria ndaj amanetit. Edhe Kurani Fisnik, me ajetin: “*Besimtarët tregojnë kujdes të veçantë për amanetin dhe premtimin që bëjnë.*”<sup>195</sup> – e ka renditur besnikërinë ndaj amanetit si një ndër shenjat e të qenit besimtar. Kjo do të thotë se njerëzit që nuk e kanë këtë cilësi, bartin në vete një prej veçorive të hipokrizisë. Edhe Profeti ynë i Nderuar (paqja qoftë mbi Të) e ka shpjeguar me këto fjalë rëndësinë e kësaj çështjeje:

*“Tri janë cilësitë e hipokritit: kur flet, gënjen; kur jep fjalën, nuk e mban atë; kur i lihet amanet diçka, ai e tradhton amanetin.”*<sup>196</sup>

Në mënyrë të fshehtë, por edhe të hapur, edhe agjërimi përherë u mëson njerëzve besnikërinë ndaj amanetit. Sepse askush tjetër, përveç Allahut, nuk mund të shohë e vëzhgojë nëse dikush është kufizuar ose jo nga ngrënia dhe pirja e gjërave të lejuara nga Allahu. Duke e braktisur ngrënien dhe pirjen nga mëngjesi gjer në mbrëmje besimtari

<sup>195</sup> Mu'mininun, 23/8.

<sup>196</sup> Buhariu, iman 24, shehadat 28, uesaja 8, libas69; Muslim, iman 107-110.

respekton kufijtë e vendosur nga ana e Allahut. Megjithëse janë të gjitha mundësitë dhe nuk ka asnjë njeri që ta shohë, besimtari e vijon agjërimin e vet. Kështu, nga mëngjesi gjer në mbrëmje, ai jeton me ndjenjën e ruajtjes së amanetit. Ky qëndrim i mbajtur kundrejt agjërimit reflekton në të gjithë jetën e myslimanit në tërësi. Rrjedhimisht, një besimtar që agjëron do të jetë tejmasë i kujdesshëm në ruajtjen e çdo amaneti që i lihet, përgjatë gjithë jetës.

### ***13. Të mëson besnikërinë dhe mirënjohjen***

Me ndjenjën e mirënjohjes individi bëhet i denjë për të qenë i besueshëm dhe kjo e lartëson. Foleja familjare ka vijimësi nëse është e ngritur mbi ndjenjën e besnikërisë dhe mirënjohjes dhe kjo e mban të gjallë. Kombet, në saje të kësaj ndjenje të lartë bëhen të virtytshme. Shteti e ruan dinjitetin kundrejt popullit të vet vetëmse përmes kësaj ndjenje. Në një vend që e ka humbur ndjenjën e mirënjohjes nuk mund të bëhet fjalë as për individë të pjekur, as për fole familjare që premtojnë siguri dhe pa këto as për shtet të pavarur dhe të besueshëm. Në një vend të këtillë individët janë plot dyshim karshi njëri-tjetrit, familja brenda saj jo e qetë, shteti kundrejt njerëzve një fatkeqësi më e madhe se çdo fatkeqësi tjetër dhe çdo gjë është e tëhuajëzuar ndaj njëra-tjetrës.

Mirënjohja bën që individët të shkojnë më së miri me njëri-tjetrin dhe të përbashkohen në një organizëm të vetëm. Falë mirënjohjes pjesët bëhen një e tërë; pjesë të ndryshme dhe të ndara nga njëra-tjetra bëhen bashkë dhe shkrihen në njëjësi. Kur ndjenja e mirënjohjes shkrihet në pafundësi, rrezet e dritës që vijnë nga përtej ndriçojnë rrugën e masave dhe çel çdo bllokim që i ka zënë shoqërisë rrugën. Mjaft që ajo shoqëri të ketë arritur pjekurinë me ndjenjën e mirënjohjes dhe ta ketë lënë veten të sigurt në krahët mbajtës dhe përbashkues të saj.

Ky është edhe një tregues i rëndësisë së posaçme që ka ajo, përderisa Kurani e përthekson duke thënë: *“Mbajeni fjalën e dhënë. Sepse fjala e dhënë kërkon përgjegjshmëri.”*<sup>197</sup> – dhe i paralajmëron njerëzit që ata të

<sup>197</sup> Isra, 17/34.

jenë mirënjohës.

Kësisoj agjërimi është ndoshta adhurimi më i mirë ku shfaqet ndjenja e mirënjohjes. Sepse ai është një besëlidhje mes Allahut dhe robit të Tij. Në prerje të caktuara të kohës, robi do të heqë dorë nga gjëra të caktuara, prandaj duke vepruar në këtë mënyrë ai do të kryejë një akt besnikërie dhe mirënjohjeje karshi Zotit. Njëkohësisht, me agjërimet e mbajtura ai do ta zhvillojë edhe më tej ndjenjën e besnikërisë dhe mirënjohjes dhe sakaq mirënjohja do të bëhet një pjesë e pandarë e tij. Dhe ai që e kthen në gjendjen e vet këtë qëndrim, si në jetën individuale, ashtu edhe në atë shoqërore dhe familjare, do të shndërrohet në një statujë të mirënjohjes.

Muaji i Ramazanit, çdo njeri që di të përfitojë prej tij e shndërron, sipas nivelit të gjithsecilit, në një hero të mirënjohjes dhe besnikërisë. Besimtari që agjëron dhe përpiqet të kuptojë gjithë fshehtësitë e tij, nuk qëndron dot pa ngarendur pas mirënjohjes dhe besnikërisë, si në prirjen e tij kah Allahu, ashtu edhe në marrëdhëniet me njerëzit. Ai nuk do të mjaftohet vetëm qenien një njeri që kryen disa adhurime në disa kohë të caktuara, por do të ecë drejt horizontit të robërisë dhe të gjithë ditën do ta vlerësojë me vetëdijen e robërisë dhe çdo çast do ta përjetojë sikur një çast të adhurimit të Krijuesit. Me të braktisur prirjet e tij të kësibotshme dhe dëshirat e trupit, përpara syve i shfaqet synimi i kthimit në një hero të së vërtetës dhe të vetëkushtimit ndaj Allahut të Madhërishëm (xhel'le xhelaluhu). Për të arritur te ky synim, e thënë me fjalët e Bediuzamanit të nderuar,<sup>198</sup> do të bëjë çdo përpjekje që të qëndrojë veç brenda rrethit të “të menduarit për Allahun, të folurit për Allahun, të dashurit vetëm të Allahut, ‘*li'l'lah, liuexh'hi'l'lah, liexhlil'lah*” dhe për të qenë përherë i prirur vetëm kah Allahu që është më i Drejti; i afrohet çdo ditë e më shumë suksesit në arritjen e synimit me çdo përpjekje që bën. Sakaq ai shndërrohet në një njeri të mirënjohjes dhe besnikërisë. Zaten edhe vetë agjërimi është shenja më e bukur e ndjenjës së mirënjohjes. Në kohë të caktuara, robi braktis disa gjëra të caktuara dhe me këtë tregon që ai është besnik ndaj premtimit të bërë;

<sup>198</sup> Shih: Bediuzaman Said Nursi, *Shkrepetimat*, fq. 21 (Shkrepetima e tretë, Pika e tretë).

dhe Allahu i Madhërishëm premtion se do të jetë vetë Ai që do ta japë shpërblimin e kësaj.

Njeriu që tregohet besnik ndaj Allahut, edhe në jetën e tij personale dhe shoqërore lartësohet në nivelin e “shëmbëlltyrës së besnikërisë dhe mirënjohjes”. Me këtë ndjenjë ai tregohet më i kujdesshëm në marrëdhëniet familjare; i zgjat çdokujt dorën e ndihmesës, aq sa hyn në një gjendje, në të cilën nuk ka më të ngopur nga ndarja në rrugën e Allahut prej asaj që është e tij.

#### **14. Të mëson të mos kesh pritmëri**

Ndjenja e mospritmërisë tek individët, prej të cilëve është e përbërë shoqëria, është një ndër dinamikat që e mbajnë në këmbë shoqërinë. Në një hadith të bekuar thuhet: *“Allahu e pasuron atë që sillet me mospritmëri.”*<sup>199</sup>— dhe në të na është treguar se cili është fryti i mospritmërisë, duke i nxitur besimtarët që ta synojnë një cilësi kaq të mirë.

Në një masë shumë të madhe një ndër shkaqet që njerëzit e vënë veten në pozita poshtëruese, aq sa të bien në marrëdhënien e robërisë dhe skllavërisë ndaj njerëzve, është fakti që vënë në plan të parë interesat materialë dhe u nënshtrohen dëshirave që nuk kanë të reshtur të egos së tyre. Duke agjëruar njeriu ngrë një mur të lartë përballë ngacmimeve dhe vesveseve djallëzore që dëshiron t’i pëshpërisë egoja e tij, i merr frerët në duart e veta dhe përpiqet t’ia japë vetë drejtimin e duhur. Sepse, kur është me agjërim, njeriu është i mbyllur ndaj të ngrënit dhe të pirit dhe ndaj shumë dëshirave trupore dhe ndjenjave të tjera të kësibotshme. Kësodore ai lirohet nga trysnia e kësaj bote dhe nis të zotërojë një mënyrë jetese kryelartë duke fituar pjesën që i takon nga kjo cilësi, për të cilën Allahu ka thënë se u takon besimtarëve. Ja se si thotë Zoti:

*“Kryelartësia u përket Allahut, të Dërguarit të Tij dhe besimtarëve.”*<sup>200</sup>

#### **15. Të përfton sekretin që Allahu nuk ka nevojë për asgjë dhe**

<sup>199</sup> Buhariu, *zekat* 50; Muslim, *zekat* 124.

<sup>200</sup> Munafikun, 63/8.

## ***çdo gjë ka nevojë për Allahun***

Që Allahu nuk ka nevojë për asgjë dhe çdo gjë ka nevojë për Allahun (*Samed*) është një ndër cilësitë e patëmeta të Allahut të Lartësuar. Sureja “Ihlas” e shpjegon më së bukuri këtë të vërtetë:

*“Thuaj: Allahu është Një. Ai është Allahu (Samed), që çdo gjë ka nevojë për Të dhe Ai nuk ka nevojë për asgjë.”*<sup>201</sup>

Ai është Një, i Vetëm; *Hasha!* Ai nuk është një krijesë e përbërë nga atome apo thërrmija të bashkuara, të cilat mund të copëzohen apo reduktohen. E thënë me fjalë të tjera, Ai nuk është një element dhe as një produkt. Ai është një Qenie e Panjohur që na e bën Vetën të njohur nëpërmjet ndodhive dhe , të Cilën ne jemi të mangët ta përkapim. Poende Ai është Një dhe i Vetëm që mbështetet te Njëshi, atje ku mbaron çdo ndarje dhe ku merr fund çdo lloj forme komponimi apo zbërthimi. Ai është Një i atillë që ndjenja e mbajtjes fort pas jetës e secilit e ka burimin drejtpërsëdrejti nga drita e shenjtë e Tij dhe secilit i jepet po prej Tij sipas vlerës së vet. Në këtë këndvështrim Allahu është që nuk ka nevojë për asgjë dhe çdo gjë ka nevojë për Të. Çdo gjë, në çdo aspekt të saj, ngarend drejt Allahut, me Të e plotëson çdo mangësi të vetën, çdo gjë e të gjithë kanë nevojë për Të, por Ai nuk ka nevojë për asgjë e askënd. Ja, këto janë domethënie të emrit *Samed* të Tij, që nuk ka nevojë për asgjë dhe çdo gjë ka nevojë për Të. Ai ua plotëson të gjithëve çdo nevojë dhe asgjë nuk shteret në thesaret e Tij. Në kuptimin absolut Ai është mospritës ndaj gjithçkaje. Sepse Ai është *Samed*.

*“Thuaj: Sikur të gjitha detet të bëhen bojë për të shkruar fjalët e Zotit tim, madje sikur t’ju sjellim edhe njëherë sa aq, do të shtereshin ato dete dhe fjalët e Zotit tim nuk do të mbaronin.”*<sup>202</sup>

Sikur detet të bëhen bojë dhe të shkruajnë, duke nisur që nga krijimi e deri te furnizimi i gjithçkaje me ushqimin dhe të mirat e nevojshme, mbaron gjithçka, e prapëseprapë fjalët e Allahut nuk mbarojnë. Sepse, çdo ditë, Ai është në një gjendje të veçantë. Nuk ka mbarim dhe reshtje

<sup>201</sup> Ihlas, 112/1-2.

<sup>202</sup> Kehf, 18/109.

në asgjë të Tij. “Ai është çdo ditë në një zotërim të veçantë.”<sup>203</sup>

Allahu (xhel’le xhelaluhu) nuk ha, nuk pi dhe mbi të nuk kalon kohë; as që mund të bëhet fjalë për gjini mashkullore dhe femërore për Të. Ai është i shenjtë dhe absolutisht larg dhe i pastër prej çdo gjëje të këtillë. Edhe robi, kur agjëron, nuk ha, nuk pi dhe shumë herë i harron fare dëshirat dhe kërkesat e tij njerëzore. Edhe pse ka çdo gjë dhe mund të bëjë shumë gjëra, ai i shtyn me të pasmen e dorës tërësej dhe mban një qëndrim të epërm mospritmërie. Kësisoj krijohet një farë rezonimi me botën e mëshirës dhe si një marrës sinjali nëpërmjet frekuencave ai përfiton nga flladet e ëmbla që fryjnë prej asaj bote dhe ato pushtojnë zemrën e tij.

Po, Allahu është *Samed* (Nuk ka nevojë për asgjë dhe çdo gjë ka nevojë për Të). Dhe këtë nuk mund ta kuptojnë veçse ata që janë të denjë për t’u sjellë si të tillë. Siç e shprehëm edhe më sipër duke përmendur hadithin kuds: “*Agjërimi është për Mua (më përket Mua); dhe jam Unë që do ta jap shpërblimin për të.*” – Allahu, shpërblyerjen e një akti si agjërimi e sheh si të lidhur fort në një raport të drejtpërdrejtë me qenien e Tij i Lartësuar dhe edhe në këtë pikë ndihet fortë reflektimi i të qenit të Tij *Samed*, që gjithçka e gjithkush ka nevojë për Të dhe Ai nuk ka nevojë për asgjë e për askënd.

## **16. Të mëson me disiplinën**

Disiplinë do të thotë urdhëresa dhe ndalesa që duhen ndjekur me përpikëripër sigurimin e rendit dhe bart kuptimin e një edukate dhe “shpirti të rendit” mendor, shpirtëror dhe në moral, që janë të nevojshme që të mund të bëhesh njeri i ekuilibruar. Kurse njeri i disiplinës është ai njeri që jeton në qerthullin e disa ligjeve dhe principeve të caktuara dhe që sillet me një kujdes e përpikëri shumë të madhe për të jetuar me rregulla e sipas një rendi të caktuar.

Në të vërtetë, në çdo kohë, jeta e besimtarit duhet të jetë në një

<sup>203</sup> Rahman, 55/29.

harmoni të plotë. Ai duhet ta dijë që më parë se çfarë duhet të bëjë, me çfarë punësh duhet të merret dhe kjo duhet të jetë sjellja e përhershme e tij. Ai duhet të jetojë duke e ditur dhe përcaktuar që më parë se çfarë duhet bërë, përherë të veprojë sipas një plani të caktuar dhe kurrsesi nuk duhet të ketë mendime të llojit, “*vallë ç’të bëj tani?*” – Ai duhet ta ndajë dhe ta caktojë që më parë çdo gjë, si në përmbushjen e detyrimeve të robërisë së tij ndaj Allahut të Madhërishëm, ashtu edhe të përgjegjësive të tij karshi njerëzve të tjerë, por edhe punët e tij përherë duhet t’i realizojë sipas një discipline të përvijuar më së miri; me çdo gjendje të tijën ai duhet të shpërfaqë një shembull të rendit dhe rregullit. Veçanërisht adhurimet janë gurë themeli tejet të rëndësishëm për sa i përket ndarjes së punës dhe kohëve të tyre dhe në më të shumtën e kohës, njeriu që beson i sistemon punët e tij sipas këtij kalendari të adhurimeve. Duke thënë, “*pas namazit të drekës*”, “*para namazit të akshamit*”, ai merr në konsideratë adhurimet dhe e ndan ditën në disa prerje të kohës dhe rreket që të mos e kalojë më kot asnjë çast të saj.

Ata që e dinë vlerën e kohës dhe që e vlerësojnë jetën si një mirësi shumë të rëndësishme, e cila duhet vlerësuar siç duhet, e vënë në disiplinë çdo gjë, duke nisur që nga të ngrënët dhe të pirët, e deri te rënia dhe ngritja nga shtrati; asgjë të tyren, ata nuk e lënë në rrëmujë dhe kaosin e paqartësisë. Ata e dinë, që koha kur kanë produktivitetin më të lartë, si njerëzit, ashtu edhe institucionet, është koha kur ato janë më të rregullta dhe me rend.

Kështu, edhe muaji i Ramazanit dhe agjërimi, të mësojnë se si ta disiplinosh jetën, duke të ndihmuar që të përcaktosh një qëndrim të caktuar karshi gjërave që dëshiron egoja, si të ngrënët, të pirët dhe të fjeturit, duke i kryer të gjitha këto aq sa është nevoja e trupit dhe me një ndjenjë të fortë mirënjohjeje dhe falënderimi. Duke u mbështetur te atmosfera e zemrës dhe shpirtit karshi kërkesave të egos, ai të jep një mësim për qëndrimin e përhershëm në drejtpeshim nëpërmjet vënies në veprim të ndërgjegjes dhe forcimit të vullnetit.

Muaji i bekuar i Ramazanit bën të mundur kufizimin dhe mbajtjen në kontroll të dëshirës për të ngrënë dhe për të pirë, e cila është një

nga damarët më të dobët të njeriut. Sikur të mëson një disiplinë të veçantë të ushqyerjes. Po, njeriu ka nevojë absolute që të hajë e të pijë, në mënyrë që të mund të vazhdojë jeta. Por çdo gjë e ngrënë dhe e pirë pa kurrfarë kriteri, pa njohur kohë dhe vend dhe pa u pasur parasysh principet e domosdoshme të shëndetit të trupit do të jetë e dëmshme për shëndetin; do të kthehet në një fatkeqësi të stomakut, i cili do të shtrëngojë zembrën dhe do ta marrë njeriun nga shkallët e larta të zembrës dhe shpirtit dhe do ta zbresë në gropat e trupores dhe kafshërores. Dhe kjo është një fatkeqësi jo vetëm për atë vetë, por edhe bie kryekëput ndesh me kënaqësinë e Allahut.

Agjërimi i mbajtur gjatë këtij muaji të bekuar e bën njeriun ta vërë trupin të bëjë ushtrime të rëndësishme, si përcaktimi i kohëve të ngrënies, shmangia nga mbushja e stomakut plot, qëndrimi larg nga të gjitha gjërat që i bëjnë dëm shëndetit të trupit dhe shpirtit dhe njëkohësisht, që ai të qëndrojë brenda rrethit të së lejuarës dhe të mos i zgjasë duart kah e ndaluara. Njerëzit që arrijnë të bëhen njësh me muajin e Ramazanit fitojnë një disiplinë shpirtërore në të gjitha këto aspekte.

Një tjetër shenjë e rëndësishme e raportit me Allahun e Drejtë është edhe leximi i Kuranit, lutjet dhe përgjërimi Allahut dhe qëndrimi pa pra i drejtuar vetëm drejt Tij. Sa keq që për shumë njerëz nxjerrja dhe dhënia fund i burgosjes së Kuranëve Fisnikë nga sëndukët me varak dhe këllëfët e mëndafshit, për ta bërë atë ëmbëlsi dhe sherbet të gjuhës dhe zembrës, bëhet e mundur vetëm gjatë muajit të bekuar të Ramazanit. Ky muaj i bekuar u jep qiellzave një shije të Kuranit dhe u mëson njerëzve disiplinën e përmendjes së vazhdueshme të Allahut.

Ja pra, për një muaj me radhë, njerëzit që sillen në bazë të disa ligjeve dhe rregullave të caktuara në lidhje me të ngrënë dhe të pirët, të fjeturit, adhurimit dhe përmendjes së Allahut, që në një farë kuptimi arrin shpirtin e disiplinës dhe përpiqen ta jetojnë jetën me rend dhe rregull, duhet të bëjnë çmos që të njëjtin rend dhe disiplinë ta ruajnë edhe pas muajit të Ramazanit. Për shembull, besimtarët që përgjatë një muaji të plotë, çohen çdo natë, ndërpresin gjumin që të përfitojnë



nga begatia e syfyrit dhe takohen edhe njëherë me Allahun nëpërmjet sixhades, duhet ta konsiderojnë këtë tridhjetëditësh si një periudhë ushtrimi dhe çdo natë të mëtejshme të vitit ta dinë një vend të ritakimit me Allahun dhe më së paku, netët t'i kalojnë duke i ndriçuar me disa rekate namaz të tehexhudit.

Po, njeriu i disiplinës e përcakton që më herët se si duhet të jetojë dhe se si duhet të veprojë dhe ku; përcakton një kurs udhëtimi duke u bazuar në disa kritere të caktuara dhe çdo hap që hedh e hedh me vetëdije të plotë. Ngjyrat, motivet dhe dekorin e sjelljeve dhe veprimeve tona i ka përcaktuar fillimisht feja. Për shembull, besimi tek Allahu dhe i Dërguari i Tij janë një kriter shumë i rëndësishëm për ne. Ky kriter është një udhërrëfyes i qenësishëm, që na përcakton edhe drejtimin e hapave tanë të mëtejshëm. Ne jemi të ngarkuar me misionin që t'ua tregojmë edhe të tjerëve Zotin që besojmë dhe të Dërguarin e Tij Fisnik, që e kemi udhërrëfyes të jetës. Rrjedhimisht, ne përpiqemi të hyjmë në zemrat e njerëzve dhe bëjmë çdo përpjekje që ta përfaqësojmë atë më së miri, në mënyrë që ata të njihen me të gjitha bukuritë e Islamit. Nisur nga ky qëllim, ne qëndrojmë në mesin e njerëzve me sjelljet dhe qëndrimet tona, të cilat janë të formësuara nga burimet e fesë sonë; ua bëjmë edhe atyre të ditura këto vlera. Për t'ua treguar të gjithëve të vërtetave që ne u jemi përkushtuar – me kushtin që të mos përfshihemi kurrë në asnjë çështje që është e ndaluar kategorikisht në fenë tonë – i përdorim të gjitha mjetet e lejuara dhe bëjmë çdo përpjekje për t'i kapërcyer të gjitha pengesat mes njerëzve dhe të vërtetave të besimit. Megjithatë ka edhe një ndryshim, i cili meriton vëmendje; ka një dallim mes sjelljes me rregullore dhe të qenit njeri i disiplinës: ne duhet të tregojmë një kujdes të jashtëzakonshëm që të kemi parasysh tërë kushtet e kohës në të cilën jetojmë, të kemi parasysh të vërtetat e mjedisit kulturor ku jetojmë dhe përherë t'u drejtohem njerëzve me një gjuhë dhe metodologji që do të jetë më se e kuptueshme për ta.

Nëse ne ia kemi kushtuar jetën arritjes së kënaqësisë së Allahut dhe arritjen e kësaj kënaqësie shpjegimit njerëzvetë Allahut të Madhërishëm, atëherë kudo që të jemi, cilatdoqofshin kushtet dhe konditat në të cilat

jetojmë, as që mund të bëhet fjalë që ne të qëndrojmë, të tregohemi të dobët, apo t'u shmangemi përgjegjësive tona. Duhet të ruajmë një gjuhë dhe metodologji të caktuar sipas çdo stine dhe çdo periudhe dhe të mos mbetemi për as edhe një grimëçast pas në përfaqësimin e të vërtetave më të përzemërta.

Pa dyshim, vështirë të arrihen, një lartësi e zemrës si kjo dhe një shpirt disipline kaq i rrallë, nëse nuk do të ketë një ndihmesë të veçantë. Arritja drejt këtij horizonti kërkon kohë të gjatë dhe ushtrime serioze. Mjaft të kuptojmë që muaji i Ramazanit është një fillim dhe një stinë tejte e rëndësishme e korrijes së begatisë së arritjes së këtyre cilësive.

Vërtet, për njerëzit që besojnë, gjithë jeta e njeriut është një Ramazan, adoleshenca kohë e agimit dhe vdekja kohë e iftarit. Një muaj i Ramazanit është si një ushtrim i agjërimit të një robërie që zgjat një jetë të tërë. Ata që arrijnë t'i fitojnë këto cilësi të rralla në vetëm tridhjetë ditë, por arrijnë t'i kenë ato të vijueshme përgjatë gjithë jetës, janë ata që në këmbim të qëndrimit pa ngrënë dhe pa pirë për një farë kohe të caktuar, matanë do të dëgjojnë një zë t'u thotë: “Robërit e Mi, shumë herë ju pashë që ju kishte ikur ngjyra e fytyrës, ju ishte prishur e zbehur çehreja, ju ishin futur sytë përbrenda dhe gropat e syve ju ishin bërë edhe më të theksuar. Të gjitha këto, ju i përballuat për Mua. Kundrejt gjithë atyre që ju bëtë në ditët e shkuara për Mua, ejani sot të hani e të pini me shpirt.” – Ja, atë ditë, ata do të bëjnë iftarin e vërtetë.

## **B. Përfitimet e shoqërisë**

Shoqëria përbëhet nga individët. Që ka herë njerëzit jetojnë në shoqëri. Dhe një shoqëri mund ta vazhdojë jetën e saj në paqe dhe harmoni vetëm e vetëm kur individët kanë një strukturë individuale të shëndoshë dhe me karakter. Por edhe kjo është e mundur vetëm përmes qëndrimit lidhur fort pas kritereve të caktuara nga ana e Krijuesit. Po, Allahu jo vetëm e ka krijuar njeriun, por edhe i ka përcaktuar atij se si duhet të

sillet e si duhet të jetojë. Për këtë Ai ka shpallur një varg ligjësish, me të cilat ka dashur mirëqenien e shoqërisë që do të krijohet prej këtyre individëve.

### **1. Bën të mundur përbashkimin dhe bashkëjetesën**

Në sajë të agjërimit të Ramazanit njeriu krijon lidhje të shumëllojshme me njerëzit e tjerë, veçanërisht në jetën shoqërore. Jo vetëm kaq, por ai ndien edhe një lidhje dhe raport shumë të fuqishëm me të gjithë ata. Të gjithë besimtarët nisin agjërimin në të njëjtën kohë, kur vjen iftari, ata e presin atë në të njëjtën kohë, ngrihen në syfyr njëkohësisht, i falin teravitë të gjithë bashkë, i japin jetë natës së Kadrit dhe të gjithë bashkë nisen të hyjnë në atmosferën e Bajramit etj., çka bëhet shkas për lindjen e një dashurie dhe vëllazërie të vërtetë e të shëndoshë. Kësisoj, besimtarët, siç thuhet edhe në fjalët e ndritura të Profetit tonë të Nderuar (sal’lallahu alejhi ues’el’lem), *“Besimtarët janë si një trup i vetëm, kur mendon lidhjet e dashurisë, mëshirës dhe dhembshurisë që ekzistojnë në mes tyre. Kur ndodh të sëmuret një gjymtyrë, atëherë edhe të gjitha gjymtyrët e tjera mbeten pa gjumë dhe i zë temperatura; ja, kështu janë edhe besimtarët.”*<sup>204</sup> Me një mendim kaq të çmuar si ky në mesin e shoqërisë lind dhe ngrihet shpirti përbashkimit dhe bashkëjetesës.

Për shembull, dy njerëz të ndryshëm që presin një tren, i cili vjen nga larg, e ndiejnë veten më afër me njëri-tjetrin krahasuar me të gjithë njerëzit e tjerë. Gjatë kësaj pritjeje, mes tyre lind një afrim, një njohje reciproke. Vetëm sepse janë duke pritur të njëjtën gjë, këta dy njerëz përbashkohen dhe afrohen edhe më shumë me njëri-tjetrin. Nëse të dy janë duke pritur të njëjtin person që është duke udhëtuar me atë tren, atëherë kjo njohje mes tyre kthehet në miqësi. Sepse tanimë mes tyre është krijuar edhe një lidhje e dytë.

Po njësoj, edhe mbledhja e pjesëtarëve të një familjeje rreth së njëjtës sofër, në pritje të iftarit, apo mënyra se si të gjithë besimtarët, një e nga një, presin çastin e iftarit, do t’i afrojnë njerëzit edhe më shumë me

<sup>204</sup> Buhariu, *edeb* 27; Muslim, *birr* 66.

njëri-tjetrin. Ata do të lidhen edhe më fort pas njëri-tjetrit edhe nga gëzimi dhe lumturia që të fal kryerja e detyrave në mënyrën e duhur.

Pritja e kohës së çeljes së iftarit është shumë e rëndësishme edhe në shtimin edhe më të dashurisë mes pjesëtarëve të familjes, si edhe për sa i përket ngritjes së familjes mbi themele edhe më të forta e të shëndetshme. Kjo situatë do të ndihmojë edhe në forcimin e lidhjeve të dashurisë dhe vëllazërisë mes të njohurish dhe të panjohurish, të cilët bëhen bashkë si të ftuar nëpër gosti të ndryshme me rastin e muajit të Ramazanit.

## ***2. Të kujton gjendjen e të varfrit***

Muaji i Ramazanit ka një aspekt të vëllazërisë dhe miqësisë. Nëpërmjet agjërimit njeriu mendon edhe për gjendjen e të varfërve që nuk kanë mundësi të gjejnë diçka për të ngrënë; e kupton më mirë gjendjen e tyre, kur është i uritur. Kjo gjendje bën që brenda tij të gëlojnë ndjenjat e bujarisë. Sajë këtij gëlimi ai përpiqet të bëjë sa më shumë mirë, sidomos gjatë muajit të Ramazanit.

Nga pikëpamja e pasurisë njerëzit nuk janë të barabartë. Ndërkohë që dikush lind me një varg mundësish nga pikëpamja e kësaj bote, në anën tjetër, ka shumë njerëz që mund të shpenzojnë të gjithë jetën e tyre e të mos i kenë ca mundësi materiale. Në të dyja këto gjendje, njeriu vazhdon të jetë nën sprovimin e Allahut. Allahu i Madhërishëm (xhel'le xhelaluhu) nuk i ka lënë krejtësisht të pavarur të pasurit, të cilëve u ka dhënë plaçkë dhe pasuri, por u ka urdhëruar që ata të ngarendin në ndihmë të të varfërve përmes rrugëzgjdhjesh si zekati, lëmosha dhe sadakaja. Dhe që i pasuri t'i zgjasë të varfërit dorën për ta ndihmuar, apo të kujdeset për nevojtarin, kjo ndodh më së miri vetëm pasi ai ta ketë provuar njëherë në trupin e tij gjendjen e të varfërit. Agjërimi është i vetmi që mund ta bëjë të pasurin ta provojë këtë gjendje.

Duke e shtyrë që të qëndrojë i etur e i uritur në kohë të caktuara agjërimi i mëson të pasurit, i cili e jeton jetën duke shijuar ushqimet më të shijshme, e ndoshta nuk ia ka as idenë se si është uria, se si është

uria dhe etja. Një uri si kjo bëhet shkas që të pasurit, të cilët i kanë të gjitha mundësitë materiale, ta kuptojnë më mirë gjendjen e atyre njerëzve që përpëlitën mes mungesës dhe varfërisë dhe për rrjedhojë edhe që ata të ndryshojnë qëndrim dhe sjellje ndaj tyre, madje te ta të zhvillohet edhe ndjenja e ndihmesës. Kur të pasurit fillojnë të shfaqin një sjellje si kjo, edhe te të varfërit nis të zbehen dhe të zhbëhen ndjenjat e hasetit dhe urrejtjes që janë potencialisht të pranishme te të varfërit, gjersa të parandalohen ende sa pa u shfaqur përplasjet e mundshme që mund të lindin mes këtyre dy klasave. Madje i varfri do që të bëhet vetë mbrojtës i pasurisë së të pasurit. Përndryshe ndodh krejt e kundërta, nëse nuk ka ndjenja bujarie te të pasurit dhe vetëmjaftim, mospritmëri, virtyt dhe dorëzim tek Allahu te të varfërit, atëherë përplasje mes tyre është e paparandalueshme. Agjërimi është dinamika më e rëndësishme që i vë në lëvizje këto ndjenja dhe emocione. Për rrjedhojë, të pasurve u krijohet mundësia të shohin gjendjen e atyre që nuk janë të pasur si ata, duke bërë që të kujtojnë fjalët e Profetit tonë të Nderuar (sal’lallahu alejhi ues’sel’lem), i Cili thotë:

*“Nuk është (vërtet) besimtar, ai që e ngrys natën, ndërkohë që fshinji i tij është i uritur.”<sup>205</sup>*

Gjendja e të uriturit kuptohet më së miri kur je vetë i uritur dhe e të eturit, kur je vetë i etur. Mbajtja e agjërimit duke i frenuar dëshirat dhe kërkesat tona, si përgjigje ndaj urdhëresës së Allahut, si dhe mësimi ynë me dietën në këtë aspekt, do të bëjnë që ne të jemi më të mirë në jetën shoqërore dhe të bëhemi një pjesë e përsosur e një shoqërie të përkryer.

### **3. Parandalon lypjen**

Njeriu që e edukon egon e vet duke agjëruar, përballon vështirësitë dhe i rreh gjoksin urisë dhe etjes, kaplohet nga një gjendje që nuk ka krijesë a ndodhi që nuk mund t’i bëjë ballë. Tashmë atë nuk e kufizojnë dot, as uria, as etja. Çfarëdo vështirësie të ketë, sikur edhe të ngelet

<sup>205</sup> El-Hakim, *el-Mustedrek* 2/15.

i etur dhe i uritur për ditë me radhë, ai nuk e sakrifikon nderin dhe krenarinë e tij dhe t'u shtrijë të tjerëve dorën. Ndërsa ai që nuk di asgjë rreth agjërimit, që nuk ka mbajtur agjërime në periudha të caktuara të jetës dhe nuk është mësuar me qëndrimin pa ngrënë dhe pa pirë, nëse i ndodh që të kaplohet nga varfëria dhe uria, ai mund të fillojë të dalë derë më derë për të lypur, duke e marrë nëpër këmbë nderin dhe krenarinë e vet.

*PJESA E KATËRT*



**ÇËSHTJE TË NDRYSHME NË LIDHJE  
ME RAMAZANIN DHE AGJËRIMIN**





## A. Agjërimi gjatë tre muajve

**Pyetje:** *A i ka kaluar Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) vazhdimisht duke agjëruar muajt e Rexhepit dhe të Shabanit? A biem ne ndesh me sjelljen e Tij, nëse agjërojmë vazhdimisht gjatë këtyre muajve?*

**Përgjigje:** Nëna jonë e nderuar, Aishja (radijallahu anha), tregon se përveç muajit të Ramazanit, Profeti ynë (paqja qoftë mbi Të) nuk ka kaluar me agjërim të pandërprerë e të plotë asnjë muaj tjetër. Muaji i Ramazanit e ka edhe një veçanti të këtillë krahasuar me muajt e tjerë. Profeti ynë u ka mësuar njerëzve një mënyrë jetese që është e përshtatshme me natyrën e tyre dhe po ashtu ka jetuar edhe vetë. Ai nuk ka bërë asnjë sjellje që të bjerë ndesh me natyrën njerëzore, si me agjërimin që ka mbajtur, ashtu edhe me namazet që ka falur apo adhurimet e tjera. Asnjë natyrë njerëzore, që nuk është e prishur, mund të gjejë qoftë edhe diçka të vetme për t'u refuzuar në adhurimet që ka kryer Profeti ynë i Nderuar (paqja qoftë mbi Të). Po ende, ka qenë nëna jonë, Aishja e nderuar (radijallahu anha), e cila ka transmetuar:

“Profeti ynë (pqmT), ndonjëherë agjëronte aq shumë, sa që ne thoshim: ‘kësaj here nuk do të ndalojë fare.’ Dhe ndonjëherë pushonte për një kohë shumë të gjatë së agjëruari, sa që ne thoshim: ‘Me gjasë, nuk do të agjërojë më.’ Përveç muajit të Ramazanit, unë nuk e kam parë të Dërguarin e Allahut të agjërojë dnonjë muaj tjetër të plotë. Dhe në asnjë muaj tjetër nuk ka agjëruar aq sa në muajin e Shabanit.”<sup>206</sup>

Kur agjëronte vetë, gjithmonë Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) zgjidhte atë që ishte më e vështira për egon. Ndërsa, kur bëhej fjalë për të tjerët, Ai kishte parasysh edhe dobësitë e tyre dhe i këshillonte të silleshin kështu të gjithëata që do të ishin në sy të shoqërisë. Njëherë Ai ka thënë: “*Me njerëzit silluni duke pasur parasysh atë që është më i dobëti prej tyre, ecni me këmbët e më të dobtëve mes tyre.*”<sup>207</sup> Duke qenë se edhe vetë sillej po në të njëjtën mënyrë, Ai

<sup>206</sup> Buhariu, *saum* 52; Muslim, *sijam* 175.

<sup>207</sup> Ebu Daud, *salat* 40; Nesai, *ezan* 32; Ibni Maxhe, *ikametu's-salat* 48.

nuk i ka kaluar duke i agjëruar të plotë, as muajin e Rexhepit, as atë të Shabanit. Sepse, po të vepronte kështu, sahabët, të cilët e ndiqnin atë hap pas hapi edhe në lëvizjen më të vogël, do të përpiqeshin të bënin të njëjtën gjë dhe kushedi, shumë syresh nuk do t'ia dilnin dot ta përmbushnin në të njëjtën shkallë dhe me të njëjtën cilësi.

Madje, njëherë, Ai pati bërë *nijet* të mbante një agjërim të njëpasnjëshëm pa syfyr dhe pa iftar. Disa nga sahabët e mësuan këtë fakt dhe patën dashur që t'i bashkoheshin edhe ata në këtë agjërim. Edhe pse i Dërguari i Allahut (pqmT) i pati këshilluar që të mos e bënin, dëshira e flaktë për ta adhuruar Allahun i pati bërë ata që të mos ia dëgjonin këshillën. Pati kaluar një ditë, dy, tri dhe sahabët ishin prerë nga fuqia duke agjëruar pa pushim për tri ditë me radhë, e ndoshta edhe kishin filluar të ndienin pendesë, që nuk e kishin dëgjuar këshillën e Krenarisë së Njerëzimit. Kur i pa në këtë gjendje, Profeti ynë (pqmT) u tha: “*Mua më jep të ha dhe të pi Allahu, nuk e ndiej urinë.*”<sup>208</sup> – duke u bërë të ditur se Për rrjedhojë, Profeti ynë arrinte të qëndronte i palëkundur si një mal edhe përballë akteve më të rënda, që do të ishin të vështira për çdo jetë njerëzore. Ky qëndrim i Tij ishte njëkohësisht edhe një pikë mbështetjeje shumë e fuqishme për sahabët, por u tregonte atyre edhe majat se ku mund të arrinin. Në ngjarje si këto ata shikonin vullnetin madhështor të Profetit tonë (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem), por edhe një vullnet dhe vendosmëri marramendës për njerëzit.

Nëse do të kalojmë tek aspekti juridik i çështjes, agjërimi gjatë tre muajve të plotë dhe pa ndërprerje është i papëlqyeshëm (*mekruh*). Sepse i Dërguari Fisnik (pqmT) nuk e ka bërë këtë gjë. Diçka e tillë nuk haset as në urdhëresat dhe këshillat e Kuranit Fisnik, as në Sunetin e të Dërguarit të Allahut (pqmT). Pavarësisht, në mesin e njerëzve është ngulitur një zakon i mbajtjes së agjërimit gjatë muajve Rexhep, Shaban dhe Ramazan me radhë. Rezultatit e një agjërimi të mbajtur në këtë mënyrë është e vështirë ta shpjegosh me qëllimin e mbajtjes së agjërimit. Sepse, kur mbahet agjërim i pandërprerë, organizmi i

<sup>208</sup> Buhariu, *saum* 20, 48; Muslim, *sijam* 55-56.

njeriut mësohet me agjërimin. Dhe për njeriun e mësuar tanimë me agjërimin nuk ka më asnjë ndryshim mes mbajtjes dhe mosmbajtjes së agjërimin. Për të nuk mund të bëhet më fjalë për një veti si ajo e durimit të disa mungesave që do të shërbenin për edukimin e egos. Për këtë arsye njeriu nuk duhet të mësohet me agjërimin duke agjëruar vazhdimisht dhe pa ndërprerje. Ai duhet të përpiqet ta edukojë egon e vet herë duke agjëruar, herë duke pushuar së agjëruari. Zaten i këtillë ishte edhe agjërimi që u këshillonte Profeti ynë sahabëve që kryenin adhurime më së shumti dhe ia kishin kushtuar jetën adhurimit, duke u thënë që një ditë të agjëronin, një ditë jo.

## **B. Mosmarrëveshja në lidhje me vendin e lindjes së hënës**

***Pyetje:** Për shkak të shfaqjes së hënës në kohë të ndryshme dhe në vende të ndryshme në pozicione të ndryshme (ihtilafi metal), banorët e çdo vendi, do ta përcaktojnë fillimin e Ramazanit dhe bajramin sipas vëzhgimeve të tyre personale? Apo vëzhgimi i hënës në një vend do të vlejë për përcaktimin e tyre edhe në çdo vend tjetër?*

***Përgjigje:** Nisur nga lëvizja e Tokës, dita dhe nata nuk fillojnë në të njëjtën kohë nëpër vende të ndryshme të botës, por shfaq ndryshime nga njëri vend në tjetrin, ndaj edhe hëna nuk shihet në të njëjtën kohë nëpër vende të ndryshme. Sepse hëna, e cila merret për bazë për fillimin e muajve hënorë, shfaqet në horizontin e perëndimit, pikërisht pas perëndimit të diellit. Duke qenë se dielli perëndon në orë të ndryshme nëpër vende të ndryshme, edhe koha e vëzhgimit të hënës ndryshon duke përparuar drejt perëndimit. Prandaj edhe vëzhgimi i hënës nëpër kohë të ndryshme në vende të ndryshme të botës quhet si “mosmarrëveshja në lidhje me vendin e lindjes së hënës”.*

Vëzhgimi i saj në një shtet dhe çështja nëse do të konsiderohet

e vlefshme edhe për vendet e tjera, ka qenë dhe është një çështje mosmarrëveshjeje mes dijetarëve. Kjo ‘mosmarrëveshje’ nuk merret për bazë nga shumë prej juristëve Hanefi, Maliki dhe Hanbeli dhe disa juristëve Shafii, si Ebu’t-Tajib et-Taberiu. Nëse hëna vëzhgohet siç duhet në një vend, edhe nëse janë afër, edhe nëse janë larg, myslimanët duhet t’i përshtaten dhe të fillojnë agjërimin ose të festojnë bajramin.

## C. Kalendarit hënor në adhurime

***Pyetje:** Cilat janë urtësitë e marrjes për bazë të kalendarit hënor në adhurimet si agjërimi dhe haxhi?*

**Përgjigje:** Si myslimanë, për organizimin e kohëve të adhurimit ne marrim për bazë lëvizjet e hënës. Ne vëzhgojmë hënën, kur nisim agjërimin e Ramazanit, kur festojmë bajramet e Ramazanit dhe të Kurbanit, kur ngjitemi në Arafat, kur jemi në Muzdelife, kur godasim me gurë djallin... me pak fjalë në shumë prej adhurimeve tona. Diçka e këtillë, jo vetëm na është përcaktuar nga vetë Allahu i Madhërishëm, por edhe praktika e të Dërguarit Fisnik të Allahut (paqja qoftë mbi Të), ndaj ndër urtësitë e marrjes për bazë të kalendarit hënor ne mund të rendisim:

1. Krahasuar me vitin diellor, viti hënor është afërsisht njëmbëdhjetë ditë më i shkurtër. Për këtë arsye, çdo vit, adhurimet tërhiqen njëmbëdhjetë ditë pas në kohë. Kështu Allahu u ka falur njerëzve mundësinë që të mund t’i kryejnë adhurimet në çdo stinë të vitit. Ta zëmë, sikur të merrej për bazë kalendarit diellor dhe muaj i agjërimit të ishte caktuar muaji janar, agjërimi do të ishte përherë i thjeshtë, sepse do të mbahej vetëm në ditë të shkurtra dhe do të ishte i pamundur realizimi i qëllimit hyjnor të arritjes së devotshmërisë që arrihet me agjërimin në ditët e gjata dhe të nxehta të verës. Veç kësaj, edhe nga pikëpamja mjekësore, vënia e trupit në perhis vetëm në një periudhë të caktuar të vitit, duke

e privuar trupin nga mbajtja perhis edhe në periudhat e tjera të vitit. Kësodore Allahu që është i Gjithëurti Absolut ka dashur që besimtarët të agjërojnë, si në vapë, ashtu edhe në të ftohtë; si në pranverë, ashtu edhe në verë, vjeshtë dhe dimër... me pak fjalë, që ata të agjërojnë në çdo kohë dhe në kushte të ndryshme.

2. Adhurimet, si agjërimi dhe haxhi, i përftojnë një vlerë shumë të madhe prerjeve të kohës në të cilat kryhen. Sepse Allahu e bën të rrjedhë me shumicë mëshirë e Tij në këto prerje të kohës. Ja pra, në mënyrë që të përfitojnë edhe muajt, stinët dhe klimat diellore nga kjo dritë dhe begati e veçantë e muajve hënorë, Allahu e ka lidhur kohën e adhurimeve me muajt hënorë duke dashur që ata të lëvizin mes muajve diellorë. Duhet një qarkullim i këtillë i ditëve, në mënyrë që çdo ditë e vitit të përkohë me Ramazanin, kurbanin dhe natën e Kadrit.

3. Vërehet që nga kjo situatë përfitojnë edhe njerëzit e varfër. Sepse, një në tridhjetë e gjashtë vjet, ndihmesat materiale, si zekati, sadakaja dhe *fitreja* jepen me shumicë. Një njeri i varfër do të ketë jetuar plot tridhjetë e gjashtë vjet, por sipas kalendarit hënor ai do të ketë marrë zekat plot tridhjetë e shtatë herë.

Kjo dhe sa e sa urtësi të tjera janë arsye të forta për sa i përket zgjedhjes së kalendarit hënor për organizimin e adhurimeve.

## D. Agjërimi në pole

**Pyetje:** *A ka Islami, që është një fe universale, një zgjidhje edhe në lidhje me se si duhet të mbahet agjërimi në vende ku dita me natën shfaqin ndryshime në shfaqjen e tyre, siç është rasti në pole?*

**Përgjigje:** Islami është fe universale. Prandaj, ajo ka medoemos një zgjidhje të vlefshme për çdokënd dhe në çdo vend për sa i përket

të jetuarit të fesë. Besimtarët që jetojnë në vende të tilla ku netët dhe ditët ndonjëherë zgjasin me muaj, për të organizuar kohët e tyre të adhurimeve, duhet të ndjekin si rregull kohët e vendit që kanë më afër. Për shembull, nëse jeton në një vend që nata zgjat plot tre muaj, atëherë ata do të marrin për bazë oraret e vendit më të afërt ku është e mundur falja e të pesë kohëve të namazit. Dhe kështu do të përmbushë detyrimin e tij të faljes së namazit.

Mbi këtë çështje është ndalur gjerësisht, që nga Imam Shafiu e deri më sot, por duke qenë se nuk ka pasur raste konkrete, ajo nuk është trajtuar imtësisht në librat e jurisprudencës islame. Por, kur Islami të arrijë gjer në pole dhe të shtohet numri i njerëzve që falin namaz dhe agjërojnë në ato vende, atëherë do të hapen edhe më shumë diskutime në lidhje me këtë çështje.

## E. Lidhja e djajve gjatë Ramazanit

**Pyetje:** *Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem) thotë: “Kur hyn Ramazani i bekuar, hapen portat e qiejve (sipas një transmetimi, ‘portat e Parajsës’), mbyllen portat e Ferrit dhe djajtë lidhe me zinxhirë.”*<sup>209</sup> *Mirëpo, ndodhitë, si rënia e yjeve, apo fenomene të tjera që janë tregues të goditjes me gurë të djajve,*<sup>210</sup> *të cilët lëvizin lirisht, ne i vërejmë edhe gjatë muajit të bekuar të Ramazanit. Si mund ta shpjegojmë këtë situatë?*

**Përgjigje:** Ashtu si njerëzit, edhe djajtë janë të ndarë në disa lloje klasash. Sipas botës së tyre, disa syresh drejtojnë shtete, disa të tjerë janë falltarë. Ata që bëjnë parashikime ngjiten deri në portat e qiellit dhe prej andej përpiqen t’u sjellin falltarëve lajme nga e panjohura. Këta janë djajtë që bombardohen nga meteorët. Kurse djajtë që bëhen fatkeqësi e njerëzve janë më shumë ata djaj inatçorë, të cilët quhen ndryshe si “*djajtë inatçorë*”. Pikërisht këta të fundit janë djajtë që lidhen

<sup>209</sup> Buhariu, *saum* 5; Darimi, *saum* 53.

<sup>210</sup> Buhariu, *saum* 5; Muslim, *sijam* 1.

gjatë muajit të Ramazanit. Puna kryesore e tyre është që të vënë në lëvizje dëshirat dhe epshet e njerëzve. Njerëzit u thonë njëri-tjetrit, “*përse e lidh veten*”, kur nuk i kënaqin dot dëshirat e tyre njerëzore, apo kur e japin veten pas tyre. Pikërisht këtë pjesë të djajve Zoti e lidh. Kjo është arsyeja që besimtarët kanë më shumë kontroll mbi vullnetin. Me pak fjalë ata e durojnë dhe e përballojnë çdo lloj vështirësie që mund të lindë gjatë agjërimit, pa njohur të nxehtë apo të ftohtë të motit, uri, etje...

Një çështje tjetër është edhe kjo: çasti që djalli i kanoset njeriut më së shumti është çasti kur njeriu i afrohet Allahut më së shumti. Prandaj edhe ju vijmë në mendje të gjitha planet dhe programet e punëve pikërisht në kohën që filloni të falni namazin. Çështjet më të ndërlikuara i zgjidhni në namaz. Kjo është më se e qartë, që kjo është një bëmë e shejtanit. Ndërsa agjërimi është një adhurim që Allahu e ka cilësuar duke thënë: “*Agjërimi është për Mua, shpërblimin për të e jap Unë.*”<sup>211</sup> Të përziësh një adhurim kaq të pastër, të kulluar dhe të qashtë, i cili tregon lidhjen e besimtarit me Zotin, kjo është diçka që vetëm djalli mund ta bëjë, madje duke marrë edhe kënaqësi prej kësaj.

## F. Ramazani: Një mysafir me naze

**Pyetje:** *Pothuajse në të gjitha shkrimet tregohet se Ramazani vjen si një mysafir me naze. Çfarë do të thotë që Ramazani të jetë me naze?*

**Përgjigje:** Shfaqja me naze është një nga format e prezantimit dhe shprehjes së vetes. Njësoj si qasja gjithë naze e fëmijëve ndaj nënës apo babait, apo e njerëzve me njerëzit që duan në përgjithësi. Nazet kanë një farë kuptimi kur ka dashuri mes atij që i bën nazet dhe atij që i pret. Kështu e shpreh veten ai që i bën ato, e ai që i pret nuk ankohet për to nga dashuria. Madje kjo bëhet shkas për shtimin e dashurisë dhe

<sup>211</sup> Buhariu, *teuhid* 35; Muslim, *sijam* 160.

interesimit ndërmjet tyre. Dhe ja, edhe muaji i Ramazanit, në sytë e besimtarit është si një mysafir me naze. Bën çdo gjë që të ai të mos ikë dhe t'ia fitojë zemrën me çdo kusht.

Ramazani i bekuar është një muaj i faljes, që e afron robin besimtar me Allahun. Ne nuk mund ta dimë me plot kuptimin e fjalës se si është cilësia e tij në ahiret, në botën e shëmbëlltyrave apo në botën e varrit. Por ai ka një gjuhë të vetën, me të cilën shprehet. Edhe besimtarët përpiqen që ta shprehin me gjuhën e tyre se si e vlerësojnë praninë e një muaji si ai. Në jetën e përditshme ai do të dëshmojë në dobi të besimtarëve, madje edhe do të ndërmjetësojë për ta. Parë nga ky këndvështrim, besimtari, sa më shumë që ta kënaqë muajin e Ramazanit - nëse lejohet të shprehemi kështu - aq më i fituar do të dalë. Prandaj, mendimi i Ramazanit si një mysafir që duhet të trajtohet me gjithë të mirat është një mendim i rëndësishëm i vlerësimit të tij.

Në të vërtetë, jo vetëm Ramazanin, por ne duhet t'i konsiderojmë si mysafirë të rëndësishëm të gjitha gjërat që Allahu i ka caktuar si detyrim për ne dhe ne tregojmë respekt për to. Njësoj siç engjëjt ndërrojnë turnin e detyrës në namazin e sabahut dhe të ikindisë, dhe dëshmojnë pranë Allahut - nëse i keni falur namazet - edhe adhurimet dëshmojnë në dobinë ose dëmin tuaj sipas gjuhës së tyre. Nga kjo pikëpamje, çdo besimtar adhurimet duhet t'i pranojë si mysafirë me naze e që kërkojnë të trajtohen mirë dhe të bëjë çdo përpjekje për t'i pritur më së miri, në mënyrë që t'ua fitojë zemrat.

## G. Përgatitjet për në Ramazan

***Pyetje:** Thuhet se për adhurimin e namazit ka një varg përgatitjesh, siç janë abdesi, ezani, kameti etj... A mund ta mendojmë edhe për muajin e Ramazanit diçka të këtillë duke pasur parasysh muajt paraardhës, Rexhepin dhe Shabanin, si dhe netët e mira që janë në ta?*

**Përgjigje:** Ramazani i bekuar është i treti i tre muajve të bekuar. Një mendim i këtillë ekziston paksa edhe prej faktit që ai nuk



është caktuar, as i pari, as i dyti, por i fundit. Bashkë me hyrjen në muajin e Rexhepit besimtarët ndiejnë sikur hyjnë në një atmosferë të veçantë shpirtërore. Dhe kjo atmosferë bëhet sa vjen e më e dendur, kur i afrohemi Ramazanit. Sidomos në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit, ajo arrin pikun dhe atje njeriu thuhet se kthehet në një engjëll. Largohet nga çdo kënaqësi trupore dhe u kushtohet vetëm adhurimeve. Për ta arritur këtë majë, duhen vlerësuar më së miri muajt Rexhep dhe Shaban, si edhe ditët dhe netët e mira në këto muaj, në mënyrë që të përfitohet në maksimum nga drita dhe begatia e tyre.

Si përgatitje për muajin e Ramazanit, Profeti ynë (paqja qoftë mbi Të) i ka shtuar, si agjërimet, ashtu edhe adhurimet e tjera, së bashku me hyrjen e muajit të Rexhepit. Sidomos gjatë muajit të Shabanit, Ai e kalonte duke agjëruar pothuajse të gjithë muajin. Kjo sjellje e Profetit tonë është tejet e rëndësishme, nëse do të kemi parasysh dimensionin e mësimin që na jep. Nëse e ka kuptuar vlerën e Ramazanit, atëherë, pa dyshim, besimtari do të bëjë çmos që të jetë sa më i përgatitur për të, duke e përgatitur botën e vetë të zemrës, që ajo të jetë sa më afër atmosferës së Ramazanit. Dhe një Ramazan i pritur kësëmënyre, duke u përgatitur materialisht dhe shpirtërisht, pa dyshim që do të vijë i ndryshëm. Ne do ta shohim me sytë tanë dhe do ta ndiejmë vetë në jetën e përtejme se si e kemi vlerësuar ditë-ditë çdo muaj të Ramazanit. Atje do t'i njohim të gjitha, agjërimet e mbajtura, teravitë e falura, lodhjen e teravive, qëndrimin të etur e të uritur... Ato do të na shfaqen përpara syve në botën tjetër, sipas dimensioneve të asaj bote. Ata që përpiqen që t'i vlerësojnë sa më drejt, si Ramazanin, ashtu edhe adhurimet e tjera, jo vetëm që do të jenë të kënaqur në këtë botë me nderimin nga ana e Allahut e veprimeve të tyre, por edhe atje do të jenë më se të kënaqur, kur të shohin nderimin me shpërblimet për ato vepra.

## H. Pritja me dëshirë të paduruar të Ramazanit të ardhshëm

**Pyetje:** *Si duhet ta konsiderojmë mendimin mbizotërues në kulturën tonë, që sa përfundon muaji i Ramazanit, njerëzit thonë 'mbetën edhe njëmbëdhjetë muaj nga Ramazani i ardhshëm'?*

**Përgjigje:** Nisur nga ambienti kulturor ku janë rritur njerëzit, një mendim i këtillë është kthyer në një pjesë të moralit të popullit tonë. Natyrisht, i këtillë duhet të jetë mendimi i çdo besimtarit që i ka besuar Allahut me gjithë zemër. Kur ky është karakteri i përgjithshëm i një shoqërie të tërë, atë të këtillë do ta shprehin edhe disa njerëz që edhe mund të mos e besojnë vërtet këtë mendim.

Ikja e Ramazanit mund t'i përngjasojë paksa përcjelljes së të rinjve, kur nisen për në ushtri. Madje pas djalit që ikën ushtar derdhen edhe lot, bëhen lutje, që ai të kthehet sa më shpejt dhe shëndoshë e mirë. Ndihet një trishtim dhe mall i gjithkrahshëm, prapëseprapë njeriun e mban në këmbë shpresa që, një ditë, ata do të takohen sërish me të. Dhe ja, edhe Ramazani do të vijë sërish pas pak më pak se njëmbëdhjetë muaj më vonë. Sërish bashkësitë e besimtarëve do të bëhen tok për të falur teravitë, do të mbahet sërish agjërim, të gjithë miqtë, të varfër dhe të pasur do të mblidhen në sofra të gëzuara dhe ngado do të vijnë meloditë e ëmbla të leximit të Kuranit.

Ramazani është një muaj që Allahu e ka caktuar veçanërisht për besimtarët. Në veçanti gjatë këtij muaji Allahu u qaset besimtarëve me mëshirë dhe falje. Shpëton mjaft njerëz nga zjarri i Xhehenemit dhe për shumë të tjerë e bën Xhenetin të domosdoshëm. Në këtë këndvështrim, Ramazani është një muaj që kurrsesi nuk duhet humbur, por duhet trajtuar dhe vlerësuar me ndjeshmërinë më të lartë. Edhe afrimi i besimtarëve me Allahun është i tjetërfartë gjatë këtij muaji. Kjo është edhe arsyeja pse besimtarët ndiejnë trishtim me mbarimin e muajit të Ramazanit dhe besojnë se nuk do të ketë asgjë që do ta mbushë dot

boshllëkun që ka lënë ikja e këtij muaji. Sepse asnjë agjërim tjetër nuk e zë dot vendin e agjërimin të mbajtur gjatë Ramazanit. Njeriu fiton shpërblime, nëse çohet gjatë natës dhe fal njëzet rekate namaz, por ky namaz nuk e zë dot vendin e teravive që falen gjatë muajit të Ramazanit. Teravitë kanë një vlerë të veçantë të vetën. Ato janë një amanet që na e ka lënë Profeti ynë i Nderuar (pqmT).

Megjithatë, mendimi i pritjes i shprehur në pyetje është i vlefshëm edhe për të gjitha adhurimet e tjera. Teksa përshkruhen shtatë kategoritë që do të ndiejnë freski edhe në mes të nxehtësisë në ditën e gjykimit, thuhet se në një prej tyre bëjnë pjesë të gjithë “*ata që janë të lidhur me zemër me faltoret*”.<sup>212</sup> Domethënia e kësaj është kjo: Ai e ka falur namazin dhe ka dalë nga faltorja, por kënaqësia që ka marrë nga namazi e bën atë të ndihet njëfarësoj që kur do t’i mbarojë të gjitha punët dhe të rikthehet sërish aty, për të falur namaze të tjera. I kujtohet qëndrimi i tij gatitur e me duart lidhur përpara Allahut, përkuljen e tij në ruku dhe rënien në sexhde dhe se si ia zbraz Allahut shpirtin në sexhde, e kjo e bën ta kaplojë emocionin e veçantë, që nuk mund të shprehet veçse me fjalët: ‘Kur do të vijë koha tjetër e namazit, që të vij sërish t’i drejtohem Zotit!’ Kështu mund ta kuptoni edhe më mirë mendimin e Profetit tonë të Nderuar (sal’lallahu alejhi ues’sel’lem) për një nga veprat e besimtarit, e cila ia fshin mëkatet dhe i ngjit shkallët besimtarit, që është «*vënia në pritje për namazin e radhës, pasi ke falur një nga namazet*».<sup>213</sup> Po në këtë kategori mund të përfshini edhe ata besimtarë që kryejnë adhurimin e haxhit dhe prapëseprapë, nuk e harrojnë dot kënaqësinë e marrë nëpër ato vende të bekuara dhe bëjnë çdo përpjekje për t’u rikthyer sërish vitin ardhshëm.

Si përfundim, me mendimet e sipërpërmendura çdo besimtar ndien një farë trishtimi me mbarimin e muajit të Ramazanit, ndien një mall dhe dëshiron që Ramazani të rikthehet edhe njëherë një orë e më parë.

<sup>212</sup> Buhariu, *ezan* 36; Muslim, *zekat* 91.

<sup>213</sup> Muslim, *taharet* 41; Tirmidhi, *taharet* 39.

## I. Ta ndiesh të gjithë Ramazanin me tërë thellësinë e vet

***Pyetje:** Si duhet të jesh i pajisur, që ta ndiesh Ramazanin me tërë thellësinë e vet?*

**Përgjigje:** Ta ndiesh Ramazanin me tërë thellësinë e vet është e lidhur paksa edhe me thellësinë e njeriut që përpiqet ta ndiejë atë. Cilido që të jetë niveli në të cilin e ndien Ramazanin, njerëzit nuk duhet të gjykojnë se si e jetojnë atë. Edhe pse mund të mos konsiderohet thellë, dikush që agjëron, fal teravitë, i fiton shpërblimet e tyre dhe çlirohet nga përgjegjësia e tyre. Por shpërblimet që do të fitojë do të jetë sipas thellësisë së mendimeve të veta. Nga ana tjetër, dikush që i përmbush këto me vetëdije të plotë, do ta marrë të shumëfishtë shpërblimin e kësaj, si në këtë botë, ashtu edhe në tjetrën.

Patjetër, çdokush që e mban agjërimin dhe i fal teravitë, në një formë apo në tjetrën, pa diskutim, do ta marrë shpërblimin e tyre. Por, kur ky është një muaj që Allahu u shpërndan dhuratat të gjithë njerëzve, pse ai të mos shfrytëzohet në mënyrën më rentabël të mundshme? Pse të gjitha privimet dhe vështirësitë e përbaluara gjatë këtij muaji të mos kthehen në kallinj që japin një me njëmijë!

Kryerja në këtë mënyrë, kryesisht e të gjitha adhurimeve, është shenjë dalluese e një myslimani fatlum. Në një farë mënyre ne jemi myslimanët fatkeq të një epoke fatkeqe. Ka një sërë burimesh të ndryshme nga ushqehet njeriu shpirtërisht. Kur ushqehet nga këto burime, besimtari bëhet një njeri që e jeton Islamin plot e përplot. Dhe në krye të këtyre burimeve vjen familja. Ne po jetojmë në një periudhë të atillë që familjet tona - edhe pse ndoshta jo të gjitha, por shumica - mund të konsiderohen injorante për sa i përket përkapjes së shpirtit të fesë dhe të jetuarit të saj. Fatkeqësisht, Islami nuk jetohet me tërë thellësinë e vet nëpër familje. Për rrjedhojë, fëmijët e rritur nëpër këto familje formohen larg shpirtit të fesë. Edhe nëse mund t'i kryejnë adhurimet, ata nuk i ndiejnë dot ato thellësisht, por mbeten të mbërthyer

pas formës dhe dukjes. Në fakt, edhe rruga nuk ka shumë dallim nga familja. Madje rruga është edhe më e pamëshirshme. Ajo ia rrëmben fëmijës edhe atë pak kulturë fetare gjysmake, të cilën e ka marrë në familje. Jam shumë i mërzitur që e them këtë, por xhamitë janë kthyer në vende ku çdo gjë që kryhet nuk është më shumë sesa një formalitet. Të mos vijmë te shkollat, të cilat janë më se të varfëra në dimensionin shpirtëror dhe nuk u ka mbetur më asgjë që mund t'ua japin fëmijëve.

Këto, nisur edhe nga funksioni kryesor i tyre, janë vendet ku njeriu ushqehet shpirërisht. Po, fëmija duhet të ushqehet mirë edhe në familje, në rrugë duhet të ketë shokë të mirë, kur të shkojë në xhami, duhet të shohl që feja jetohet thellësisht, por ai duhet të marrë një farë ushqimi shpirtëror edhe nga shkolla, në mënyrë që të mund të bëhet mysliman. Sa keq që pothuajse në të gjitha këto burime është duke u përjetuar një ngrirje paralizuese. Për rrjedhojë, besimtari që nuk është i ushqyer nga të gjitha këto burime nuk mund ta jetojë muajin e Ramazanit me të gjithë thellësinë e vet. Tani, pasi e përcaktuam problemin, le të ndalemi për pak edhe mbi çështjen se çfarë mund të bëjmë në lidhje me zgjidhjen e tij.

Me vend do të ishte luajtja paksa me formatin, në mënyrë që të kapërcehet disi kjo ngrirje paralizuese që ka prekur burimet, por edhe për ta shpëtuar jetën fetare nga formalitetet. Për shembull, shoqëria mund të përfshihet në një diskutim të gjerë mes veti dhe të thotë: “Ejani, këtë Ramazan ta lexojmë Kuranin pak më ndryshe. Teksa e lexojmë në gjuhën arabe nga njëra anë, të ndalemi paksa edhe te kuptimi në gjuhën tonë, por edhe te tefsiri i atyre ajeteve. T’i japim fjalën njëri-tjetrit, që t’i falim teravitë me *hatme*. Dhe teksa falim teravitë, të dërgojmë salavate plot kumbim, të lexojmë libra lutjesh si *Xheusheni* dhe *Eurad-i Kudsije*. Të bëjmë gjithçka që është e nevojshme, vetëm ta ndiejmë pak më thellë praninë e Ramazanit.” Zaten e pëlqyeshme për teravitë është që të ulesh e të lexosh diçka sa koha e faljes së namazit pas çdo dhënieje të selamit. Nëse falni dy rekat, aq kohë sa duhet për të falur dy rekate, nëse falni katër rekate, aq kohë sa për katër rekate, të uleni dhe të lexoni diçka. Do ta mbani vazhdimisht të gjallë dhe të fortë atë ndienjë duke lexuar

çdo ditë nga një lutje të re. Do t'i ushqeni adhurimet e kryera përditë duke ua ndryshuar atyre nga pak ngjyrën dhe motivet.

Pra, bashkësitë mund të merren vesh dhe të bëjnë një diskutim të tillë. Vetëm se kur ta bëjnë këtë, ata duhet të tregohen të kujdesshëm që të mos i ngarkojnë njerëzit me përgjegjësi të rënda, të cilat do të jenë të papërballueshme për ta. Ata mund të bien dakord në një masë që do ta vërë paksa në vështirësi egon, por nuk do t'i fusë njerëzit në pesimizëm; t'i marrin ato përgjegjësi përsipër dhe me sa të mundin, t'i jetësojnë.

Për shembull, mund ta lexojmë që gjatë ditës kuptimin e ajeteve që do të këndojmë gjatë faljes së teravive. Kësisoj, në vend që të kaplohemi nga gjithfarë mendimesh që i përkasin kësaj bote, gjatë faljes së namazit, në mendje të na vijnë e të ndalemi të paktën te domethëniet e atyre ajeteve.

Një anë tjetër e çështjes është edhe kjo: teravitë nuk duhet të falen me mendimin që ejani t'i falim e t'i përfundojmë sa më shpejt dhe të shohim secili punën e vet, por t'i kryejmë ato duke i ndjerë në shpirt. Shumë njerëz përpiqen që t'i falin dhe t'i kryejnë teravitë sa më shpejt, madje për këtë, ata zgjedhin edhe suret dhe ajetet më të shkurtra. Çfarë dallimi ka nga ushtrimet gjimnastikore një namaz i këtillë? Namazi do të falet për Allahun e Madhërishëm, në mendje do të silltet vetëm Ai Lartësi e lartësive në çdo pjesë të namazit, do të kryhet me edukatën dhe principet që kërkon të qenët përpara Tij, nuk do të bëhet asgjë që e prish këtë prani dhe do të shmanget çdo sjellje apo qëndrim që ndikon për keq në atë atmosferë. Kurani i lexuar shpejt e shpejt ku nuk kuptohet asgjë, rukutë dhe sexhdet e përbëra veçse nga ulje-ngritje të shpejta e të njëpasnjëshme, nuk i kanë kurrresi hije të qenit përpara Allahut. Ashtu siç leximi dhe këndimi në këtë mënyrë vështirë se mund të quhen lexim apo këndim, edhe namazi i falur vështirë se mund të quhet namaz.

Me pak fjalë, në mënyrë që njeriu ta ndiejë Ramazanin me tërë thellësinë e vet, njeriu duhet ta fitojë njëherë brenda vetes atë thellësi.

## J. Agjërimi me besim

**Pyetje:** Në një hadith të bekuar thuhet: “Kushdo që e mban agjërimin duke besuar dhe duke e pritur shpërblimin vetëmse nga Allahu, atij i falen të gjitha mëkatet e shkuara.”<sup>214</sup> Po si duhet ta kuptojmë ne frazën, “... me besim dhe duke e pritur shpërblimin vetëmse nga Allahu”?

**Përgjigje:** Me këtë hadith të bekuar Profeti ynë i Nderuar (ekmelut’tehaja) na ka dhënë sihariqin se do t’i falen të gjitha mëkatet e shkuara kujtdo që beson plotësisht te begatia që vjen bashkë me Ramazanin, e mban agjërimin me sinqeritet dhe përzemërsi dhe e vlerëson këtë muaj me të gjitha adhurimet dhe devotshmërinë e nevojshme dhe shpërblimin e pret vetëm e vetëm nga Allahu.

Me fjalën “besim” në këtë ajet nënkuptohet besimi te çdo gjë që është për t’u besuar dhe mbi të gjitha besimi pa kurrfarë dyshimi a lëkundjeje e me gjithë zemër te të gjitha urdhëresat fetare në lidhje me agjërimin; që agjërimi është *farz*, për të cilin ka një shpërblim mjaft të madh dhe mbi të gjitha, që përbën një shkas për fitimin e kënaqësisë hyjnore.

Po, sepse ne jemi robërit e Allahut; Allahu është i adhurueshmi ynë. Ato çfarë kryejmë ne kundrejt Tij janë e drejta e Tij dhe detyrë e përgjegjësi e jona. Ai është në dijeni të adhurimeve tona dhe di çdo gjë që bëjmë ne. Të gjitha bëmat tona, të cilat Allahu i sheh dhe i di, do të vijë koha dhe do të na kthehen neve në trajtën e pemëve që japin fryte. Veç kësaj, kur ne ngremë duart dhe i drejtohem Atij, siç thuhet edhe në një hadith kudsî, “nuk do të kthehen duarbosh duart e hapura që i drejtohen Atij.”<sup>215</sup>

Kur i drejtohem Allahut dhe i lutemi e i përgjyerohem, para së gjithash duhet të besojmë plotësisht që Ai i sheh robërit e Tij, ua dëgjon lutjet dhe ka gjithë fuqinë që t’ua realizojë dëshirat dhe kërkesat.

<sup>214</sup> Buhariu, *iman* 28; Muslim, *salatu’l-musafirin* 176.

<sup>215</sup> Tirmidhi, *daauat* 104; el-Bezzar, *el-Musned* 6/479; et-Taberani, *el-Mu’xhemu’l-kebir* 12/423.

Përndryshe, hapja e duarve fiton një kuptim, sikur “po ma dha ma dha, po nuk ma dha nuk ma dha”, e kjo është edhe mungesë respekti, por edhe dihet që një thirrje e këtillë nuk është as e denjë për të marrë një përgjigje. Ai, me mirësinë dhe bujarinë e Tij dhe duke qenë se mëshirën e ka më të gjerë sesa ndëshkimin, mund t’u japë edhe të tillëve; ne nuk mund të themi që nuk u jep. Por, nisur nga dimensionin ynë, kushti i parë që Ai t’i pranojë lutjet tona është besimi tek Ai me gjithë zemër. Kur besimtari i ngre duart lart me sinqeritet, Allahu nuk i kthen pas lutjet e tij, nuk e nxjerr të turpëruar atë; përkundrazi, e trajton atë me mirësi, në mënyrë që ai të dojë t’i drejtohet asaj porte edhe njëherë tjetër. Ky është kuptimi i kushtit “*duke besuar*” të shprehur në hadith.

Ndërsa, fraza “*duke e pritur shpërblimin vetëm nga Allahu*” do të thotë ta shpresosh çdo shpërblim nga mëshira e Tij, duke mos pasur kurrfarë pritmerie dhe duke pasur parasysh vetëm e vetëm kënaqësinë e Tij. Në punët e mira dhe në adhurime nuk duhet të ketë asgjë që bie ndesh me sinqeritetin dhe përzemërsinë; njeriu nuk duhet të bjerë, as në vetëpëlqim, as në dëshirën për t’u dukur. Asnjë bëmë, asnjë punë, nuk duhet të ngrihet mbi vlerësimin dhe duartrokitjet e njerëzve; çdo gjë duhet të bëhet për Allahun dhe prishmëritë duhet të jenë vetëm e vetëm nga Allahu. Edhe në ato pritmeri, përpjekja për t’i arritur ato duhet të mbahet përherë shumë e lartë; punët e bëra nuk duhet të varen nga dobite e kësibotshme që mund të sjellin. Duhet të bëjmë çdo përpjekje për punët që bëjmë, ta përdorim siç duhet vullnetin, por, tekefundit, rezultatit e çdo gjëje duhet ta presim vetëm nga Allahu. Teksa ia paraqesim Allahut robërinë tonë, nuk duhet ta nxjerrim asfare nga mendja se i Adhuruari është Ai, ndërsa ne jemi thjesht robërit e Tij; ne duhet ta përmbushim robërimin tonë vetëm sepse kjo është e drejta e Tij. Prandaj ne nuk duhet t’i lidhim adhurimet me nevojat dhe dëshirat tona, por t’i kryejmë ato sepse janë një detyrim që kemi ndaj Krijuesit.

Në vetvete, as kërkimi i diçkaje nga Allahu nuk është një e drejtë e jona; ajo është më shumë si një e drejtë mirësi, që na e ka falur po Ai. Ai bën aq shumë mirësi, sa që na ka dhënë neve edhe një të drejtë si kjo, që



ne të mund të kërkojmë prej Tij. Njëfarësoj Ai na ka thënë: “Më adhuroni dhe përmbusheni robërinë tuaj me devotshmëri - kjo është detyra juaj - që Unë t’ju gëzoj ju edhe më shumë me mirësitë marramendëse që do t’ju fal në botën tjetër.” Pra, ka bërë një marrëveshje me ne duke na dhënë disa të drejta. Është Ai që na ka falur të drejtën të lutemi dhe është Po Ai që do ta japë mundësinë e asaj për të cilën jemi lutur.

Tekefundit çfarë kemi ne në natyrën tonë, apo sa është kapitali që kemi nga rrisku që na ka falur Zoti, që ne të kemi ndonjë të drejtë vetanake tonën! Ne, kryekëput dhe me çdo gjë tonën i përkasim vetëm Atij dhe edhe pse kemi ndonjë të drejtë, të cilën na e ka falur po Ai, ne jemi para së gjithash robërit e Tij. Kështu që ne duhet të sillemi siç i ka hije robërisë dhe duhet të kërkojmë vetëm e vetëm kënaqësinë e Krijuesit dhe Furnizuesit tonë të vërtetë, Zotit. Edhe adhurimet, me këtë synim duhet t’i kryejmë. Ja pra, edhe fraza “duke e pritur shpërblimin”, thekson se agjërimi duhet të mbahet vetëm për Allahun dhe domosdoshmërinë që shpërblimin ta presë vetëm e vetëm nga Ai.

## K. Darkat gjithë madhështi të iftareve

**Pyetje:** Vitet e fundit, kur thua Ramazan, në mendje të vijnë të parat sofrat gjithë madhështi të iftareve dhe programet me nuancat e spektaklit. Mirëpo, në shkrimet për Ramazanin tregohet më shumë horizonti i qetësisë, thellësisë dhe finesës. Në mënyrë që të bëhet shkas për afrimin me Allahun, Ramazani duhet të jetohet si spektakël, apo duhet të jetë më shumë i drejtuar kah vetja dhe i karakterizuar nga qetësia?

**Përgjigje:** Në jetën e tij personale njeriu duhet të zgjedhë të jetë pa dëshirë për t’u dukur dhe pa madhështi. Ai duhet të jetë i thjeshtë dhe i përkorë. Le ta shohin sikur nga çasti në çast do të bjerë e do të rrëzohet njerëzit që e shohin nga jashtë. Por në botën e tij të brendshme ai duhet të ketë një forcë drejtqëndrimi aq të fortë - sa që ta zëmë - sikur një nga pllakat e qiellit të shkëputet e të rrëzohet, ai prapëseprapë do të dijë të

qëndrojë në vend dhe i palëkundur. Aq i shëndoshë dhe i fortë duhet të qëndrojë, si për sa i përket anës shpirtërore, ashtu edhe ndjeshmërive të tij hyjnore. Kjo është thelbësore për ne. Njësoj si Sulltan Ahmeti, i cili, teksa ndërtohej xhamia që mban sot emrin e tij, mbante në rrobën e tij gurë dhe thoshte: “O Zot! Pranoje këtë shërbim të vogël të Ahmetit Tënd të vogël!” - edhe ne të jemi brenda vetes po kaq madhështisht të thjeshtë. Ne kështu e shohim egon tonë, edhe sikur të bëhemi shkas për punë shumë të rëndësishme, që do t'i lëviznin vendit edhe botët. Thënia, “*Egoja është më e ulëta se çdo gjë, detyra është më e mira se çdo gjë!*”<sup>216</sup> - është thelbësore për ne. Përherë në këtë bosht duhet të jenë të gjitha sjelljet që ne shfaqim ne jetën personale.

Megjithatë, nëse mendojmë t'ua paraqesim edhe të tjerëve botën tonë të ndjenjave dhe mendimeve, këtu duhet të ndjekim një metodë pak më ndryshe. Para se t'i njohim ata me botën tonë, më parë jemi ne që ndoshta duhet të hedhim një hap drejt botës së tyre. Të shkosh me këto argumente te njerëzit që nuk janë mësuar ende me vlerat e thjeshtësisë, përkorjes dhe modestisë së ngopjes së barkut edhe me një pjatë supë dhe të vetëmjaftimit edhe me disa hurma të thata, mund të krijonte tek ata një efekt të përkundërt me qëllimin. Prandaj, këta njerëz duhet t'i mirëpresim në një hapësirë të denjë pritjeje dhe jo në çadra, ndaj mund të duhet që t'u shtroni atyre një darkë të denjë dhe atje të përfaqësoni vlerat tuaja. Këtu fiton përparësi çështja e socializimit dhe shprehjes së vetes.

Po, sikur të mund t'u shpjegojmë atyre njerëzve diçka me këto mënyra, prapëseprapë ia vlen, sikur me dhjetëra herë t'u shtrojmë darka, me dhjetëra herë të organizojmë spektakle, me dhjetëra herë të organizojmë udhëtime me ta. Nëse ne ia dalim që të çelim sado pak ndonjë portë nga ku mund t'i njohim ata me vlerat tona shpirtërore, ne duhet medoemos t'i vlerësojmë siç duhet këto mundësi dhe të mos e anashkalojmë gjasat për të zbrazur në zemrat e diçka prej frymëzimeve të shpirttrave tona.

Thënë ndryshe, në jetën personale thjeshtësia, përkorja, modestia

<sup>216</sup> Shih: Bediuzaman Said Nursi, *Rrezet*, fq. 424 (Rrezja e Katërmbëdhjetë).

dhe largimi prej egoizmit duhet të jenë secila nga një kriter i qenësishëm, por kur vjen puna te njohja e të tjerëve me vlerat tona, duhet që të përcaktohet mjaft mirë se çfarë duhet bërë duke vlerësuar kushtet dhe nëse është e nevojshme, i gjithë Ramazani të kalohet nën atmosferën e një feste madhështore.

**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**